



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë e**  
**Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”**

**Tiranë, Shtator 2023**

<b>Nr.</b>	<b>PËRMBAJTJA:</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>3-11</b>
a.	Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit	3
b.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-8
c.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	8-11
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>12-14</b>
<b>1</b>	Titulli	12
<b>2</b>	Marrësi	12
<b>3</b>	Objektivat dhe qëllimi	12
<b>4</b>	Identifikimi i çështjes	13
<b>5</b>	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
<b>6</b>	Përgjegjësitë e audituesve	13-14
<b>7</b>	Kriteret e vlerësimit	14
<b>8</b>	Standardet e auditimit	14
<b>9</b>	Metodat e auditimit	14
<b>10</b>	Dokumentimi i auditimit	14
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>15-143</b>
<b>1</b>	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	15-16
<b>2</b>	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	16-143
<b>2.1</b>	<b>Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm</b>	16-18
<b>2.2</b>	<b>Mbi zbatimin e procedurave ligjore në fushën e administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara me vendim gjykate</b>	<b>18-143</b>
2.2.1	Mbi përdorimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara	18-22
2.2.2	Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për administrimin e asetëve të marra në dorëzim dhe mënyra e menaxhimit të tyre nga administratorët	22-57
2.2.3	Mbi vendimmarrjen dhe procedurat e ndjekura nga administratorët në lidhje me dokumentacionin dhe të dhënat e regjistruara pranë QKB-së, në funksion të administrimit të drejtëpërdrejtë të shoqërive tregtare	57-64
2.2.4	Mbi administrimin e pasurive të luajtshme dhe llogarive bankare	64-67
2.2.5	Mbi kontrollin fizik të pasurive në terren	67-74
2.2.6	Për zbatimin e procedurave të dhënies me qira të objekteve, dhënies në përdorim dhe kalimi në pronësi institucioneve shtetërore	74-117
2.2.7	Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për dorëzimin e pasurive të revokuara	117-126
2.2.8	Mbi procedurat për tjetërsimin/shitjen e pasurive të konfiskuara me vendim gjykate	127-136
2.2.9	Mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të KNMKKO	136-143
<b>2.3</b>	<b>Mbi menaxhimin financiar dhe ligjor të fondeve buxhetore të përdorura nga AAPSK</b>	<b>143-192</b>
2.3.1	Mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	143-153
2.3.2	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit	154-171
2.3.3	Mbi përputhshmërinë ligjore në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin financiar	171-183
2.3.4	Mbi përputhshmërinë ligjore në përgatitjen e procedurave të inventarizimit	183-187
2.3.5	Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm	188-192
<b>2.4</b>	<b>Të tjera</b>	<b>192-226</b>
2.4.1	Mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës me stafin e punësuar me kontratë “administratorët” si dhe procedurat e krijimit dhe administrimit të dosjeve të personelit	192-200
2.4.2	Mbi shpërndarjen dhe përballimin e shpenzimeve të administrimit që lindin nga pagesa e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës	201-202
<b>IV</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME</b>	203-223
<b>V</b>	<b>ANEKSE</b>	223-225
<b>VI</b>	<b>LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT</b>	225-226

## I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

### 1.a. Përshkrim i shkurtër i objektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 17/1 prot., datë 11.01.2023, i ndryshuar me shkresën nr. 17/4 prot., datë 26.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri në datë 09.06.2023, në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, u krye auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën nga data 01.10.2017 deri më 31.12.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. E.H, Përgjegjëse Grupi,
2. K.T, Kryeauditues,
3. A.Ç, Audituese,
4. M.V, Audituese.

Auditimi u krye me bazë risku, për vlerësimin e zbatimit të procedurave ligjore në fushën e administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e agjencisë, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

### 1.b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka një sistem elektronik për mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrimit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara (RPSK), por nuk aksesohet nga administratorët për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, duke sjellë për pasojë mungesën e një baze të dhënash për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mangësi në monitorimin e tyre dhe risk të shtuar në keqadministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 33 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe me kërkesat e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.</p> <p>Ky regjistër është instaluar nga AKSHI në vitin 2018 dhe sipas informacioneve të vëna në dispozicion, AAPSK nuk e administron kontratën e lidhur, vlerën e shpenzuar për sistemin dhe mirëmbajtjen e tij, pasi procedura e prokurimit është zhvilluar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Mungesa e kontratës vështirëson ndjekjen, monitorimin e zbatimit të saj dhe vlerësimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale. Mungesa e aksesimit në sistem nga ana e administratorëve nuk ka mundësuar marrjen e informacioneve në lidhje me institucionin, administratorët, numrin dhe datën e vendimit, subjektin, numrin e pasurive të sekuestruara, konfiskuara, revokuara, vendimet gjyqësore që kanë prekur pasurinë, statuset e tyre, kontratat e qirave dhe të ardhurat e shpenzimet e bëra për çdo pasuri, etj. Përgjatë viteve 2018-2022, ky regjistër nuk ka shërbyer për mbikëqyrjen e proceseve, ka shtuar volumin shkresor, ndërkohë që nuk ka mundësuar kryerjen e veprimeve online nga ana e administratorëve. Mungesa e krijimit të një baze të dhënash në lidhje me një informacion të përgjithshëm për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mungesa e regjistrimit dhe monitorimit të të gjithë objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara të dhëna me qira, është tregues i qartë që ky regjistër elektronik nuk ka arritur qëllimin për të cilin është konceptuar dhe ka sjellë shpenzime pa efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit.</p> <p>Nga AAPSK, regjistri i të dhënave është mbajtur në format Excel, i cili ka pasur përdorim të brendshëm, pa i krijuar akses institucioneve që kanë të drejtën e marrjes së</p>	faqe 18-22	E lartë	Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mungesën e aksesimit të regjistrimit elektronik, si dhe të komunikojë me strukturat drejtuese të Ministrisë së Brendshme dhe AKSHI-t me qëllim vënien në përdorim dhe përditësimin e regjistrimit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

	informacionit të drejtpërdrejtë apo statistika raportuese në RPSK, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 14 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020.			
2	<p>a) Nga shqyrtimi i praktikës, në lidhje me procedurat e ndjekura nga administratori në funksion të qiradhënies së pasurisë, rezulton se përpara lidhjes kontratës së qirasë, në një rast, nuk është kërkuar deklaratë me shkrim nga qiramarrësi, ku ky i fundit të deklarojë se nuk ka lidhje me shtetasin të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës. Në këtë rast, administratori ka vepruar në kundërshtim të Rregullores nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25.</p> <p>b) Nga shqyrtimi i praktikës së ndjekur nga administratorët përkatës, rezulton se, në një rast, nuk janë marrë masat për zbatimin e plotë të vendimit të gjykatës. Në informacionin e përgatitur nga administratori citohet ndër të tjera se: subjekti "T.T." me NIPT K.....E nuk mund të merret në administrim pasi ka rezultate negative (mungesë fitimi) dhe për pasojë mund të ketë impakt social negativ...". Vendimi i marrë në mënyrë diskrecionale nga ana e administratorit për të mos marrë një pasuri në administrim rezulton në kundërshtim me nenin 11, pika 2 (a, c) të ligjit nr. 34/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara". Nga ana tjetër, në rastin konkret, justifikimi i fitimit të munguar të subjektit nuk qëndron pasi, sipas ekstraktit të shoqërisë, kjo e fundit ka deklaruar 16,680,084 lekë fitim për vitin 2020 dhe 216,767,616 lekë fitim për vitin 2021.</p> <p>c) Administratori i pasurisë, në lidhje me veprimet e "bllokimit" të pasurive pranë ASHK-së përkatëse, ka vepruar me një vonesë prej më shumë se 8 muaj, nisur nga fakti se emërimi i tij është kryer në datën 29.10.2020 ndërsa kërkesa drejtuar ASHK-së është e datës 28.07.2021. Në lidhje me këto veprime, në kuadrin ligjor rregullator, parashikohet se administratori duhet të veprojë menjëherë. Konkretisht, administratori ka vepruar në kundërshtim neni 11, pika 2/a, e ligjit nr. 34/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara".</p> <p>- Administratori i pasurisë, në lidhje pasurinë "truall 900 m<sup>2</sup>" nga të cilat 300 m<sup>2</sup> ndërtesë, në të cilën kryhet aktiviteti "hotel, restorant, bar-kafe", pasi e ka marrë në dorëzim, i ka lënë administrimin e saj shtetases, e cila është subjekt i vendimit të sekuestrimit. Edhe pse sipas procesverbalit citohet se "këto pasuri i janë lënë në ruajtje..." disponimi i pasurisë në rastin konkret përkon me administrimin e saj. Situata në rastin konkret është në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25, sipas të cilës: "Administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në lidhjen e kontratave të qirasë të pasurive, të kërkojnë deklaratë me shkrim nga personat fizik apo juridik, të cilët do të marrin me qira pasurinë, që nuk kanë lidhje me shtetasit apo subjektet e përfshira në vendimin e gjykatës, të cilëve ju është bërë sekuestrimi apo konfiskimi i pasurisë".</p> <p>d) Nga auditimi i kryer, rezultoi se në 2 (dy) raste, për një kohë të gjatë, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive të paluajtshme, të konfiskuara me vendim gjykatë, konkretisht:</p> <p>-Për pasurinë e konfiskuar me vendimin nr. 4 datë 18.01.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda", për një periudhë 12-vjeçare (2008-2022) nuk është kryer asnjë veprim. Gjithashtu, duke filluar që nga data e emërimit të administratorës së pasurisë 07.09.2022 deri aktualisht (mbylljen e auditimit në terren) edhe pse procedurat paraprake të nevojshme janë kryer, kjo pronë, në tejkallim të afateve (90 ditë), ende nuk i është kaluar për vendimmarje destinimi Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.</p> <p>-Për pasurinë e konfiskuar me vendimin nr. 37 datë 13.07.2021 të GJKKO, për një periudhë 9-mujore pas datës së komunikimit të vendimit të formës së prerë të konfiskimit nuk është kryer asnjë veprim.</p> <p>Moskryerja e veprimeve brenda afatit ligjor rezulton në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 23, pika 2 të ligjit nr. 34/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", çka ndikon negativisht në mirëadministrimin e pasurive përkundër parimit të efektivitetit, eficientës, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.</p> <p>e) Nga auditimi i kryer, konstatohet se pas marrjes në dorëzim të pasurive të paluajtshme, nga ana e administratorit nuk rezulton të jetë kryer një raportim kundrejt kryeadministratorit, gjykatës apo prokurorit të çështjes mbi gjendjen e pasurive. Gjithashtu nuk rezulton e dokumentuar, të jetë kryer ndonjë veprim me qëllim rritjen e vlerës së pasurive duke i dhënë ato me qira, në kundërshtim me nenin 11, pika 2/(ç dhe e) të ligjit nr. 34/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara".</p>	faqe 22-57	E lartë	Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe administratorët të marrin masa për plotësimin e deklaratës me shkrim para lidhjes së kontratës së qirasë; marrjen në administrim në afatet përkatëse; njoftimin e menjëhershëm të masës së sekuestrimit, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; për paraqitjen në afat të pasurive të konfiskuara me vendim gjykatë të formës së prerë pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar; për paraqitjen e raporteve dhe kërkesave në afatet respektive, si dhe sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë.

	<p>f) Nga auditimi i kryer, konstatohet se pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara me vendimin nr. 112 datë 20.07.2020 të GJKKO, nga ana e administratorit, në raportimin kundrejt kryeadministratorit, gjykatës dhe prokurorit të çështjes, ndër të tjera, citohet se: “është kryer ekzekutimi i plotë i vendimit të gjykatës...”. Pavarësisht këtij pohimi, nuk rezultoi të jetë marrë në administrim automjeti me targë A..... Y, i markës “Audi” model A6, në kundërshtim me nenin 11, pika 2/(dh) të ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.</p> <p>g) Pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara, në të gjitha rastet apo praktikave të shqyrtuara nga grupi i auditimit rezultoi se, në asnjë rast, nga administratori i pasurisë së sekuestruar, nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Gjithashtu, nuk rezultojnë të jenë kryer nga administratorët veprime paraprake për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kontrate të vlefshme sigurimi të pasurisë përpara marrjes së tyre në administrim, çka do të justifikonte apo përligjte mosveprimin në rastin konkret, veprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht: Ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18; VKM nr. 687, datë 5.10.2011 “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, kreu VI, pika 2/b; Udhëzimin nr. 324, datë 2.10.2020 “Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave për Administrimin e të Ardhurave dhe Limiteve të Kryerjes së Shpenzimeve për Pasuritë e Sekuestruara dhe Konfiskuara”, kreu II, pika 2/3; Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK-së, neni 17, pika 6.</p>			
3	<p>Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacionit përbërës të tij, në lidhje me dhjetë shoqëri tregtare në administrim të drejtpërdrejtë nga administratorët, u konstatuan disa parregullsi, në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht:</p> <p>a-Në shtatë raste rezultoi se QKB ka regjistruar vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar “Pasqyrat Financiare”, është vendosur gjithashtu edhe për destinimin e fitimit të shoqërisë. Referuar përmbajtjes së vendimeve në fjalë, rezultoi se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është subjekti kundrejt të cilit gjykata ka vendosur masën e sekuestros preventive. Në rastet e sipërcituara, subjektet rezultojnë të kenë kryer një vendimarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë janë subjekt i një vendimi gjykate me të cilin, veç të tjerave, është vendosur sekuestrimi i kuotave/aksioneve duke kaluar këto të fundit në administrim të AAPSK. Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, neni 16, pika 1; ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5;</p> <p>b-Në tre raste rezultoi se nuk është regjistruar bilanci vjetor kontabël për vitin 2021. Nga administratorët përkatës, nuk janë marrë masat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit të të dhënave në regjistrin tregtar sipas përcaktimeve të nenit 22 dhe 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rastin konkret, edhe pse administrimi dhe menaxhimi i shoqërive kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një institucion shtetëror (AAPSK), në zbatim të ligjit nr. 34/2019, neni 19, pika 4, duhet të zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 95, pika 3 (dh) dhe ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3.</p>	faqe 57-64	E lartë	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, administratorët përkatës, në lidhje me shoqëritë tregtare të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë, të merren masa që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendimarrja për administrimin e tyre të jetë e pavarur dhe e pandikuar nga subjekti mbi të cilin rëndon masa e sekuestros apo konfiskimit;</li> <li>- Regjistrimi i bilancit vjetor kontabël pranë QKB-së, të kryhet brenda afateve ligjore.</li> </ul>
4	<p>Nga auditimi i zbatimit të 112 kontratave të qirave për periudhën 01.10.2017-31.12.2022 u konstatua se:</p> <p>-1 kontratë qiraje është lidhur në kundërshtim me nenin 21/a, Kreun III të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, konkretisht kontrata e qirasë nr. 694, datë 04.07.2018 lidhur midis AAPSK-së, përfaqësuar nga Kryeadministratori dhe Shoqërisë “S. resort” me përfaqësues 2 (dy) administratorë të AAPSK-së, me afat 04.07.2018-03.01.2019 dhe vlerë mujore 121,580 lekë.</p> <p>-për 77 kontrata qiraje, pagesat e qirasë janë kryer pas datës 5 të çdo muaji, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të kontratave të qirasë ku citohet se: pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë</p>	faqe 74-117	E lartë	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, me qëllim rritjen e të ardhurave të përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme</li> <li>-për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga auditimi me qëllim shmangien e rrishtit në mirëfunksionimin e institucionit.</li> <li>-që për shkeljet e konstatuara në kontratat e qirave, të verifikohen rast pas rasti pagesat si të detyrimeve ashtu dhe të penaliteteve dhe në vijim për të gjitha</li> </ul>

	<p>vonesë nga data e caktuar qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.</p> <p>-për 6 kontrata qiraje çmimi i vendosur në kontratë nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni në procesverbalin për vlerësimin e çmimit të tregut, pasi në 4 raste çmimi i kontratës rezultoi më i lartë se çmimi në procesverbal, në 1 rast më i ulët dhe në 1 rast tjetër komisioni në procesverbal nuk është shprehur me çmim fikse.</p> <p>-4 kontrata qiraje janë zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësit nuk kanë paguar penalitetin në vlerën 590,730 lekë, në kundërshtim me pikën 10.2 të kontratës së qirasë ku citohet se: "qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penalitet që është sa çmimi mujor i qirasë".</p> <p>-Është lidhur 1 kontratë qiraje, konkretisht kontrata nr. 3533, datë 15.12.2022, me çmim qiraje 25,000 lekë/muaj bruto sipas pikës 5.1 të saj ndërkohë që në pikën 5.2 citon se: çmimi i qirasë do të jetë 30,000 lekë/muaj, në momentin që qiramarrësi do të përfitojë bonusin e qirasë nga Bashkia e Tiranës, duke vendosur kusht një ngjarje jo të sigurt të së ardhmes.</p> <p>-Për 2 pasuri, konkretisht për pasurinë nr. 35/143 dhe pasurinë nr. 23/27-T Kryeadministratori nuk ka nxjerrë Urdhër "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara", në kundërshtim me pikën 5, të nenit 19 të Ligjit nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara". Gjithashtu nga ana e administratorëve nuk është kryer një studim fizibiliteti për pasuritë e marra në administrim dhe nuk ia kanë paraqitur atë kryeadministratorit, me qëllim marrjen e vendimit përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë", në kundërshtim me pikën 1, të nenit 19 të Ligjit nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara".</p> <p>-Çmimi i përcaktuar për kontratën e qirasë nr. 1652 datë 24.05.2021 dhe kontratën nr. 1727 datë 01.06.2021 rezultoi në kundërshtim me nenin 2 të vendimit nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave, për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar.</p> <p>-Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1498 datë 06.05.2021 rezultoi se mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira, urdhri i brendshëm "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara" dhe procesverbalin i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut, duke krijuar hapsirë për abuzim në lidhje me çmimin e vendosur në kontratë dhe si rrjedhojë dhe në mirëadministrimin e pasurive.</p> <p>-Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për pasurinë me vetëdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj.Vendore Durrës, me deklaratë noteriale nr. 4733. Rep dhe nr. 1677 KoI, datë 20.12.2019, nuk është kontraktuar ekspert i pasurive të paluajtshme për të përcaktuar sipërfaqen totale dhe veç e veç për çdo hapësirë të shfrytëzueshme, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 34/2019, Kryeadministratori i AAPSK-së i ka lidhur kontratat në kushtet kur për sipërfaqen e objektit nuk ka informacion nga ASHK-ja dhe as informacion të të shprehur në vendimin gjyqësor nr. 68 datë 27.01.2021. Mungesa e përcaktimit të sipërfaqes së saktë ka sjell ka pasojë në vlerësimin dhe përlloraritjen e qirasë në përputhje me këtë të dhënë.</p>			<p>rastet e klasifikuara me detyrime të papaguara të kërkohej arkëtimi i vlerave duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative.</p>
5	<p>Nga auditimi mbi të ardhurat/shpenzimet e veprimtarisë dhe me burim buxhetin e shtetit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara u konstatua se: Nisur nga testimet e KLSH-së mbi raportimet e AAPSK-së, të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (pa të ardhurat nga buxheti i shtetit) janë konsiderueshëm më të ulëta se shpenzimet, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 298,044 mijë lekë. Si rrjedhojë diferenca prej 120,686 mijë lekë rezultoi kosto për buxhetin e shtetit.</p>	faqe 74-117	E lartë	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:</p> <p>-për një analizë të faktorëve, që kanë impakt negativ në realizimin e të ardhurave dhe për një planifikim të kujdesshëm të shpenzimeve që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.</p> <p>-për shfrytëzimin dhe ritjen e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara aty ku është e mundur, me qëllim administrimin me eficiencë, efikasitet dhe efektivitet të tyre.</p>
6	<p>Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për periudhën objekt auditimi, rezultoi se janë financuar 10 projekte me vlerë prej 93,403,412 lekë, nga të cilat u audituan 4 projekte në vlerën 12,960,000 lekë. Nga auditimi mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar (KNMKKO) konstatohet se:</p>	faqe 136-143	E lartë	<p>Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara:</p> <p>-Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,140,000 lekë, nga Fondacioni "A." (C..I)" për shkeljet e konstatuara në kontratën nr.</p>

	<p>-KNMKKO, sipas Vendimit nr. 11, datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm subjektin Fondacioni A. "C." në shumën e 2,280,000 lekë, për projektin "Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritit dhe punësimit". Midis AAPSK-së dhe Fondacionit "A. (C.) është lidhur kontrata nr. 682, datë 26.02.2021. Nëpërmjet Urdhër Pagesës së kryer nga AAPSK në datë 22.04.2021, subjekti përfitues ka marrë pagesën paraprake prej 50% të fondit që është 1,140,000 lekë. Rezulton se nga ana e fondacionit, në datë 25.06.2021, për realizimin e projektit është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën "P.", në kundërshtim me nenin 9. Pavarësisht se ky fakt është evidentuar nga ana e komisionit të verifikimit me relacionin nr. 3091 prot., datë 10.11.2021, AAPSK nuk ka marrë asnjë masë të mëtejshme për kthimin në buxhet të shumës së nënkontraktuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 16 dhe 17 të kontratës.</p> <p>- KNMKKO, sipas Vendimit nr. 06 datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm fondacionin "G." në shumën 5,000,000 lekë, për projektin "Për rehabilitimin e familjeve të efektive të rënë në detyrë". Midis AAPSK-së dhe subjektit "G." është lidhur kontrata nr. 679 datë 26.02.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky fondacion në lidhje me këtë projekt rezulton se nuk janë paraqitur kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore dhe dokumenti që vërteton se subjekti aplikues ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit" pika 9.</p> <p>Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 679 datë 26.02.2021, rezulton se Fondacioni "G." nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit financiar dhe përshkruar për shumën prej 2,500,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit" pika 18 dhe 19.</p> <p>Nga auditimi i urdhër pagesave rezulton se AAPSK ka derdhur në llogari të Fondacionit "G." shumën prej 5,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 4 të kontratës që citon: Pjesa prej 40% e fondit të posaçëm do të financohet pas miratimit të raportit afatmesëm (që përkton me gjysmën e periudhës së zbatimit të Projektit) dhe pjesa e mbetur prej 10% jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të raportit final".</p> <p>Për pjesën prej 50% të financimit, subjekti përfitues nuk ka përcjellë asnjë raportim financiar dhe përshkruar dhe nga AAPSK, në vijim nuk është marrë asnjë masë për kthimin në buxhet të vlerës prej 2,500,000 lekë, veprim ky në kundërshtim me nenin 16 dhe 17 të kontratës.</p>			<p>682, datë 26.02.2021 për projektin "Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritit dhe punësimit".</p> <p>-Të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,500,000 lekë, nga Fondacioni "G." për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 679, datë 26.02.2021 për projektin "Për rehabilitimin e familjeve të efektive të rënë në detyrë".</p>
7	<p>Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura në bazë risku i dokumentacionit përbërës, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur për dorëzimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, për periudhën objekt auditimi, u konstatuan parregullsi, veprime dhe mosveprime, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht si vijon:</p> <p>- Në lidhje me kthimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, nga ana e administratorëve të AAPSK-së janë dorëzuar pasuritë pa llogaritur dhe mbajtur paraprakisht shpenzimet e administrimit të bëra nga shteti, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me pikat 1, 2, 4 të nenit 20, pikat 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, dhe shkronjën "ë", neni 26 kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar. Nga auditimi u përlogaritën në total 7,566,958 lekë, dëm shkaktuar buxhetit të shtetit, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 3 datë 27.02.2018, nuk janë përlogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 816,783 lekë.</li> <li>2. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 1 datë 09.01.2019, nuk janë përlogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 817,089 lekë.</li> <li>3. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 7 datë 27.04.2018, nuk janë përlogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 704,829 lekë.</li> <li>4. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 8 datë 03.05.2018, nuk janë përlogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 2,562,518 lekë.</li> <li>5. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 5 datë 16.03.2018, nuk janë përlogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 604,007 lekë.</li> <li>6. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 25 datë 19.11.2018, nuk janë përlogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 2,061,732 lekë.</li> </ol>	faqe 117-126	E lartë	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa që:</p> <p>-të kryhet verifikimi i të gjitha rasteve ku nuk janë mbajtur shpenzimet e administrimit dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, arkëtimi i vlerës prej 7,566,958 lekë.</p>
8	<p>Nga auditimi mbi administrimin dhe destinacionin e pasurive të luajshme të sekuestruara apo të konfiskuara konstatohet se:</p>	faqe 64-67	E lartë	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:</p>

<p>Përgjatë viteve 2017-2020, nuk është marrë asnjë vendim për destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara.</p> <p>Me formatimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, prej datës 20.10.2020-31.12.2022, janë marrë vendime për destinimin dhe shitjen e pasurive të luajtshme si në vijim:</p> <p>Përgjatë vitit 2021 i janë dhënë Institucioneve Publike 20 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 35,193,750 lekë.</p> <p>Përgjatë vitit 2022 i janë dhënë Institucioneve Publike 37 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 31,646,590 lekë. Me vendim të KNMKKO, janë shitur 10 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 1,030,800 lekë.</p> <p>Pasuritë e luajtshme (automjetet) jo vetëm janë faturuar me shpenzimet e pagave të administratorëve të pasurive, por janë amortizuar duke u rënë vlera në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 të nenit 21, të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar.</p> <p><b>Si konkluzion</b>, administrimi i pasurive të luajtshme për periudhën 2017-2022 ka rritur koston e administrimit, duke ndikuar negativisht dhe në buxhetin e shtetit, krahas mungesës së efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar.</p> <p>Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga përgjegjësi i sektorit të marrëdhënieve me institucionet, çështjeve juridike dhe provave materiale të AAPSK-së, gjendja e automjeteve të marra në dorëzim nga administratorët deri më datë 31.12.2022 rezultojnë si vijon: 23 automjete të konfiskuara dhe 80 automjete të sekuestruara. Ndërkohë, sipas përgjegjësit të magazinës gjendja e automjeteve deri më datë 31.12.2022 rezultojnë: 79 automjete të sekuestruara/konfiskuara të magazinuara. Pra, 24 automjete nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga administratorët në ambientet magazinuese të AAPSK-së, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 20, të ligjit 34/2014, i ndryshuar dhe pikën 7, të nenit 14, të Rregullores së Brendshme të AAPSK.</p>		<p>-për shitjen e pasurive të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit duke respektuar parimin e mirëadministrimit si edhe shmangien e shpërdorimit të tyre.</p> <p>-për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurive të luajtshme dhe provave materiale në administrim me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre.</p> <p>-dorëzimin e pasurive të luajtshme në mjediset e caktuara magazinuese.</p> <p>-nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mosdorëzimin e automjeteve në ambientet magazinuese.</p>
--	--	--

### 1.c. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), për periudhën e aktivitetit nga data 01.10.2017 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat kjo strukturë realizon misionin e vet. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

#### Opinion i modifikuar/ kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë<sup>1</sup>

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në veprimtarinë e AAPSK-së janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale cilësore, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

#### Baza për opinionin mbi përputhshmërinë

Nga evidencat e marra dhe të shqyrtuara për veprimtarinë e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në periudhën 2017-2022, kanë rezultuar problematikat si në vijim:

- Sistemi elektronik për mbajtjen dhe azhornimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara (RPSK), nuk aksesohet nga administratorët për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, duke sjellë për pasojë mungesën e një baze të dhënash për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, si dhe mangësi në monitorimin e tyre, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 33 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe me kërkesat e pikave 5, 6, 8 të

<sup>1</sup> Opinion i modifikuar/ kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë: *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura.*



VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

- Në shoqëritë tregtare në administrim janë konstatuar 7 subjekte që kanë kryer vendimarrje në mungesë të plotë të kompetencës dhe subjekte që nuk kanë kryer procedura prokurimi sipas ligjit përkatës për shpenzimet në lidhje me administrimin e pasurive, duke përjashtuar këtu shpenzimet e veprimtarisë ekonomike, në kundërshtim me pikën 1, neni 16 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe nenin 5 të ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, i ndryshuar;

- Pagesat e qirasë janë kryer jashtë afatit të përcaktuar në kontratë dhe pa paguar kamatëvonesë deri në 3 muaj, si dhe ka raste që janë zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë pa paguar penaltet, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 dhe 10.2 të kontratave të qirasë;

- Procesverbalet e mbajtura nga administratorët AAPSK-së me pronarët e pasurive, për kthimin e 4 pasurive të revokuara nga 12 raste të shqyrtuara, rezultojnë në tejkalim të afateve të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar;

- Fondet për administrimin e pasurive të sekuestruara janë përballuar nga buxheti i shtetit, me të drejtën e kthimit të tyre nga personi të cilit i sekuestrohet pasuria, në rastet e revokimit me vendim gjykate. Nga ana e administratorëve të AAPSK-së janë dorëzuar 7 pasuri nga 12 të shqyrtuara, pa kërkuar shpenzimet e administrimit të përballuara nga shteti, duke i shkaktuar dëm buxhetit të shtetit në vlerën 7,567 mijë lekë, në kundërshtim me nenet 20, 25 dhe 26 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar;

- Nga 4 projektet e përzgjedhura për auditim, të financuara nga Fondi i Posaçëm me vendim të KNMKKO, dy prej tyre rezultojnë se nuk kanë justifikuar me dokumentacion për financimin e përfituar, ndërsa zbatimi i tyre është në tejkalim të afateve dhe detyrimeve kontraktuale me AAPSK-në, duke i shkaktuar dëm buxhetit të shtetit në vlerën 3,640 mijë lekë. Nga ana e AAPSK-së nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme administrative, për arkëtimin e vlerave, konkretisht: arkëtimi i vlerës prej 1,140 mijë lekë, nga Fondacioni “A.” (C..I)” dhe arkëtimi i vlerës prej 2,500 mijë lekë, nga Fondacioni “G.”, veprime në kundërshtim me pikat 9, 18, 19 të Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga Fondi i Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” dhe me përcaktimet kontraktuale;

- Në lidhje me veprimet e “bllokimit” të pasurive pranë ASHK-së është vepruar me vonesë për më shumë se 8 muaj, në kundërshtim me pikën 2/a, të nenit 11, të ligjit nr. 34/2019 i ndryshuar;

- Në 2 raste, për pasurinë e konfiskuar me vendimin nr. 4, datë 18.01.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda” për një periudhë 12-vjeçare dhe për pasurinë e konfiskuar me vendimin nr. 37, datë 13.07.2021 të GJKKO për një periudhë 9-mujore, pas datës së komunikimit të vendimit të formës së prerë, pra për një periudhë të konsiderueshme, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive të paluajtshme, të konfiskuara me vendim gjykate, si raportim dhe kalim për vendimarrje destinimi te Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 23, pika 2 të ligjit nr. 34/2019; i ndryshuar;

- Pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara nga administratorët, në asnjë rast nga 23 praktikat e audituara, nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit nr. 34/2019 i ndryshuar;

- Nuk është shitur asnjë pasuri e luajtshme e sekuestruar, të cilave jo vetëm i janë faturuar shpenzime pagat e administratorëve të pasurive, por edhe u ka rënë vlera nga amortizimi, veprime në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 të nenit 21, të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar;

- Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga përgjegjësi i sektorit të marrëdhënieve me institucionet, çështjeve juridike dhe provave materiale të AAPSK-së, gjendja e automjeteve të marra në dorëzim nga administratorët deri më datë 31.12.2022 rezulton si vijon: 23 automjete të konfiskuara dhe 80 automjete të sekuestruara. Ndërkohë, sipas përgjegjësit të magazinës gjendja e automjeteve deri më datë 31.12.2022 rezulton: **79** automjete të sekuestruara/konfiskuara të magazinuara. Pra, 24 automjete nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga administratorët në ambientet magazinuese të AAPSK-së, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 20, të ligjit 34/2014, i ndryshuar dhe pikën 7, të nenit 14, të Rregullores së Brendshme të AAPSK;

- Për vitet 2018, 2019 dhe 2021 nuk është kryer inventarizimi fizik i pronave dhe llogarive në administrim të AAPSK, duke sjellë risk të humbjes apo tjetërsimit të tyre, në kundërshtim me pikën 26 dhe 28 të kreut III, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

- Në raportimet e AAPSK-së mbi realizimin e të ardhurave konstatohet se, janë përfshirë në të ardhurat e vetë agjencisë edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit, për të mbuluar shpenzimet, por që nuk përfaqësojnë të ardhura nga veprimtaria e tyre, duke i mbivlerësuar në këtë mënyrë këto të fundit, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 298,044 mijë lekë, ku diferenca prej 120,686 mijë lekë rezulton kosto për buxhetin e shtetit.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit**

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është një institucion buxhetor, aktualisht në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Brendshëm dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie.

Kryeadministratori si drejtues dhe përfaqësues i AAPSK-së, drejton, organizon, përfaqëson dhe raporton sipas dispozitave ligjore përpara Ministrit të Brendshëm dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër financimit të terrorizmit.

Ai gjithashtu kontrollon punën e administratorëve nëpërmjet raportimeve periodike, i paraqet gjykatës listën e ekspertëve për administrimin e pasurive, lidh kontratën e punës me administratorin 30 ditë pas emërimit me vendim gjykate, raporton për problematikat, të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përgjigjet për përgatitjen e raportit vjetor të administrimit të pasurisë, përfaqëson AAPSK-në në raport me të tretët etj.

Përveç Kryeadministratorit në përbërje të AAPSK-së ka edhe specialist të fushave të ndryshme, me qëllim realizimin e funksionit të kësaj agjencie, që është miradministrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e AAPSK-së ka qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit.

Përveç standardeve të ISSAI, ne aplikuam edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikuam dhe përpunuam riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikuam, realizuam procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbulluam evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë.

Krijua një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të të dhënave janë kryer në mënyrën e duhur dhe u bazuam në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çonin në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikua me drejtuesin ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë, përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që identifikua gjatë auditimit tonë.

## **II. HYRJA**

Raporti Përfundimtar i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të përmbledhjes ekzekutive është trajtuar një përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit, gjetjeve kryesore, konkluzioni i përgjithshëm dhe opinion i auditimit. Në kapitullin e dytë është vijuar me paraqitjen e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në kapitullin e tretë është përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej tre drejtimeve të auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Kreu i pestë paraqet Anekset ndërsa kreu i gjashtë është lista e dokumentacionit shoqërues të auditimit.

### **1. Titulli**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

### **2. Marrësi**

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

### **3. Objektivat dhe qëllimi**

Objektivi i auditimit është arritja e një konkluzioni dhe dhënia e opinionit nëse aktiviteti i zhvilluar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatorë përkatëse.

Qëllimi i auditimit vlerësimi i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga AAPSK gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e punës në të ardhmen.

### **4. Identifikimi i çështjes**

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është krijuar në zbatim të Ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe aktualisht funksionon në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 70/2017, datë 27.04.2017 dhe 85/2020, datë 02.07.2020.

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka për objekt të veprimtarisë:

- Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar.
- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.
- Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit.
- Administrimi i provave materiale të konfiskuara dhe shitja e tyre me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

## **5. Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:**

AAPSK është një institucion buxhetor, aktualisht në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Brendshëm dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie. Kryeadministratori si drejtues dhe përfaqësues i AAPSK-së, drejton, organizon, përfaqëson dhe raporton sipas dispozitave ligjore përpara Ministrinë të Brendshme dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër financimit të terrorizmit. Ai gjithashtu kontrollon punën e administratorëve nëpërmjet raportimeve periodike, i paraqet gjykatës listën e ekspertëve për administrimin e pasurive, lidh kontratën e punës me administratorin 30 ditë pas emërimit me vendim gjykate, raporton për mbarëvajtjen e institucionit, problematikat, të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përgjigjet për përgatitjen e raportit vjetor të administrimit të pasurisë, përfaqëson AAPSK-në në raport me të tretët etj.

Përveç Kryeadministratorit në përbërje të AAPSK-së ka edhe specialist të fushave të ndryshme, me qëllim realizimin e funksionit të kësaj agjencie, që është miradministrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

## **6. Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, i cili shprehet nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. ISSAI 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave të nevojshme për të siguruar dëshmi e evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionin tonë. Procedurat e kryera janë bazuar në gjykimin profesional të audituesve publikë, duke përfshirë vlerësimin e riskut të mospërputhjeve materiale, qofshin këto për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ne besojmë se provat e mbledhura të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionin tonë.

Audituesit e KLSH janë të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

## **7. Kriteret e vlerësimit**

### ▪ Akte ligjore:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

- Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 70/2017, datë 27.04.2017 dhe ligjin nr. 85/2020 datë 02.07.2020.

- Ligji nr. 34, datë 04.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar.

- VKM nr. 888, dt. 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.

- VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

- Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 324, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara”.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 80, datë 06.03.2020 “Për kushtet e zbatimit të urdhrimit për evakuimin e ndërtesave që janë objekt i masës së sekuestros”.

- Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 323, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

- Urdhri i Kryeministrit nr. 14, datë 13.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AAPSK”.

Të tjera akte ligjore dhe nënligjore rregullative që lidhen me objektin e veprimtarisë së njësive së audituar.

## **8. Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

ISSAI 130 “Kodin Etik”

ISSAI 2315 “Risku”

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

## **9. Metodat e auditimit**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

c. Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

## **10. Dokumentimi i auditimit**

Auditimi është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë ISSAI 4000, si edhe Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë ISSAI 400-499. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e planifikimit dhe auditim në terren, si dhe janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është një institucion buxhetor, aktualisht në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Brendshëm dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është krijuar në zbatim të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe aktualisht funksionon në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 34 datë 04.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”. Në zbatim të ndryshimeve ligjore janë miratuar:

- VKM nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.

- VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 324, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara”.

- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 80, datë 06.03.2020 “Për kushtet e zbatimit të urdhrimit për evakuimin e ndërtesave që janë objekt i masës së sekuestros” etj.

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka për objekt të veprimtarisë:

- Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë“, ndryshuar me ligjin nr. 70, datë 27.04.2017 dhe ligjin nr. 34, datë 04.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar.

- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

- Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit.

- Administrimin e provave materiale të konfiskuara dhe shitja e tyre me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

Nga momenti i marrjes në administrim të pasurive të sekuestruara sipas akteve ligjore, deri në përfundim të procesit të gjykimit që mbyllet me revokimin e pasurisë (pasuria i kthehet subjektit), apo konfiskimin e pasurisë (pasuria kalon në pronësi të shtetit), administratori duhet ta mirëadministrojë pasurinë duke ruajtur vlerën e saj dhe kur është e mundur ta shtojë këtë vlerë.

Pasuritë e konfiskuara (biznese, pasuri të paluajtshme apo pasuri të luajtshme), mund të shiten, të kalojnë në pronësi të institucioneve qendrore apo njërive të qeverisjes vendore ose të jepen në përdorim. Vlera e shitjes, kalon në të ardhurat nga pasuritë e sekuestruara dhe konfiskura. Këto të ardhura derdhen në një llogari të veçantë pranë AAPSK.

Të ardhurat e krijuara nga pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara përdoren për :

- Derdhjen në buxhetin e shtetit.
- Llogarinë e AAPSK në përballimin e shpenzimeve.
- Fondin e Posaqëm.

Auditimi i zhvilluar në AAPSK paraqitet me rëndësi në planet e auditimit të KLSH-së, për rolin e veçantë që ky institucion ka në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, ndikimi i të cilave prek buxhetin e shtetit.

## **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve:**

### ***2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm***

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2016 deri 31.09.2017, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 185, datë 22.12.2017, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 999/7 prot., datë 26.12.2017, rezulton se:

**Janë lënë gjithsej 10 rekomandime masa organizative.**

**Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është konstatuar se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:**

*-Janë pranuar 9 masa organizative dhe prej tyre janë realizuar plotësisht 7 dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa, konkretisht masa nr. 6 dhe nr. 7.*

Në lidhje me 2 rekomandimet e mësipërme është kërkuar zbatimi i plotë i tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2019 dhe raportimi mbi ecurinë e tyre brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve, dërguar me shkresën nr.1219/31 prot datë 21.12.2018 “Dërgohet raporti përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”.

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”).**

Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me shkresën me nr. 275 prot., datë 26.03.2019 është dërguar statusi i zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6-mujor, nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e ligjit nr. 154/2014.

### **III. Realizimi i rekomandimeve**

Me shkresën përcjellëse nr. 1219/31 prot., datë 21.12.2018 janë lënë 2 masa organizative. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të tyre rezulton si më poshtë: të pranuar dhe **pjesërisht të zbatuara.**

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

#### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**Rekomandimi 6:** AAPSK duhet të krijojë një regjistër të vendimeve të marra për ekzekutim dhe të kryejë rakordime të mëvonshme, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të vendimeve, nga momenti i marrjes së këtyre vendimeve nga Administratori i pasurisë, deri në ekzekutimin e tij, duke ulur riskun e humbjes së gjurmës së auditit, plotësisë së të dhënave si dhe zbatueshmërinë e gjithë vendimeve të ardhura në drejtim të saj.

Ngritja e një databaze me të dhëna historike mbi çdo pasuri të konfiskuar dhe të sekuestruar që administrohen nga kjo Agjenci, nga dalja e vendimit të gjykatës, deri në përfundim të procesit, do të mundësojë mbikëqyrjen e proceseve, shton mundësinë e lidhjes dhe kryqëzimin e të dhënave me institucionet që bashkëpunojnë me Agjencinë si dhe mundëson dhënien në kohë reale të informacioneve të kërkuara nga institucionet e ndryshme në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*



**Komenti i Subjektit:** Përfundoi ndërtimi i softit, u implementua në AASPK, u trajnuan punonjësit e agjencisë dhe ka filluar hedhja e të dhënave nën monitorimin e specialistëve që kanë ndërtuar softin. Mirëmbajtja e sistemit dhe asistenca e përdorimit të tij do të jetë për një periudhë 5-vjeçare.

**Oëndrimi i audituesve shtetërorë:** Nga auditimi u konstatua se AASPK ka ndërtuar një sistem në lidhje me regjistrimin e vendimeve dhe pronave të sekuestruara, por rezulton se ky sistem nuk është funksional dhe si rrjedhojë nuk përmbush funksionin e vet me qëllim uljen e riskut të humbjes së gjurmës së auditit dhe plotësisë së të dhënave dhe mbikëqyrjen e plotë të procesit të administrimit të pasurive. Për sa më sipër ky rekomandim cilësohet **pjesërisht i zbatuar**.

**Rekomandimi 7:** AASPK në bashkëpunim me Gjykatat dhe Policinë Gjyqësore, të rrisë përpjekjet për të intensifikuar bashkëpunimin për përmirësimin e punës administruese të pasurive për sekuestrim/konfiskim/revokim, në funksion të shkurtimit të kohës së marrjes në administrim dhe shfrytëzimit eficient të këtyre pasurive.

*Në vijimësi*

**Komenti i Subjektit:** Në fund të vitit 2018 nga ana e Kryetarit të Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër Krimit të Organizuar z. E.H, iu kërkua Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit një bashkëpunim më i frytshëm, në marrjen në administrim të pasurive në një kohë sa më të shpejt. Në takimet e organizuara në kuadër të Moneyval dhe përmirësimeve ligjore në kuadër të BE, janë organizuar takime të shpeshta me ekspertë të institucioneve, që marrin pjesë në luftën kundër krimit të organizuar.

**Oëndrimi i audituesve shtetërorë:** Nga auditimi konstatohet se pavarësisht përpjekjeve për bashkëpunim dhe intensifikim me qëllim marrjen në administrim të pasurive në një kohë sa më të shpejt, nga praktikat e përzgjedhura konstatohen vonesa të konsiderueshme në marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara, konfiskuara, revokuara. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **pjesërisht i zbatuar**.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	i	Mos zbatimi i plotë rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së.
<b>Situata:</b>		<p>Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2016 deri 31.09.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 185, datë 22.12.2017, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 999/7 prot., datë 26.12.2017, rezulton se: <i>Janë lënë gjithsej 10 rekomandime masa organizative.</i></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është konstatuar se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë: -Janë pranuar 9 masa organizative dhe janë realizuar 7. Nuk janë zbatuar plotësisht 2 masa, konkretisht masa nr. 6 dhe nr. 7, për të cilat është kërkuar zbatimi i plotë i tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2019 dhe raportimi mbi ecurinë e tyre brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve, dërguar me shkresën nr.1219/31 prot datë 21.12.2018. Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me shkresën me nr. 275 prot, datë 26.03.2019 është dërguar statusi i zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6-mujor, nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, <i>në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e ligjit nr. 154/2014.</i></p> <p>Nga auditimi mbi zbatimin e tyre, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të 2 rekomandimeve rezulton si më poshtë: <b>të pranuar dhe pjesërisht të zbatuara.</b></p>

<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 154/2014, neni 30, pika 2.
<b>Impakti:</b>	Rekomandimet e pazbatuara plotësisht ndikojnë në performancën e veprimtarisë së AAPSK-së.
<b>Shkaku:</b>	Mosmarrja e masave për zbatimin e plotë të rekomandimeve, për shkak të mangësive në vlerësimin e realizimit të tyre.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masat e nevojshme me qëllim zbatimin e dy rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht të zbatuara.

## **2.2 Mbi zbatimin e procedurave ligjore në fushën e administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara me vendim gjykatë.**

### ***2.2.1 Mbi përdorimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.***

Në zbatim të ligjit nr. 34/2019 ka dalë VKM nr. 825, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

Nga auditimi rezultoi se AAPSK disponon një sistem elektronik për mbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara. Ky regjistër është instaluar nga AKSHI në vitin 2018 dhe sipas informacioneve të vëna në dispozicion, AAPSK nuk e administron kontratën e lidhur.

Versioni fillestar i sistemit “Krijimi i pasaportës dixhitale për pronat e sekuestruara” është prezantuar në 12.12.2018 nga “S. & S.” SHPK, në ambientet e AAPSK, ku është diskutuar mbi proceset e punës që realizohen nga AAPSK dhe pasqyrimi i tyre në sistem. Versioni i ri i këtij sistemi është instaluar në vitin 2019 nëpërmjet të cilit administratorët janë asistuar në hedhjen e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara në sistem.

Ky regjistër mirëmbahet nga S. D., S. & S. SHPK, përfaqësuar nga znj. I.TH, e cila ka trajnuar administratorët e pasurive, i ka asistuar për trajtimin e problemeve në sistemin e mbajtjes së “Regjistri elektronik” dhe i ka pajisuar ata me manual përdorimi mbi sistemin e administrimit të pronave të sekuestruara dhe konfiskuara.

Sipas komunikimeve elektronike të datës 02.02.2023, të përcjella nga Administratorja e Pasurive znj. B.I, sqarohet se manuali i përdorimit i mundëson përdoruesve të autorizuar të administrojnë pasuritë e sekuestruara, të cilat janë objekt shqyrtimi nga AAPSK, si në vijim:

- *Moduli i profilit, sigurisë dhe login i mundëson përdoruesve të regjistrohesh në sistem.*
- *Moduli i konfigurimeve, i mundëson përdoruesve administrator që të realizojnë të gjitha konfigurimet e nevojshme që do të shërbejnë për funksionimin korrekt të sistemit.*
- *Moduli i administrimit të pronave, i mundëson përdoruesve të marrin një informacion të përgjithshëm në lidhje me sistemin dhe mënyrën e organizimit të tij.*

Pavarësisht sqarimeve si më sipër, nga auditimi konstatohet se, administratorët e pasurive nuk aksesohen për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”. Mosaksesimi në sistem ka sjell mungesën e marrjes së informacioneve si në vijim:

**- Në tabelën e të dhënave** (bazuar në filtrat e përzgjedhur nga përdoruesi) do të mundësoheshin informacione mbi: *institucionin, numrin e vendimit, datën e vendimit, subjektin, numrin e pasurive të sekuestruara, numrin e pasurive të konfiskuara dhe numrin e pasurive të revokuara*. Këto të dhëna mundësojnë shkarkimin e tyre edhe në formën e një raporti.

- Në faqen e statistikave të pasurisë do të mundësoheshin informacione mbi: *administratorët, vendimet gjyqësore që kanë prekur pasurinë, statuset e tyre, kontratat e qirave dhe të ardhurat e shpenzimet e bëra për çdo pasuri.*

- Në faqen e statistikave të të ardhurave nga qiraja do të mundësoheshin informacione të ndryshme të pasurisë si psh: *qiramarrësi, administratori dhe vlerat për muajt përkatës të vitit bazuar në filtra.*

AAPSK nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “*Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij*” të cilat citojnë se:

5. *Të dhënat për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara hidhen në RPSK elektronikisht nga administratori i pasurisë nëpërmjet llogarisë së tij.*

6. *Të dhënat hidhen që në momentin e marrjes në dorëzim nga protokollin e AAPSK-së.*

8. *Të dhënat për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara hidhen në RPSK sipas llojit dhe statusit, në përputhje me rendin kronologjik të vendimit, kur ai përmban disa pasuri.*

Nga AAPSK, regjistri është mbajtur në format Excel, i cili ka patur përdorim të brendshëm pa i krijuar akses institucioneve që kanë të drejtë marrjen e informacionit të drejtpërdrejtë apo statistika raportuese në Regjistrin të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (RPSK), **duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 14 të VKM nr. 825, datë 28.10.2020 e cila citon se:**

14. *Institucionet që kanë të drejtë marrjen e informacionit në RPSK janë, si më poshtë vijon:*

a) *ministri dhe sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose të autorizuarit prej tyre;*

b) *të autorizuarit e Prokurorisë së Përgjithshme;*

c) *të autorizuarit e Prokurorisë së Posaçme;*

ç) *të autorizuarit e ministrit përgjegjës për drejtësinë;*

d) *të autorizuarit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;*

dh) *të autorizuarit e Drejtorisë së Shërbimit Informativ të Shtetit.*

Nga grupi i auditimit, me email-in e datës 02.02.2023, iu është kërkuar administratorëve të pasurive të plotësojnë një pyetësor mbi problematikat që mbart regjistri elektronik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, për të cilin grupi i auditimit nuk ka marr përgjigje.

Nga komunikimi verbal me administratorët e pasurive, disa prej tyre janë shprehur që: edhe pse i hedhin të dhënat e pasurive ato fshihen apo dublohen, nuk gjenerohen raporte dhe nuk është lehtësisht i aksesueshëm. Administratorët e rinj janë shprehur që nuk kanë user dhe pasworde për t'u loguar në sistem.

Në raportin e aktivitetit të punës së AAPSK-së për vitin 2018, dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 54 prot., datë 23.01.2019, faqe 19 citohet: “*Shpallja e fituesit për ndërtimin e databazës nga AKSHI dhe ndërtimi i sistemit të të dhënave, i jep mundësi shumë të mirë informatizimit të të dhënave dhe ndjek në çdo hap, ecurinë e marrjes në administrim dhe miradministrimin e pasurive. Ky sistem të dhënash mundëson një koordinim më të mirë midis operacioneve konkrete që kryen, kohës në të cilën realizohen ato, bashkërendimin e punës me institucionet bashkëpunuese në këtë proces, informacion më të plotë dhe mbi të gjitha efikasitet në punën e AAPSK-së. Ky sistem është ndërtuar nga firma fituese e projektit, duke marrë në konsideratë sugjerimet e AAPSK-së dhe është në fazën përfundimtare të implementimit të tij. Ky sistem do të shërbejë edhe si një lidhje pararendëse me institucionet e tjera që marrin pjesë në luftën kundër krimit, duke krijuar një sistem unik të marrjes dhe përpunimit të informacionit në kohë, bashkërendim, unifikim dhe vazhdimësi në të gjitha problemet dhe statistikat në këtë fushë”.*

Përgjatë viteve 2019-2022, ky regjistër nuk ka shërbyer për pasuritë e marra në administrim nga dalja e vendimit të gjykatës deri në përfundim të procesit, duke e bërë të pamundur mbikëqyrjen e proceseve, ka shtuar volumin shkresor, ndërkohë që nuk ka mundësuar kryerjen

e veprimeve on-line nga ana e administratorëve.

Si rrjedhojë, është ulur niveli i bashkërendimit me institucionet, mundësia e lidhjes dhe kryqëzimi i të dhënave me institucione që bashkëpunojnë me Agjencinë, si dhe ka penguar dhënien në kohë reale të informacioneve të kërkuara nga institucionet vendase dhe të huaja në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.

Ky regjistër elektronik nuk ka arritur qëllimin për të cilin është konceptuar, në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 34/2019 i ndryshuar, me pikat 4, 5, 6, 7 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020, me nenin 4, pika 1 dhe nenin 7 pika 4 (b) të Rregullores së Brendshme nr. 1363 prot., datë 22.04.2021 “Për organizmin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

Mungesa e zbatimit të kriterëve ligjore, mungesa e krijimit të një baze të dhënash në lidhje me një informacion të përgjithshëm për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mungesa e regjistrimit dhe monitorimit të të gjithë objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara të dhëna me qira, është tregues i qartë që objektivat e krijimit të sistemit nuk janë arritur e për rrjedhojë niveli i riskut në lidhje me mbarëvajtjen e punës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara është i lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.B, z. A.S, z. B.B, znj. B.I, znj. E.A, znj. E.O, z. E.B, z. F.A, z. S.M, znj. E.P, z. E.R, z. E.T, z. A.P, z. E.M, z. E.A, z. T.C në cilësinë e administratorëve dhe z. A.K në cilësinë e Kryeadministratorit për periudhën 01.10.2017-09.03.2021, z. Q.T në cilësinë e Kryeadministratorit për periudhën 09.03.2021-01.04.2022 dhe z. A.K në cilësinë e Kryeadministratorit për periudhën 01.04.2022-31.12.2022.

Nga përfaqësuesit e AAPSK znj. E.O, me shkresën nr. 27/47 prot., datë 11.08.2023 dhe znj. B.I, me shkresën nr. 27/45 prot., datë 11.08.2023, janë paraqitur observacione mbi projekt raportin, përkatësisht si në vijim:

**Pretendimi i subjektit:**

znj. E.O:- Sa i përket Akt konstatimit nr. 10 ju bëjmë me dije se ky sistem mbart disa problematika të hasura gjatë regjistrimit të të dhënave ndër të cilat evidentohen: ndryshimet e ligjit anti-mafia 85-20 nuk janë pasqyruar në sistem; vlerësimi që ne i bëjmë nuk është vlerësim tregu por i referuar për efekt taksimi; ASHK nuk përgjigjet për kërkesat e bllokimit të pasurive të paluajtshme dhe mbeten të paregjistruara pasuritë në proces legalizimi.

znj. B.I:- Në Akt-Konstatimin nr. 10, në lidhje me: “Regjistri elektronik”. Sqaroj se: Administratori i pasurisë ka për detyrë regjistrimin e të dhënave në lidhje me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (detyrë e kryer nga të gjithë administratorët e pasurive), bashkëlidhur gjeni foto nga sistemi të të gjithë pasurive të regjistruara që unë kam në administrim. Sjell në vëmendjen se ligji 34/2019 i ndryshuar me ligjin 19/2020 përmend dy pozicione pune: Kryeadministrator dhe Administrator. Të drejtat e administratorëve të pasurive në këtë institucion i përfitojnë pozicionet e shfuqizuara në ligj dhe përgjegjësitë shkojnë paralelisht.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pas shqyrtimit të observacioneve, grupi i auditimit sqaron se:

-Nga ana znj. O. nuk është kundërshtuar gjetja e grupit të auditimit. Në lidhje me përgjegjësitë grupi i auditimit vlerëson se përgjegjësia për shkak të funksionit, është dhe e administratorëve përkatës, sipas në përcaktimeve të pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835,

datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

-Në lidhje me observimin e znj. I., nga ana e grupit të auditimit, në datë 02.02.2023 është kërkuar plotësim i një pyetësori mbi të dhënat për regjistrin elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, për të cilin nuk është marr asnjë përgjigje nga ana e administratorëve të pasurive, në këtë rast as nga ana juaj. Gjithashtu gjatë fazës së auditimit në terren nuk kanë rezultuar të jenë hedhur të dhëna në lidhje me pasuritë e marra në administrim.

Marrja e masave për regjistrimin e plotë të pasurive në administrim ka vijuar pas konstatimeve nga ana e KLSH-së dhe pas përfundimit të auditimit në terren.

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi të gjitha pretendimet tuaja referuar regjistrin elektronik të pasurive nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	AAPSK nuk përdor regjistrin elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, duke ndikuar negativisht në performancën e institucionit
<b>Situata:</b>	<p>Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka një sistem elektronik për mbajtjen dhe azhornimin e regjistrin elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara (RPSK), por nuk aksesohet nga administratorët për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, duke sjellë për pasojë mungesën e një baze të dhënash për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mangësi në monitorimin e tyre dhe risk të shtuar në keqadministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 33 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe me kërkesat e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.</p> <p>Ky regjistër është instaluar nga AKSHI në vitin 2018 dhe sipas informacioneve të vëna në dispozicion, AAPSK nuk e administron kontratën e lidhur, mungesa e së cilës vështirëson ndjekjen, monitorimin e zbatimit të saj dhe vlerësimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale. Mungesa e aksesimit në sistem nga ana e administratorëve nuk ka mundësuar marrjen e informacioneve në lidhje me institucionin, administratorët, numrin dhe datën e vendimit, subjektin, numrin e pasurive të sekuestruara, konfiskuara, revokuara, vendimet gjyqësore që kanë prekur pasurinë, statuset e tyre, kontratat e qirave dhe të ardhurat e shpenzimet e bëra për çdo pasuri, etj.</p> <p>Përgjatë viteve 2018-2022, ky regjistër nuk ka shërbyer për mbikëqyrjen e proceseve, ka shtuar volumin shkresor, ndërkohë që nuk ka mundësuar kryerjen e veprimeve online nga ana e administratorëve. Mungesa e krijimit të një baze të dhënash në lidhje me një informacion të përgjithshëm për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mungesa e regjistrimit dhe monitorimit të të gjithë objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara të dhëna me qira, është tregues i qartë që ky regjistër elektronik nuk ka arritur qëllimin për të cilin është konceptuar dhe ka sjellë shpenzime pa efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit.</p> <p>Nga AAPSK, regjistri i të dhënave është mbajtur në format Excel i cili ka pasur përdorim të brendshëm pa i krijuar akses Institucioneve që kanë të drejtë marrjen e informacionit të drejtpërdrejtë apo statistika raportuese në RPSK, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 14 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 33 pika 2.</p> <p>- VKM-së nr. 835 datë 28.10.2020 “Për rregullat për përmbajtjen, formën e Regjistrin të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”, pika 5, 6, 8, 14.</p>

<b>Impakti:</b>	-Shpenzime pa efektivitet, eficiencë dhe efikasitet për krijimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara. -Nuk ka shërbyer për mbikëqyrjen e proceseve, ka shtuar volumin shkresor, nuk ka mundësuar kryerjen e veprimeve on-line nga ana e administratorëve. -Nuk ka mundësuar një bazë të dhënash të sakta, të plota dhe të regjistruara në sistem duke rritur në këtë mënyrë riskun e keqadministrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. -Mos përdorimi i regjistrit ka penguar dhënien në kohë reale të informacioneve të kërkuar nga institucionet vendase dhe të huaja në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kriterëve ligjore të përcaktuara për krijimin dhe përdorimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mungesën e aksesimit të regjistrimit elektronik, si dhe të komunikojë me strukturat drejtuese të Ministrisë së Brendshme dhe AKSHI-t me qëllim vënien në përdorimi dhe përditësimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

### **2.2.2 Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për administrimin e aseteve të marra në dorëzim dhe mënyra e menaxhimit të tyre nga administratorët**

Në 23 vendime të audituara nga 77 të raportuara, nga shqyrtimi me zgjedhje në bazë risku i dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, u konstatuan disa parregullsi, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

**1-Në lidhje me vendimin nr. 164 regj., datë 08.06.2022** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në ngarkim të subjektit në hetim E. D., “Për caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” mbi sendin pasuri e paluajtshme me nr. 3/560, me sipërfaqe totale truall 182 m<sup>2</sup>, ndërtesë 147 m<sup>2</sup>, me adresë Korçë, rr. “Naum Voskopoja”, Z. K. 8564, të regjistruar në emër të L. K.”.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me këtë pasuri janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 26.09.2022 (protokolluar me nr. 2724). Në datën 28.09.2022 me urdhrin nr. 63 të kryeadministratorit, në lidhje me pasurinë e sipërcituar është caktuar administrator i pasurisë z. A.B. Me shkresën nr. 2768 prot., datë 28.09.2022, AAPSK ka kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë bashkëpunimin e saj, në kuadër të ekzekutimit të vendimit. Me shkresën nr. 2808 prot., datë 03.10.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK Korçë plotësimin e aplikimit për vendosjen e sekuestros duke bashkëlidhur vendimin e gjykatës. Konfirmimi për vendosjen e sekuestros nga ASHK Korçë është marrë nga AAPSK në datën 05.12.2022 (protokolluar me nr. 2808/1). Në datën 27.10.2022 është kryer ekzekutimi i vendimit të gjykatës, për të cilin administratori i pasurisë i ka paraqitur kryeadministratorit relacionin nr. 3112 prot., datë 28.10.2022 të shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim në të cilin është përshkruar pasuria e sekuestruar si një ambient funksional ku ushtrohet aktiviteti i hotelierisë. Pas kërkesës së administratorit përkatës, kryeadministratori me urdhrin nr. 131 datë 31.10.2022 ka ngritur komisionin për vlerësimin e tregut në lidhje me çmimin e qirasë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 3126/2 prot., datë 08.11.2022 duke propozuar si çmim për qiradhënie vlerën 60,000 lekë/muaj. Një ditë më pas, në datën 09.11.2022, midis AAPSK-së dhe znj. E.M. është lidhur kontrata e qirasë me afat 1 vjeçar dhe vlerë 80,000 lekë në muaj.

Referuar dokumentacionit dhe praktikës së ndjekur nga administratori në lidhje me pasurinë e sipërcituar u konstatuan parregullsi në zbatimin e kuadrit ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

-Administratori i pasurisë të sekuestruar përpara lidhjes kontratës së qirasë nuk ka kërkuar deklaratë me shkrim nga qiramarrësi, ku ky i fundit të deklarojë se nuk ka lidhje me shtetasin të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës. Në këtë rast, administratori nuk ka vepruar sipas kërkesave të Rregullores nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25, sipas të cilës: *“Administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në lidhjen e kontratave të qirasë të pasurive, të kërkojnë deklaratë me shkrim nga personat fizik apo juridik, të cilët do të marrin me qira pasurinë, që nuk kanë lidhje me shtetasit apo subjektet e përfshira në vendimin e gjykatës, të cilëve ju është bërë sekuestrimi apo konfiskimi i pasurisë”*.

Duhet theksuar se, mosplotësimi i deklaratës (mohuese) me shkrim nga qiramarrësi përpara nënshkrimit të kontratës së qirasë, përbën një risk të shtuar që pasuritë e administruara formalisht *"de jure"* nga AAPSK të administrohen në të vërtetë *"de facto"* nga subjekti apo shtetasi të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës. Në rastin konkret, ky risk është vërtetuar pasi, referuar përmbajtjes së vendimit nr. 164 regj., datë 08.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, qiramarrësja rezulton të jetë edhe bashkëjetuesja e shtetasit të cilit i është bërë sekuestrimi. Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., me detyrë administrator i pasurisë.

**2-Në lidhje me vendimin nr. 3 (75) datë 22.01.2022** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në ngarkim të subjektit në hetim E. S., *“Për sekuestrimin e pasurive të paluajtshme: 1-Pasuria vilë 2 kat në Dhërmi, në kompleksin turistik “I. O.” me nr. G 44 (me emërtimin E8 sipas aneks kontratës), Dhërmi, Bashkia Himarë, ndërtuar nga shoqëria “H.” SHPK sipas lejes së ndërtimit nr. 10 datë 12.04.2017 të miratuar nga K.K.T.; 2-Pasuria nr. 104/92+1-68, vol.49, fq. 94, e llojit apartament me sipërfaqe 56.20 m<sup>2</sup>, ZK 3292 Selitë, Tiranë; 3-Pasuria nr. 104/92+1-59, vol. 49, fq. 85, e llojit apartament me sipërfaqe 74.40 m<sup>2</sup>, ZK 3292 Selitë, Tiranë”*.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me këtë pasuri janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 26.01.2022 (protokolluar me nr. 224). Në datën 27.01.2022 me urdhrin nr. 259 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. A.B. Me shkresën nr. 269 prot., datë 28.01.2022, AAPSK ka kërkuar nga DVP Lushnjë bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit. Me shkresën nr. 304 prot., datë 01.02.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK Tiranë plotësimin e aplikimit për vendosjen e sekuestros duke bashkëlidhur vendimin e gjykatës. Me shkresën nr. 832 prot., datë 11.03.2022, AAPSK ka kërkuar nga DVP Fier (për kompetencë) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit. Në datën 12.04.2022 është kryer ekzekutimi i pjesshëm i vendimit të gjykatës (*vilë 2-kate*), për të cilin administratori i pasurisë i ka paraqitur Kryeadministratorit relacionin nr. 1148 prot., datë 13.04.2022 të shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim në të cilin janë bashkëlidhur disa foto të objektit si dhe është përshkruar pasuria e sekuestruar ku ndër të tjera citohet se: *“Nga firma ishin duke vazhduar punimet për përfundimin e punimeve. Nuk ishin vendosur akoma dyert e brendshme dhe pajisjet hidrosanitare të cilat nga ana e firmës pretendonin të përfundonin në fund të muajit prill. Për këtë arsye nuk u dorëzua tek administratori çelsi i vilës...”*.

Në datën 14.04.2022 ka vijuar veprimtaria për ekzekutimin e pjesës tjetër të vendimit të gjykatës, konkretisht apartamentet për të cilat nuk është arritur marrja në dorëzim e tyre. Në lidhje me këto objekte administratori i pasurisë i ka paraqitur kryeadministratorit relacionin nr. 1165 prot., datë 19.04.2022, të shoqëruar me procesverbalin përkatës, ku ndër të tjera citohet se: *“Këto dy pasuri ishin në formë dupleksi me shkallë nga brenda. U bënë foto të ambientit por nga ana e oficerit të policisë nuk u bë dorëzimi i pasurisë tek administratori. Arsye e mosekzekutimit të vendimit ishte sepse në këtë apartament jetonte familja e shtetasit J. S. me të shoqen, nusen dhe tre fëmijë të mitur...”*.

Me shkresën nr. 1192 prot., datë 19.04.2022 të nënshkruar nga Kryeadministratori, nga ana e administratorit të pasurisë është hartuar një **raport në lidhje me elementet thelbësore të**

***ekzistencës dhe gjendjes së pasurive të sipërcituara, drejtuar gjykatës kompetente dhe prokurorit të çështjes.***

Në lidhje me pasurinë “vilë 2-kate”, pas kërkesës së administratorit përkatës, Kryeadministratori me urdhrin nr. 1202 datë 20.04.2022 ka ngritur komisionin për vlerësimin e tregut në lidhje me çmimin e qirasë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 1202/1/2 prot., datë 26.04.2022 duke propozuar si çmim për qiradhënie vlerën 180,000 lekë/muaj (sezonal). Në lidhje me këtë pasuri nuk rezultoi të jetë lidhur asnjë kontratë qiraje.

**3- Në lidhje me vendimin nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO, në ngarkim të subjekteve M. dhe G. T. dhe personave të lidhur me ta, “Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...: (20 pasuri të paluajtshme; 4 Automjete; 2 motorë; 1 rimorkio; 1 llogari bankare; 100% të aksioneve të subjektit “R.”; 100% të aksioneve të subjektit “T.-B.” i cili ka në pronësi të tij 13 mjete; 100% të aksioneve të subjektit “T. B.” i cili ka në pronësi të tij 1 pasuri të paluajtshme dhe 40 mjete)”**.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 10.11.2020 (protokolluar me nr. 1151/1). Në datën 13.11.2020 me urdhrin nr. 1919 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. S.M.

Me shkresën nr. 1923 prot., datë 16.11.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Berat “bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese” në lidhje me pasuritë e përcaktuara në vendimin nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Berat, me shkresën nr. 5295/1 prot., datë 26.11.2020 “kthim përgjigje”, AAPSK bëhet me dije, ndër të tjera, se: “...për të bërë të mundur pajisjen me shërbimin e kërkuar nga ju, konkretisht ekzekutimin e vendimit të pasurive të regjistruara në emër të M. dhe G.T dhe familjarëve të tyre në administrim të AAPSK-së, duhet të kryeni aplikimin përkatës në portalin e-Albania kundrejt tarifave përkatëse në bazë të VKM 389 datë 13.05.2020 “Për Miratimin e Listës dhe Shërbimeve Kadastrale”.

Me shkresën nr. 1924 prot., datë 16.11.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Me shkresën nr. 1958 prot., datë 23.11.2020, AAPSK ka kërkuar nga I. S. Bank, Shqipëri “bllokimin e llogarisë bankare me vlerë 14 300 Paund” në emër të shtetasit F.A.T, sipas vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Nga I. S. Bank, me shkresën nr. 1958/1 prot., datë 07.12.2020 “kthim përgjigje”, AAPSK bëhet me dije se: “subjektet debitorë nga ju cituar nuk kanë llogari pranë I. S. Bank Albania sh.a.”.

Me shkresën nr. 188 prot., datë 20.01.2021, AAPSK ka kërkuar nga z. G.B., OPGJ pranë (OFL), bashkëpunim në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO vetëm për bllokimin dhe marrjen në administrim të mjeteve apo automjeteve në emër personal të subjekteve si dhe mosbllokimin e mjeteve apo automjeteve në emër (pronësi) të shoqërive pasi këto të fundit janë në aktivitet dhe do të administrohen nga AAPSK.

Në datën 03.06.2021 AAPSK është njohur me vendimin nr. 161 datë 18.05.2021 të GJKKO, në lidhje me “Zgjatjen e afatit të sekuestros mbi pasuritë...”.

Me shkresën nr. 1347 prot., datë 20.04.2021, AAPSK ka kërkuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat “informacion mbi detyrimet tatimore” në lidhje me tre subjektet e sekuestruara sipas vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Nga DRT Berat, me shkresën nr. 772/1 prot., datë 22.04.2021 “kthim përgjigje”, AAPSK bëhet me dije se: “sipas sistemit c@ts për subjektet e kërkuara rezultoi përkatësisht: subjekti “R.” me NIPT L.....D ka detyrime 0 lekë; subjekti “T.-B.” me NIPT L.....F ka detyrime 7,511 lekë; subjekti “T. B.” me NIPT K.....E ka detyrime 5,804,683 lekë”.

Me shkresën nr. 1348 prot., datë 20.04.2021, AAPSK ka kërkuar nga Bashkia Berat “informacion mbi detyrimet tatimore” në lidhje me tre subjektet e sekuestruara sipas vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Nga Bashkia Berat, me shkresën nr. 2149/1 prot., datë 29.04.2021 “kthim përgjigje”, AAPSK bëhet me dije se: “për subjektet e kërkuara, në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, rezultoi përkatësisht: subjekti “R.” me nipt L.....D ka detyrime



0 lekë; subjekti "T.-B." me nipt L.....F ka detyrime 543,175 lekë; subjekti "T. B." me nipt K.....E ka detyrime 0 lekë".

Me shkresën nr. 1579 prot., datë 17.05.2021, AAPSK ka kërkuar nga QKB ndryshimin e administratorit të shoqërisë "T. -B." me nipt L.....F duke emëruar në atë pozicion z. S.M administrator pranë AAPSK.

Me shkresën nr. 1591 prot., datë 17.05.2021, administratori përkatës i pasurive z. S.M, ka informuar kryeadministratorin në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këtë të fundit se deri në datë 17.05.2021 janë ekzekutuar një pjesë e pronave të specifikuar në vendim si dhe shoqëria "T.-B.", për pjesën tjetër, sipas administratorit, ekzekutimi do të vijojë në datën 19.05.2021. Në lidhje me vijimin e ekzekutimit, administratori ka paraqitur informacionin e datës 24.05.2021 dhe 12.07.2021 ku ka bashkëlidhur proces-verbalet e ekzekutimit dhe sqarimet në lidhje me vështirësitë si dhe pamundësitë e marrjes në dorëzim të disa pasurive.

Me shkresën nr. 2043 prot., datë 12.07.2021 të nënshkruar nga kryeadministratori, nga ana e administratorit të pasurisë është hartuar një **raport në lidhje me elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurive të sipërcituara, drejtuar gjykatës kompetente dhe prokurorit të çështjes.**

Me shkresën nr. 2326 prot., datë 05.08.2022, administratori përkatës i pasurive z. S.M, ka informuar kryeadministratorin në lidhje me ecurinë e financiare të shoqërisë "T. -B." duke bashkëlidhur pasqyrat financiare të vitit 2021, vendimin e asamblesë dhe analizën e bilancit. Në informacionin e përgatitur nga administratori citohet ndër të tjera se, "*subjekti "T. B." me NIPT K.....E nuk mund të merret në administrim pasi ka rezultate negative (mungesë fitimi) dhe për pasojë mund të ketë impakt social negativ...*".

Në datën 06.07.2022 me urdhrin e brendshëm nr. 2005 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. E.B. dhe është larguar administratori z. S.M.

**Së pari**, vendimi i marrë në mënyrë diskrecionale nga ana e administratorit për të mos marrë një pasuri në administrim rezulton në kundërshtim me nenin 11, pika 2 (a, c) të ligjit nr. 34/2019 "*Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara*" sipas të cilës: "*Administratori i pasurisë a) njofton menjëherë për masën e sekuestrimit për pasuritë e sekuestruara të regjistruara, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; c) merr në administrim pasuritë e sekuestruara që i caktohen për administrim*" dhe dispozitivin e vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Mosmarrja në administrim e pasurive, e justifikuar me një vlerësim subjektiv të situatës, edhe pse me të cilin ka bërë me dije gjykatën apo prokurorin e çështjes, nuk justifikojnë mosveprimin e administratorit deri në momentin që gjykata nuk ka dalë me një vendim tjetër apo "të ndryshuar". Nga ana tjetër, në rastin konkret, justifikimi i fitimit të munguar të subjektit nuk qëndron pasi, sipas ekstraktit të shoqërisë, kjo e fundit ka deklaruar 16,680,084 lekë fitim për vitin 2020 dhe 216,767,616 lekë fitim për vitin 2021.

**Së dyti**, e njëjta situatë ka vijuar të jetë edhe pas ndryshimit të administratorit të pasurisë, i cili duke filluar nga data 06.07.2022 (data e emërimit) deri në momentin e auditimit nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me pasuritë në fjalë.

**Si konkluzion**, mosmarrja e në administrim të gjitha pasurive të specifikuar në vendimin e gjykatës e justifikuar me një vlerësim subjektiv të situatës rrezikon, veç të tjera, humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik "sekuestrës preventive".

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me nenin 11, pika 2 (a, c) të ligjit nr. 34/2019, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi: **z. S.M. dhe z. E.B.** me detyrë administrator i pasurisë.

**4-Në lidhje me vendimin nr. 175 datë 27.10.2020 të GJKKO**, në ngarkim të shtetasit G.C, "*Për vendosjen e masës së sekuestrës mbi pasuritë...: (pasuri truall 900 m<sup>2</sup> nga të cilat 300 m<sup>2</sup> ndërtesë, në emër të V.C; pasuri truall 300 m<sup>2</sup> nga të cilat 136,6 m<sup>2</sup> ndërtesë, në emër të G. C; Automjet me targa A.....P, në emër të G.C;)*".

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 29.10.2020 (protokolluar me nr. 1770). Në datën

29.10.2020 me urdhrin nr. 1783 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. E.B.

Me shkresën nr. 377 prot., datë 03.02.2021, administratori përkatës i pasurive z. E.B, ka informuar kryeadministratorin në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bashkëlidhur proces-verbalet e ekzekutimit dhe sqarimet në lidhje me vështirësitë si dhe pamundësitë e marrjes në dorëzim të disa pasurive. Konkretisht, ndër të tjera, referuar proces-verbaleve citohet “*pasuria truall 300 m<sup>2</sup> nga të cilat 136,6 m<sup>2</sup> ndërtesë nuk është ekzekutuar pasi përdorej për banim nga subjekti në pamundësi tjetër...; pasuria truall 900 m<sup>2</sup> nga të cilat 300 m<sup>2</sup> ndërtesë, në emër të V.C, rezulton godinë në të cilën kryhet aktiviteti “hotel, restorant, bar-kafe” ju dorëzua administratorit të AAPSK-së...”. Nga ana tjetër, në fund të proces-verbalit të marrjes në dorëzim është shtuar nënshkrimi i vetë V.C. e cila ka deklaruar se: “Unë V.C. marr përsipër për të ruajtur pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të vendimit”.*

Me shkresën nr. 386 prot., datë 03.02.2021, të nënshkruar nga Kryeadministratori, nga ana e administratorit të pasurisë është hartuar në mënyrë të përmbledhur një **raport në lidhje me elementet e gjendjes së pasurive të sipërcituara, drejtuar gjykatës kompetente dhe SPAK-ut si institucion dhe jo nominalisht prokurorit të çështjes.**

Me shkresën nr. 2223 prot., datë 28.07.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e përcaktuara në vendimin nr. 175 datë 27.10.2020 të GJKKO. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, me shkresën nr. 9190/1 prot., datë 04.08.2021 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije në lidhje me plotësimin e kërkesës.

Pas kërkesës së datës 01.03.2021 të paraqitur nga shtetasi F.H. “*për marrje me qira*”, AAPSK ka lidhur kontratën e qirasë me vlerë 100.000 lekë në muaj edhe pse administratori i pasurisë të sekuestruar përpara lidhjes kontratës së qirasë nuk ka kërkuar deklaratë me shkrim nga qiramarrësi, ku ky i fundit të deklarojë se nuk ka lidhje me shtetasin të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës.

Me shkresën nr. 2080 prot., datë 15.07.2022, administratori përkatës i pasurive z. E.B., ka informuar kryeadministratorin në lidhje me ecurinë e ekzekutimit në lidhje me automjetin me targa A.....P duke bashkëlidhur proces-verbalin e ekzekutimit të datës 13.07.2022. Ndër të tjera, referuar proces-verbalit citohet shënimi “*Mjeti nuk u arrit ti hapet dera dhe për këtë arsye u la në ambientet e DVP Shkodër...*”.

Me shkresën nr. 2081 prot., datë 15.07.2022, të nënshkruar nga Kryeadministratori, nga ana e administratorit të pasurisë është njoftuar, në lidhje me ekzekutimin e mjetit, **gjykata kompetente dhe SPAK-u si institucion dhe jo nominalisht prokurori i çështjes.**

**Së pari**, konstatohet se administratori i pasurisë, në lidhje me veprimet e “bllokimit” të pasurive pranë ASHK-së përkatëse, ka vepruar me një vonesë prej më shumë se 8 muaj, nisur nga fakti se emërimi i tij është kryer në datën 29.10.2020 ndërsa kërkesa drejtuar ASHK-së është e datës 28.07.2021. Në lidhje me këto veprime, në kuadrin ligjor rregullator, parashikohet se administratori duhet të veprojë menjëherë. Konkretisht, neni 11, pika 2/a, e ligjit nr. 34/2019 “*Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara*” përcakton se: “*Administratori i pasurisë njofton menjëherë për masën e sekuestrimit për pasuritë e sekuestruara të regjistruara, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra*”.

Duhet theksuar se, në rastin konkret, vonesat në kryerjen e veprimeve të administratorit përbëjnë një risk eventual (tjetërsim pasurie), për humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestrros preventive”, duke ndikuar gjithashtu negativisht në administrimin e pasurisë.

**Së dyti**, konstatohet se administratori i pasurisë, në lidhje pasurinë “*truall 900 m<sup>2</sup> nga të cilat 300 m<sup>2</sup> ndërtesë, në të cilën kryhet aktiviteti “hotel, restorant, bar-kafe”, pasi e ka marrë në dorëzim, i ka lënë administrimin e saj shtetases V.C., e cila është subjekt i vendimit të sekuestrimit. Edhe pse sipas procesverbalit citohet se “*këto pasuri i janë lënë në ruajtje...*” disponimi i pasurisë në rastin konkret përkon me administrimin e saj.*

Duhet theksuar se, lënia në administrim, e pasurive të sekuestruara, personave të cilët janë subjekt i vendimit të gjykatës, bën që pasuritë të administrohen formalisht "*de jure*" nga AAPSK por realisht ato administrohen në të vërtetë "*de facto*" nga subjekti apo shtetasi të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **z. E.B.** me detyrë administrator i pasurisë.

**5-Në lidhje me vendimin nr. 4 datë 18.01.2006** të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (lënë në fuqi me vendimin nr. 28 datë 28.04.2006), në ngarkim të shtetasit A.L, e cila ndër të tjera ka vendosur: "*Kalimin në favor të shtetit të materialeve të sekuestruara siç janë: 1-shuma prej 20.348 \$ pranë B.; 2-lokali "Bar M."; 3-Automjeti "Benz" me targa TR .....,...*". Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon:

Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 04.03.2008 (protokolluar me nr. 310). Në lidhje me këtë vendim nga ana e AAPSK-së, në mënyrë të pashpjegueshme, nuk është kryer asnjë veprim edhe pse ka qenë në dijeni të vendimit nr. 76 datë 21.10.2005 i cili në pikën 2 të dispozitivit ngarkon AAPSK-në për veprime me pasuritë. Në datën 30.08.2022 me shkresën nr. 2479 nga kryeadministratori i është kërkuar informacion, mbi ecurinë e procesit, gjykatës kompetente. Kjo e fundit njofton AAPSK-në se për vendimin në fjalë në datën 30.05.2006 ka dalë urdhri i ekzekutimit me anë të të cilit është ngarkuar Zyra Përmbarimore Tiranë.

Në datën 07.09.2022 me urdhrin e brendshëm nr. 31, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. E.O.

Pas fillimit të procedurave për marrjen në administrim të pasurive dhe raportimit përkatës, me shkresën nr. 3407 prot., datë 30.11.2022, të nënshkruar nga kryeadministratori, është hartuar në mënyrë të përmbledhur një **raport në lidhje me elementet e gjendjes së pasurisë së paluajtshme të marrë në administrim, drejtuar gjykatës kompetente dhe prokurorit të çështjes.**

Në lidhje me marrjen në administrim të Automjetit "*Benz*" me targa TR ....., pas një korrespondence me autoritetet, nga ana e Komisarariatit Divjakë është njoftuar se nuk disponohen regjistrat e vitit 2006 dhe se mjeti nuk ndodhet në ambientet e komisarariatit.

Me shkresën nr. 41 prot., datë 06.01.2023, administratori përkatës i pasurive znj. E.O, ka informuar kryeadministratorin në lidhje me ecurinë e administrimit të pasurisë së paluajtshme duke i parashtruar elementët si vijon:

-Statusi i pasurisë: *E konfiskuar me vendimin e formës së prerë nr. 28 datë 28.04.2006;*

-Përshkrimi dhe vendndodhja: *Një përshkrim i përgjithshëm;*

-Vlerësimi i pasurisë: *Çmimi sipas vkm 168 datë 27.03.2019 (referuar zona 7, Tiranë 100000 x 142 sip - 14 200 000 lekë);*

-Konkluzionet: *Kjo pasuri i përcillet komitetit për destinim.*

Në lidhje me sa më sipër konstatohet se, në mënyrë të pashpjegueshme, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurisë në një periudhë 12-vjeçare (2008-2022).

Gjithashtu, duke filluar që nga data e emërimit të administratores së pasurisë 07.09.2022 deri aktualisht në datën e hartimit të këtij akt konstatimi 09.06.2023, edhe pse procedurat paraprake të nevojshme janë kryer, kjo pronë, në tejkallim të afateve (90 ditë), ende nuk i është kaluar për vendimmarrje destinimi Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

Duhet theksuar se, moskryerja e veprimeve brenda afatit ligjor të përcaktuar ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive përkundër parimit të efektivitetit, efikasitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë. Konkretisht, Neni 23, pika 2 e Ligjit nr. 34/2019 "*Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara*" përcakton se: "*Me kalimin e pasurisë në favor të shtetit, Agjencia përgatit raportin tekniko-financiar me rekomandimet përkatëse për destinimin, mënyrën dhe kushtet e administrimit të pasurisë së konfiskuar dhe ia paraqet Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar..., brenda 90 ditëve, nga njoftimi i vendimit gjyqësor për konfiskimin e pasurisë*".

Për sa më sipër, AAPSK nuk ka respektuar afatet sipas kuadrit ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Kryeadministratori A.K., periudha 01.10.2017-09.03.2021; Q.T., periudha 09.03.2021-01.04.2022 dhe A.K, periudha 01.04.2022-31.12.2022 ).

**6-Në lidhje me vendimin nr. 189 datë 12.11.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasve V. S., (R.T.), J.T, dhe personave të lidhur me to, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): (1-Apartament 118,125 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasës M.M.; 2-Apartament 109,03 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasës M.M.; 3-Apartament 80,7 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasës M.M.; 4-Apartament 110,36 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasës M.M.; 5-Njësi 122 m<sup>2</sup> dhe 2 (dy) poste parkimesh (nr. 13 dhe 14) në rrugën “Tefta Tashko”, Tiranë, në emër të shtetasës M.M.; 6-Apartament 52,27 m<sup>2</sup> në Orikum, Vlorë, në emër të shtetasit N.T.; 7-Apartament 54,50 m<sup>2</sup> në Orikum, Vlorë, në emër të shtetasit N.T; 8-Ndërtesë 134 m<sup>2</sup> në L. “Uji i Ftohtë”, Vlorë, në emër të shtetasit N.T.; 9-Llogari bankare “R. Bank”, në emër të shtetasit V.S.”.*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon:

Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 18.11.2020 (protokolluar me nr. 1935). Në datën 18.11.2020 me urdhrin nr. 1944 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. E.O.

Me shkresën nr. 1963 prot., datë 23.11.2020, AAPSK ka kërkuar nga R. Bank, Shqipëri “*bllokimin e llogarisë bankare me nr. 0021...*” në emër të shtetasit V.S sipas vendimit nr. 189 datë 12.11.2020 të GJKKO. Për këtë kërkesë, R. Bank ka konfirmuar bllokimin e llogarisë me gjendje 10.85 USD. Kjo e fundit është marrë në administrim nga administratori përkatës sipas proces-verbalit të datës 23.11.2020.

Me shkresat nr. 1987 dhe 1988 prot., datë 26.11.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, përkatësisht Drejtoria Vendore Vlorë dhe Tiranë “*bllokimin dhe vendosjen e sekuestros*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 189 datë 12.11.2020 të GJKKO. Nga ana e Drejtorisë Vendore Vlorë me shkresën nr. 9527/1 prot., datë 31.12.2020 është konfirmuar kryerja e shërbimit, për të cilin gjithashtu i është kërkuar AAPSK-së kryerja e pagesës së tarifës përkatëse. Për pjesën e pasurive të ndodhura në Tiranë, kërkesa për “*bllokimin dhe vendosjen e sekuestros*” është përsëritur pas 5 muajsh me shkresën nr. 1313 prot., datë 16.04.2021 drejtuar Drejtorisë Rajonale.

Me shkresën nr. 1994 prot., datë 26.11.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 189 datë 12.11.2020 të GJKKO. Në lidhje me pasurinë “*njësi 122 m<sup>2</sup> dhe 2 (dy) poste parkimesh*”, pas kërkesës nr. 523 datë 12.02.2021 së administratorit përkatës, Kryeadministratori me urdhrin nr. 526 datë 12.02.2021 ka ngritur komisionin për vlerësimin e tregut në lidhje me çmimin e qirasë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 526/1 prot., datë 15.02.2021 duke propozuar si çmim për qiradhënie vlerën 70,000 lekë/muaj. Në lidhje me këtë pasuri është lidhur kontrata e qiramarrjes me shtetasin E.I. duke qenë se ky i fundit ishte duke zhvilluar në këtë pasuri aktivitetin bar-kafe.

Në lidhje me pasurinë “*Apartament 109,03 m<sup>2</sup> dhe Apartament 110,36 m<sup>2</sup>*”, pas kërkesës nr. 491 prot., datë 10.02.2021 së administratorit përkatës, Kryeadministratori me urdhrin nr. 492 datë 10.02.2021 ka ngritur komisionin për vlerësimin e tregut në lidhje me çmimin e qirasë.

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit të vendimit, me shkresën nr. 2078 prot., datë 09.12.2020, është njoftuar ***gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes***. Në vijim, me shkresën nr. 2247 prot., datë 28.12.2020 është njoftuar ***gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “1-Ndërtesa 134 m<sup>2</sup> në L. “Uji i Ftohtë”, Vlorë, në emër të shtetasit N.T., ju la në përdorim nga OPGJ prindërve të shtetasit N.T.; U morën në administrim 2-Apartamenti 52,27 m<sup>2</sup> në Orikum, Vlorë, në emër të shtetasit N.T., 3-Apartamenti 54,50 m<sup>2</sup> në Orikum, Vlorë, në emër të shtetasit N.T. si dhe 4-llogaria bankare “R. Bank”, në emër të shtetasit V.S.”.***

Gjithashtu në vijim, me shkresën nr. 334 prot., datë 02.02.2021 është njoftuar ***gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të***

**tjera se është marrë në administrim:** “1-Apartament 118,125 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasve M.M; 2-Apartament 109,03 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasve M.M;” dhe **pritet vijimi i ekzekutimit për:** : “1-Apartament 80,7 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasve M.M; 2-Apartament 110,36 m<sup>2</sup> në rrugën “Sul Bega”, Tiranë, në emër të shtetasve M.M; 3-Njësi 122 m<sup>2</sup> në rrugën “Tefta Tashko”, Tiranë, në emër të shtetasve M.M;”. **Në lidhje me** 2 (dy) postet e parkimit (nr. 13 dhe nr. 14) administratorja e pasurive ka raportuar vështirësinë në evidentimin të tyre dhe ka kërkuar bashkëpunim për ekzekutimin e tyre.

Në lidhje me pasuritë e mara në administrim, administratorja përkatëse, ka vijuar procedurat për qiradhënien e tyre në zbatim të kuadrit ligjor rregullator.

**7-Në lidhje me vendimin nr. 68 datë 27.01.2021** të GJKKO, në ngarkim të shtetasve B.H, T.H dhe personave të lidhur me to, “Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): (1-Pasuria nr. 17/263 me sipërfaqe 981,15 m<sup>2</sup>, truall në Shkozë, Durrës, në emër të shtetasit B.T.H; 2- Pasuria nr. 8420 dhe nr. 9509 me vetëdeklarim dhe aplikues A.U.S.;3- Pasuria nr. 9/1308 me sipërfaqe 63,8 m<sup>2</sup>, në rrugën “Selaudin Zorba”, në emër të shtetasit A.H; 4-Apartament 65 m<sup>2</sup> në Golem, në emër të shtetasve H.H; 5- Apartament (kontratë porosie) 73.2 m<sup>2</sup> në Golem, në emër të shtetasit B.H.”.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon:

Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 02.02.2021 (protokolluar me nr. 330). Në datën 03.02.2021 me urdhrin nr. 371 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. E.O.

Me shkresën nr. 1381 prot., datë 22.04.2021 është njoftuar **gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se:** “1-Pasuria nr. 17/263 me sipërfaqe 981,15 m<sup>2</sup>, truall në Shkozë, Durrës, në emër të shtetasit B.T.H është marrë në administrim në datën 15.04.2021...; 2- Pasuria nr. 8420 dhe nr. 9509 me vetëdeklarim dhe aplikues A.U.S. është marrë në administrim në datën 15.04.2021...;3- Pasuria nr. 9/1308 me sipërfaqe 63,8 m<sup>2</sup>, në rrugën “Selaudin Zorba”, nuk është marrë në administrim pasi OPGJ administroi një kontratë shitje në emër të z. M.K i cili banonte në atë objekt; 4-Apartament 65 m<sup>2</sup> në Golem, në emër të shtetasve H.H nuk është marrë në administrim pasi H.H. banonte në atë objekt”.

**Në lidhje me pasurinë** “Apartament (kontratë porosie) 73.2 m<sup>2</sup> në Golem, në emër të shtetasit B.H”, nga ana e administratorit i është raportuar gjykatës kompetente dhe prokurorit të çështjes me shkresën nr. 1623 prot., datë 20.05.2021. **Proces-verbali i ekzekutimit i datës 15.04.2021, ndër të tjera në lidhje me pasurinë në fjalë, mban shënimin** “...shtetësja H.H. deklaroi se në dijeni të saj kjo pasuri nuk zotërohet nga ata pasi nuk kanë përfunduar kontratën e shitjes. Në lidhje me këtë pasuri do të kryhen verifikime nga ana jonë”. **Pas verifikimeve të kryera (proces-verbali i datës 15.05.2021) rezultoi se pasuria “apartament 73.2 m<sup>2</sup>” ndodhej në Qerret, Durrës, i pabanuar pasi rezultonte ende në ndërtim.**

Referuar dokumentacionit dhe praktikës së ndjekur nga administratori në lidhje me pasuritë e sipërcituara vlerësohet se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e kuadrit ligjor rregullator.

**8-Në lidhje me vendimin nr. 217 datë 09.06.2020** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në ngarkim të shtetasit P.T, “Për vendosjen e sekuestros mbi pasuritë...: (1-Pallat një kat nën tokë 4-6 kate mbi tokë ndërtuar në pasurinë nr. 4/43, Vol. 44, Fq. 221, ZK. 8518 pallat 2-4-6 kate; 2- Pallat nr. 4/44, Vol. 44, Fq. 222, ZK. 8518 objekt Hotel+Bar C. në Plazh”.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon:

Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 12.06.2020 (protokolluar me nr. 837).

Në lidhje me pasuritë e sipërcituara nga vetë gjykata është caktuar administrator znj. E.O.

Me shkresën nr. 873 prot., datë 16.06.2020 është kërkuar bashkëpunimi i DVP Durrës në **lidhje me ekzekutimin e vendimit.**

Me shkresën nr. 874 prot., datë 16.06.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK Durrës “vendosjen e sekuestros dhe pajisjen me hartat treguese dhe kartelat përkatëse” në lidhje me pasuritë e

paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 217 datë 09.06.2020. Nga ana e Drejtorisë Vendore Durrës me shkresën nr. 5788/1 prot., datë 01.07.2020 është konfirmuar kryerja e shërbimit.

Me shkresat nr. 933 dhe nr. 934 prot., datë 25.06.2020 është njoftuar **gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “nga ana e OPGJ-së është shtyrë ekzekutimi për shkak se ditën e paraqitjes në objekt është konstatuar fakti se subjekti nuk ishte njohur me vendimin e gjykatës”.**

Me shkresën nr. 873/2 prot., datë 10.07.2020 është rikërkuar bashkëpunimi i DVP Durrës në **lidhje me ekzekutimin e vendimit dhe marrjen në administrim të pasurive, kërkesë e cila është ripërsëritur** me shkresën nr. 873/3 prot., datë 05.08.2020, **fakt për të cilin nga administratorja e pasurive janë hartuar edhe raportet/relacionet përkatëse.**

**Nga relacioni i datës 25.08.2020 rezulton se, në datën 19.08.2020 është vepruar me marrjen në administrim të 6 njësive për të cilat, edhe pse kanë qenë të dhëna me qira në persona të tretë, AAPSK ka vijuar me procedurat për vlerësimin e tyre dhe përcaktimin e çmimit të qirasë me qëllim lidhjen e kontratave të reja për subjektet që do të shpallin interes.**

Me shkresën nr. 118 prot., datë 13.01.2021 është njoftuar **prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “AAPSK ndan shqetësimin se shtetasi P.T. për shkak të temperamentit të njohur ka ndërhyrë indirekt tek qiraxhinjtë...duke mos i lënë të qetë në posedim...”. Duke qenë se i njëjti shqetësim ka vijuar në mënyrë të përsëritur, nga ana e AAPSK-së është adresuar edhe pranë strukturave të policisë së shtetit.**

**Në datën 12.12.2022 AAPSK është njohur me vendimin nr. 217/3 datë 31.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në ngarkim të shtetasit P.T, me të cilin është vendosur “Konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit të pasurisë së sekuestruar: -Pallat nr. 4/44, Vol. 44, Fq. 222, ZK. 8518 objekt Hotel+Bar C. Revokimi i sekuestrës për pasurinë: -Pallat një kat nën tokë 4-6 kate mbi tokë ndërtuar në pasurinë nr. 4/43, Vol. 44, Fq. 221, ZK. 8518 pallat 2-4-6 kate;”.**

Me shkresën nr. 3624 prot., datë 22.12.2022 është njoftuar **gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “...pasi jemi paraqitur në objekt...OPGJ znj. L. D. ka deklaruar se në kuadër të ekzekutimit të vendimit duhet të njoftohej subjekti për ekzekutim vullnetar dhe më pas të merren masat për ekzekutim të detyrueshëm. Duke qenë se shtetasi P.T nuk ishte prezent ekzekutimi u shty për një datë tjetër”.**

Me shkresën nr. 70 prot., datë 10.01.2023 është rikërkuar bashkëpunimi i DVP Durrës në **lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. 217/3 datë 31.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.**

Me shkresën nr. 693/1 prot., datë 23.02.2023 është njoftuar gjykata dhe **prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “Ekzekutimi i vendimit nuk u bë i mundur për shkak se në katin e parë të banimit u konstatuan 10 apartamente të mbyllura, ku pasi u trokit nuk u konstatua askush. Në katin e dytë u konstatuan 8 apartamente, ku konkretisht në apartamentin nr. 17 u konstatua z. I.T., i cili nuk pranoi të lirojë vullnetarisht apartamentin, apartamentet e tjera në këtë kat u gjetën të mbyllura. Në katin e tretë u konstatuan 8 dyer apartamentesh të mbyllura, ku pasi u trokit nuk u konstatua askush. Ky ekzekutim u pezullua dhe u vendos nga ana e OPGJ-së për t’u ekzekutuar në një moment të dytë”.**

**9-Në lidhje me vendimin nr. 119 datë 03.08.2020 të GJKKO, në ngarkim të shtetasit I. O. dhe të afërmve të tij, “Për vendosjen e masës së sekuestrës mbi pasuritë...(shkurtimisht): (1-pasuri e paluajtshme nr. 46/68/ND+1-34, ZK 8518, 91.96 m<sup>2</sup>, në emër të I.O. dhe S.O., lagjia 13 Durrës; 2-pasuri e paluajtshme nr. 46/188+1-28, ZK 8518, 91.96 m<sup>2</sup>, në emër të S.O. dhe F.O., lagjia 13 Durrës; 3-pasuri e paluajtshme nr. 58/29, ZK 8518, 600 m<sup>2</sup> truall nga të cilat 240 m<sup>2</sup> ndërtim hotel (3-kate), në emër të R.O, lagjia 13 Durrës...; 4-pasuri e paluajtshme nr. 46/146/ND+1-10, ZK 8518, 87.65 m<sup>2</sup>, në emër të L.O dhe A.O, lagjia 13 Durrës ;5-Autoveturë “Sangyong” me targë A....., në emër të I.O; 6-Autoveturë “Citroen” me targë A.....I, në emër të S.O;7-Autoveturë “Renault” me targë D.....F, në emër të S. dhe L.O ;8-Autoveturë “Ford” me targë A.....E, në emër të L. O.; 9-Subjekti “O.-A.” me NIPT K.....R, Elbasan, në emër dhe administrator shtetasin S.O.”.**

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 10.08.2020 (protokolluar me nr. 1252). Në datën 11.08.2020 me urdhrin nr. 1269 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. E.B.

Me shkresën nr. 1297 prot., datë 17.08.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 119 datë 03.08.2020 të GJKKO. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 9318/1 prot., datë 01.09.2021 “*kthim përgjigje*”, konfirmohet kryerja e shërbimit të kërkuar.

Me shkresën nr. 1426 prot., datë 04.09.2020 është njoftuar **gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “1-Në datën 02.09.2020 u krye dorëzimi i pasurisë së paluajtshme nr. 58/29, ZK 8518, 600 m<sup>2</sup> truall nga të cilat 240 m<sup>2</sup> ndërtim hotel (3-kate), në emër të R.O, lagjia 13 Durrës...; 2-Në datën 03.09.2020 u krye dorëzimi i subjektit “O.-A.” me NIPT K.....R, Elbasan, në emër dhe administrator shtetasin S.O;(bashkëlidhur proces-verbalet)”**.

Me shkresën nr. 1428 prot., datë 04.09.2020, AAPSK ka kërkuar nga QKB, zëvendësimin e administratorit të subjektit “O.-A.” me NIPT K.....R duke emëruar z. E.B. Për këtë veprim janë kryer edhe ndryshimet përkatëse pranë R. Bank dhe B.

Me shkresën nr. 16749 prot., datë 26.10.2020 të OFL, AAPSK është njoftuar se për tre pasuritë e tjera të paluajtshme nuk mund të kryhet ekzekutimi për shkak se ato përdoren për banim nga familjarët si e vetmja mundësi e këtyre të fundit.

**10-Në lidhje me vendimin nr. 1 datë 09.01.2021** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit A.(E) M, L.H. dhe të afërmeve të tyre, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): (1-pasuri e paluajtshme nr. 23/21, ZK 8642, 688 m<sup>2</sup> truall dhe ndërtesën mbi të hotel “H.”, Sarandë në emër të P.B; 2- pasuri e paluajtshme nr. 23/15, ZK 8642, 688 m<sup>2</sup> truall dhe ndërtesën mbi të, Sarandë në emër të P.B;)”*.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 12.01.2021 (protokolluar me nr. 99). Në dispozitivin e vendimit të gjykatës, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. E.B dhe z. E.R.

Me shkresën nr. 180 dhe 181 prot., datë 19.01.2021 është njoftuar kryeadministratori, **gjykata kompetente dhe prokurori i çështjes lidhur me ecurinë e ekzekutimit duke raportuar ndër të tjera se: “Në datën 14.01.2021 u krye ekzekutimi vendimit dhe pasuritë ju lanë në ruajtje shtetasit K.G; (bashkëlidhur proces-verbalet)”**.

Me shkresën nr. 205 prot., datë 21.01.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 1 datë 09.01.2021 të GJKKO. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë, me shkresën nr. 583/1 prot., datë 27.01.2021 “*kthim përgjigje*”, konfirmohet kryerja e shërbimit të kërkuar.

Në kundërshtim të vendimit të gjykatës, në datën 27.07.2021 me urdhrin nr. 2201 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është larguar si administrator z. E.R. (*pasi kalon në detyrë tjetër*) duke lënë si administrator vetëm z. E.B.

**Në vijim AAPSK është njohur me vendimin nr. 18 datë 26.06.2021** të GJKKO, një tjetër vendim në ngarkim të shtetasit A.(E) M, L.H dhe të afërmeve të tyre, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë...(shkurtimisht): (1-pasuri e paluajtshme, njësi me nr. 6/1236-N2, ZK 8310, 51 m<sup>2</sup>, rr. Don Bosko, Tiranë, në emër të shtetasit S.D dhe e bllokuar për llogari të O. Bank dhe shtetas A.M;)”*.

Përkatësisht me shkresat nr. 2171 dhe 2172 prot., datë 21.07.2021, administratori përkatës i pasurive z. E.B., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bashkëlidhur edhe procesverbalin përkatës.

Me shkresën nr. 2142 prot., datë 19.07.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*”

në lidhje me pasurinë e paluajtshme të përcaktuar në vendimin nr. 18 datë 26.06.2021 të GJKKO. Nga ASHK, me shkresën nr. 8029/1 prot., datë 30.07.2021 “*kthim përgjigje*”, konfirmohet kryerja e shërbimit. Pas këtij njoftimi nga ana e administratorit z. E.B. është vepruar duke ndjekur procedurat e dhënies me qira të pasurisë në fjalë.

**11-Në lidhje me vendimin nr. 459 datë 07.06.2016** të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Urdhrit të Prokurorit nr. 383 datë 22.07.2020, në ngarkim të shtetasve C.A, K.L, M.H, “*Për kalimin në pronësi të shtetit të pasurive...(konfiskimin)*”:

“1- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-107, ZK 8518, 105.198 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga C.A;

2- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-7, ZK 8518, 86.345 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga K.L;

3- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-66, ZK 8518, 130.033 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga K.L;

4- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-15, ZK 8518, 91.653 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga M.H;

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës dhe Urdhri i Prokurorit është marrë nga AAPSK në datën 27.07.2020 (protokolluar me nr. 1145). Në dispozitivin e vendimit të gjykatës, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. E.B.

Në dosjen e cila përmban dokumentacionin e praktikës së ndjekur nga administratori, administrohen, veç të tjerave, proces-verbalet mbi ekzekutimet si vijon:

- **Procesverbal i datës 05.08.2020** ora 10:20 midis administratorit z. E.B. dhe OPGJ-së z. A.M, mbi ekzekutimin e pasurisë: “1-Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-15, ZK 8518, 91.653 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga M.H”;

- **Procesverbal i datës 01.03.2022** ora 14:00 midis administratorit z. E.B. dhe OPGJ-së z. A.M, mbi ekzekutimin e pasurive: “1- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-7, ZK 8518, 86.345 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga K.L dhe 2- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-66, ZK 8518, 130.033 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga K.L”;

- **Procesverbal i datës 01.03.2022** ora 14:00 midis administratorit z. E.B. dhe OPGJ-së z. A.M, mbi ekzekutimin e pasurisë: “1- Apartament, pasuri e paluajtshme nr. 24/128-ND+1-107, ZK 8518, 105.198 m<sup>2</sup>, Plazh-Durrës, i blerë nga C.A.”.

Me shkresën nr. 1295 prot., datë 17.08.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 9662/1 prot., datë 14.09.2020 “*kthim përgjigje*”, konfirmohet kryerja e shërbimit të kërkuar.

Me shkresën nr. 2216 prot., datë 28.07.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës “*kalimin në favor të shtetit të pasurisë (nr. 24/128-ND+1-107, ZK 8518, 105.198 m<sup>2</sup>) dhe vënien në dispozicion të certifikatës dhe dokumentacionit përkatës*”. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 7162/1 prot., datë 03.09.2021 “*kthim përgjigje*”, konfirmohet kryerja e shërbimit të kalimit të pronësisë ndërsa për pajisjen me dokumentacionin përkatës bëjnë me dije AAPSK-në se kjo e fundit duhet të aplikojë on-line. Përkatësisht me shkresat nr. 757 dhe 758 prot., datë 09.03.2022, administratori përkatës i pasurive z. E.B, ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit se “*ekzekutimi është kryer tërësisht*” por pa dhënë asnjë detaj tjetër në lidhje me gjendjen e pasurive.

Me shkresën nr. 1248 prot., datë 22.04.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës “*kalimin në favor të shtetit të katër pasurive të përcaktuara në vendimin e gjykatës si dhe vënien në dispozicion të certifikatave dhe dokumentacionit përkatës bazuar në aplikimet nr. 12652, 10964, 10926, 10921*”. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 4004/1 prot., datë 17.06.2021 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se “*në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të plotësoni një aplikim të ri...*”. Pas një



korrespondence midis ASHK dhe AAPSK, kjo e fundit në datën 24.10.2022 pajiset me dokumentacionin përkatës.

Me shkresën nr. 3353 prot., datë 21.11.2022, AAPSK ka kërkuar nga Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional marrjen e një vendimi në lidhje me pasuritë e konfiskuara, duke përcjellë gjithashtu edhe raportin e vlerësimit Tekniko-Financiar të tyre.

**12-Në lidhje me vendimin nr. 55-2022 datë 29.07.2022** të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, në ngarkim të shtetasit F.S., “Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë... (shkurtimisht): (1-pasuri e paluajtshme nr. 100/14, ZK 1791, 500 m<sup>2</sup> truall, Golem-Kavajë; 2-pasuri e paluajtshme nr. 132/43, ZK 1791, 1250 m<sup>2</sup> arë Golem-Kavajë; 3- pasuri e paluajtshme, Hotel, nr. 132/150, ZK 1791, 500 m<sup>2</sup>, Golem-Kavajë;)”.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës dhe urdhri i prokurorit është marrë nga AAPSK në datën 04.08.2022 (protokolluar me nr. 2302). Në datën 08.08.2022 me urdhrin nr. 2331 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. E.B.

Me shkresën nr. 2377 prot., datë 12.08.2022 është kërkuar bashkëpunimi i DVP Kukës në **lidhje me ekzekutimin e vendimit dhe marrjen në administrim të pasurive**.

Me shkresën nr. 2378 prot., datë 12.08.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Kukës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Kukës, me shkresën nr. 2175/1 prot., datë 18.08.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se kompetencën për veprimet e kërkuara e ka Drejtoria Vendore Durrës.

Përkatësisht me shkresat nr. 2431 dhe 2432 prot., datë 22.08.2022, administratori përkatës i pasurive z. E.B., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bashkëlidhur edhe procesverbalin përkatës.

Me shkresën nr. 2449 prot., datë 23.08.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 6054/1 prot., datë 07.09.2022 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se kompetencën për veprimet e kërkuara e ka Drejtoria Vendore Kavajë.

Në datën 27.12.2022, AAPSK është njohur me vendimin nr. 229 datë 03.10.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër i cili ka ndryshuar dhe rrëzuar vendimin nr. 55-2022 datë 29.07.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës duke revokuar sekuestron.

Pas kryerjes së pagesës së shpenzimeve në datën 30.01.2023 në vlerën 24.070 lekë nga ana e subjektit, nga administratori janë kthyer pasuritë e sipërcituara duke hartuar edhe procesverbalin përkatës të datës 03.02.2023.

Në lidhje me procedurat e ndjekura nga administratori z. E.B., referuar praktikës së sipërcituar, vlerësohet se përgjithësisht është respektuar kuadri ligjor rregullator me përjashtim të konfuzionalitetit të krijuar mbi kompetencat e Drejtorive Vendore të ASHK-së.

**13-Në lidhje me vendimin nr. 102 datë 09.07.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit A.K dhe të afërmve të tij, “Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë... (shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 211/14, ZK 1727, 2800 m<sup>2</sup>, në emër të M.K; 2-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 119/3, ZK 1727, 2500 m<sup>2</sup>, në emër të A.K; 3-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 119/2, ZK 1727, 2500 m<sup>2</sup>, në emër të A.K; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 102/5, ZK 1727, 8700 m<sup>2</sup>, në emër të A.K; 5-Autoveturë “Wolsvagen” me targë A.....R, në emër të A.K; 6- Autoveturë “Toyota” me targë A.....Z, në emër të M.K; 7- Autoveturë “Citroen” me targë A.....R, në emër të R.K; 8- Autoveturë “Lancia” me targë A.....D, në emër të N.K;”.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 22.07.2020 (protokolluar me nr. 1118).

Në datën 23.07.2020 me urdhrin nr. 1126 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara, fillimisht është caktuar administrator znj. E.P., dhe më pas me urdhrin nr. 1280 datë 12.08.2020 kjo e fundit është zëvendësuar me z. E.B.

Me shkresën nr. 1147 prot., datë 27.07.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 102 datë 09.07.2020 të GJKKO. Me shkresën nr. 1148 prot., datë 27.07.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasurinë e paluajtshme të përcaktuar në vendimin nr. 102 datë 09.07.2020 të GJKKO. Nga ASHK, me shkresën nr. 8844/1 prot., datë 10.08.2020 “*kthim përgjigje*”, konfirmohet kryerja e shërbimit. Edhe pse nga ASHK është konfirmuar kryerja e shërbimit në datën 10.08.2020, në mënyrë të pakuptimtë ky shërbim i është rikërkuar të njëjtit institucion me shkresën nr. 2221 prot., në datën 28.07.2021.

Përkatësisht me shkresat nr. 1444 dhe 1445 prot., datë 08.09.2020, administratori përkatës i pasurive z. E.B., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit se “*ekzekutimi në lidhje me pasuritë e paluajtshme është kryer tërësisht në datën 13.08.2020, ndërsa për atë të automjeteve vetëm për atë “Wolsvagen” me targë A.....R” i cili u la në ruajtje pranë komisariatit Shijak*” por pa dhënë asnjë detaj tjetër në lidhje me gjendjen e pasurive.

Në datën **17.12.2021** AAPSK njihet me vendimin e formës së prerë **nr. 37 datë 13.07.2021** të GJKKO (protokolluar me nr. 3442), me të cilin është vendosur: “*Konfiskimi dhe kalimi në pronësi të shtetit i pasurive...(shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 211/14, ZK 1727, 2800 m<sup>2</sup>, në emër të M.K; 2-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 119/3, ZK 1727, 2500 m<sup>2</sup>, në emër të A.K; 3-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 119/2, ZK 1727, 2500 m<sup>2</sup>, në emër të A.K; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 102/5, ZK 1727, 8700 m<sup>2</sup>, në emër të A.K; 5-Autoveturë “Wolsvagen” me targë A.....R, në emër të A.K; 6- Autoveturë “Toyota” me targë A.....Z, në emër të M.K; 7- Autoveturë “Citroen” me targë A.....R, në emër të R.K; 8- Autoveturë “Lancia” me targë A.....D, në emër të N.K;”*”.

Me shkresën nr. 2732 prot., datë 26.09.2022, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 37 datë 13.07.2021 të GJKKO.

Me shkresën nr. 2746 prot., datë 27.09.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK “*kalimin në favor të shtetit të katër pasurive të përcaktuara në vendimin e gjykatës si dhe vënien në dispozicion të certifikatave dhe dokumentacionit përkatës*”. Nga ASHK, me shkresën nr. 7417/1 prot., datë 08.11.2022 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se “*në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të kryhen pagesat sipas VKM-së nr. 389...*”. Pas një korrespondence midis ASHK dhe AAPSK, kjo e fundit ka kryer pagesat dhe aplikimet përkatëse por deri në momentin e auditimit nga KLSH nuk është pajisur ende me dokumentacionin e kërkuar.

Në dosjen e praktikës së ndjekur nga administratori në lidhje me pasuritë e sipërcituara konstatohen gjithashtu dy raporte tekniko-financiare (nr. 42 dhe 43 prot., datë 06.01.2023) përkatësisht për mjetet “*autoveturë “Wolsvagen” me targë A.....R dhe autoveturë “Toyota” me targë A.....Z*”. Në lidhje me këtë të fundit, Komiteti Ndërinstitucional me vendimin nr. 89 datë 06.02.2023 ka vendosur kalimin kapital pa pagesë nga AAPSK tek Drejtoria e Shërbimit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve.

Në lidhje me sa më sipër konstatohet se, në mënyrë të pashpjegueshme, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive për një periudhë 9-mujore pas datës së komunikimit të vendimit të formës së prerë të konfiskimit. Në respekt të afateve, sipas kuadrit ligjor rregullator, nga data e komunikimit të vendimit të formës së prerë të konfiskimit, deri në paraqitjen e praktikës pranë Komitetit Ndërinstitucional, veprimet duhet të kryhen brenda 90 ditëve. Konkretisht, Neni 11, pika 2/(e/v) e Ligjit nr. 34/2019 “*Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara*” përcakton se: “*Administratori i pasurisë e) ...paraqet raportin tekniko-financiar, brenda 90 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e formës së prerë, për konfiskimin e pasurisë;*”.

Duhet theksuar se, moskryerja e veprimeve brenda afatit ligjor të përcaktuar ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive përkundër parimit të efektivitetit, efijencës, ekonomikitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.

Për sa më sipër, AAPSK nuk ka respektuar afatet sipas kuadrit ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **z. E.B.**, me detyrë administrator i pasurisë si dhe Kryeadministratori (A.K periudha 01.10.2017-09.03.2021; Q.T., periudha 09.03.2021-01.04.2022 dhe A.K, periudha 01.04.2022-31.12.2022).

*Nga përfaqësuesit e AAPSK znj. E.O., me shkresën nr. 27/46 datë 11.08.2023, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:*

**Pretendimi i subjektit:** -*“Sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur subjekti pretendon se, në nenin 20 të rregullores së AAPSK, datë 30.08.2022 me nr. 2479 është përcaktuar qartë procedura e ndjekur për destinimin e pasurisë në Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar dhe zbatimin e vendimeve të tij... Në përfundim, mos dërgimi në komitet i pasurisë së konfiskuar nuk është përgjegjësi e administratorit të pasurisë. Detyra e administratorit përfundon me përgatitjen e raportit teknik financiar, informacionit të përgjithshëm të pasurisë dhe gjithë dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e vendimit për destinimin e pronës në Komitet”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** -Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga znj. O., në lidhje me situatën, kryesisht me përgjegjësinë mbi zbatimin e afateve ligjorë në rastin përkatës, grupi i auditimit e merr në konsideratë dhe ka kryer reflektimin në këtë raport përfundimtar auditimi.

**14-Në lidhje me vendimin nr. 70 datë 29.01.2021** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit L.Z dhe të afërmeve të tij, *“Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë... (shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “Garazhe” (gjithsej 16) të regjistruara në ZK 3866, në Kashar, Yzberisht, Tiranë, në emër të F.G.Z.; 2-Pasuri e llojit “automjet” me targë A.....H, “Benz” “S.....”, në emër të F.F.K;”.*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 19.02.2021 (protokolluar me nr. 589).

Në datën 24.02.2021 me urdhrin nr. 644 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator z. F.A.

Me shkresën nr. 771 prot., datë 09.03.2021, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 70 datë 29.01.2021 të GJKKO. Me shkresën nr. 772 prot., datë 09.03.2021, AAPSK ka kërkuar nga DPSHTRR dhe DPPSH *“vendosjen e masës së sekuestros mbi mjetin me targë A.....H”.*

Me shkresën nr. 788 prot., datë 10.03.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Tiranë *“bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese”* në lidhje me 16 (gjashtëmbëdhjetë) pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 70 datë 29.01.2021.

Në dosje është administruar proces-verbali *“mbi ekzekutimin...”* i datës 17.05.2021, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe avokatit të subjektit. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“pasuritë u dorëzuan vullnetarisht dhe u morën në administrim”.*

Në lidhje me sa më sipër konstatohet se, pas marrjes në dorëzim të pasurive të paluajtshme, nga ana e administratorit nuk rezulton të jetë kryer një raportim kundrejt kryeadministratorit, gjykatës apo prokurorit të çështjes mbi gjendjen e pasurive. Gjithashtu nuk rezulton e dokumentuar, të jetë kryer ndonjë veprim me qëllim rritjen e vlerës së pasurive duke i dhënë ato me qira. Në lidhje me këtë situatë, neni 11, pika 2/(ç dhe e) e ligjit nr. 34/2019 *“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”* përcakton se: *“Administratori i pasurisë..., ç) nëse është e mundur, rrit vlerën e pasurisë që ka në administrim; e)...paraqet raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, për kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit, për elementet thelbësore të*

*ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit;”.*

Duhet theksuar se, moskryerja e raportimeve në zbatim të kuadrit ligjor ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive sipas parimit të efektivitetit, eficiencës, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi **z. F.A.**, me detyrë administrator i pasurisë.

**15-Në lidhje me vendimin nr. 156 datë 30.09.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit A. H dhe të afërmve të tij, *“Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 300/132, ZK 3866, 300 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në emër të A.H; 2-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 300/131, ZK 3866, 400 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në emër të A.H; 3-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 300/131, ZK 3866, faqe 228, 210 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në emër të A.H; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament” nr. 5/73+1-5, 61.2 m<sup>2</sup>, “Muhamet Gjollështa”, Tiranë, në emër të D.M; 5-Pasuri e paluajtshme e llojit “objekt”, 30 m<sup>2</sup>, Tiranë, në proces legalizimi me aplikimin nr. 13593 viti 2009, në emër të A. dhe E.H; 6-Pasuri e paluajtshme e llojit “objekt”, 20 m<sup>2</sup>, Tiranë, në proces legalizimi me aplikimin nr. 13593 viti 2009, në emër të A.dhe E.H; 7-Pasuri me numër 1308734 datë 21.04.2016, në emër të K.H (lidhur me banesën 3-katëshe në Yzberisht); 8-Pasuri me numër 14840 datë 27.01.2015, në emër të N.H (lidhur me banesën dhe magazinën Kodër-Kamëz);”.*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 02.10.2020 (protokolluar me nr. 1566).

Në datën 07.10.2020 me urdhrin nr. 1598 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. B.I.

Me shkresën nr. 1601 prot., datë 08.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 156 datë 30.09.2020 të GJKKO. Me shkresën nr. 1602 prot., datë 08.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Tiranë *“bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese”* në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuar në vendimin nr. 156 datë 30.09.2020 të GJKKO. Nga ASHK, me shkresën nr. 15234/1 prot., datë 03.11.2020 *“kthim përgjigje”*, AAPSK bëhet me dije se *“në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të kryhen pagesat dhe aplikimi sipas VKM-së nr. 389/2020...”*.

Në dosje janë administruar: **1-proces-verbali “mbi ekzekutimin e vendimit...”** i datës 14.01.2021, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit E.H. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është marrë në administrim pasuria e paluajtshme e llojit “objekt”, 20 m<sup>2</sup>, Tiranë, në proces legalizimi me aplikimin nr. 13593 viti 2009, në emër të A. dhe E.H”*; **2-proces-verbali “mbi ekzekutimin e vendimit...”** i datës 14.01.2021, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit E.H. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është marrë në administrim pasuria e paluajtshme e llojit “objekt”, 30 m<sup>2</sup>, Tiranë, në proces legalizimi me aplikimin nr. 13593 viti 2009, në emër të A. dhe E.H”*; **3-proces-verbali “mbi ekzekutimin e vendimit...”** i datës 14.01.2021, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit E.H. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është marrë në administrim pasuria e paluajtshme me numër 1308734 datë 21.04.2016, në emër të K.H (lidhur me banesën 3-katëshe në Yzberisht) por gjithsesi nga administratorja i është lënë për banim shtetases K.H”*.

Përkatësisht me shkresat nr. 198 dhe 201 prot., datë 21.01.2021, administratori përkatës i pasurive znj. B.I., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim (gjithsej 3) deri në datën 14.01.2021, për të cilat ka filluar procedurat ligjore për dhënien me qira të tyre.

Me shkresën nr. 261 prot., datë 25.01.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit, për pjesën e mbetur, të vendimit nr. 156 datë 30.09.2020.

Me përjashtim të veprimeve për qiradhënien e dy pasurive të marra në administrim, nga administratori i pasurive nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim tjetër deri në datën 31.03.2023. Në këtë datë me shkresën nr. 1203 prot., “*kërkesë për informim...*”, administratori përkatës i pasurive znj. B.I, ka informuar gjykatën dhe prokurorinë në duke bërë me dije këta të fundit se në lidhje me pasuritë: “*1-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 300/132, ZK 3866, 300 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në emër të A.H; 2-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 300/131, ZK 3866, 400 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në emër të A.H; 3-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë” nr. 300/131, ZK 3866, faqe 228, 210 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në emër të A.H; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament” nr. 5/73+1-5, 61.2 m<sup>2</sup>, “Muhamet Gjollësja”, Tiranë, në emër të D.M. -Këto pasuri nuk janë dorëzuar nga OPGJ akoma, pasi në ditën e ekzekutimit të vendimit nuk e identifikonin vendndodhjen, dhe kërkuan kohë që ti drejtohen Njësisë Administrative Kashar për vendosjen në dispozicion të një topografi. Kemi dërguar sërish kërkesa për bashkëpunim me OPGJ, por nuk kemi asnjë përgjigje.”.*

**16-Në lidhje me vendimin nr. 151 datë 01.10.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit J.K (A.) dhe të afërmve të tij, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë... (shkurtimisht): “1-Automjet, autoveturë “Audi” me targë A.I, në emër të E.K; 2-Automjet, autoveturë “Benz” me targë A.J; 3- Automjet, autoveturë “Golf” me targë A.....U, në emër të S.A; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “truall” nr. 29/236, ZK 8512, me sipërfaqe totale 362 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe 193 m<sup>2</sup> ndërtesë, në emër të F.A; 5-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë+truall”, ZK 2309, me sipërfaqe të përgjithshme 856 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli 300 m<sup>2</sup>, ndërtesë 147 m<sup>2</sup>, Shijak; 6-Pasuri e paluajtshme e llojit “arë”, 6000 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi sipas AMTP nr. 17, Shijak; Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 13.10.2020 (protokolluar me nr. 1626).*

Në datën 13.10.2020 me urdhrin nr. 1632 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. B.I.

Me shkresën nr. 1665 prot., datë 15.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me tre pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 151 datë 01.10.2020 të GJKKO.

Nga ASHK, me shkresën nr. 15729/1 prot., datë 17.11.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se “*në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të kryhen pagesat dhe aplikimi sipas VKM-së nr. 389/2020...*”. Gjithashtu, nga Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 10989/1 prot., datë 29.01.2021 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se është vendosur masa e sekuestros për pasuritë e kërkuara.

Me shkresën nr. 1666 prot., datë 15.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor vënien në dispozicion të mjeteve dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me tre automjetet e përcaktuara në vendimin nr. 151 datë 01.10.2020 të GJKKO.

Me shkresën nr. 1683 prot., datë 19.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 151 datë 01.10.2020 të GJKKO. Në dosje janë administruar: **1**-proces-verbali “*mbi ekzekutimin e vendimit...*” i datës 14.12.2020, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit E.A. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “*është marrë në administrim pasuria e paluajtshme e llojit “truall” nr. 29/236, ZK 8512, me sipërfaqe totale 362 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe 193 m<sup>2</sup> ndërtesë dhe nisur nga fakti që kjo pasuri ishte në përdorim (pa asnjë titull) nga shtetasi E.A, nga administratorja i’u la këtij të fundit në ruajtje deri në caktimin e mënyrës së administrimit*”; **2**-proces-verbali “*mbi ekzekutimin e vendimit...*” i datës 14.12.2020, i mbajtur midis administratorit dhe OPGJ-së pranë komisariatit të policisë Shijak. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “*automjeti, autoveturë “Benz” me targë A.....J edhe pse me goma të rëna dhe nuk ndizej është marrë në dorëzim nga administratori por gjithsesi i është lënë në ruajtje komisariatit deri në momentin e transportimit*”; **3**-proces-verbali (akt-konstatimi) “*mbi ekzekutimin e vendimit...*” i datës 14.12.2020, i mbajtur midis OPGJ por

jo administratorit. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“jemi paraqitur pranë pasurisë (“arë+truall”, ZK 2309, me sipërfaqe të përgjithshme 856 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli 300 m<sup>2</sup>, ndërtesë 147 m<sup>2</sup>) por nuk kishte njeri prandaj ekzekutimi u shty për një datë tjetër.”*; 4-proces-verbali *“mbi ekzekutimin e vendimit...”* i datës 14.12.2020, i mbajtur midis OPGJ dhe administratorit. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është marrë në dorëzim pasuria e llojit “arë” (6000 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi sipas AMTP nr. 17,) pasuri e cila rezulton si një hapësirë boshe...”*;

Përkatësisht me shkresat nr. 2186 prot., datë 18.12.2020 dhe nr. 2187 prot., datë 21.12.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim sipas procesverbaleve të sipërcituar.

Në dosje administrohet gjithashtu relacioni si dhe proces-verbali *“mbi ekzekutimin e vendimit...”* i datës 08.02.2022, i mbajtur nga z. E.R (punonjës i AAPSK-së) në mungesë të administratores znj. B.I. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është marrë në administrim pasuria autoveturë “Audi” me targë A.....I...”*;

Me shkresën nr. 262 prot., datë 25.01.2022, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të plotë të vendimit nr. 151 datë 01.10.2020 të GJKKO.

**17-Në lidhje me vendimin nr. 155 datë 25.09.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit L. K. dhe të afërmve të tij, *“Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): “1- Pasuri e paluajtshme e llojit “njësi tregtare” nr. 26/137-N2, ZK 8603, Vlorë, me sipërfaqe 69.5 m<sup>2</sup>, në emër të L. dhe E.K.; 2- Pasuri e paluajtshme e llojit “njësi tregtare” nr. 26/105-N312, ZK 8603, Vlorë, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, në emër të L. dhe E.K.; 3- Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament” nr. 22/98+2-8, ZK 8603, Vlorë, në emër të L. dhe E.K.; 4- Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament”, Vlorë, me sipërfaqe 116.1 m<sup>2</sup>, me kontratë porosie nr. 1631 rep., dhe nr. 632 kol., datë 04.09.2014, në emër të L.K.; 5- Automjet, autoveturë “Fiat” me targë A.....B, në emër të M.K.;*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 30.09.2020 (protokolluar me nr. 1549).

Në datën 01.10.2020 me urdhrin nr. 1556 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. B.I.

Me shkresën nr. 1559 prot., datë 01.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Vlorë *“bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese”* në lidhje me katër pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 155 datë 25.09.2020 të GJKKO.

Nga ASHK, me shkresën nr. 14898/1 prot., datë 21.10.2020 *“kthim përgjigje”*, AAPSK bëhet me dije se *“në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të kryhen pagesat dhe aplikimi sipas VKM-së nr. 389/2020...”*. Gjithashtu, nga Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresën nr. 8145/1 prot., datë 13.10.2021 *“kthim përgjigje”*, AAPSK bëhet me dije se është vendosur masa e sekuestros vetëm për tre pasuritë e para të cilat rezultojnë të regjistruara.

Me shkresën nr. 1560 prot., datë 01.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 155 datë 25.09.2020 të GJKKO.

Në dosje janë administruar: 1-proces-verbali *“mbi ekzekutimin e vendimit...”* i datës 28.10.2020, ora 12:00, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasve L. dhe E.K. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është dorëzuar vullnetarisht dhe marrë në administrim pasuria (“njësi tregtare” nr. 26/137-N2, ZK 8603, Vlorë, me sipërfaqe 69.5 m<sup>2</sup>) e cila ishte bosh dhe pa orendi...”*; 2-proces-verbali *“mbi ekzekutimin e vendimit...”* i datës 28.10.2020, ora 12:20, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasve E.K. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: *“është dorëzuar vullnetarisht dhe marrë në administrim pasuria (“njësi tregtare” nr. 26/105-N312, ZK 8603, Vlorë, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>) në të cilën ushtrohej aktiviteti i parukerisë në emër të E.K., ...në mënyrë që të mos dëmtohej imazhi kjo pasuri i'u la në ruajtje znj. L. P, punonjëse në këtë parukeri”*; 3-proces-verbali *“mbi ekzekutimin e vendimit...”* i datës

28.10.2020, ora 12:45, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit R.N. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “*është dorëzuar vullnetarisht dhe marrë në administrim pasuria “apartament” nr. 22/98+2-8, ZK 8603, në të cilin jetonte me qira shtetasi R.N. Ky i fundit shprehu interesin për të marrë me qira objektin dhe për këtë arsye kjo pasuri i’u la në ruajtje deri në përfundimin e procedurave...*”; 4-akt-konstatimi “*mbi ekzekutimin e vendimit...*” i datës 28.10.2020, ora 13:00, i mbajtur midis OPGJ-së dhe shtetasve L. dhe E.K. Në këtë akt-konstatimi, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “*në pasurinë “apartament” me sipërfaqe 116.1 m<sup>2</sup> jetonte familja e L. dhe E.K, për këtë arsye dhe për të evituar pasoja sociale kjo pasuri i’u la në ruajtje...*”;

Përkatësisht me shkresat nr. 1809 dhe nr. 1810 prot., datë 02.11.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim sipas procesverbaleve të sipërcituar.

Në datën **27.06.2022** AAPSK është njohur me vendimin nr. 47 datë 02.11.2021 të GJKKO (protokolluar me nr. 1892), në ngarkim të shtetasit L.K. dhe të afërmve të tij, sipas të cilit është vendosur:

**1-** “*konfiskimi dhe kalimi në pronësi të shtetit të pasurive...(shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “njësi tregtare” nr. 26/137-N2, ZK 8603, Vlorë, me sipërfaqe 69.5 m<sup>2</sup>, në emër të L. dhe E.K; 2- Pasuri e paluajtshme e llojit “njësi tregtare” nr. 26/105-N312, ZK 8603, Vlorë, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, në emër të L.dhe E.K; 3- Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament”, Vlorë, me sipërfaqe 116.1 m<sup>2</sup>, me kontratë porosie nr. 1631 rep., dhe nr. 632 kol., datë 04.09.2014, në emër të L.K; 4- Automjet, autoveturë “Fiat” me targë A.....B, në emër të M. K; 2-* “*heqjen e masës së sekuestros për pasurinë...(shkurtimisht): “Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament” nr. 22/98+2-8, ZK 8603, Vlorë, në emër të L. dhe E.K;*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK, në kuadër të konfiskimit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon:

Me shkresën nr. 2020 prot., datë 06.07.2022, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 47 datë 02.11.2021 të GJKKO.

DPPSH ne shkresën nr. 1587 prot., datë 20.07.2022 ka njoftuar AAPSK, ndër të tjera, duke e bërë me dije këtë të fundit se: “*shtetasi L.K. nuk ka pranuar të bëjë lirim të pasurisë së konfiskuar (e cila përdorej për banim), për këtë arsye do të vijohet me veprime të tjera ligjore, (bashkëlidhur procesverbali)”*.

Me shkresën nr. 2019 prot., datë 06.07.2022, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Vlorë “*vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” dhe zbatimin e vendimit nr. 47 datë 02.11.2021 të GJKKO në lidhje me katër pasuritë e paluajtshme të përcaktuara.

Nga ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë me shkresën nr. 7467/1 prot., datë 25.08.2022 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se “*është ekzekutuar vendimi në lidhje me tre pasuritë e regjistruara ndërsa pasuria e referuar me kontratë nuk mund të identifikohet...Për pasuritë e kaluara shtet ju do të pajiseni vetëm me kartelë dhe harta treguese pasi sistemi jonë nuk gjeneron certifikata të cilat nuk kanë NIPT ose ID*”.

Nisur nga vonesat e procedurave, me shkresën nr. 2019/2 prot., datë 06.09.2022, AAPSK ka rikërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Vlorë “*vënien në dispozicion të certifikatave, kartelave dhe hartave treguese*” në zbatimin të vendimit nr. 47 datë 02.11.2021 të GJKKO.

Në kuadër të sa më sipër, në dosje është administruar edhe shkresa nr. 13661/2 prot., datë 15.09.2022 me të cilën ASHK ka kërkuar, nga Drejtoria Vendore Vlorë, marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e kërkesës së AAPSK-së.

Në mënyrë identike dhe të përsëritur, nga (ASHK) Drejtoria Vendore Vlorë me shkresën nr. 9669/1 prot., datë 18.10.2022 “*kthim përgjigje*”, AAPSK ribëhet me dije se “*është ekzekutuar vendimi në lidhje me tre pasuritë e regjistruara ndërsa pasuria e referuar me kontratë nuk mund të identifikohet...Për pasuritë e kaluara shtet ju do të pajiseni vetëm me kartelë dhe harta treguese pasi sistemi jonë nuk gjeneron certifikata të cilat nuk kanë NIPT ose id*”.

Pas njoftimit të policisë së shtetit, administratorja e pasurisë në datën 20.10.2022 është paraqitur në qytetin e Vlorës për të kryer ekzekutimin e vendimit në lidhje me pasurinë “apartament”, Vlorë, me sipërfaqe 116.1 m<sup>2</sup>, me kontratë porosie nr. 1631 rep., dhe nr. 632 kol., datë 04.09.2014”, por nuk ka mundur ta kryej. Për rastin konkret është mbajtur procesverbali i datës 20.10.2022 në të cilin, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “u mor kontakti telefonik me shtetasin L.K. i cili deklaroi që ndodhet në Tiranë..., pas takimit me avokatin e tij, ky i fundit deklaroi se nuk ka tagër për marrjen e njoftimeve por vetëm të përfaqësimit në gjykatë...”.

Në kuadër të vijimit të ekzekutimit, për sa më sipër, në dosje është administruar edhe shkresa nr. 2224 prot., datë 26.10.2022 me të cilën DPPSH ka kërkuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, marrjen e masave për lirimin forcërisht të pasurisë së sipërcituar në datën 10.11.2022. Sipas relacionit të kryer nga administratorja e pasurisë edhe në datën 10.11.2022 nuk u bë i mundur ekzekutimi i vendimit pasi nuk kishte përfaqësues të subjektit. Në këto kushte ekzekutimi u shty në mënyrë që Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë të shoqërojë forcërisht shtetasin L.K.

Sipas relacionit nr. 224 prot., datë 23.01.2023 të kryer nga administratorja e pasurisë si edhe korrespondencës me policinë e shtetit rezulton se për ekzekutimin e vendimit është tentuar edhe në datën 19.01.2023 por në kushtet kur nga subjektet e interesuara është bërë me dije se ka filluar një proces gjyqësor për rishikimin e vendimit, nga palët është lënë afat për ekzekutimin deri sa të shprehet gjykata.

Në datën **24.04.2023** AAPSK është njohur me vendimin nr. 16 datë 09.02.2023 të GJKKO (protokolluar me nr. 1421), sipas të cilit është vendosur: “*mospranimi i kërkesës për rishikim*”. Në këto kushte, me shkresën nr. 1592 prot., datë 15.05.2023, AAPSK ka rikërkuar nga DPPSH bashkëpunimin e saj në kuadër të vijimit të ekzekutimit të vendimit nr. 47 datë 02.11.2021.

**18-Në lidhje me vendimin nr. 3 datë 07.02.2020 të GJKKO**, në ngarkim të shtetasit B. S. dhe të afërmve të tij, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht):* “**1-Pasuria nr. 154/153 vol. 11 fq. 230, Z. K. 2574, e llojit Arë+Truall me sipërfaqe e 5954 m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe ndërtesë 3070 m<sup>2</sup>, e cila figuron në pronësi të shtetases E.S.** **2-Pasuria nr. 381/45 vol. 1 fq.116, zk,2704, e llojit ullishtë me sipërfaqe 6550 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me shtetasit A.H, D.O dhe M.L.** **3-Mjetet me targa A.....F, e markës Fiat, modeli 500, e vitit të prodhimit 2008 dhe A.....B, markës Land Rover, modeli RANGE ROVER, e vitit të prodhimit 2014 në pronësi të shtetases E.E.S;** **4-Mjetet me targa A.....Y, e markës AUDI, modeli A2, e vitit të prodhimit 2001 në pronësi të shtetases A.M.H;** **5-Mjetin me targa A.....B, e markës Fiat, modeli 500L, e vitit të prodhimit 2014 në pronësi të shtetasit E.O.S;** **6-Mjetet me targa A.....J, e markës Mercedes Benz, modeli B.....I, e vitit të prodhimit 2012 në pronësi të shtetases A.E.S;** **7-Aseteve, aksioneve/kuotave, dhe pasurive të subjektit "R.P." SHPK me NIPT L.....Q, me status aktiv me administrator z. S.O dhe aksionere me 100% të aksioneve shtetase E.S, si dhe të subjektit "B.S. " me NIPT L.....H, me aktivitet fast food me status aktiv.** **8-Llogari dhe shuma në Bankën R. të shtetases E.S me gjendje 1,981,946 lekë.** **9-Llogari dhe shuma në Bankën R. të shtetasit R.S me gjendje 1,121,298 lekë.** **10-Llogari dhe shuma në C. Bank të shtetases L.S me gjendje 19.000 Euro.** **11-Llogari dhe shuma në T. Bank të shtetasit B.S me balance 2.022 Euro.”**

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 11.02.2020 (protokolluar me nr. 170). Me vendimin e sekuestrimit, gjithashtu, është caktuar administrator znj. B.I.

Në dosje janë administruar: **1**-proces-verbali “*mbi ekzekutimin e vendimit...*” i datës 11.02.2020, ora 15:35, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit S.O (administrator i “*R. P. " SHPK*”). Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “*është dorëzuar dhe marrë në administrim pasuria (nr.154/153 vol.11 fq.230, Z.K.2574, e llojit Arë+Truall me sipërfaqe e 5954 m<sup>2</sup> dhe "R.P." sh.p.k.) së bashku me asetet e inventarizuara...*”; **2**-proces-verbali “*mbi ekzekutimin e vendimit...*” i datës 11.02.2020, ora 15:00, i mbajtur midis administratorit dhe OPGJ-së. Në këtë procesverbal, në mënyrë të



përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “*në ambientet e "R.P." SHPK gjenden mjetet me targa A.....B, markës Land Rover dhe A.....J e markës Mercedes Benz, të cilat janë dorëzuar dhe marrë në administrim nga administratorja dhe janë lënë në ruajtje z. S.SH. (roje objekti)*”; Në mënyrë të përsëritur, me shkresat nr. 179 prot., datë 12.02.2020 dhe nr. 179/1 prot., datë 19.02.2020, AAPSK ka kërkuar nga QKB “*ndryshimin e administratorit*” në lidhje me pasuritë e përcaktuara në vendimin nr. 3 datë 07.02.2020 konkretisht “*Aseteve, aksioneve/kuotave, dhe pasurive të subjektit "R.P." SHPK me NIPT L.....Q, me status aktiv me administrator z. S.O. dhe aksionere me 100% të aksioneve shtetase E.S., si dhe të subjektit "B.S." me NIPT L.....H, me aktivitet fast food me status aktiv*”. Nga QKB, me shkresën nr. 2224/1 prot., datë 21.02.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se është zbatuar kërkesa e sipërcituar (nr. 179 prot., datë 12.02.2020). AAPSK në përgjigje të shkresës nr. 2224/1 prot., datë 21.02.2020, me shkresën nr. 179/3 prot., datë 26.02.2020 ka konfirmuar për QKB-në ndryshimin e administratorit vetëm për “*R.P." SHPK pasi subjektit "B.S." me NIPT L.....H nuk është marrë ende në administrim*”.

Me shkresën nr. 180 prot., datë 12.02.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme “*nr. 154/153 vol. 11 fq. 230, Z. K. 2574, e llojit Arë+Truall me sipërfaqe e 5954 m<sup>2</sup>; nr. 381/45 vol. 1 fq. 116, zk. 2704, e llojit ullishte me sipërfaqe 6550 m<sup>2</sup>; Aseteve, aksioneve/kuotave, dhe pasurive të subjektit "R.P." SHPK me NIPT L.....Q, me status aktiv me administrator z. S.O. dhe aksionere me 100% të aksioneve shtetase E.S., si dhe të subjektit "B. S." me NIPT L.....H*”.

Nga Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. 1939/1 prot., datë 27.02.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se është zbatuar kërkesa e sipërcituar (nr. 180 prot., datë 12.02.2020).

Me shkresën nr. 181 prot., datë 12.02.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPSHTRR zbatimin e vendimit nr. 3 datë 07.02.2020 të GJKKO-së për pasuritë: “*Mjet me targa A.....F, e markës Fiat, mjet me targa A.....B Land Rover, mjetet me targa A.....Y e markës Audi, mjet me targa A.....B e markës Fiat, mjet me targa A.....J e markës Mercedes Benz...*”.

Nga DPSHTRR, me shkresën nr. 4224/1 prot., datë 25.02.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se në lidhje me kërkesën e sipërcituar (nr. 181 prot., datë 12.02.2020) “*organi kompetent është Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)*”.

Në dosje është administruar, në përputhje me dispozitat ligjore, korrespondenca midis AAPSK-së dhe bankave të nivelit të dytë me qëllim sekuestrimin në zbatim të vendimit nr. 3 datë 07.02.2020 të GJKKO-së për pasuritë: “*-Llogari dhe shuma në Bankën R. të shtetases E.S. me gjendje 1,981,946 lekë; -Llogari dhe shuma në Bankën R. të shtetasit R.S. me gjendje 1,121,298 lekë; -Llogari dhe shuma në C. Bank të shtetases L.S me gjendje 19.000 euro; -Llogari dhe shuma në T. Bank të shtetasit B.S. me balancë 2.022 euro...*”.

Përkatësisht me shkresat nr. 210 dhe nr. 211 prot., datë 21.02.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim sipas procesverbaleve të sipërcituar.

Me shkresën nr. 260 prot., datë 02.03.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I, ka informuar gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke kërkuar bashkëpunimin e OPGJ-së për ekzekutimin e plotë të vendimit (kërkesë e përsëritur me shkresat nr. 562 prot., datë 22.04.2020, nr. 701 prot., datë 18.05.2020, nr. 1691 prot., datë 20.10.2020) duke bërë me dije se kanë mbetur pa u marrë në administrim “*ullishte 6550 m<sup>2</sup>*” dhe “*fastfood*”.

Me shkresën nr. 315 prot., datë 06.03.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I, ka informuar kryeadministratorin në lidhje me studimin e fizibilitetit mbi pasurinë “*R. P.*” SHPK duke propozuar administrimin e drejtpërdrejtë të saj.

**19-Në lidhje me vendimin nr. 112 datë 20.07.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit G.K. dhe të afërmve të tij, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): "I-*

*Një ndërtesë 4-katëshe biznesi, me sip. totale 332,3 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 241/4-ND, ZK.2592, Vol.7, faqe 76, Maqellarë, Dibër, regjistruar në pronësi të shtetasit G.I.K. Ky objekt ka 2 kate shërbime dhe 2 kate banim, ku kati I- 77 m<sup>2</sup>, Kati II- 81.5 m<sup>2</sup> kati i III- 81.5 m<sup>2</sup> dhe kati i IV- 81.5 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe trualli 77 m<sup>2</sup>; 2-Një sipërfaqe trualli me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 241/4, ZK 2592, Vol 7, Fq. 75, në Maqellarë Dibër, regjistruar në pronësi të shtetasit G.I.K; 3-Një apartament me sipërfaqe 67.3 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 58/332/ND+1-25, Zona Kadastrale nr. 8518, volumi 60, faqe 171, Indeks harte DR-XY-1G, 17, ndodhur në lagjen nr. 13 Durrës, në pronësi të shtetasit I.G.K; 4-Pasuria me nr. 35/212, Z. K. 2932, vol. 19, fq. 158 e ndodhur në Peshkopi, në pronësi të I.G.K. Kjo pasuri është pjesë e ndarë e pasurisë nr. 35/132, ndërtesë 4-kate, ku 1 kat është lokal, një kat hotel dhe 2 kate banim; 5-pasuria me nr. 35/212+1-1, Z.K 2932, vol. 40, Fq. 48, Peshkopi, regjistrim i përkohshëm, regjistruar në pronësi të I.G.K. Kjo pasuri është ngritje kati mbi objektin ekzistues 4- katësh, pjesë e ndarë e pasurisë nr. 35/212, (ndërtesë 4-kate, ku 1 kat është lokal, një kat hotel dhe 2 kate banim); 6-Një automjet me targë A.....I, i markës “Audi” model A6”, në pronësi të shtetasit I.G.K; 7-Një automjet me targë A....., i markës “Audi” model A6”, në pronësi të shtetasit I.G.K.”*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara duke filluar nga data 03.08.2020 deri në datën 31.12.2022 janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 03.08.2020 (protokolluar me nr. 1181).

Në datën 05.08.2020 me urdhrin nr. 1225 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara, fillimisht është caktuar administrator z. E.T., më pas me urdhrin nr. 1636 datë 13.10.2020 është caktuar administrator z. S.M. Ky i fundit me urdhrin nr. 1828 datë 03.11.2020 është zëvendësuar me znj. B.I.

Në dosje është administruar: 1-proces-verbali “mbi ekzekutimin e vendimit...” i datës 09.12.2020, ora 12:00, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit G.K. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “është dorëzuar dhe marrë në administrim pasuria (ndërtesë 4-katëshe biznesi, me sip. totale 332,3 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 241/4-ND, ZK.2592), objekti rezulton i mbyllur dhe pa aktivitet; ...është dorëzuar dhe marrë në administrim pasuria (ndërtesë 4-katëshe nr. 35/212, Z.K 2932) vetëm për dy kate. Kati i parë i objektit është lokal pa aktivitet ndërsa kati i dytë hotel pa funksion. Kati i tretë dhe i katërt i lihen subjektit për banim...”; 2-proces-verbali “mbi ekzekutimin e vendimit...” i datës 16.12.2020, ora 10:00, i mbajtur midis administratorit, OPGJ-së dhe shtetasit G.K. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “është dorëzuar dhe marrë në administrim pasuria (nr. 58/332/ND+1-25, Zona Kadastrale nr. 8518, apartament në lagjen nr. 13 Durrës), objekti rezulton i dëmtuar nga tërmeti dhe i pabanuar...”; 3-proces-verbali “mbi ekzekutimin e vendimit...” i datës 09.12.2020, i mbajtur nga administratori. Në këtë procesverbal, në mënyrë të përmbledhur veç të tjerave, citohet se: “është dorëzuar dhe marrë në administrim pasuria (automjet me targë A.....I, i markës “Audi” model A6), mjet i cili është lënë në ruajtje pranë Drejtorisë së Policisë Dibër deri në transportimin e saj pranë magazinave të AAPSK-së...”.

Me shkresën nr. 1648 prot., datë 15.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Durrës “bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese” në lidhje me pasurinë e paluajtshme “nr. 58/332/ND+1-25, Z. K. nr. 8518, në lagjen nr. 13 Durrës”. Drejtoria Vendore Durrës (ASHK) me shkresën nr. 11361/1 prot., datë 04.12.2020 ka konfirmuar kryerjen e shërbimit.

Me shkresën nr. 1654 prot., datë 15.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Dibër “bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese” në lidhje me pasuritë e paluajtshme: “1-ndërtesë 4-katëshe biznesi, me sip. totale 332,3 m<sup>2</sup> nr. 241/4-ND, ZK.2592, Vol.7, faqe 76, Maqellarë, Dibër; 2-sipërfaqe trualli me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> nr. 241/4-ND, ZK.2592, Vol.7, faqe 76, Maqellarë, Dibër; 3-nr. 35/212, Z. K. 2932, vol. 19, fq. 158; 4-nr. 35/212+1-1, Z.K 2932, vol. 40, fq. 48, Maqellarë, Dibër;”.

Nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Dibër përkatësisht me shkresat nr. 15554/1 prot., datë 03.11.2020 dhe nr. 3687/1 prot., datë 20.10.2020 “kthim përgjigje”, AAPSK bëhet me dije se

*“në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të kryhen pagesat dhe aplikimi sipas VKM-së nr. 389/2020...”*.

Përkatësisht me shkresat nr. 2136 prot., datë 14.12.2020 dhe nr. 2161 prot., datë 16.12.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim sipas procesverbaleve të sipërcituar.

Në lidhje me pasuritë e mara në administrim, administratorja përkatëse, ka vijuar procedurat për qiradhënien e tyre në zbatim të kuadrit ligjor rregullator.

Në datën **23.06.2022** AAPSK është njohur me vendimin nr. 13 datë 21.02.2021 të GJKKO (protokolluar me nr. 1879), në ngarkim të shtetasit G.K dhe të afërmve të tij, sipas të cilit është vendosur konfiskimi i pasurive të sekuestruara me vendimin nr. 112 datë 20.07.2020 të GJKKO, duke ngarkuar AAPSK për administrimin e tyre.

Në lidhje me vendimin e konfiskimit, nga AAPSK dhe administratori përkatës i pasurive znj. Burbuqe Islami, deri në datën 31.12.2022 (periudhë auditimi) nuk rezulton të jetë kryer asnjë procedure tjetër në funksion të administrimit.

Në lidhje me sa më sipër konstatohet se, pas marrjes në dorëzim të pasurive të sipërcituara, nga ana e administratorit, në raportimin kundrejt kryeadministratorit, gjykatës dhe prokurorit të çështjes, ndër të tjera, citohet se: *“është kryer ekzekutimi i plotë i vendimit të gjykatës...”*. Pavarësisht këtij pohimi, nuk rezulton të jetë marrë në administrim automjeti me targë A.....Y, i markës “Audi” model A6.

Si konkluzion, raportimi i gabuar i gjendjes së ekzekutimit të vendimit në ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive sipas parimit të efektivitetit, efijencës, ekonomikitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi **znj. B.I.**, me detyrë administrator i pasurisë.

**20-Në lidhje me vendimin nr. 392 datë 14.10.2021** të GJKKO, me të cilin është vendosur: *(shkurtimisht): “-Caktimi i masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, mbi shoqërinë “A. E. F.” SHPK me NUIS L.....Q themeluar më datë 12.12.2011 dhe regjistruar në datë 13.12.2011, mbi aksionet, si dhe të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të këtij personi juridik.”*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 15.10.2021 (protokolluar me nr. 2805). Me vendimin e sekuestrimit, gjithashtu nga gjykata, është caktuar administrator i pasurive znj. B.I. Me shkresën nr. 2811 prot., datë 18.10.2021, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 392 datë 14.10.2021 të GJKKO. Me shkresën nr. 2810 prot., datë 18.10.2021, AAPSK ka kërkuar, nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, informacion të detajuar si dhe zbatimin e vendimit nr. 392 datë 14.10.2021 në lidhje me të gjitha llogaritë bankare të shoqërisë “A. E. F.”.

Me shkresën nr. 2817 prot., datë 18.10.2021, AAPSK ka kërkuar, nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Q.K.B.), zbatimin e vendimit nr. 392 datë 14.10.2021 si dhe informacion të detajuar në lidhje me dokumentet ligjorë të krijimit të shoqërisë “A. E. F.”.

Përkatësisht me shkresat nr. 2837 dhe nr. 2838 prot., datë 19.10.2021, administratori përkatës i pasurive znj. B.I., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit (të pjesshëm) duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim sipas procesverbaleve përkatëse bashkëlidhur informacionit. Pas disa informacioneve (relacione) periodike, konkretisht në datat 27.10.2021, 09.11.2021, 12.11.2021, përkatësisht me shkresat nr. 3523 dhe nr. 3524 prot., datë 28.12.2021, administratori përkatës i pasurive znj. B.I., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me përfundimin e ekzekutimit (të plotë) të vendimit duke kaluar në këtë mënyrë në administrim të AAPSK shoqërinë “A. E. F.”.

**21-Në lidhje me vendimin nr. 148 datë 29.09.2020** të GJKKO, në ngarkim të shtetasve K.B., E.F. dhe të afërmve të tyre, *“Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë... (gjithsej 65, shkurtimisht): “I-Pasuria e llojit apartament me nr. 5/651-ND+1-49, ZK 8513, Vol. 56, fq.137,*

sipërfaqe 81.14 m<sup>2</sup> Durrës, në pronësi të K.B; **2-Pasuria** e llojit apartament me nr. 5/651-ND+2-47, ZK 8513, Vol. 56, fq.197, sipërfaqe 65.6 m<sup>2</sup> Durrës, në pronësi të shtetasit K.B; **3-Pasuria** e llojit apartament me nr. 5/651-ND+2-50, ZK 8513, Vol. 56, fq.200, sipërfaqe 71.3 m<sup>2</sup> Durrës, në pronësi të shtetasit K.B; **4-Pasuria** e llojit apartament me nr. 5/651-ND+2-44, ZK 8513, Vol. 56, fq.194, sipërfaqe 111.40 m<sup>2</sup> Durrës, në pronësi të shtetasit K.B; **5-Pasuria** e nr. 4/40, Vol. 5, fq. 22 e llojit truall me sip. 1380 m<sup>2</sup>, ZK.2100 me adresë Karpen Durrës, në pronësi të shtetasit K.B; **6-Pasuria** e nr. 4/41, Vol. 5, fq. 23 e llojit Are me sip. 1824 m<sup>2</sup>, ZK.2100 me adresë Karpen Durrës, në pronësi të shtetasit K.B; **7-Pasuria** e nr. 34/53, Vol. 4, fq. 232 e llojit Arre me sip. 1380 m<sup>2</sup>, ZK. 2225 m<sup>2</sup> me adresë Armathe Durrës, në pronësi të shtetasve M.B dhe K.B; **8-Pasuria** e nr. 34/12, Vol. 1, fq. 140 e llojit Arre me sip. 1140 m<sup>2</sup>, ZK. 1038 m<sup>2</sup> me adresë Armathe Durrës, në pronësi të shtetasve M.B dhe K.B; **9-Pasuria** e llojit apartament në rrugën “Don Bosko” me nr. (B-6-8) kati i gjashtë mbi tokë, me sip. 81.01 m<sup>2</sup> me kontratën e poroisë 85/20 datë 10.10.2014, të cilën shtetasja M.B ia ka blerë shtetases S.P; **10-Pasuria** nr. 22/5, Bvol. 3 fq. 21 ZK 1038, lloji i pasurisë Arë me sip. Totale 12,200 m<sup>2</sup>, e përfutuar nga shtetasi R.V.F me aktin e marrjes së Tokës në pronësi nr. 16. Pasuria është transkriptuar në favor të shtetasit R.F, Xh.F, A.F, K.B, E.F; **11-Pasuria** nr. 5/24, ZK. 1522, lloji i pasurisë P.F (Ranishte) me sip. totale 7500 m<sup>2</sup>, e përfutuar nga shtetasi R.F me kontratë shitblerje; **12-Pasuria** me nr. 14/86, vol. 5 fq. 154, e llojit Arë me sip. 1824 m<sup>2</sup>, ZK. 2100, me adresë Armath Durrës, në pronësi të shtetasi E.F; **13-Pasuria** me nr. 14/87, vol. 5 fq. 155, e llojit Arë me sip. 500 m<sup>2</sup>, ZK. 1038, me adresë Armath Durrës, në pronësi të shtetasi E.F. **14-Pasuria** me nr. 9/227+2-11, vol. 35 fq.50, e llojit apartament me sip. 123.3 m<sup>2</sup>, me adresë Rruga Don Bosko Tiranë, në pronësi të shtetasi E.F; **15-Pasuria** me nr. 14/47, vol. 4 fq. 136 e ndodhur në Armath Durrës, në pronësi të shtetasi E.F; **16-Pasuria** me nr. 14/48, vol. 4 fq. 136 e ndodhur në Armath Durrës, në pronësi të shtetasi E.F; **17-Pasuria** me nr. 14/76, godinë banimi e shtetasi E.R.F, e përfutuar si aplikues me vetëdeklarimin nr. 12506, datë 18.12.2014 me adresë Armath, Manëz, Durrës; **18-Pasuria** me nr. 35/10 e krijuar si rezultat i ndarjessë pasurisë me nr. 35/3, vol. 3, Fq. 22, ZK.1038, lloji i pasurisë Arë, me sip. totale 630 m<sup>2</sup>, e përfutuar nga shtetasi R.V.F me aktin e marrjes së Tokës në pronësi nr.16; **19-Pasuria** me nr. 35/11 e krijuar si rezultat i ndarjes së pasurisë me nr. 35/3, vol. 3 faqe 22, ZK. 1038, lloji i pasurisë Arrë me sip. totale 630 m<sup>2</sup>, e përfutuar nga shtetasi R.V.F me Aktin e Marrjes së Tokës në pronësi me nr. 16; **20-Pasuria** me nr. 76/13 Vol. 3 fq. 22, ZK 1038, lloji i pasurisë Arrë me sip. totale 9000 m<sup>2</sup> e përfutuar nga shtetasi R.V.F me aktin e marrjes së Tokës në pronësi nr.16; **21-Pasuria** me nr.10/5, Vol.4, Fq. 28, ZK. 147, me sip. totale 805 m<sup>2</sup> nga të cilat 108 m<sup>2</sup> truall dhe nga sip. truall 396.9 m<sup>2</sup> Ndërtesë. **22-Pasuria** me nr.10/6, Vol.4, Fq. 28, ZK. 148, me sip. totale 805 m<sup>2</sup> nga të cilat 805 m<sup>2</sup> truall dhe nga sip. truall 396.9 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasit R.F; **23-Pasuria** nr. 10/7, vol. 4, Fq. 149, ZK.1038, lloji i pasurisë Truall me sip. totale 1388 m<sup>2</sup> e përfutuar nga shtetasi R.V dhe XH.F; **24-Pasuria** nr. 14/104, vol. 6, fq.23, lloji i pasurisë Arrë me sip. totale 5050 m<sup>2</sup> e përfutuar nga shtetasi R.V.F me Kontratë Dhurimi nga shtetasi T.C; **25-Pasuria** nr. 14/106, Vol. 6, Fq. 25, lloji i pasurisë Arë me sip. totale 811 m<sup>2</sup> përfutuar nga shtetasi R.V.F me kontratë dhurimi nr. 699/294, dt. 20.09.2019; **26-Pasuria** me nr. 34/7/2, ZK. 1038, sip. 300 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit R.V.F, shtesë e pasurisë me nr. 34/7; **27-Pasurinë** e llojit apartament, me nr. 1/362+2-12, ZK.8260, Vol.33, fq. 3, sip. 89.82 m<sup>2</sup>, ndodhur në bulevardin Bajram Curri, Tiranë në pronësi të shtetasit R.F; **28-Pasuri** e shtetasit R.F, si aplikues me vetëdeklarimin me nr. 12507; **29-Pasuri** e shtetasit R.F, si aplikues me vetëdeklarimin me nr. 12515; **30-Pasuri** e shtetasit R.F, si aplikues me vetëdeklarimin me nr. 5989, me adresë Armath, Manëz, Bashkia Durrës; **31-Pasuria** e shtetasve R.F, E.A.F, përfutuar si aplikues me vetëdeklarimin nr. 5957, me adresë Armath, Manëz Bashkia Durrës; **32-Pasuria** e shtetases XH.I.F, e përfutuar si aplikues me vetëdeklarimin nr. 6672, datë 19.01.2017 me adresë Armath Durrës. Për këtë aplikim subjekti është pajisur me leje legalizimi nr. 268425, datë 08.5.2017, godinë banimi 2 kate +1 katë nëntokë, Manëz bashkia Durrës; **33-Pasuria** e shtetases XH.I.F, e përfutuar si aplikues me vetëdeklarimin nr. 5988, datë 04.11.2014 me adresë Armath Durrës; **34-Pasuria** nr. 172/242/ND65+1-9, Vol. 15, Fq. 92, e llojit apartament

me sip. 67.3 m<sup>2</sup>, ZK2100, me adresë Lalëz Durrës, në pronësi të subjektit “R. B.D.”; **35-Pasuria e llojit Arë me nr. 319/11, vol. 7, fq. 48, Zk. 2332, aktualisht në pronësi të shoqërisë R. B.**; **36-Pasuria e llojit Arë me nr. 319/12, vol. 7, fq. 48, Zk. 2332, aktualisht në pronësi të shoqërisë R. B.**; **37-Pasuria 319/25, ZK 2332, vol. 7, fq.191 me adresë Kuraten Durrës në pronësi të shoqërisë R. B.**; **38-Pasuria e lloji arë 319/26, ZK 2332, vol. 7, fq.192 aktualisht në pronësi të shoqërisë R. B.**; **39-Pasuria me nr. 14/81, vol. 5 fq.83, e llojit arë me sip. 1054 m<sup>2</sup>, ZK.1038, me adresë Armath Durrës, në pronësi të shtetases M.F.**; **40-Pasuria nr. 14/82, Vol. 5, fq. 84, e llojit truall me sip. 500 m<sup>2</sup>, nga kjo 138 m<sup>2</sup> është godinë 2-katëshe, ZK. 1038, me adresë Armath Durrës, në pronësi të shtetases M.F.**; **41-Pasuria nr. 53/7, Vol. 1, fq. 1644, e llojit Arrë me sip. 5600 m<sup>2</sup>, ZK. 1038, me adresë Armath Durrës, në pronësi të shtetases M.F.**; **42-Pasuria nr. 34/45, Vol. 5, fq. 84, e llojit Arrë me sip. 3078 m<sup>2</sup>, ZK. 1038, me adresë Armath Durrës, në pronësi të shtetases M. F.**; **43-Pasuria nr. 9/227+2-27, ZK 8330 Vol. 35, fq. 88, e llojit Apartament në pronësi të shtetases M.F.** **44-Pasuri e shtetasve R.R.F dhe M.SH.F, si aplikues me vetëdeklarimin nr. 5990, datë 04.11.2014 nga verifikimet në sistemin online me adresë Armath, Manëz, Bashkia Durrës;** **45-Pasuria nr. 34/73, vol. 5, Fq. 79, Zk. 1038, lloji i pasurisë Arë me sip. totale 1800 m<sup>2</sup> e përfituar nga shtetasi R.F si ndarje e pasurisë nr. 34/7. Pasuria është transkriptuar në favor të shtetasit A.F, me kontratë pjesëtimi nr.1256/646;** **46-Pasuria nr. 34/74, vol.5, fq. 80, lloji i pasurisë truall me sip. totale 300 m<sup>2</sup>, nga të cilat 300 m<sup>2</sup> dhe 105 m<sup>2</sup> Ndërtesë (godinë 3-katëshe banim) përfituar nga ndarja e pasurisë nr.34/7;** **47-Pasuria e shtetasit A.R.F me nr. 604, ndodhur në Manëz, Durrës, sipërfaqja e truallit e zënë 500 m<sup>2</sup>, viti i ndërtimit 2005;** **48-Pasuria me nr. 2/582-G30, vol. 58, fq. 125, Zk. 8150, e llojit garazh, ndodhur në rrugën “Qemal Stafa” Tiranë, në pronësi të shtetasit A.XH;** **49-Pasuria me nr. 2/582-G29, vol. 58, fq. 124, Zk. 8150, e llojit garazh, ndodhur në rrugën “Qemal Stafa” Tiranë, në pronësi të shtetasit A.XH;** **50-Pasuria me nr. 2/582-1-23, vol. 58, fq. 124, Zk. 8150, e llojit Apartament, ndodhur në rrugën “Qemal Stafa” Tiranë, në pronësi të shtetasit A.XH;** **51-Pasuria nr. 4/35, ZK.2100, Vol.4, Fq. 232, lloji i pasurisë Arë me sip. totale 3204 m<sup>2</sup> e regjistruar me referencë nr. 334 në pronësi të shtetasit A.XH;** **52-Subjekti tregtar “E. E. S.” SHPK me NIPT L.....F me administrator K.B;** **53-Subjekti tregtar “R.-B.” SHPK me NIPT K.....B, me administrator dhe aksioner R.F;** **54-Subjekti tregtar “R. b.” SHPK me nipt L.....H, me administratore shtetasen M.B ortak shtetasin K.B;** **55-Subjekti tregtar “R. C.” SHPK me NIPT K.....T, me administrator shtetasin E.F dhe ortakun shtetasin R.F;** **56-Subjekti tregtar “E.F” person fizik me nr. NIPT L.....R, me administrator E.F, me seli në Armath Manëz, Durrës, godinë private 1 katëshe;** **57-Mjeti me targë A.....B, tip autoveturë, e markës Mercedes Benz, e vitit 2014, në pronësi të shtetases M.F.;** **58-Mjeti me targë A.....N, tip auto veturë, e markës Smart, e vitit 1999, në pronësi të shtetases M.B;** **59-Mjeti me targë A.....A, tip autoveturë, e markës BMW X5, e vitit 2007, në pronësi të M.B;** **60-Mjeti me targë D.....E, e markës Mercedes benz, e llojit ATP, i viti 2000, ngjyra e bardhë në pronësi të shtetasit E.R.F;** **61-Mjeti me targë A.....I e llojit autoveturë , e markës B.....D, e vitit 2015, ngjyrë e zezë, në pronësi të shtetasit A.XH;** **62-Mjeti me targë A.....V, e llojit autoveturë, e markës SQ7, në pronësi të shtetasit A.F.XH;** **63-Mjeti me targë A.....O, e llojit autoveturë, e markës B.....D, në pronësi të shtetasit A.F.XH;** **64-Mjeti me targë A..... e llojit motorë, e markës BMW R.....T, në pronësi të shtetasit A.F.XH** **65-Mjeti me targë A.....V, e llojit autoveturë, e markës Audi A4, në pronësi të shtetasit A.R.F”.**

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara janë si vijon: Vendimi i gjykatës, për zbatimin e të cilit është caktuar administrator znj. B.I., është marrë nga AAPSK në datën 13.10.2020 (protokolluar me nr. 1623).

Me shkresën nr. 1668 prot., datë 16.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 148 datë 29.09.2020 të GJKKO. Me shkresën nr. 1660 prot., datë 15.10.2020, AAPSK ka kërkuar, nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Q.K.B.), zbatimin e vendimit nr. 148 datë 29.09.2020 si dhe informacion të detajuar në lidhje me dokumentet ligjorë të krijimit të subjekteve “E. E. S.” SHPK, “R. -B.” SHPK, “R. b.” SHPK, “R. C.” SHPK dhe “E. F.” person fizik. Nga QKB, me shkresën nr. 9358/1 prot.,

datë 02.11.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se është zbatuar kërkesa e sipërcituara (nr. 1660 prot., datë 15.10.2020).

Me shkresën nr. 1667 prot., datë 15.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH dhe DPSHTRR zbatimin e vendimit nr. 148 datë 29.09.2020 në lidhje me pasuritë “*Mjete Rrugore (gjithsej 9 mjete)*” duke kërkuar bllokimin e mjeteve së bashku me dokumentacionin përkatës.

Me shkresën nr. 1669 prot., datë 16.10.2020, AAPSK ka kërkuar nga ASHK dhe Drejtoria Vendore Tiranë dhe Durrës “*bllokimin dhe vënien në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese*” në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përcaktuara në vendimin nr. 148 datë 29.09.2020 (*gjithsej 56 pasuri*). Nga ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë (Tirana veri) dhe Durrës përkatësisht me shkresat nr. 10148/1 prot., datë 10.12.2020 dhe nr. 11049/1 prot., datë 20.11.2020 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se janë zbatuar kërkesat e sipërcituara.

Përkatësisht me shkresat nr. 2235 dhe nr. 2226 prot., datë 24.12.2020, administratori përkatës i pasurive znj. B.I, ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit (të pjesshëm) duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim sipas procesverbaleve përkatëse bashkëlidhur informacionit. Relacionet mbi ecurinë e ekzekutimit janë kryer në mënyrë periodike nga administratorja në përputhje me ligjin nr. 34/2019.

Gjithashtu nga AAPSK (administratori i pasurive) është kërkuar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, informacion të detajuar si dhe zbatimin e vendimit nr. 148 datë 29.09.2020 në lidhje me të gjitha llogaritë bankare të shoqërive objekt vendimi.

**22-Në lidhje me vendimin nr. 62 datë 15.01.2021** të GJKKO, në ngarkim të shtetasit Ç.M. dhe të afërmve të tij, “*Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë...(shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “truell” nr. 7/80, ZK 8110, 206 m<sup>2</sup>, Tiranë, mbi të cilën ndodhet edhe pasuria ndërtesë “godinë banimi” me 3 kate e legalizuar...; 2-Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament” nr. 60/105+2-34, ZK 2679, 93.4 m<sup>2</sup>, Mëzes, Tiranë; 3-Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament” nr. 60/105+3-36, ZK 2679, 107.8 m<sup>2</sup>, Mëzes, Tiranë; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament”, 64.08 m<sup>2</sup>, Qesarak, Tiranë, e përfutuar me kontratën nr. 8928 rep. dhe nr. 3519 kol. date 07.11.2016...; 5-Automjet i markës “Benz” ML me targa A.....U.*

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara, deri në datën 31.12.2022 janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 19.01.2021 (protokolluar me nr. 172).

Në datën 21.01.2021 me urdhrin nr. 207 të Kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. E.A.

Me shkresën nr. 310 prot., datë 29.01.2021, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 62 datë 15.01.2021 të GJKKO.

Përkatësisht me shkresat nr. 469, 471 dhe 472 prot., datë 10.02.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore (Tirana Rurale 1 dhe 2) dhe Tirana Veri ekzekutimin e vendimit nr. 62 datë 15.01.2021 të GJKKO në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Nga ASHK, me shkresën nr. 2944/1 prot., datë 17.03.2021 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se “*në mënyrë që të ofrohet shërbimi i kërkuar duhet të kryhen pagesat dhe aplikimi sipas VKM-së nr. 389/2020...*”. Nga Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. 1997/1 prot., datë 22.02.2021 “*kthim përgjigje*”, AAPSK bëhet me dije se është ekzekutuar kërkesa në lidhje me pasurinë “*nr. 7/80, ZK 8110, 206 m<sup>2</sup>, Tiranë, mbi të cilën ndodhet edhe pasuria ndërtesë “godinë banimi” me 3 kate...*”.

Përkatësisht me shkresat nr. 985 dhe 972 prot., datë 19.03.2021, administratori përkatës i pasurive znj. E.A, ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim. Konkretisht, në relacionin e përgatitur, ndër të tjera, citohet se: “*Në pasurinë me nr. rendor 1 jetonin Ç.M. dhe familja e tij, për këtë arsye kjo pasuri nuk u mor në administrim. Pasuritë me nr. rendor 2 dhe 3 rezultojnë apartamente të pa përfunduar (dyer, dritare, energji, etj), për këtë arsye këto pasuri nuk u morën në administrim. Pasuria me nr.*

rendor 4 ishte e dhënë me qira (pa kontratë) nga shtetasi Ç.M, kjo pasuri u mor në administrim. Pasuria me nr. rendor 6 (automjet) është shpallur në kërkim dhe pritet bllokimi i saj për të vijuar procedurat...”.

Në lidhje me pasurinë e marrë në administrim “e llojit “apartament”, 64.08 m<sup>2</sup>, Qesarak, Tiranë” nga ana e administratores janë ndjekur procedurat për dhënien me qira.

**23-Në lidhje me vendimin nr. 81 datë 02.02.2021** të GJKKO, në ngarkim të shtetasis A.I. dhe të afërmeve të tij, “Për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë... (shkurtimisht): “1-Pasuri e paluajtshme e llojit “ndërtesë” (kompleks shërbimesh) nr. 152/10-ND, ZK 3981, 529.40 m<sup>2</sup>, Fier; 2-Pasuri e paluajtshme e llojit “truall” nr. 8/538, ZK 8532, 1580 m<sup>2</sup>, Fier, mbi të cilën është ndërtuar një objekt me sipërfaqe 1200 m<sup>2</sup> (dyqane)...; 3-Pasuri e paluajtshme e llojit “banesë vile 3-katëshe” (vetëdeklarim) nr. 8/620, ZK 8532, Sheq i Madh, Fier; 4-Pasuri e paluajtshme e llojit “njësi” nr. 11/69-N13, ZK 8531, 55.16 m<sup>2</sup>, Fier; 5-Automjet i markës “Audi” A4 me targa A.....A.

Procedurat e ndjekura nga AAPSK në lidhje me pasuritë e sipërcituara, deri në datën 31.12.2022 janë si vijon: Vendimi i gjykatës është marrë nga AAPSK në datën 08.02.2021 (protokolluar me nr. 422).

Në datën 08.02.2021 me urdhrin nr. 433 të kryeadministratorit, në lidhje me pasuritë e sipërcituara është caktuar administrator znj. E.A.

Me shkresën nr. 467 prot., datë 10.02.2021, AAPSK ka kërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të vendimit nr. 81 datë 02.02.2021 të GJKKO.

Me shkresën nr. 475 prot., datë 10.02.2021, AAPSK ka kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Fier, ekzekutimin e vendimit nr. 81 datë 02.02.2021 të GJKKO në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Nga Drejtoria Vendore Fier, me shkresën nr. 1099/1 prot., datë 12.03.2021 “kthim përgjigje”, AAPSK bëhet me dije se “është vendosur sekuestro për pasuritë e paluajtshme (sipas vendimit) me nr. rendor 1, 2 dhe 4...”.

Përkatësisht me shkresat nr. 1231 dhe 1230 prot., datë 12.04.2021, administratori përkatës i pasurive znj. E.A., ka informuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë e ekzekutimit duke bërë me dije këta të fundit në lidhje me gjendjen e pasurive të marra në administrim. Konkretisht, në relacionin e përgatitur, ndër të tjera, citohet se: “Në pasurinë me nr. rendor 3 jetonin A.I dhe familja e tij, për këtë arsye kjo pasuri nuk u mor në administrim. Pasuria me nr. rendor 1 rezulton pa aktivitet, kjo pasuri u mor në administrim pa probleme. Pasuritë me nr. rendor 2 dhe 4 ishin dhënë me qira dhe palët qiramarrëse shprehen interes për vazhdimin e kontratave me AAPSK. Pasuria me nr. rendor 5 (automjet) është shpallur në kërkim dhe pritet bllokimi i saj për të vijuar procedurat...”.

Në lidhje me gjendjen e pasurive të sekuestruara dhe të marra në administrim, administratori përkatës i pasurive znj. E.A., përkatësisht me shkresat nr. 2507 dhe 2508 prot., datë 13.09.2021, ka riinformuar kryeadministratorin, gjykatën dhe prokurorinë në lidhje me ecurinë. Ky informacion, i shoqëruar me procesverbalet përkatëse, në mënyrë periodike është përsëritur edhe në datën 09.09.2021.

Me shkresën nr. 2179 prot., datë 22.07.2021, AAPSK ka rikërkuar nga DPPSH (OFL) bashkëpunimin e saj në kuadër të ekzekutimit të plotë të vendimit nr. 81 datë 02.02.2021.

Në datën 03.03.2022 nga administratori përkatës i pasurive znj. E.A. është kryer një kontroll fizik i pasurive të marra në administrim për të cilat nuk janë konstatuar probleme dhe është raportuar tek kryeadministratorin me shkresën nr. 745 prot., datë 09.03.2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur nga administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim gjykate, të trajtuara si më sipër me nr. rendor 1-23, u konstatua mosveprimi në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht: **Ligji nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18**, sipas të cilit: “Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori i pasurisë së sekuestruar merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë, duke lidhur kontrata sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Për sigurimin e këtyre shërbimeve zbatohen procedurat e prokurimit publik.”; **VKM nr. 687, datë**

**5.10.2011 “Për Organizimin, Kompetencat dhe Funksonimin e Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe Mënyrën e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të”, kreu VI, pika 2/b, sipas të cilit: “Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori i pasurisë merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë, duke lidhur kontrata sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Për sigurimin e këtyre shërbimeve zbatohen procedurat e prokurimit publik.”; Udhëzimi nr. 324, datë 2.10.2020 “Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave...”, kreu II, pika 2/3, sipas të cilit: “...Sigurimi i pasurisë bëhet për çdo njësi pasurie. Për pasuritë e paluajtshme, vlera për t’u siguruar do të jetë jo më e vogël se vlera e referencës së dhënë në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.”; Rregullorja nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK-së, neni 17, pika 6, sipas të cilës: “Pas marrjes në administrim të pasurisë së sekuestruar, Administratori i pasurisë bën sigurimin fizik të pasurisë, bazuar në llojin dhe veçoritë e secilës pasuri.”.**

Në të gjitha rastet apo praktikatat e shqyrtuara nga grupi i auditimit rezulton se, në asnjë rast, nga administratori i pasurisë së sekuestruar, nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Gjithashtu, nuk rezultojnë të jenë kryer nga administratorët veprime paraprake për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kontrate të vlefshme sigurimi të pasurisë përpara marrjes së tyre në administrim, çka do të justifikonte apo përligjte mosveprimin në rastin konkret.

Si konkluzion, mosmarrja e masave për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, ekspozon eventualisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohen me përgjegjësi:

**-Administratorët** e pasurive: z. A.B, z. E.R, znj. B.I, z. E.B, z. S.M, z. F.A, znj. E.A, znj. E.O;  
**-Kryeadministratori** (A.K. periudha 01.10.2017-09.03.2021; Q.TH., periudha 09.03.2021-01.04.2022 dhe A.K., periudha 01.04.2022-31.12.2022), në zbatim të nenit 9, pika 2/b, i ligjit nr. 34/2019 ngarkohet me kompetencën dhe përgjegjësinë për të mbikëqyrur dhe kontrolluar veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Nga përfaqësuesit e AAPSK znj. E.O. me shkresën nr. 27/46 prot., datë 11.08.2023, znj. B.I. me shkresën nr. 27/45 prot., datë 11.08.2023, z. S.M. me shkresën nr. 27/44 prot., datë 10.08.2023, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:

**Pretendimi i subjektit:** (në mënyrë të përmbledhur)

**z. S.M.:** -“Nga ana e administratorëve janë kryer rregullisht kërkesat për sigurimet e domosdoshme të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara deri në vitin 2019. Gjatë periudhës objekt auditimi viti 2019 e në vazhdim për mungesë fondesh është bërë ndërprerja e kërkesave të sigurimeve të domosdoshme. (nga ana e administratorëve janë bërë kërkesat për kryerjen e këtij shpenzimi por për mungesë të protokollit të brendshëm e kemi të pamundur vërtetimin e këtij veprimi). Përgjegjësi i sektorit ekonomik financiar ka kundërshtuar dhe nuk ka miratuar këto kërkesa”.

(Pas dorëzimit të akt-konstatimeve nga grupi i auditimit ) Është vijuar menjëherë me marrjen e masave të sigurimit të domosdoshëm (ZTE)...

**znj. E.O.:** -“Administratori, ka kryer një sërë kërkesash për sig nga dëmtimet e ujit, zjarrit dhe faktorë të tjerë natyror, por përgjegjësi i sektorit ekonomik financiar në bashkëpunim me të cilin bëhen këto kërkesa, i cili ka dhe përgjegjësi për llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të AAPSK, ka pasur raste, për shkak të shpenzimeve të mëdha të AAPSK që vinin nga numri i pasurive në administrim nuk e ka parë të nevojshme kryerjen e këtij sigurimi.

**znj. B.I.:** -“Sigurimi dhe kontrata e sigurimit të pasurisë nuk është kompetencë e administratorit. Në rastin konkret unë si administratore për çdo pasuri të marrë në dorëzim i kam paraqitur institucionit kërkesë për sigurimin e pronës. Në institucionin tonë mungon



*protokoll i brendshëm dhe shumë kërkesa të miat kanë mbet pa protokoll” ... Në dosjen “G.. që unë kam në administrim ka dy kontrata sigurimi...”*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga z. M., në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. Pretendimi se sigurimi i pasurive kërkon fonde të cilat, sipas pretendimeve verbale të subjektit, nuk disponohen nuk përjashton zbatimin e nenit 18 i ligjit nr. 34/2019. “Njoftimi” se, pas dorëzimit të akt-konstatimeve nga grupi i auditimit, është vijuar menjëherë me marrjen e masave të sigurimit të domosdoshëm, nuk ndikon mbi gjetjen e grupit të auditimit pavarësisht se ky i fundit e vlerëson atë pozitivisht.

-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga znj. O. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. Pretendimi i mungesës së bashkëpunimit midis stafit (“ka kërkesa por nuk ka protokoll”) në kuadër të sigurimit të pasurive nuk përjashton përgjegjësinë e administratorit përkatës për zbatimin e nenit 18 i ligjit nr. 34/2019.

-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga znj. I., në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. Për sa i përket pretendimit se “*nuk është kompetencë e administratorit*” sqarojmë se, ky pretendim është i gabuar. Konkretisht, neni 18 i ligji nr. 34/2019; VKM nr. 687, datë 5.10.2011, kreu VI, pika 2/b dhe Rregullorja nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK-së, neni 17, pika 6, përcaktojnë në mënyrë eksplicite se: “*administratori i pasurisë së sekuestruar merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë.* Gjithashtu, edhe pse nga ana e subjektit pretendohet se ka edhe pasuri për të cilat janë kryer sigurimet e nevojshme, grupi i auditimit thekson se ka hartuar gjetjen mbi procedurat dhe praktikatat e audituara të specifikuara sa më sipër.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në procedurat e ndjekura nga administratori në funksion të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
<b>Situata:</b>	<p>1)- Nga shqyrtimi i praktikës, në lidhje me procedurat e ndjekura nga administratori në funksion të qiradhënies së pasurisë, rezulton se përpara lidhjes kontratës së qirasë nuk është kërkuar deklaratë me shkrim nga qiramarrësi, ku ky i fundit të deklarojë se nuk ka lidhje me shtetasin të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës. Në këtë rast, administratori nuk ka vepruar sipas kërkesave të Rregullores nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25, sipas të cilës: “<i>Administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në lidhjen e kontratave të qirasë të pasurive, të kërkojnë deklaratë me shkrim nga personat fizik apo juridik, të cilët do të marrin me qira pasurinë, që nuk kanë lidhje me shtetasit apo subjektet e përfshira në vendimin e gjykatës, të cilëve ju është bërë sekuestrimi apo konfiskimi i pasurisë</i>”.</p> <p>2)- Nga shqyrtimi i praktikës së ndjekur nga administratorët përkatës, rezulton se nuk janë marrë masat për zbatimin e plotë të vendimit të gjykatës. Në informacionin e përgatitur nga administratori citohet ndër të tjera se: “<i>subjekti “T. B.” me NIPT K.....E nuk mund të merret në administrim pasi ka rezultate negative (mungesë fitimi) dhe për pasojë mund të ketë impakt social negativ...</i>”. Vendimi i marrë në mënyrë diskrecionale nga ana e administratorit për të mos marrë një pasuri në administrim rezulton në kundërshtim me nenin 11, pika 2 (a, c) të ligjit nr. 34/2019 “<i>Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të</i></p>

*Konfiskuara” sipas të cilës: “Administratori i pasurisë a) njofton menjëherë për masën e sekuestrimit për pasuritë e sekuestruara të regjistruara, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; c) merr në administrim pasuritë e sekuestruara që i caktohen për administrim” dhe dispozitivin e vendimit nr. 178 datë 28.10.2020 të GJKKO. Mosmarrja në administrim e pasurive, e justifikuar me një vlerësim subjektiv të situatës, edhe pse me të cilin ka bërë me dije gjykatën apo prokurorin e çështjes, nuk justifikojnë mosveprimin e administratorit deri në momentin që gjykata nuk ka dalë me një vendim tjetër apo “të ndryshuar”. Nga ana tjetër, në rastin konkret, justifikimi i fitimit të munguar të subjektit nuk qëndron pasi, sipas ekstraktit të shoqërisë, kjo e fundit ka deklaruar 16,680,084 lekë fitim për vitin 2020 dhe 216,767,616 lekë fitim për vitin 2021.*

3)- Administratori i pasurisë, në lidhje me veprimet e “bllokimit” të pasurive pranë ASHK-së përkatëse, ka vepruar me një vonesë prej më shumë se 8 muaj, nisur nga fakti se emërimi i tij është kryer në datën 29.10.2020 ndërsa kërkesa drejtuar ASHK-së është e datës 28.07.2021. Në lidhje me këto veprime, në kuadrin ligjor rregullator, parashikohet se administratori duhet të veprojë menjëherë. Konkretisht, neni 11, pika 2/a, e ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” përcakton se: “Administratori i pasurisë njofton menjëherë për masën e sekuestrimit për pasuritë e sekuestruara të regjistruara, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra”.

- Administratori i pasurisë, në lidhje pasurinë “*truall 900 m<sup>2</sup> nga të cilat 300 m<sup>2</sup> ndërtesë, në të cilën kryhet aktiviteti “hotel, restaurant, bar-kafe”*”, pasi e ka marrë në dorëzim, i ka lënë administrimin e saj shtetases, e cila është subjekt i vendimit të sekuestrimit. Edhe pse sipas procesverbalit citohet se “*këto pasuri i janë lënë në ruajtje...*” disponimi i pasurisë në rastin konkret përkon me administrimin e saj. Situata në rastin konkret është në kundërshtim me frymën e ligjit si dhe Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25, sipas të cilës: “*Administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në lidhjen e kontratave të qirasë të pasurive, të kërkojnë deklaratë me shkrim nga personat fizik apo juridik, të cilët do të marrin me qira pasurinë, që nuk kanë lidhje me shtetasit apo subjektet e përfshira në vendimin e gjykatës, të cilëve ju është bërë sekuestrimi apo konfiskimi i pasurisë”.*

4)- Nga auditimi i kryer, konstatohet se në 2 (dy) raste, në mënyrë të pashpjegueshme, për një kohë të gjatë, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive të paluajtshme, të konfiskuara me vendim gjykate, konkretisht:

-Për pasurinë e konfiskuar me vendimin “*nr. 4 datë 18.01.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda*”, për një periudhë 12-vjeçare (2008-2022) nuk është kryer asnjë veprim. Gjithashtu, duke filluar që nga data e emërimit të administratores së pasurisë 07.09.2022 deri aktualisht në datën e hartimit të këtij akt konstatimi 09.06.2023, edhe pse procedurat paraprake të nevojshme janë kryer, kjo pronë, në tejkalim të afateve (90 ditë), ende nuk i është kaluar për vendimmarrje destinimi Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimet të Organizuar.

-Për pasurinë e konfiskuar me vendimin “nr. 37 datë 13.07.2021 të GJKKO”, për një periudhë 9-mujore pas datës së komunikimit të vendimit të formës së prerë të konfiskimit nuk është kryer asnjë veprim.

5)- Nga auditimi i kryer, konstatohet se pas marrjes në dorëzim të pasurive të paluajtshme, nga ana e administratorit nuk rezultojnë të jetë kryer një raportim kundrejt kryeadministratorit, gjykatës apo prokurorit të çështjes mbi gjendjen e pasurive. Gjithashtu nuk rezultojnë e dokumentuar, të jetë kryer ndonjë veprim me qëllim rritjen e vlerës së pasurive duke i dhënë ato me qira. Në lidhje me këtë situatë, neni 11, pika 2/(ç dhe e) e ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” përcakton se: “Administratori i pasurisë..., ç) nëse është e mundur, rrit vlerën e pasurisë që ka në administrim; e)...paraqet raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, për kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit, për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit;”.

6)- Nga auditimi i kryer, konstatohet se pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara me vendimin nr. 112 datë 20.07.2020 të GJKKO, nga ana e administratorit, në raportimin kundrejt kryeadministratorit, gjykatës dhe prokurorit të çështjes, ndër të tjera, citohet se: “është kryer ekzekutimi i plotë i vendimit të gjykatës...”. Pavarësisht këtij pohimi, nuk rezultojnë të jetë marrë në administrim automjeti me targë A.....Y, i markës “Audi” model A6. Në lidhje me këtë situatë, neni 11, pika 2/(dh) e ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” përcakton se: “Administratori i pasurisë..., dh) paraqet çdo kërkesë të nevojshme për ekzekutimin e masës së sekuestrimit dhe për administrimin e sendit, pranë prokurorisë, shërbimit përmbartës apo çdo institucioni tjetër shtetëror”, gjithashtu neni 5 i ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” përcakton se: “Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, efikasitetit, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit”.

7)- Pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara, në të gjitha rastet apo praktikave të shqyrtuara nga grupi i auditimit rezultojnë se, në asnjë rast, nga administratori i pasurisë së sekuestruar, nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Gjithashtu, nuk rezultojnë të jenë kryer nga administratorët veprime paraprake për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kontrate të vlefshme sigurimi të pasurisë përpara marrjes së tyre në administrim, çka do të justifikonte apo përlligjte mosveprimin në rastin konkret. Në rastin konkret, situata është në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht: Ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18, sipas të cilit: “Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori i pasurisë së sekuestruar merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë, duke lidhur kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Për sigurimin e këtyre shërbimeve zbatohen procedurat e prokurimit publik.”; VKM nr.

	<p>687, datë 5.10.2011 “Për Organizimin, Kompetencat dhe Funksionimin e Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe Mënyrën e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, kreu VI, pika 2/b, sipas të cilit: “Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori i pasurisë merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë, duke lidhur kontrata sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Për sigurimin e këtyre shërbimeve zbatohen procedurat e prokurimit publik.”; Udhëzimin nr. 324, datë 2.10.2020 “Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave për Administrimin e të Ardhurave dhe Limiteve të Kryerjes së Shpenzimeve për Pasuritë e Sekuestruara dhe Konfiskuara”, kreu II, pika 2/3, sipas të cilit: “...Sigurimi i pasurisë bëhet për çdo njësi pasurie. Për pasuritë e paluajtshme, vlera për t’u siguruar do të jetë jo më e vogël se vlera e referencës së dhënë në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.”; <b>Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK-së, neni 17, pika 6</b>, sipas të cilës: “Pas marrjes në administrim të pasurisë së sekuestruar, Administratori i pasurisë bën sigurimin fizik të pasurisë, bazuar në llojin dhe veçoritë e secilës pasuri.”.</p>
<p><b>Kriteri:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 9, pika 2, neni 11, pika 2 (a), (c) dhe (d), neni 18 dhe neni 23, pika 2;</li> <li>- VKM nr. 687, datë 5.10.2011 “Për Organizimin, Kompetencat dhe Funksionimin e Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe Mënyrën e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, kreu VI, pika 2/b;</li> <li>- Udhëzimi nr. 324, datë 2.10.2020 “Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave për Administrimin e të Ardhurave dhe Limiteve të Kryerjes së Shpenzimeve për Pasuritë e Sekuestruara dhe Konfiskuara”, kreu II, pika 2/3;</li> <li>- Rregullorja nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK, neni 14, pika 25, neni 17, pika 6.</li> </ul>
<p><b>Impakti:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mosplotësimi i deklaratës (mohuese) me shkrim nga qiramarrësi përpara nënshkrimit të kontratës së qirasë, përbën një risk të shtuar që pasuritë e administruara formalisht "de jure" nga AAPSK të administrohen në të vërtetë "de facto" nga subjekti apo shtetasi të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës.</li> <li>- Mosmarrja e në administrim të gjitha pasurive të specifikuar në vendimin e gjykatës e justifikuar me një vlerësim subjektiv të situatës rrezikon, veç të tjera, humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestrës preventive”.</li> <li>- Vonesat në kryerjen e veprimeve të administratorit përbëjnë një risk eventual (tjetërsim pasurie), për humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestrës preventive”, duke ndikuar gjithashtu negativisht në administrimin e pasurisë.</li> <li>- Lënia në administrim, e pasurive të sekuestruara, personave të cilët janë subjekt i vendimit të gjykatës, bën që pasuritë të administrohen formalisht "de jure" nga AAPSK por realisht ato administrohen në të vërtetë "de facto" nga subjekti apo shtetasi të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës.</li> <li>- Moskryerja e veprimeve brenda afatit ligjor të përcaktuar ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive përkundër parimit të</li> </ul>

	<p>efektivitetit, efijencës, ekonomikitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.</p> <p>- Moskryerja e raportimeve në zbatim të kuadrit ligjor ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive sipas parimit të efektivitetit, efijencës, ekonomikitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.</p> <p>- Raportimi i gabuar i gjendjes së ekzekutimit të vendimit në ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive sipas parimit të efektivitetit, efijencës, ekonomikitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.</p> <p>- Mosmarrja e masave për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, ekspozon eventualisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik.</p>
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimit i kuadrit ligjor rregullator në fuqi.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe administratorët të marrin masa për plotësimin e deklaratës me shkrim para lidhjes së kontratës së qirasë; marrjen në administrim në afatet përkatëse; njoftimin e menjëhershëm të masës së sekuestrimit, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; për paraqitjen në afat të pasurive të konfiskuara me vendim gjykate të formës së prerë pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar; për paraqitjen e raporteve dhe kërkesave në afatet respektive, si dhe sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur nga administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim gjykate, të trajtuara si më sipër me nr. rendor 1-23, u konstatua parregullsi në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

Referuar procedurave të sipërcituara, konstatohet se të gjitha dosjet fizike të administrimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbale, shkresa të dala, “kthim përgjigje”, etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes ose ky i fundit pasqyron vetëm pjesërisht përmbajtjen.

Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, kërkohet që për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes, parregullsia e mbajtjes së tij dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohen me përgjegjësi:

**-Administratorët e pasurive:** z. A.B, z. E.R, znj. B.I, z. E.B, z. S.M, z. F.A, znj. E.A, znj. E.O;

*Nga përfaqësuesit e AAPSK z. S.M, me shkresën nr. 27/44 prot., datë 10.08.2023, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:*

**Pretendimi i subjektit:**

*z. S.M: -(Pas dorëzimit të akt-konstatimeve nga grupi i auditimit) “Nga ana e administratorit dhe ndihmësit të tij, është vijuar me marrjen e masave për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara...”*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga z. M., në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. “Njoftimi” se, pas dorëzimit të akt-konstatimeve, nga ana e administratorit dhe ndihmësit të tij, është vijuar me marrjen e masave për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit, nuk ndikon mbi gjetjen e grupit të auditimit pavarësisht se ky i fundit e vlerëson atë pozitivisht.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në procedurat e ndjekura nga administratori në funksion të administrimit të pasurive të sekuestruara me vendim gjykate.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i kryer, konstatohet se, të gjitha dosjet fizike të administrimit të audituara (25), të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbale, shkresa të dala, kthim përgjigje, etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes ose ky i fundit pasqyron vetëm pjesërisht përmbajtjen. Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, kërkohet që për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësi.
<b>Kriteri:</b>	-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 23, pika 5; -Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 42; -Rregullorja nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK, neni 15, pika 3.
<b>Impakti:</b>	-Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes, parregullsia e mbajtjes së tij dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimit i kuadrit ligjor rregullator në fuqi.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nga ana e administratorit përkatës dhe ndihmësit të tij, të merren masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke cilësuar të gjithë procesin apo veprimtarinë administrative në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur nga administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim gjykate, të trajtuara si më sipër, u konstatuan parregullsi në lidhje me veprimet e tyre kundrejt administrimit të mjeteve motorike (autovetura, motorë, etj.), konkretisht si vijon:

- Në lidhje me praktikën si më sipër me nr. rendor 3, sipas të cilës ngarkohet administratori S.M. dhe E.B. për administrimin e 60 mjeteve motorike;
- Në lidhje me praktikën si më sipër me nr. rendor 5, sipas të cilës ngarkohet administratori E.O. për administrimin e 1 mjeti motorik;
- Në lidhje me praktikën si më sipër me nr. rendor 14, sipas të cilës ngarkohet administratori F.A. për administrimin e 1 mjeti motorik;
- Në lidhje me praktikën si më sipër me nr. rendor 4, 9, 13 dhe 14, sipas të cilave ngarkohet administratori E.B. për administrimin e 13 mjeteve motorike;

- Në lidhje me praktikat si më sipër me nr. rendor 16, 17, 18, 19 dhe 21, sipas të cilave ngarkohet administratori B.I. për administrimin e 20 mjeteve motorike;

- Në lidhje me praktikat si më sipër me nr. rendor 22 dhe 23, sipas të cilave ngarkohet administratori E.A. për administrimin e 2 mjeteve motorike;

Në të gjitha rastet e sipërcituara, në lidhje me veprimet e kryera në kuadër të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, për sa i përket mjeteve motorike, administratorët janë mjaftuar vetëm me kërkesën “për bashkëpunim” drejtuar Policisë së Shtetit. Në disa raste, konkretisht në praktikat e trajtuara me nr. rendor 14, 18 dhe 21, administratorët i janë drejtuar DPSHTRR-së duke kërkuar nga kjo e fundit bllokimin e mjeteve dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës.

Nga sa më sipër rezulton se administratorët nuk kanë marrë masa për të shmangur mundësinë e tjetërsimit të mjeteve të cilat ende nuk janë marrë në administrim. Situatë e cila nuk reflekton zbatimin e nenit 5 të Ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” sipas të cilit: “Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, efijencës, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit”. Konkretisht, bllokimi i mundësisë së tjetërsimit të mjetit, mbi të cilin është vendosur një masë sekuestro, realizohet nga Regjistri i Barreve Siguruese (R.B.S). Vlen të theksohet se R.B.S ka dy funksione: “1-T’u sigurojë barrëmarrësve (kreditorëve) mjete për të regjistruar barrë siguruese mbi pasurinë; 2-Të sigurojë një sistem kërkimi me informacion të saktë dhe aktual për palët e interesuara për të blerë apo për të dhënë hua duke u bazuar mbi pasuritë si kolateral”.

Në lidhje me këtë situatë AAPSK ka qenë në dijeni për sa kohë kjo e fundit është njoftuar nga DPSHTRR, me shkresën nr. 4224/1 prot., datë 25.02.2020 “kthim përgjigje”, në të cilën ndër të tjera citohet se “...në lidhje me kërkesën tuaj organi kompetent është Regjistri i Barreve Siguruese (RBS)”.

Si konkluzion, mosmarrja e masave për vendosjen e RBS-së, në lidhje me mjetet të cilat ende nuk janë marrë në administrim, përbën një risk për tjetërsimin e tyre dhe për pasojë ndikon negativisht në administrimin e pasurive.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi administratorët e pasurive të cilët ende kanë mjete të pa marra në administrim: z. A.B, znj. B.I, z. E.B, z. S.M, z. F.A, znj. E.A, znj. E.O; Kryeadministratori (A.K. periudha 01.10.2017-09.03.2021; Q.TH, periudha 09.03.2021-01.04.2022 dhe A.K., periudha 01.04.2022-31.12.2022) në zbatim të nenit 9, pika 2/b, i ligjit nr. 34/2019 ngarkohet me kompetencën dhe përgjegjësinë për të mbikëqyrur dhe kontrolluar veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në procedurat e ndjekura nga administratori në funksion të marrjes në administrim të mjeteve motorike.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i kryer, konstatohet se, në 14 raste, në lidhje me veprimet e kryera në kuadër të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, për sa i përket mjeteve motorike të cilat ende nuk janë marrë në administrim, administratorët janë mjaftuar vetëm me kërkesën “për bashkëpunim” drejtuar Policisë së Shtetit. Nga sa më sipër, rezulton se administratorët nuk kanë marrë masa për të shmangur mundësinë e tjetërsimit të mjeteve të cilat ende nuk janë marrë në administrim. Situatë e cila nuk reflekton zbatimin e nenit 5 të Ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” sipas të cilit: “Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, efijencës, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit”. Konkretisht, bllokimi i mundësisë së tjetërsimit të mjetit, mbi të cilin është vendosur një masë sekuestro, realizohet nga Regjistri i Barreve Siguruese (R.B.S). Theksojmë se, pas përcaktimit të

	parimeve të përgjithshme të administrimit në nenin 5 të ligjit 34/2019, në nenin 11 të tij përcaktohet shprehimisht se: <i>“Administratori...d) harton të gjitha shkresat zyrtare dhe mban korrespondencën me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për marrjen në administrim, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të sekuestruara; dh) paraqet çdo kërkesë të nevojshme për ekzekutimin e masës së sekuestrimit dhe për administrimin e sendit, pranë prokurorisë, shërbimit përmbartimor apo çdo institucioni tjetër shtetëror”</i> .
<b>Kriteri:</b>	- Ligjit nr. 34/2019 <i>“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”</i> , neni 5 dhe neni 11, pika 2 (a, d, dh);
<b>Impakti:</b>	- Mosmarrja e masave për vendosjen e RBS-së, në lidhje me mjetet të cilat ende nuk janë marrë në administrim, përbën një risk për tjetërsimin e tyre dhe për pasojë ndikon negativisht në administrimin e pasurive.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimit i kuadrit ligjor rregullator në fuqi.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe nga ana e administratorit përkatës, në lidhje me mjetet motorike, të cilat ende nuk janë marrë në administrim (dorëzim), të merren masa, për njoftimin e DPSHTRR-së si dhe për vendosjen e RBS-së.

### **2.2.3 Mbi vendimmarrjen dhe procedurat e ndjekura nga administratorët në lidhje me dokumentacionin dhe të dhënat e regjistruara pranë QKB-së, në funksion të administrimit të drejtpërdrejtë të shoqërive tregtare**

Nga 20 shoqëritë tregtare të raportuara dhe të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga AAPSK (administratori përkatës) përgjatë periudhës 2017-2022, grupi i auditimit, me përzgjedhje, shqyrtoi Ekstraktet Historikë dhe dokumentacioni përbërës i tyre, i pasqyruar në regjistrin tregtar (elektronik), të krijuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim “QKB”) në lidhje me 10 shoqëri:

- “S. Q.P. R.” SHPK me NUIS: L.....E;
- “E. E. S.” SHPK me NUIS: L.....F;
- “R. -B.” SHPK me NUIS: K.....B;
- “O. A.” SHPK me NUIS: K.....R;
- “A. E. F.” SHPK me NUIS: L.....Q;
- “A. F. 7” SHPK me NUIS: L.....F;
- “A. – 2.” SHPK me NUIS: L.....M;
- “A. E.” SHPK me NUIS: L.....H;
- “I. T. W. T. F.” SHPK me NUIS: L.....F;
- “I. T. S.” SHPK me NUIS: L.....C.

**1-Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacioni përbërës i tij, në lidhje me shoqërinë “S. Q. P. R.” SHPK me administrator z. A.B., për periudhën nga data 14.12.2017 deri më datën 10.03.2022 dhe bashkëadministrator z. E.R., për periudhën nga data 14.12.2017 deri më datën 04.08.2021, u konstatuan disa parregullsi, veprime apo mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:**

Në datën 30.07.2019 “QKB” ka regjistruar vendimin nr. 2 datë 27.07.2019 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin janë miratuar “Pasqyrat Financiare” të bilancit të vitit 2018. Vlen të theksohet se, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, neni 95, pika 3 (dh): *“Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”* gjithashtu ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 *“Për Qendrën*



*Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3, përcakton se: “subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas dispozitave të legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.”. Referuar përmbytjes së vendimit nr. 2 datë 27.07.2019 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi B.B në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë. Ky shtetas rezulton të ketë kryer një vendimmarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë është subjekt i vendimit nr. 28, datë 21.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Me këtë vendim, veç të tjerave është vendosur sekuestrimi i pasurive të subjektit të sipërcituar dhe ngarkimi i z. A.B., dhe E.R., për administrimin dhe përdorimin e tyre. Në rastin konkret, administratorët e AAPSK-së, jo vetëm nuk kanë përmbytur detyrat e ngarkuara nga gjykata por, nga ana tjetër, duke lejuar që vendimmarrja të merret nga subjekti i sipërcituar, kanë cënuar qëllimin dhe efektin e instrumentit juridik “sekuestrros preventive”.*

**2-Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacioni përbërës i tij, në lidhje me shoqërinë “E. E. S.” SHPK me administrator znj. B.I. (nga data 13.10.2020 e në vijim), u konstatuan disa parregullsi, veprime apo mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:**

**a)-**Në datën 02.08.2022 “QKB” ka regjistruar vendimin e datës 25.06.2021 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin janë miratuar “Pasqyrat Financiare” të bilancit të vitit 2020. Referuar përmbytjes së këtij vendimi, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi K.B në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

**b)-**Në datën 04.08.2022 “QKB” ka regjistruar vendimin e datës 26.06.2022 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar “Pasqyrat Financiare” të bilancit të vitit 2021, është vendosur gjithashtu edhe për destinacionin e fitimit në vlerën 18,014,653 lekë (5% kalon “për rezervë ligjore” dhe 95% “për investime”). Referuar përmbytjes së këtij vendimi, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi K.B. në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Në dy rastet e sipërcituara, shtetasi K.B. rezulton të ketë kryer një vendimmarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë është subjekt i vendimit nr. 148, datë 15.09.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me këtë vendim, veç të tjerave është vendosur sekuestrimi i kuotave/aksioneve të subjektit “E. E. S.” i cili ka kaluar në administrim të AAPSK-së. Për administrimin e kësaj pasurie me urdhrin nr. 1631 prot., datë 13.10.2020 është emëruar e znj. B.I. e cila, jo vetëm nuk ka përmbytur detyrat e ngarkuara nga gjykata por, nga ana tjetër, duke lejuar që vendim-marrja të merret nga subjekti i sipërcituar, ka cënuar qëllimin dhe efektin e instrumentit juridik “sekuestrros preventive”.

**3-Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacioni përbërës i tij, në lidhje me shoqërinë “R.-B.” SHPK me administrator znj. B.I. (nga data 13.10.2020 e në vijim), u konstatuan disa parregullsi, veprime apo mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:**

**a)-**Në datën 26.07.2021 “QKB” ka regjistruar vendimin e datës 24.06.2021 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar “Pasqyrat Financiare” të bilancit të vitit 2020, është vendosur gjithashtu edhe për destinacionin e fitimit në vlerën 18,369,076 lekë (vlera 3,369,076 lekë kalon “për investime” dhe vlera 15,000,000 lekë kalon “divident”). Referuar përmbytjes së këtij vendimi, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi A.F. në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

**b)-**Në datën 02.08.2022 “QKB” ka regjistruar vendimin e datës 20.06.2022 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar “Pasqyrat Financiare” të bilancit të vitit 2021, është vendosur gjithashtu edhe për destinacionin e fitimit në vlerën 3,613,458 lekë (vlera 3,613,458 lekë kalon “për investime”). Referuar përmbytjes së këtij

vendimi, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi A.F. në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Në dy rastet e sipërcituara, shtetasi A.F. rezulton të ketë kryer një vendimmarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë është subjekt i vendimit nr. 148, datë 15.09.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me këtë vendim, veç të tjerave është vendosur sekuestrimi i kuotave/aksioneve të subjektit "R.-B." i cili ka kaluar në administrim të AAPSK-së. Për administrimin e kësaj pasurie me urdhrin nr. 1631 prot., datë 13.10.2020 është emëruar e znj. B.I. e cila, jo vetëm nuk ka përmbushur detyrat e ngarkuara nga gjykata por, nga ana tjetër, duke lejuar që vendimmarrja të merret nga subjekti i sipërcituar, ka cënuar qëllimin dhe efektin e instrumentit juridik "sekuestros preventive".

**4-Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacioni përbërës i tij, në lidhje me shoqërinë "O.-A." SHPK me administrator z. E.B. (nga data 03.09.2020 e në vijim), u konstatuan disa parregullsi, veprime apo mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:**

**a)-**Në datën 17.06.2021 "QKB" ka regjistruar vendimin e datës 01.06.2021 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar "Pasqyrat Financiare" të bilancit të vitit 2020, është vendosur gjithashtu edhe për destinacionin e fitimit në vlerën 891,726 lekë (*vlera 891,726 lekë kalon "për rezerva"*). Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi S.O. në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

**b)-**Në datën 26.07.2022 "QKB" ka regjistruar vendimin e datës 30.06.2022 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar "Pasqyrat Financiare" të bilancit të vitit 2021, është vendosur gjithashtu edhe për destinacionin e fitimit në vlerën 754,512 lekë (*vlera 754,512 lekë kalon "për rezerva"*). Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është shtetasi S.O. në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Në dy rastet e sipërcituara, shtetasi S.O. rezulton të ketë kryer një vendimmarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë është subjekt i vendimit nr.119, datë 03.08.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me këtë vendim, veç të tjerave është vendosur sekuestrimi i kuotave/aksioneve të subjektit "O.-A." i cili ka kaluar në administrim të AAPSK-së. Për administrimin e kësaj pasurie me urdhrin nr. 1269 prot., datë 11.08.2020 është emëruar e z. E.B. i cili, jo vetëm nuk ka përmbushur detyrat e ngarkuara nga gjykata por, nga ana tjetër, duke lejuar që vendimmarrja të merret nga subjekti i sipërcituar, ka cënuar qëllimin dhe efektin e instrumentit juridik "sekuestros preventive".

**Si konkluzion,** në kushtet kur rezulton e faktuar se vendimmarrja e sipërcituar është marrë nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros preventive, sipas nenit 274 të kodit të procedurës penale, disponimi në rastin konkret ka cënuar qëllimin dhe efektin e instrumentit juridik "sekuestros preventive". Nga ana tjetër, në mënyrë direkte apo indirekte, nga veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara, rezulton se subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros ndikojnë në menaxhimin apo administrimin e pasurive.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator. Konkretisht në lidhje me këtë situatë: *Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar", neni 16, pika 1, përcakton se: "Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar"; Ligji nr. 34/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara", neni 5, përcakton se: "Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, efikasitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit.";*

*Ligji nr. 34/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara", neni 19, pika 4, përcakton se: "Në rastet e menaxhimit të drejtpërdrejtë zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë";*

Për veprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi administratorët (z. E.R, z. A.B, znj. B.I, z. E.B.) të cilët kanë në administrim të drejtpërdrejtë subjektet e sipërcituara.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik, në lidhje me disa nga shoqëritë të cilat administrohen dhe menaxhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga AAPSK, konstatohet gjithashtu se, nga administratorët përkatës, nuk janë marrë masat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit të të dhënave në regjistrin tregtar sipas përcaktimeve të nenit 22 dhe 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rastin konkret, edhe pse administrimi dhe menaxhimi i shoqërive kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një institucion shtetëror (AAPSK), në zbatim të ligjit nr. 34/2019, neni 19, pika 4, duhet të zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

Në kundërshtim me nenin 43, pika 3/a të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” sipas të cilit, ndër të tjera, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas dispozitave të legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, grupi i auditimit konstaton si vijon:

**a-**Në lidhje me “A. E. F.” SHPK me NUIS: L.....Q me administrator znj. B.I. (nga data 14.10.2021 e në vijim), u konstatua se nuk është regjistruar bilanci vjetor kontabël për vitin 2021.

**b-**Në lidhje me “A. E.” SHPK me NUIS: L.....H me administrator z. A.B. (nga data 13.12.2021 e në vijim), u konstatua se nuk është regjistruar bilanci vjetor kontabël për vitin 2021.

**c-**Në lidhje me “I. T. S.” SHPK me NUIS: L.....C me administrator z. F.A. (nga data 13.12.2021 e në vijim), u konstatua se nuk është regjistruar bilanci vjetor kontabël për vitin 2021.

**Si konkluzion**, mosregjistrimi apo regjistrimi jashtë afateve ligjore të bilancit vjetor kontabël, së pari ndikon negativisht në transparencën e menaxhimit të subjektit dhe së dyti ekspozon këtë të fundit kundrejt sanksioneve administrative (gjyba) me efekt negativ financiar.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohen me **përgjegjësi administratorët** z. A.B, znj. B.I dhe z. F.A, të cilët kanë në administrim të drejtpërdrejtë subjektet e sipërcituara.

*Nga përfaqësuesit e AAPSK znj. B.I., me shkresën nr. 27/45 prot., datë 11.08.2023, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:*

**Pretendimi i subjektit:** (Në mënyrë të përmbledhur dhe në thelb, observacionet e paraqitura nga subjekti në lidhje me projekt-raportin e auditimit janë të njëjta, në frymë, argument dhe koncept, me ato observacione të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve. Për këtë arsye trajtimi dhe argumentimi i tyre nga ana e grupit të auditimit është si vijon.

**znj. B.I:** -“Për sa i përket situatës (I) sqaroj se: Neni 274 i kodit të procedurës penale parashikon objektin e sekuestros preventive; “1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të 153 lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”

Në përputhje me këtë dispozitë por edhe në përputhje me ligjin 34/2019 i ndryshuar nga ana ime është vepruar në përputhje me ligjin duke vënë sekuestro edhe juridikisht në QKB (referoju shkresave të përsëritura drejtuar QKB nga marrja dijani e vendimit datë 13.10.2020 e deri me datë 08.02.2021 kur është regjistruar sekuestro në QKB bashkëlidhur këtij observacioni), por edhe fizikisht, duke shkuar dhe marrë në dorëzim të gjithë dokumentacionin kontabël dhe inventarin fizik të shoqërive të mësipërme, si dhe duke vënë sekuestro në të gjithë bankat e nivelit të dyte ku shoqëritë kishin llogari bankare. Pavarësisht se që nga marrja në dorëzim e në vazhdim është kërkuar dhe relatuar domosdoshmëria e kontraktimit të një audituesi ligjor, për marrjen në dorëzim të shoqërisë (referojuni raporteve mujore bashkangjitur këtij observacioni të miratuara nga ana e institucionit.) Në

*lidhje me vendimin e ortakëve K.B dhe A.F, duke theksuar se janë vendime që ka ngel vetëm në letër formalisht, pasi nuk janë miratuar dhe as lejuar nga ana ime dhe referuar po akteve të paraqitura në QKB janë paraqitur nga persona të paautorizuar nga ana ime dhe sapo jam vënë në dijeni të raportit paraprak nga ana juaj, pasi QKB nuk më ka njoftuar, kam bërë shkresë për çregjistrimin e çështjeve që kanë aprovuar regjistrimin e vendimeve të ortakëve, pas vendosjes së sekuestros në QKB. Përgjegjësia për regjistrimin e këtyre vendimeve të pa autorizuara dhe pamiratuara nga ana ime, në mungesë edhe të dijenisë sime është e punonjësve të QKB që kanë bërë regjistrimin. Vendimet e ortakëve si më sipër nuk kanë gjetur zbatim (referojuni si provë statementeve bankare të shoqërisë ku përveç lëvizjeve bankare që lidhen me veprimtarinë dhe aktivitetin operativ të shoqërisë nuk është bërë asnjë lëvizje tjetër.).*

*Sa më sipër znj. B.I. ka përmbushur detyrat e ngarkuara nga gjykata, duke regjistruar në QKB vendimin e sekuestros dhe marrë në administrim shoqërinë fizike dhe gjithë veprimtarinë ekonomike të saj, (nuk është krijuar shoqëri tjetër, pas datës së vendimit të sekuestrimit dhe pastaj të regjistrohej vendimi i gjykatës mbi personin juridik të krijuar rishtas) nga ana tjetër, ndryshe sa kenë argumentuar ju nuk ka lejuar që vendimmarrja e marrë nga subjekti i sipërcituar të cenohet qëllimin dhe efektin e instrumentit juridik “sekuestros preventive” pasi vendimi nuk është autorizuar dhe nuk ka gjetur zbatim. Nga ana subjektive nuk ka pas asnjë lidhje mes mosveprimit të administratorës dhe veprimit të ortakut i cili nuk provohet të jetë në dijeni efektive të administratorës. Pavarësisht se sekuestro preventive nuk ka si qëllim zhveshjen e ortakut nga pronësia e tij mbi aksionet e shoqërisë ortakët nuk kanë pas asnjë lloj lidhje me shoqërinë dhe aksionet e saj si dhe as me fitimin apo të ardhurat. Vendimi i regjistruar në kundërshtim me ligjin nga punonjësit e QKB, është një vendim fiktiv dhe nuk lidhet me asnjë veprim apo mosveprim në kundërshtim me ligjin të administratorës. Statementet bankare vërtetojnë që përveç pagesave për aktivitetin operativ të kompanisë, nuk janë shpërndarë dividend dhe nuk janë kryer investime apo krijuar rezerva ligjore siç specifikon vendimi i ortakut.*

*-Për sa i përket situatës (II) sqaroj se: Sipas ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nr 9901, datë 14.04.2008 i ndryshuar dhe kuadrit ligjor për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë nuk rezulton se pasqyrat financiare janë përgjegjësi e administratorit i cili vetëm bën miratimin e pasqyrave financiare ndërsa përpilimi dhe ndërtimi i pasqyrave financiare bëhet nga ana e financierit të shoqërisë në mungesë të tij nga një auditues ligjor i kontraktuar që nga ana ime është kërkuar kontraktimi i një audituesi ligjor dhe nuk është kontraktuar një i tillë nga institucioni. Sa i përket financieres së A. E. F. ajo është larguar nga puna dhe pavarësisht se kam bërë njoftimin për zëvendësimin e saj nuk është bërë akoma e mundur gjetja e një kuadri pune, për shef Finance. (referojuni emaileve dhe korrespondencës me shefen e financës së A. E. F. bashkangjitur këtij observacioni, si dhe raporteve mujore të miratuara nga institucioni për kërkesën time të vazhdueshme për të kontraktuar një auditues ligjor si për këtë shoqëri edhe për shoqëritë e tjera në administrimin tim, ju është përcjell vetëm pjesa e raportit ku kërkohet auditues dhe e-maillet në adresë zyrtare).*

*-Për sa i përket situatës (III) sqaroj se: Shoqëritë në administrim nga ana ime, në momentin e marrjes në administrim i kanë pasur të lidhura kontratat e furnizimit dhe se nuk është rilidhur rishtas asnjë kontratë furnizimi dhe nuk është bërë asnjë blerje për nevojat e veprimtarisë ekonomike. Në ato raste kur ka qenë nevoja është kryer e gjithë procedura e prokurimit publik për blerjet e vogla dhe se ligji për shoqëritë tregtare nuk e kërkon publikimin në SPE të prokurimeve që bëhen nga shoqëritë tregtare. Në rast të shpenzimeve të bëra nga ana e AAPSK nuk është kompetencë e administratorit.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga znj.I., qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Konkretisht në lidhje me situatën I.: -Pretendimi se nga administratorja është kërkuar që AAPSK të kontraktojë një auditues ligjor nuk ndikon në gjetjen e grupit të auditimit. Nga**

ana tjetër, kërkesa për kontraktimin e një audituesi ligjor nga AAPSK është e pabazuar për sa kohë nuk plotësohen kriteret e parashikuara në ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 16, pika 8 (mungesë e dokumentacionit); - Pretendimi se vendimmarrja e subjektit, e regjistruar pranë QKB-së, është vetëm në letër dhe formale pasi realisht nuk është shpërndarë dividend, nuk përjashton faktin se vendimi, mbi rezultatet financiare të subjektit, rezulton të jetë një i vetëm dhe është marrë nga subjekti kundrejt të cilit është vendosur masa e sekuestros. Nga ana tjetër, grupi i auditimit vlerëson pozitivisht mbetjen pa veprim të vendimit të sipërcituar pasi në rast të kundërt do të ishim përpara faktit të një dëmi ekonomik eventual (në rast konfiskimi); -Pretendimi se është QKB-ja institucioni i cili duhet të mos merrte në konsideratë vendimin, nuk ndikon në gjetjen e grupit të auditimit. Vlen të theksohet se në thelb (referuar qëllimit të ligjit përkatës), aktiviteti i QKB-së është ai i regjistrimit dhe publikimit të akteve të subjekteve tregtarë, dhe jo shqyrtimi i ligjshmërisë të tyre.

-Në lidhje me situatën II, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Konkretisht, në lidhje me pretendimin se nga administratorja është kërkuar kontraktimi një audituesi ligjor, grupi i auditimit ka të njëjtin arsyetim si në lidhje me situatën I. Për sa i përket pretendimit se, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” nuk rezulton se pasqyrat financiare janë përgjegjësi e administratorit, theksojmë se ky është një pretendim sa i pabazuar aq dhe i gabuar. Konkretisht, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në nenin 95, pika 3 (dh) përcakton se: “Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nga ana tjetër, bilanci vjetor kontabël është një element i detyrueshëm për regjistrim, referuar ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3.

-Në lidhje me situatën III, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Pretendimi se ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” nuk e kërkon publikimin në SPE është një pretendim i cili nuk ndikon në gjetjen e grupit të auditimit. Subjektet të cilave ju referohet grupi i auditimit, janë subjekte të sekuestruara dhe të administruara nga shteti dhe si të tilla për administrimin e tyre, është i detyrueshëm jo vetëm zbatimi ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” por specifikisht dhe ligji nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, si dhe ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” me ndryshimet e tij. Grupi i auditimit rithekson edhe njëherë se, për sa më sipër, duke përjashtuar shpenzimet e veprimtarisë ekonomike të drejtpërdrejtë (psh. marrëdhënie midis furnitorëve, klientëve, pagesa e taksave, pagat e punonjësve, etj), për shpenzimet në funksion të administrimit të subjektit (riparime, rikonstruksione, blerje pajisje, etj) duhet të zbatohet ligji për prokurimin publik (referoju arsyetimit ligjor tek situata III).

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje konkrete ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në procedurat e ndjekura nga administratorët në funksion të administrimit të drejtpërdrejtë të shoqërive tregtare.
<b>Situata:</b>	Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacioni përbërës i tij, në lidhje me dhjetë shoqëri tregtare në administrim të drejtpërdrejtë nga administratorët, u konstatuan disa parregullsi, në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht: 1-Në shtatë raste rezulton se “QKB” ka regjistruar vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar “Pasqyrat Financiare” të bilancit, është vendosur gjithashtu edhe për destinacionin e fitimit të shoqërisë. Referuar përmbajtjes së vendimeve në fjalë, rezulton se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është subjekti kundrejt të cilit gjykata ka vendosur masën e sekuestros preventive. Në rastet e sipërcituara,

	<p>subjektet rezultojn të kenë kryer një vendimmarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë janë subjekt i një vendimi gjykatës me të cilin, veç të tjerave, është vendosur sekuestrimi i kuotave/aksioneve duke kaluar këto të fundit në administrim të AAPSK. Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator. Konkretisht në lidhje me këtë situatë: <i>Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar”, neni 16, pika 1, përcakton se: “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar”;</i> <i>Ligji nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, përcakton se: “Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, efikasitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit”.</i></p> <p>2-Në tre raste rezultojn se nuk është regjistruar bilanci vjetor kontabël për vitin 2021. Nga administratorët përkatës, nuk janë marrë masat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit të të dhënave në regjistrin tregtar sipas përcaktimeve të nenit 22 dhe 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rastin konkret, edhe pse administrimi dhe menaxhimi i shoqërive kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një institucion shtetëror (AAPSK), në zbatim të ligjit nr. 34/2019, neni 19, pika 4, duhet të zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë. Vlen të theksohet se, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 95, pika 3 (dh): “Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” gjithashtu ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3, përcakton se: “subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas dispozitave të legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme”.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar”, neni 16, pika 1;</li> <li>-Ligji nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 19, pika 4 dhe neni 30, pika 4;</li> <li>-Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3;</li> <li>-Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 95, pika 3 (dh).</li> </ul>
<b>Impakti:</b>	<p>Vendimmarrja nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros preventive, në mënyrë direkte apo indirekte, ndikon në menaxhimin apo administrimin e pasurive;</p> <p>Mosregjistrimi apo regjistrimi jashtë afateve ligjore të bilancit vjetor kontabël ndikon negativisht në transparencën e menaxhimit të subjektit dhe ekspozon këtë të fundit kundrejt sanksioneve administrative (gjyqësore) me efekt negativ financiar.</p>
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimit i kuadrit ligjor rregullator në fuqi.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë

<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, administratorët përkatës, në lidhje me shoqëritë tregtare të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë, të merren masa që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendimmarrja për administrimin e tyre të jetë e pavarur dhe e pandikuar nga subjekti mbi të cilin rëndon masa e sekuestros apo konfiskimit;</li> <li>- Regjistrimi i bilancit vjetor kontabël pranë QKB-së, të kryhet brenda afateve ligjore.</li> </ul>
---------------------	--

#### **2.2.4 Mbi administrimin e pasurive të luajtshme dhe llogarive bankare**

Për pasuritë e luajtshme, të cilat në tërësi konsistojnë në vlera monetare cash, automjete, llogari rrjedhëse apo depozituese, sipas ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, edhe në ligjin e ri nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, parashikohet, administrimi, përdorimi dhe shitja e këtyre pasurive, duke pasur parasysh llojin e pasurive të luajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara. Në ligjin e ri nr. 34/2019, kalimi i të drejtave reale për pasuritë e sekuestruara të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit, me kërkesë të Agjencisë, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar vendos përdorimin e të drejtave reale nga të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë. Disa nga mënyrat e përdorimit të këtyre pasurive janë:

##### **a. shitja;**

##### **b. dhënia në përdorim;**

Format e përdorimit janë:

- 1) kalimi në përgjegjësi administrimi, për institucionet qendrore;
- 2) kalimi në pronësi, për njësitë e qeverisjes vendore;
- 3) dhënia në huapërdorje, për subjektet e tjera përfituese.

Referuar ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, neni 24 përcakton që: Për mbikëqyrjen e veprimtarisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga ana e Agjencisë, sipas fushës së veprimtarisë të përcaktuar në nenin 3, të këtij ligji, dhe kryerjen e funksioneve të tjera të parashikuara nga ky ligj, si dhe për vendimmarrjen për përdorimin e këtyre pasurive, funksionon Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, i ngritur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, të ndryshuar. KNMKKO, vendos për destinimin e pasurive, si dhe për përdorimin efektiv të të ardhurave brenda buxhetit të shtetit, përfshirë edhe vendimin për pagimin e shpenzimeve operative të Agjencisë.

**Gjatë fazës së auditimit në terren është kërkuar informacion në lidhje me të dhënat sipas viteve, për numrin dhe vlerat sipas llojeve të pasurisë luajtshme, informacion i cili nuk u vu në dispozicion.**

Përgjatë viteve 2017-2020, nuk është marrë asnjë vendim për destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara.

Me formatimin e KNMKKO, prej datës 20.10.2020 - 31.12.2022, janë marrë vendime për destinimin dhe shitjen e pasurive të luajtshme të konfiskuara si më poshtë vijon:

Përgjatë vitit 2021 i janë dhënë Institucioneve Publike 20 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 35,193,750 lekë, sipas aneksit nr. 1.

Përgjatë vitit 2022 i janë dhënë Institucioneve Publike 37 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 31,646,590 lekë, sipas aneksit nr.2.

Me vendim të KNMKKO, janë shitur 10 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 1,030,800 lekë.

Referuar kërkesave të ligjit të ri nr. 34/2019, për pasuritë e sekuestruara të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit, me kërkesë të Agjencisë, Komiteti

Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar vendos përdorimin e të drejtave reale nga të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë. ***Nga auditimit rezulton se AAAPSK nuk ka shitur asnjë pasuri të luajtshme të sekuestruar.***

Pasuritë e luajtshme (automjetet) jo vetëm janë faturuar me shpenzimet e pagave të administratorëve të pasurive, por janë amortizuar duke u rënë vlera në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 të nenit 21, të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar.

**Si konkluzion**, administrimi i pasurive të luajtshme për periudhën 2017-2022 ka rritur koston e administrimit, duke ndikuar negativisht dhe në buxhetin e shtetit, krahas mungesës së efektivitetit në luftën kundër krimin të organizuar.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga përgjegjësi i sektorit të marrëdhënieve me institucionet, çështjeve juridike dhe provave materiale të AAPSK-së z. Q.Th., gjendja e automjeteve të marra në dorëzim nga administratorët deri më datë 31.12.2022 rezulton si vijon: **23** automjete të konfiskuara dhe **80** automjete të sekuestruara (detajuar në aneksin nr. 3). Ndërkohë sipas magazinierit z. E.B. gjendja e automjeteve deri më datë 31.12.2022 ka qenë **79** automjete të sekuestruara/konfiskuara të magazinuara.

Nga grupi i auditimit u kërkua informacion mbi vendndodhjen e pasurive të luajtshme të cilat nuk ndodheshin në magazinë, informacion i cili nuk u vendos në dispozicion.

Nga grupi i auditimit me email-in e datës 24.03.2023 u kërkua plotësimi i një pyetësori nga ana e administratorëve të pasurive mbi administrimin e pasurive të sekuestruara /konfiskuara, me qëllim evidentimin e pasurive të luajtshme për periudhën objekt auditimi dhe rakordimin e tyre me gjendjen në magazinë. Ky pyetësor nuk u dorëzua nga asnjë prej administratorëve. Nga informacioni i përcjellë me email-in e datës 08.06.2023, nga z. Gj.D. është evidentuar se nuk janë marrë në dorëzim të gjithë automjetet në dorëzim, pasi disa prej administratorëve të pasurive nuk i kanë dorëzuar. Pra, 24 automjete nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga administratorët në ambientet magazinuese të AAPSK-së, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 20, të ligjit 34/2014, i ndryshuar dhe pikën 7, të nenit 14, të Rregullores së Brendshme të AAPSK.

-pikën 1, neni 20, të Ligjit 34/2014, i ndryshuar, ku citohet: *Pasuritë e luajtshme transportohen dhe ruhen në mjediset e caktuara nga Agjencia, përveç rasteve kur këto pasuri janë pjesë e veprimtarisë së një biznesi apo kur ato shërbejnë për dhënien e pasurisë me qira.*

-pikën 7, neni 14, të Rregullores së Brendshme të AAPSK-së ku citohet: *Me marrjen në administrim të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, administratori i pasurisë bën sigurimin fizik të pasurisë, bazuar në llojin dhe veçoritë e secilës pasuri, për aq sa është e mundur dhe i propozon menjëherë sektorit të administrimit ekonomiko-financiar të pasurive një plan masash për ruajtjen, mirëmbajtjen, menaxhimin ose dhënien me qira të pasurisë.*

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi administratorët përkatës për secilën pasuri të luajtshme të pa-magazinuar, të cilët nuk mund të evidentohen nga ana e grupit të auditimit, për shkak të mungesës së informacionit mbi pasuritë e luajtshme që secili prej tyre ka patur në administrim.**

### Llogaritë bankare

Në lidhje me llogaritë bankare të sekuestruara, konfiskuara dhe të revokuara për periudhën objekt auditimi konstatohet si në vijim:

*Pasqyra nr.2 Llogaritë bankare të sekuestruara, konfiskuara dhe të revokuara*

Vitet	Llogari bankare të sekuestruara	Vlera në lekë	Llogari bankare të konfiskuara	Vlera në lekë	Llogari bankare të revokuara	Vlera në lekë
2017	9	125,251,153	1	1,380,920	6	327,808,835
2018	54	(253,474,548)	6	122,401,851	12	39,845,848
2019	9	50,452,009	-	-	34	2,822,668
2020	9	6,154,800	4	13,983,258	-	-
2021	14	95,620,175	7	41,508,888	-	-



2022	1	6,000	3	421,549,628	6	60,058,872
<b>Totali</b>	<b>96</b>	<b>24,009,589</b>	<b>21</b>	<b>600,824,545</b>	<b>58</b>	<b>430,536,224</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për vitin 2018 konstatohen 54 llogari të sekuestruara në vlerën -253,475 mijë lekë, të cilat paraqiten me vlerë negative për shkak të detyrimeve kundrejt palëve të treta.

Llogaritë bankare të sekuestruara me vlerën më të lartë paraqiten në vitin 2021 në vlerën 95,620 mijë lekë, të konfiskuara në vitin 2022 në vlerën 421,550 mijë lekë, ndërsa të revokuara në vitin 2017 në vlerën 327,809 mijë lekë.

Në total për periudhën objekt auditimi vlera e llogarive bankare të sekuestruara paraqitet 24,010 mijë lekë, vlera e llogarive bankare të konfiskuara paraqitet 600,825 mijë lekë ndërsa vlera e llogarive bankare të revokuara 430,536 mijë lekë.

AAPSK për periudhën objekt auditimi nuk ka kryer asnjë veprim me llogaritë bankare me qëllim rritjen e vlerës së tyre, në kundërshtim me pikën 2, nenin 20, të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar ku citohet: “Pasuritë e luajtshme, në formë të mjeteve monetare, investohen në bono thesari ose depozitohen në llogari bankare të caktuara, për të cilat vendos kryeadministratori”.

Në lidhje me gjendjen e llogarive bankare, referuar të dhënave të raportit të aktivitetit për periudhën objekt auditimi rezulton se llogaritë bankare të sekuestruara kanë qenë llogari rrjedhëse dhe depozita. Llogaritë e konfiskuara paraqiten në tabelën e të ardhurave totale vjetore të AAPSK-së dhe e jo të detajuara si zë më vete.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos zbatimi i kriterëve ligjor për mirëadministrimin dhe destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi mbi administrimin dhe destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara konstatohet se:</p> <p>Përgjatë viteve 2017-2020, nuk është marrë asnjë vendim për destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara. Me formatimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, prej datës 20.10.2020- 31.12.2022, janë marrë vendime për destinimin dhe shitjen e pasurive të luajtshme si në vijim:</p> <p>Përgjatë vitit 2021 i janë dhënë Institucioneve Publike 20 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 35,193,750 lekë.</p> <p>Përgjatë vitit 2022 i janë dhënë Institucioneve Publike 37 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 31,646,590 lekë. Me vendim të KNMKKO, janë shitur 10 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 1,030,800 lekë.</p> <p>Pasuritë e luajtshme (automjetet) jo vetëm janë faturuar me shpenzimet e pagave të administratorëve të pasurive, por janë amortizuar duke u rënë vlera në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 të nenit 21, të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar.</p> <p>Si konkluzion, administrimi i pasurive të luajtshme për periudhën 2017-2022 ka rritur koston e administrimit, duke ndikuar negativisht dhe në buxhetin e shtetit, krahas mungesës së efektivitetit në luftën kundër krimin të organizuar.</p> <p>Nga auditimi konstatohet sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga përgjegjësi i sektorit të marrëdhënieve me institucionet, çështjeve juridike dhe provave materiale të AAPSK-së, gjendja e automjeteve deri më datë 31.12.2022 rezulton si vijon: 23 automjete të konfiskuara dhe 80 automjete të sekuestruara. Ndërkohë sipas përgjegjësit të magazinës gjendja e automjeteve deri më datë 31.12.2022 rezulton: 79 automjete të sekuestruara/konfiskuara të magazinuara dhe kjo diferencë e automjeteve midis gjendjes në magazinë dhe numrit total të raportuar është për arsien</p>

	se nga ana e tij nuk janë marr në dorëzim të gjithë automjetet në administrim nga administratorët duke qenë se një pjesë e tyre nuk i kanë dorëzuar. Mos-mbajtja e pasurive të luajtshme në magazinë është në kundërshtim me pikën 1, nenin 20, të ligjit 34/2014 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” dhe pikën 7, nenin 14, të Rregullores së Brendshme të AAPSK.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 20, pika 1, neni 21 pika 1,2,3 - Rregullore e Brendshme e AAPSK-së, neni 14, pika 7
<b>Impakti:</b>	Mos zbatimi i kriterëve ligjor ka sjellë amortizim dhe shpenzime për magazinim, ruajtje e paga të administratorëve të pasurive.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i akteve ligjore dhe nën ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	-Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: -për shitjen e pasurive të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit duke respektuar parimin e mirëadministrimit si edhe shmangien e shpërdorimit të tyre. -për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurive të luajtshme dhe provave materiale në administrim me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre. -dorëzimin e pasurive të luajtshme në mjediset e caktuara magazinuese. -nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mosdorëzimin e automjeteve në ambientet magazinuese.

### 2.2.5 Mbi kontrollin fizik të pasurive në terren

Referuar kuadrit ligjor të veprimtarisë së institucionit të AAPSK- së, referuar Rregullores nr. 1363 prot., datë 22.04.2021 “Për organizmin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” (AAPSK), neni 12, **specialisti për kontrollin fizik dhe provat materiale ka detyrë dhe përgjegjësi të kontrolloj në terren gjendjen e pasurive të sekuestruara/konfiskuara në administrim të AAPSK.** Bazuar në raportet mujore të administratorëve të pasurisë, ai inicion kontrole të autorizuara nga Kryeadministratori i AAPSK-së. Ky specialist, kryen kontrollin periodik të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar bashkë me administratorin e pasurisë duke asistuar dhe në miradministrimin e saj, dhe raporton mbi punën e kryer pranë përgjegjësit të sektorit dhe kryeadministratorit.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Specialisti i Kontrollit fizik dhe provave materiale, mbi kontrollin, shkeljet e konstatuara dhe raportimin rezulton se janë mbajtur procesverbalet si në vijim, shoqëruar me konstatimet dhe rekomandimet përkatëse:

#### **Procesverbale të Specialistit mbi kontrollin fizik të pasurive dhe provave materiale.**

##### Procesverbal nr. 1

Më datë 14.10.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 182 datë 26.10.2020 me administrator z. A.S. Lloji i pasurisë njësi shërbimi në rrugën “Bulevardi 18 Shtatori”, Gjirokastrë.

**Konstatim:** Pasuria e llojit njësi gjendet në katin e dytë të një pallati të mirë administruar, e mobiluar dhe e restauruar në ambient lokal. Pozicionimi dhe investimi i konsiderueshëm e favorizojnë për dhënie me qira.

**Rekomandim:** Nevojitet shpallje e vazhdueshme veçanërisht tek gazetat lokale.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 17 ku citohet: *Bën njoftimet përkatëse për dhënien me qira të pasurive dhe bashkëpunon me specialistin për marrëdhëniet*

*me institucionet dhe ndjekjen e projekteve, për publikimin dhe reklamimin sa më të plotë të pasurisë. Rifreskimi i publikimit të bëhet minimalisht njëherë në muaj.*

Procesverbal nr. 2

Më datë 02.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë së konfiskuar sipas vendimit gjyqësor nr. 28 datë 28.03.2021 me administrator z. S.M. Lloji i pasurisë “Vilë” në Velipojë.

**Konstatim:** Pasuria e llojit vilë 3 copë, në gjendje të rregullt dhe të pa banuara.

**Rekomandim:** Administratori duhet të marrë masa për ndërprerjen e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm dhe të përgatisë dokumentacionin mbi destinimin e pasurisë.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 11 ku citohet: *Nëse brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim nuk ka palë të interesuara për marrjen me qira, ose qiramarrës që janë konstatuar në objekt, duhet të fillojë procedura e ndërrimit të bravës, si dhe ndërprerja e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm.*

Procesverbal nr. 3

Më datë 01.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë sipas vendimit gjyqësor nr. 214 datë 14.12.2020 me administrator znj. E.S. Lloji i pasurisë “Apartament” në rrugën “Bodlli”, Durrës.

**Konstatim:** Pasuria e llojit apartament, në gjendje të rregullt e përshtatshme për dhënie me qira.

**Rekomandim:** Të ngrihet komision mbi vlerësimin e çmimit të tregut dhe të procedohet shpallja me qira.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 17.

Procesverbal nr. 4

Më datë 10.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë së konfiskuar sipas vendimit gjyqësor nr. 110 datë 17.07.2020 me administrator z. A.B. Lloji i pasurisë “Apartament” në rrugën “Pelivan Leskaj”, Vlorë.

**Konstatim:** Për këtë apartament u bë ndërprerja e energjisë elektrike nga grupi i punës së OSHEE.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 11.

Procesverbal nr. 5

Më datë 07.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 622018-3002 datë 25.06.2018 me administrator z. E.B. Lloji i pasurisë “Apartament” në rrugën “Komuna e Parisit”, Tiranë.

**Konstatim:** Pasuria e llojit apartament nr. 2 pa qira, pritët të finalizohet kontrata e qirasë me një person të interesuar.

**Rekomandim:** Në rast të kundërt të procedohet ndërprerja me energji elektrike dhe ujë dhe të shpallet me qira.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 7 ku citohet: *Me marrjen në administrim të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, administratori i pasurisë bën sigurimin fizik të pasurisë, bazuar në llojin dhe veçoritë e secilës pasuri, për aq sa është e mundur dhe i propozon menjëherë sektorit të administrimit ekonomiko-financiar të pasurive një plan-masash për ruajtjen, mirëmbajtjen, menaxhimin ose dhënien me qira të pasurisë.*

Procesverbal nr. 6

Më datë 07.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 6 datë 21.06.2019 me administrator z. E.B. Lloji i pasurisë “Truall+Objekt 2 kate” në rrugën “Pashko Gjeçi”, Tiranë.

**Konstatim:** Pasuria e llojit truall+objekt 2 kate, pa qira pritët të finalizohet kontrata e qirasë me një person të interesuar.

**Rekomandim:** Në rast të kundërt të procedohet me ndërprerjen e energjisë elektrike dhe ujit dhe të bëhet publikim i vazhdueshëm periodik.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 7.

Procesverbal nr. 7

Më datë 22.11.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 189 datë 12.11.2020 me administrator znj. E.O. Lloji i pasurisë “Njësi shërbimi” në rrugën “Tefta Tashko Koço”, Tiranë.

**Konstatim:** Njësia me sipërfaqe 122 m<sup>2</sup>, e cila shërben si biznes i llojit lokal. Pasuria është lëshuar me qira shtetasit E.I. me kontratë të rregullt 1 vjeçare qiraje. Në lidhje me detyrimet kontraktore, qiramarrësi deklaroi se do të shlyejë të gjitha detyrimet brenda vitit 2021. Bashkëlidhur procesverbalit gjendet deklarata dhe fotografitë.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 18 ku citohet: Kur pasuria jepet me qira:

a. ndjek periodikisht mbarëvajtjen e kontratës së qirasë;

b. bën kontrolle të herëpashershme në objekt për të parë gjendjen fizike të pasurisë;

c. eviton problemet dhe merr masa për eliminimin e tyre, në rastet kur kanë lindur jo për faj të qiramarrësit;

d. kontrollon pagesat mujore të qirasë, pagesat e faturave të energjisë, ujit të pijshëm si dhe çdo shpenzimi që mund të lindë nga përdorimi i pasurisë;

e. kur konstaton se qiraja nuk paguhet nga qiramarrësi në afat, propozon masat e parashikuara në kontratë, deri në zgjidhjen e saj;

f. në kushtet e mospërputhjes së tregut me çmimin e përcaktuar dhe nëse pasuria nuk jepet me qira për një kohë të caktuar për arsye të çmimit të qirasë, i propozon Kryeadministratorit aplikimin e çmimit më të ulët.

Procesverbal nr. 8

Më datë 11.11.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 173 datë 27.10.2020 me administrator znj. E.S. Lloji i pasurisë “Truall” në fshatin Rreth Tapi, Kuçovë.

**Konstatim:** Trualli objekt sekuestrimi u konstatua dhe fotografua nga grupi i punës me ndihmën e SPZ së zonës z. D.M. Pasuritë konsiderohen të rregullta dhe të pa përshtatshme për administrim, për shkak të vendndodhjes dhe infrastrukturës.

Procesverbal nr. 9

Më datë 07.09.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 07 datë 18.07.2019 me administrator z. S.M. Lloji i pasurisë “Apartament, njësi shërbimi, shoqëri tregtare” në rrugën “Bulevardi Nënë Tereza”, Shëngjin, Lezhë.

**Konstatim:** Hotel “A.” i cili përbëhet nga 17 dhoma të cilat ndodhen në katin e pestë dhe të gjashtë të kompleksit “A.”. Gjatë sezonit turistik 2021 janë shitur 333 netë fjetje në vlerën 3,000 lekë. Stafi i hotelit përbëhet nga 4 persona: 1 pastruese, 2 receptionist, 1 roje/mirëmbajtje. Pasuria u konstatua dhe fotografua nga grupi i punës.

**Rekomandim:** Në sezonin turistik 2022 nevojiten kontrolle periodike mbi monitorimin e hotelit.

Procesverbal nr. 10

Më datë 15.09.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 68 datë 27.01.2021 me administrator znj. E.O. Pasuri e dhënë me qira në rrugën “Martin Camaj”, Durrës.

**Konstatim:** Gjatë kontrollit fizik u gjend qiramarrësi z. T.N. i cili ushtronte aktivitetin e tij. Sipërfaqja prej 200m<sup>2</sup> nuk përputhet me gjendjen faktike. Sipërfaqja e shfrytëzuar nga qiramarrësi konstatohet më e madhe se 200m<sup>2</sup>.

**Rekomandim:** Nevojiten matje fizike në terren për saktësimin e metrave katror në shfrytëzim. Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në Ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 19 citon: Administratori i pasurisë së sekuestruar kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në

*administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira. Kryeadministratori, me kërkesë të administratorit të pasurisë, mund të autorizojë, sipas nevojës, ndihmën e specialistëve të fushave të ndryshme apo të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë, brenda kufijve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave dalë për këtë qëllim.*

Procesverbal nr. 11

Më datë 14.09.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 217 datë 09.06.2020 me administrator znj. E.O. Lloji i pasurisë së dhënë me qira “Njësi shërbimi” në rrugën “Pavarësia”, Durrës.

**Konstatim:** Gjatë kontrollit fizik se në njësinë me mbishkrimin “V.” ushtron aktivitet z. K.Sh. me kontratë qiraje nr. 1485 datë 11.09.2020. Në njësinë me mbishkrimin “Butik” ushtron aktivitetin znj. Xh.T. me kontratë qirajë nr. 1484/3 datë 29.12.2020.

Regjistrimi i kontratave të qirasë mbi monitorimin e afateve. z. K. Sh. i kishte mbaruar afati. Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 18.

Procesverbal nr. 12

Më datë 23.09.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 14 datë 17.07.2021 me administrator z. B.B. Lloji i pasurisë “Njësi shërbimi” në rrugën “Sulejman Delvina”, Vlorë.

**Konstatim:** 7 njësi të lira në katin e parë “bosh”. Pasi u fotografuan u vendosën dhe shënimet përkatëse pasuri e sekuestruar.

**Rekomandim:** Për 7 njësi nevojitet publikim më i shpeshtë për dhënie me qira.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 17.

Procesverbal nr. 13

Më datë 29.09.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 20 datë 15.09.2018 me administrator z. A.B. Lloji i pasurisë “Apartament” në rrugën “Gjergj Kastrioti”, Vlorë.

**Konstatim:** Pasuria u fotografua në gjendje të rregullt. Për këtë pasuri gjykata është shprehur për konfiskim. Administratori duhet të njoftojë gjykatën mbi shpenzimet e administrimit sipas Ligjit 34 për AAPSK. Procedura e vlerësimit pas vendimit për konfiskim dhe destinimin e pasurisë.

Procesverbal nr. 14

Më datë 30.09.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 110 datë 17.07.2020 me administrator z. A.B. Lloji i pasurisë “Apartament” në rrugën “Pelivan Leskaj”, Vlorë.

**Konstatim:** Apartamentet u gjendën në gjendje të rregullt dhe u fotografuan nga grupi i punës.

**Rekomandim:** Nevojitet procedura për ndërprerjen e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë. Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 11 ku citohet: *Nëse brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim nuk ka palë të interesuara për marrjen me qira, ose qiramarrës që janë konstatuar në objekt, duhet të fillojë procedura e ndërrimit të bravës, si dhe ndërprerja e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm.*

Procesverbal nr. 15

Më datë 11.10.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 145 datë 24.09.2020 me administrator z. A.S. Lloji i pasurisë “Shoqëri tregtare” në rrugën “Damian Humariti”, Vlorë.

**Konstatim:** Shoqëria M. V.A 2. SHPK me NIPT L.....S në administrim të drejtpërdrejtë nga z. A. S., nr punonjësve 6, ku personi i punësuar në numrin rendor 2 është subjekti të cilit i është sekuestruar pasuria.

Administratori i pasurisë nuk ka kryer detyrën e tij mbështetur në rregulloren e brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 26 ku citohet: Para lidhjes së kontratës së punësimit në objekte si biznese, shoqëri tregtare etj, administratori i pasurisë kërkon nga personat me poste drejtuese që do të punësohen në këto shoqëri, deklaratën me shkrim, ku të përcaktohet që këta punonjës nuk kanë lidhje me pronarët, të cilëve ju është sekuestruar apo konfiskuar pasuria.

Procesverbal nr. 16

Më datë 21.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 148 datë 29.09.2021 me administrator znj. B.I. Lloji i pasurisë “autoveturë” në Maminas, Durrës.

**Konstatim:** Pasuria e llojit autoveturë tip Mercedes Benz C Class 220 CDI naftë me targë A.....B, të cilin administratorja ia ka lënë në ruajtje dhe ngarkim z. A.J. Automjeti u fotografua nga grupi i punës.

Ligjin nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, neni 20 ku citohet: *Administrimi i pasurisë së luajtshme. Pasuritë e luajtshme transportohen dhe ruhen në mjediset e caktuara nga Agjencia, përveç rasteve kur këto pasuri janë pjesë e veprimtarisë së një biznesi apo kur ato shërbejnë për dhënien e pasurisë me qira.* neni 17 ku citohet: *Përveç rasteve kur autorizohet paraprakisht nga gjykata, administrator nuk lejohet të marr pjesë në gjykim, të marr kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurisë së sekuestruara apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshme.*

Procesverbal nr. 17

Më datë 21.12.2021 u krye kontrolli i pasurisë së sekuestruar sipas vendimit gjyqësor nr. 26 datë 25.03.2020 me administrator znj. B.I. Lloji i pasurisë “autoveturë” në Maminas, Durrës.

**Konstatim:** Pasuria e llojit autoveturë tip Mercedes Benz S 550 benzinë, e blinduar të cilin administratorja ia ka lënë në përdorim z. A.J. me detyrë ekonomist. Automjeti u fotografua nga grupi i punës.

Ligjin nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, neni 20.

Nga auditimi konstatohet se problematikat e mësipërme që lidhen me: *mungesën e njoftimeve periudike për dhënien me qira, mospërgatitjen e dokumentacionit për destinimin e pasurive, mosmarrjen e masave për ndërprerjen e energjisë dhe ujit për pasuritë nën administrim, mbajtjen si të punësuar të individëve pasuria e të cilëve rezulton e sekuestruar, dhënien e pasurive të luajtshme në përdorim pa autorizimin e titullarit etj, janë në kundërshtim me:*

Nenin 20 të Ligjit nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, ku citohet: *Pasuritë e luajtshme transportohen dhe ruhen në mjediset e caktuara nga Agjencia, përveç rasteve kur këto pasuri janë pjesë e veprimtarisë së një biznesi apo kur ato shërbejnë për dhënien e pasurisë me qira.*

Pikën 7 të Rregullores së brendshme të AAPSK-së, “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, ku citohet:

*7. Me marrjen në administrim të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, administratori i pasurisë bën sigurimin fizik të pasurisë, bazuar në llojin dhe veçoritë e secilës pasuri, për aq sa është e mundur dhe i propozon menjëherë sektorit të administrimit ekonomiko-financiar të pasurive një plan-masash për ruajtjen, mirëmbajtjen, menaxhimin ose dhënien me qira të pasurisë.*

**Për sa më sipër nga grupi i auditimit të KLSH-së u verifikuan në terren pasuritë si vijon:**

1. **Pasuria me nr. rendor 15 (e sekuestruar)**, konkretisht me specifikimet 55% truall me nr. 5/143, Rr “Transballkanike”, Lagjia “1 Maji”, Vlorë. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Në këtë pasuri, mbi të cilën ushtron aktivitet subjekti “G. O.”, nuk janë evidentuar probleme apo dëmtime.

2. **Pasuria me nr. rendor 16 (e sekuestruar)**, konkretisht me specifikimet truall me nr. 46/273, Rruga nacionale Vlorë - Himarë, km 4. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë.

3. **Pasuria me nr. rendor 37 (e konfiskuar)**, konkretisht me specifikimet truall dhe ndërtesë 64 m<sup>2</sup>, Rruga “Stefan Pano”, Vlorë. Kjo pasuri nuk u aksesua nga grupi i auditimit, pasi dera u gjend e mbyllur.

4. **Pasuria me nr. rendor 14 (e sekuestruar)**, konkretisht me specifikimet ½ truall me nr. 23/27-T, Rruga “10 Korriku” Vlorë. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Në këtë pasuri, mbi të cilën ushtron aktivitet subjekti “Kastrati”, nuk janë evidentuar problem apo dëmtime.

5. **Pasuritë me nr. rendor 39&40 (e konfiskuar)**, konkretisht me specifikimet Apartament 2+1 me sip. 85 m<sup>2</sup> dhe apartament 2+1 me sip. 96 m<sup>2</sup>, Rruga “Pelivan Leskaj”, Lagjia “Pavarësia”, Vlorë. Këto pasuri rezultojnë në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Apartamentet ndodhen në një pallat pa ashensor. Apartamenti i ndodhur në katin e 8 (tetë), e kishte çelësin e dëmtuar dhe nuk hapej dera, ndërsa apartamenti në katin e 2 (dytë) është i dhënë me qira, por nuk u gjend njeri në banesë.

6. **Pasuria me nr. rendor 42 (e konfiskuar)**, konkretisht me specifikimet apartament nr. 28/554+1-58, Vlorë. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Ky apartamenti është i dhënë me qira dhe nuk u gjend njeri në banesë.

7. **Pasuria me nr. rendor 48 (e konfiskuar)**, konkretisht me specifikimet apartament nr. 18/103-N9, Rruga “Zaho Koka” Vlorë. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Ky apartamenti ndodhej në katin e 2 (dytë) dhe rezulton i përshtatur për klinikë mjekësore.

8. **Pasuria me nr. rendor 49 (e sekuestruar)**, konkretisht me specifikimet truall dhe ndërtesë, lagjia “Pusi Mezin”, Rr “Demokracia”, Vlorë. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Në këtë pasuri, mbi të cilën ushtron aktivitet subjekti “E.”, nuk janë evidentuar probleme apo dëmtime.

9. **Pasuritë me nr. rendor 46&47 (të konfiskuara)**, konkretisht me specifikimet Apartament 27/131 dhe garazh 27/154, Rruga “Maro Konti”, Vlorë. Këto pasuri rezultojnë në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Apartamenti rezulton i pa dhënë me qira dhe bosh. Gjithashtu dera e garazhit ishte e dëmtuar dhe jo funksionale, si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike.

10. **Pasuria me nr. rendor 45 (e konfiskuar)**, konkretisht me specifikimet Njësi 21/7-N3/2, Rr “Hajredin Haxhiraj”, Vlorë. Kjo pasuri rezulton në përputhje me përshkrimin e agjencisë drejtuar Gjykatës dhe Prokurorisë. Pasuria rezulton të jetë me bashkëpronar, e pandarë dhe nuk është dhënë me qira.

11. **Pasuritë me nr. rendor 47&48 (të sekuestruara)**, konkretisht me specifikimet truall dhe ndërtesë, Lagjia “Isa Boletini”, Rr “Suejman Delvina”, Vlorë. Këto pasuri janë revokuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë.

12. **Pasuria me nr. rendor 51 (e sekuestruar)**, konkretisht me specifikimet truall dhe ndërtesë, Lagjia “Isa Boletini”, Rr “Sulejman Delvina”, Vlorë. Kjo pasuri rezulton se nuk është marrë në dorëzim.

Në kundërshtim me pikën 18 të nenit 14 të Rregullores së Brendshme, në lidhje me pasuritë e verifikuara në terren, nga ana e administratorëve nuk është përgatitur asnjë raport apo procesverbal periodik ku të pasqyrohen kontrollet e herëpas-hershme në objekt për të parë

gjendjen fizike të pasurisë apo pagesat mujore të qirasë, faturave të energjisë dhe ujit të pijshëm.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi administratori përkatës i pasurisë si dhe Kryeadministratori.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Mungesa e kontrolleve periodike mbi pasuritë e marra në administrim nga ana e administratorëve të pasurive</b>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i procesverbaleve të mbajtura nga Specialisti i Kontrollit fizik mbi monitorimin, shkeljet e konstatuara dhe raportimin janë konstatuar problematikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Administratorët e pasurive nuk kanë bërë shpallje për dhënien me qira dhe nuk kanë marrë masa për ndërprerjen e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm në kundërshtim me pikën 11, 17 të nenit 14 të Rregullores së Brendshme të AAPSK-së.</li> <li>-Në 2 njësi shërbimi, është konstatuar ushtrimi i aktivitetit pa paguar qira dhe nga ana e administratorit të pasuritë nuk është ndjekur procedura e rinovimi të kontratës së qirasë, në kundërshtim pikën 18, b/d të nenit 14 të Rregullores së Brendshme të AAPSK-së.</li> <li>-Nga ana e administratorit të pasurisë është lidhur kontratë qiraje për një sipërfaqe që nuk përputhje me gjendjen faktike, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 19 të ligjit nr. 34/2019.</li> <li>-Për shoqërinë tregtare “M. V. 2.” SHPK me NIPT L.....S në administrim të drejtpërdrejtë nga administratori i pasurisë vazhdon të jetë në listën e të punësuarve subjekti të cilit i është sekuestruar pasuria në kundërshtim me pikën 26, neni 14 të Rregulloren së Brendshme të AAPSK-së.</li> <li>-Nga ana e Administratorit të pasurive, rezulton se dy prej automjeteve të sekuestruara sipas vendimit gjyqësor nr. 26 datë 25.03.2020 i janë lënë në ruajtje dhe ngarkim ekonomistit të shoqërisë “R. B. D.” me NIPT K.....B, në kundërshtim me pikën f të nenit 9, pikën 1, 2 të nenit 14 dhe pikën 1 të nenit 20 të ligjit nr. 34/2019.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” neni 9, pika f, neni 14 pika 1, 2, neni 19, pika 3, neni 20, pika 1.</li> <li>-Rregullorja e brendshme të AAPSK-së, neni 14 “Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve”, pika 7, 11, 17, 18, 26.</li> </ul>
<b>Impakti:</b>	Mungesa e kontrolleve periodike në objekt për të parë gjendjen fizike të pasurisë si dhe dokumentimi i tyre nga ana e administratorëve përkatës përbën një risk të shtuar në funksion të mirëadministrimit të pasurive.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara me ligj dhe rregullore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Administratorët e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara së bashku me specialistin për kontrollin fizik dhe provave materiale të kryejnë kontrolle periodike në terren dhe të raportojnë tek Kryeadministratori mbi cdo problematikë të hasur.</p> <p>Kryeadministratori i AAPSK-së në cilësinë e titullarit të institucionit, të marrë masa për administratorët e pasurive të cilët shmangin detyrat dhe përgjegjësitë nga detyrat e tyre funksionale.</p>



## 2.2.6 Për zbatimin e procedurave të dhënies me qira të objekteve, dhënies në përdorim dhe kalimi në pronësi institucioneve shtetërore

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga AAPSK mbi pronat e sekuestruara, të revokuara dhe të konfiskuara për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, gjendja rezulton si në vijim:

Pasqyra nr. 3 Pasuritë e sekuestruara, revokuara, konfiskuara

2017								
Sekuestruar			Revokuar			Konfiskuar		
Sasi	Vlerë ALL	Euro	Sasi	Vlerë ALL	Euro	Sasi	Vlerë ALL	Euro
49	676,171,912.00	5,085,911.34	32	68,384,705.00	514,364.0842	25	184,503,128.00	1,387,763.28
2018								
Sekuestruar			Revokuar			Konfiskuar		
Sasi	Vlerë ALL	Euro	Sasi	Vlerë ALL	Euro	Sasi	Vlerë ALL	Euro
183	901,326,213.03	7,268,759.78	99	515,291,000.60	4,155,572.585	6	3,302,868.00	26,636.03
2019								
Sekuestruar			Revokuar			Konfiskuar		
Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro
41	2,471,281,216.71	20,091,717.21	77	337,038,693.53	2,740,151.90	5	106,981,794.00	869,770.70
2020								
Sekuestruar			Revokuar			Konfiskuar		
Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro
230	2,590,944,950	21,098,900	8	32,112,000.00	261,498.37	5	20,169,835	164,249
2021								
Sekuestruar			Revokuar			Konfiskuar		
Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro
327	7,273,830,337.00	60,615,252.81	31	574,849,941.10	4,790,416.18	48	508,714,584.69	4,239,288.21
2022								
Sekuestruar			Revokuar			Konfiskuar		
Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro	Sasi	Vlerë ALL	Konvertuar në Euro
74	4,825,831,157.50	41,601,992.74	78	1,656,143,637.16	14,277,100.32	86	608,964,011.83	5,429,689.76

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se:

-për pasuritë e sekuestruara viti 2021 zë peshën më të lartë, si numër ashtu dhe në vlerë, konkretisht 327 pasuri të sekuestruara, në vlerë 7,273,830 mijë lekë, ndërsa peshën më të ulët e ka viti 2017 me 41 pasuri në vlerën prej 2,471,281 mijë lekë.

-për pasuritë e revokuara viti 2022 zë peshën më të lartë, me 78 pasuri të revokuara në vlerën 1,656,144 mijë lekë ndërsa peshën më të ulët e ka viti 2020 me 8 pasuri me vlerë 32,112 mijë lekë.

-për pasuritë e konfiskuara viti 2022 zë peshën më të lartë me 86 pasuri në vlerën 608,964 mijë lekë, ndërsa viti me peshën më të ulët e ka viti 2020 me 5 pasuri në vlerën prej 20,170 mijë lekë.

Nëse marrim në konsideratë vlerën e siguruar nga të ardhurat konstatohet se veprimtaria e AAPSK-së është formale dhe nuk është e ndikuar nga numri dhe vlera e pasurive në dispozicion, pasi ka ndryshim të konsiderueshëm të raportit numër-vlerë pasurie/ të ardhura sipas viteve të periudhës së audituar.

Në të njëjtën kohë, numri dhe vlera e lartë e pasurive të revokuara përbën një risk të shtuar në mirëfunksionimin e veprimtarisë së AAPSK-së.

### Të ardhurat dhe Shpenzimet e Agjencisë

Nga auditimi konstatohet se nuk ka një plan të ardhurash dhe shpenzimesh me qëllim që të analizohet realizimi i treguesve krahasuar me planin, duke qenë se aktiviteti ndryshon vit pas viti dhe të ardhura/shpenzimet e pasurive janë qenë në varësi të pasurive në administrim.

Pika 1 e Nenit 29 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar citon:

1. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara përftohen nga:
  - a) dhënia me qira e pasurive;
  - b) administrimi i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të tretëve i veprimtarive ekonomike;
  - c) interesat e përfituara nga depozitimi i vlerave monetare në llogari bankare apo bono thesari;

ç) të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara;  
d) të ardhurat nga shitja e pasurive;  
dh) të ardhura të tjera në çdo lloj cilësie a burimi të ligjshëm.

Sipas përcaktimeve të pikës 1/a dhe 2 të nenit 7, të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, Buxheti i Agjencisë financohet nga:

a) buxheti i shtetit, si pjesë përbërëse e buxhetit të “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”

2. Buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e Agjencisë, si dhe ato për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, vetëm në rastet kur të ardhurat e siguruara nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive nuk janë të mjaftueshme.

Sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 24, të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar është Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar i cili vendos për destinimin e pasurive, si dhe për përdorimin efektiv të të ardhurave brenda buxhetit të shtetit, përfshirë edhe vendimin për pagimin e shpenzimeve operative të Agjencisë.

### Viti 2017

Referuar raportit të aktivitetit të vitit 2017 të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Pasqyra nr. 4 Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre 2017*

	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në %</b>
1	Qiraja e objekteve	6,104,395	11.39
2	Të ardhurat nga interesat dhe kamatëvonesat	2,484,983	4.63
3	Të ardhurat nga pasuritë e konfiskuara	44,999,968	84
	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>53,589,347</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Referuar tabelës, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga pasuritë e konfiskuara në vlerën 44,999,968 lekë ose 84% e totalit të të ardhurave.

*Pasqyra nr. 5 Shpenzimet e vitit 2017*

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në %</b>
1	Marrja në dorëzim	81,926	0.2
2	Shërbim roje	24,628,819	63
3	Shërbime për veprimtarinë e pasurisë (psh ekspertë për vlerësimin e pasurive)	1,884,005	5
4	Paga e administratorëve dhe ndihmës administratorëve	12,240,537	31.2
5	Sigurimi i domosdoshëm	289,628	0.75
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>39,124,917</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Siç shihet nga tabela zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën **24,628,819 lekë** ose 63% të totalit të shpenzimeve. Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat e administratorëve në vlerën 12,240,537 lekë ose rreth 31.2 % të totalit të shpenzimeve. Në lidhje me shpenzimet për zërin sigurim i domosdoshëm nga auditimi u konstatua se jo të gjitha pasuritë sigurohen.

### Viti 2018

Referuar raportit të aktivitetit të vitit 2018 të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Pasqyra nr. 6 Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre 2018*

	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në %</b>
1	Qiraja e objekteve	5,048,808	93
2	Të ardhurat nga interesat dhe kamatëvonesat	372,626	7

	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>5,421,434</b>	<b>100%</b>
--	------------------------------	------------------	-------------

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pasurive në vlerën 5,048,808 lekë ose 93% e totalit të të ardhurave.

*Pasqyra nr. 7 Shpenzimet e vitit 2018*

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Shërbimi i rojës së objekteve të sek/konf.	12,558,661	39.7
2	Pagat + Sigurime shoqërore	12,427,881	39.4
3	Të tjera	6,587,533	20.9
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>51,348,695</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Siç shihet nga tabela zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën **12,558,661 lekë** ose 39.7% të totalit të shpenzimeve. Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 12,427,881 lekë ose rreth 39.4 % të totalit të shpenzimeve. Në vitin 2018 evidentohet një ndryshim i konsiderueshëm i të ardhurave krahasuar me vitin 2017 (të ardhurat e vitit 2018 rreth 10% e të ardhurave të vitit 2017) pasi në vitin 2018 nuk janë marr fonde nga buxheti i shtetit por shpenzimet janë mbuluar me fondet e buxhetit të shtetit të marra në vitin 2017.

## Viti 2019

Referuar raportit të aktivitetit për vitin 2019 të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Pasqyra nr. 8 Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre 2019*

	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Qiraja e objekteve	7,655,833	11.1
2	Të ardhurat nga interesat bankare	24,627	0.03
3	Të ardhura nga konfiskimi i pasurive	61,400,000	88.8
4	Të ardhura nga kamatëvonesa për pasuritë e dhëna me qira	21,772	0.03
	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>69,102,226</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës, zërin kryesor të të ardhurave e zë e ardhura në buxhet nga konfiskimi i pasurive me vendim komiteti në vlerën 61,400,000 lekë ose 88.8% e totalit të të ardhurave. Gjithashtu zëri i dytë kryesor është e ardhura nga dhënia me qira e pasurive në vlerën 7,655,833 lekë ose 11.1% e të ardhurave.

*Pasqyra nr. 9 Shpenzimet e vitit 2019*

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Shërbimi i rojës së objekteve te sek/konf.	18,260,734	52.6
2	Pagat + Sigurime shoqërore	12,402,911	35.7
3	Të tjera	4,037,675.95	11.7
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>34,701,320.95</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Siç shihet nga tabela zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën **18,260,734 lekë** ose 52.6% të totalit të shpenzimeve. Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 12,402,911 lekë ose rreth 35.7 % të totalit të shpenzimeve.

## Viti 2020

Referuar raportit të aktivitetit për vitin 2020 të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Pasqyra nr. 10 Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre 2020*

	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në %</b>
1	Qiraja e objekteve	15,242,246	96.6
2	Të ardhurat nga interesat	524,595	3.32
3	Të ardhura nga shitja e pasurive të sek/konfiskuara	0	0
4	Të ardhura nga kamatëvonesa për pasuritë e dhëna me qira	0	0
5	Të ardhura nga revokimi i pasurive	4,390	0.08
	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>15,771,221</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Referuar tabelës, zërin kryesor të të ardhurave e zë e ardhura nga dhënia me qira e pasurive në vlerën 15,242,246 lekë ose 96.6% e të ardhurave.

*Pasqyra nr. 11 Shpenzimet e vitit 2020*

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në %</b>
1	Shërbimi i rojës së objekteve te sek/konf.	17,818,149	46.8
2	Pagat + Sigurime shoqërore	13,060,272	34.4
3	Të tjera	7,211,532	18.8
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>38,059,953</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Siç shihet nga tabela zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën **17,818,149 lekë** ose 46.8% të totalit të shpenzimeve. Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 13,060,272 lekë ose rreth 34.4 % të totalit të shpenzimeve.

## Viti 2021

Referuar raportit të aktivitetit për vitin 2021 të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Pasqyra nr. 12 Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre 2021*

	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>	<b>Vlera në %</b>
1	Qiraja e objekteve	50,327,224	59
2	Të ardhurat nga interesat bankare	458,653	0.54
3	Të ardhura nga kamat vonesa	15,800	0.01
4	Të ardhura në buxhet nga konfiskimi i pasurive me vendim kom	27,055,942	31.9
5	Të ardhura nga revokimi i pasurive	6,938,156	8.18
	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>84,795,775</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Referuar tabelës, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve, në shumën 50,327,224 lekë ose 59% të totalit të të ardhurave. Gjithashtu zëri i dytë kryesor është e ardhura në buxhet nga konfiskimi i pasurive me vendim komiteti në vlerën 27,055,942 lekë ose 31.9% e totalit.

*Pasqyra nr. 13 Shpenzimet e vitit 2021*

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Shërbimi i rojës së objekteve te sek/konf.	25,951,830.16	50.5
2	Pagat + Sigurime shoqërore	14,772,987	28.7
3	Të tjera	10,623,877.84	20.8
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>51,348,695</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Siç shihet nga tabela zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në shumën prej **25,951,830 lekë** ose 50.5% të totalit të shpenzimeve. Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në shumën prej **14,772,987 lekë** ose rreth 28.7 % të totalit të shpenzimeve.

**Viti 2022**

Referuar raportit të aktivitetit për vitin 2022 të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

*Pasqyra nr. 14 Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre 2022*

	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Qiraja e objekteve	74,981,049	45.4
2	Të ardhura në buxhet nga konfiskimi i pasurive me vendim kom	83,000,000	50.2
3	Të ardhura nga revokimi i pasurive	7,153,171	4.34
	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>165,134,220</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Siç shihet edhe nga tabela, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga konfiskimi i pasurive me vendim komitetit në vlerën 83,000,000 lekë ose 50.2%, e totalit të të ardhurave gjithsej. Zërin e dytë kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat nga qiraja në vlerën **74,981,049 lekë** ose rreth 45.4 % të totalit të të ardhurave.

*Pasqyra nr. 15 Shpenzimet e vitit 2022*

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Shërbimi i rojës së objekteve të sek/konf.	33,608,353	40.3
2	Pagat + Sigurime shoqërore	18,975,964	22.7
3	Të tjera	30,875,717	37
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>83,460,034</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Siç shihet nga tabela zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën **33,608,353 lekë** ose 40.3% të totalit të shpenzimeve. Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në shumën prej **18,975,964 lekë** ose rreth 22.7 % të totalit të shpenzimeve.

**Konkluzion:** Nga testimet e KLSH-së dhe raportimet nga ana e AAPSK-së rezulton se shpenzimet më të larta për të gjithë periudhën objekt auditimi e zë zëri shpenzime roje objekti dhe zëri pagat e administratorëve.

Nga auditimi konstatohet se në zërin të ardhura përfshihen edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit, konkretisht:

Nr	Emërtimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Total
1.	Të ardhura nga aktiviteti	8,589,379	5,421,434	7,702,226	15,771,221	57,739,833	82,134,220	177,358,313

2.	Shpenzime	39,124,917	51,348,695	34,701,321	38,059,953	51,348,695	83,460,034	298,043,615
3.	Diferenca (të ardhura nga buxheti i shtetit)	-30,535,538	-45,927,261	-26,999,095	-22,288,732	6,391,138	-1,325,814	<b>120,685,302</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi konstatohet se në raportimet e AAPSK-së mbi të ardhurat janë përfshirë edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit për të mbuluar shpenzimet, që nuk përfaqësojnë të ardhura nga vet veprimtaria e tyre, duke i mbivlerësuar në këtë mënyrë këto të fundit.

Nisur nga testimet e KLSH-së mbi raportimet e AAPSK-së, të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (pa të ardhurat nga buxheti i shtetit) janë konsiderueshëm më të ulëta se shpenzimet, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 298,044 mijë lekë. Si rrjedhojë diferenca prej 120,686 mijë lekë rezulton kosto për buxhetin e shtetit.

Duke e zhveshur raportimin e AAPSK-së nga të ardhurat e buxhetit, të ardhurat e vet AAPSK-së do të rezultonin si në vijim:

Pasqyra nr. 16 Të ardhura-shpenzime

Në lekë

Nr	Emërtimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.	Të ardhura	<b>8,589,379</b>	5,421,434	<b>7,702,226</b>	15,771,221	<b>57,739,833</b>	<b>82,134,220</b>
2.	Shpenzime	39,124,917	51,348,695	34,701,321	38,059,953	51,348,695	83,460,034
3.	Diferenca	-30,535,538	-45,927,261	-26,999,095	-22,288,732	6,391,138	-1,325,814

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën objekt auditimi u audituan me zgjedhje procedurat e ndjekur nga AAPSK për asetet dhe përputhshmëria ligjore e tyre në rastet kalimit në pronësi, dhënies në administrim/përdorim, dhe me qira.

Referuar Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, Vendimit nr. 632, datë 23.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara” dhe Vendimit nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, kreut II “Format e përdorimit të pasurive të konfiskuara dhe procedura e dhënies në përdorim” janë:

- kalimi në përgjegjësi administrimi për institucionet qendrore dhe kalimi në përdorim për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- dhënia në huapërdorje, për subjektet e tjera përfituese;
- dhënia me qira.

### - Lidhur me dhënien në përdorim

Në fund të vitit 2022 rezultojnë 86 pasuri të konfiskuara me vlerë totale 608,964,011 lekë.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga AAPSK, rezulton se për periudhën 2017-2022 janë dhënë për përdorim social 4 pasuri të paluajtshme të konfiskuara si në vijim:

Pasqyra nr. 17 Pasuritë e dhëna për përdorim social

Pasuritë e dhëna për përdorim social					
Nr.	Lloji i pasurisë	Projekti	Subjekti përfitues	Afati	Vlera e përafërt
1	2 Njësi, Fier	K. B.	E.	15.01.2018- 01.2028 (e rinovuar)	12,681,900
2	Lokal, Durrës	K. C. L.	F.A. S.	01.05.2019-01.2023	6,679,268
3	Garazh, Sarandë	P.	I. Z., M. I.	29.04.2019-30.04.2024	2,400,000
4	Bodrum, Elbasan	T.	J. F.	01.04.2021- 31.03.2026	4,275,500

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Këto pasuri të paluajtshme janë shndërruar në biznese sociale si më poshtë:

-Njësi në qytetin e Fierit, shndërruar pastičeri “K.”, pjesë e projektit C. implementuar nga E.

Referuar Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 41, datë 08.05.2017 “Për kalimin e pasurive të konfiskuara në dispozicion të projektit C. (C. A. U. S. E.) është lidhur kontrata nr. 59, datë 15.02.2018.

-Garazh në qytetin e Sarandës, shndërruar në punishte artizanale “G. S. A.”, pjesë e projektit C., implementuar nga I. (I.). Referuar Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 41, datë 08.05.2017 “Për kalimin e pasurive të konfiskuara në dispozicion të projektit C. (C. A. U. S. E.) është lidhur kontrata nr. 378, datë 26.04.2019.

-Njësi në qytetin e Durrësit shndërruar në qendër studimore dhe aktivitetesh akademike “K. C. L.”, pjesë e projektit C., implementuar nga F. A. S. dhe Q. Z. S. C. D. Referuar Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 41, datë 08.05.2017 “Për kalimin e pasurive të konfiskuara në dispozicion të projektit C. (C. A. U. S. E.) është lidhur kontrata nr. 379, datë 26.04.2019.

-Njësi në qytetin e Elbasanit shndërruar në punishte artizanale “T.” nëpërmjet E. A. Referuar vendimit nr. 17, datë 03.03.2021 të KNMKKO “Për dhënien në përdorim të bodrumit me sipërfaqe 85 m<sup>2</sup>, në zbatim të projektit R.-A., për një periudhë 5-vjeçare pa qira, është lidhur kontrata nr. 1867, datë 21.06.2021.

Dy pasuri të luajshme si në vijim: Referuar Vendimit nr. 19 datë 07.04.2021 të KNMKKO “Për kalimin e dy automjeteve në pronësi të Bashkive Shkodër dhe Peshkopi” që të përdoren si biblioteka lëvizëse në Bashkitë respektive, në kuadër të Projektit të G.

### Lidhur me kalimin në pronësi Institucioneve Publike

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga AAPSK, rezulton se janë kaluar në pronësi të Institucioneve Publike asetet si më poshtë vijon:

*Pasqyra nr. 18 Pasuri kaluar në pronësi të Institucioneve Publike*

Pasuri kaluar në pronësi të Institucioneve Publike		
Nr.	Lloji i Pasurisë/të tjera	Institucioni përfitues
1	Laguna e Karavastësë	Ministria e Mjedisit
2	Truall për shkollën	Shkollës së mesme 18 Tetori (Bashkia Lushnje)
3	Truall +objekt	Komisariati Lushnje
4	Tokë Pyll Darezëzë Fier	Ministria e Mjedisit
5	Pajisje të një palestere	Akademisë së Policisë
6	Pajisje të një bar restorant dhe qendër argëtuese	Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të trafikimit
7	Pajisje zyre	Gardës së Republikës

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

### Lidhur me dhënien me qira

Referuar Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, nenit 16,1: *Administratori ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, ai ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive.*

Referuar Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, nenit 9, pikës f: *Kryeadministratori negocion dhe lidh kontratat e qirasë, huapërdorjes dhe enftëzës për pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara.*

Për caktimin e çmimeve të dhënies me qira, kryeadministratori ngre rast pas rasti një komision për vlerësimin e tregut, i cili duhet të bëjë vlerësimin e tregut duke u bazuar në:

- a) akte ligjore në fuqi, që përafrojnë vlerësimin me zonat kadastrale ku ndodhet pasuria;
- b) vlerësimin e ekspertit;
- c) çmimet e aplikuara në zonën përreth pasurisë së konfiskuar;
- ç) çmimet zyrtare për objekte të së njëjtës natyrë;
- d) kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhet pasuria.

Komisioni ngrihet nga kryeadministratori, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, të ndryshuar, dhe përbëhet nga administratori i pasurisë dhe 2 (dy) përfaqësues të AAPSK-së, të cilët caktohen nga kryeadministratori.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga AAPSK, rezulton se janë dhënë me qira pasuritë si

më poshtë vijon:

*Pasqyra nr. 19 Pasuritë e dhëna me qira dhe të ardhurat totale*

Pasuritë e dhëna me qira dhe të ardhurat totale në lekë		
Vitet	Nr pasurive me qira	Totali i të ardhurave nga qiraja
2018	38	5,048,808
2019	40	7,676,850
2020	65	15,376,894
2021	146	50,336,224
2022	170	74,981,049
<b>Totali</b>	<b>459</b>	<b>153,419,825</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*


Nëse marrim në konsideratë të ardhurat nga qiraja në raport me të ardhurat totale sipas viteve, evidentohet si në vijim:

*Pasqyra nr. 20 Të ardhura nga qiraja/të ardhura totale*

Vitet	Të ardhura nga qiraja	Të ardhura totale	%
2017	6,104,395	53,589,347	11%
2018	5,048,808	5,421,434	93%
2019	7,655,833	69,102,226	11%
2020	15,242,246	15,771,221	97%
2021	50,327,224	84,795,775	59%
2022	74,981,049	165,134,220	45%
<b>Totale</b>	<b>153,255,160</b>	<b>340,224,876</b>	

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Konstatohet se viti 2022 ka vlerën më të lartë të të ardhurave, kryesisht për shkak të rritjes së numrit të pasurive të sekuestruara/konfiskuara dhe rritjes së numrit të pasurive të dhëna me qira, paraqitur dhe grafikisht si në vijim:



Nga 459 pasuri të dhëna me qira periudhën objekt auditimi janë audituar 112 prej tyre ose 24.4% e tyre.

Nga shqyrtimi i tyre u konstatuan disa parregullsi, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

**1.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 11, datë 20.07.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 2/357-B3, zona kadastrale 8270, vol. 92, faqe 22, bodrum me sipërfaqe 224,5 m<sup>2</sup> në Tiranë, në pronësi të shtetasit E.P.S. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1677, datë 28.05.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”.

Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1677/1, datë 28.05.2021 propozimi i çmimit për bodrumin me sipërfaqe 224,5 m<sup>2</sup>, është vendosur 289,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr.1711 prot., datë 31.05.2021 midis AAPSK-së dhe S. B. S. P. rezultoi se: qiramarrësi ka paguar çdo muaj qiranë prej 245,650 lekë. Pas përfundimit të afatit I(një) vjeçar, AAPSK-ja ka rinovuar kontratën nr. 1532 datë 20.05.2022 me shoqërinë B. S. P.

**2.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas



vendimit nr. 177 datë 27.10.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/111/ND, zona kadastrale 3369, vol. 16, faqe 205, ndërtesë me sipërfaqe totale të ndërtimit 435 m<sup>2</sup> Kat.I-83 m<sup>2</sup>, Kat.II -88 m<sup>2</sup>, Kat.III- 88 m<sup>2</sup>, Kat.IV- 88 m<sup>2</sup>, Kat.V- 88 m<sup>2</sup> në Shijak Durrës, në pronësi të shtetasve L. dhe V.K.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 368, datë 03.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 368/1, datë 04.02.2021 propozimi i çmimit për ndërtesën me sipërfaqe totale 435 m<sup>2</sup>, është vendosur 100,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2630, datë 28.09.2021 midis AAPSK-së dhe qiramarrësit V.A. rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Rezultojnë pagesa vetëm në muajin shkurt (400,000 lekë), qershor (200,000 lekë) dhe në muajin nëntor (300,000 lekë), pa llogaritur kamatë vonesë.

**3.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, sipas vendimit nr. 164, datë 08.06.2022 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 3/560, zona kadastrale 8564, me sipërfaqe trualli 182 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 147 m<sup>2</sup> në Korçë, në pronësi të shtetas L.K.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 3126/1, datë 31.10.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 3126/2, datë 08.11.2022, propozimi i çmimit për objektin me sipërfaqe trualli 182 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 147 m<sup>2</sup> të jetë 60,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3241 prot., datë 09.11.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses E.M. rezultoi se: çmimi i kontraktuar është 80.000 lekë/muaj. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga AAPSK, qiramarrësi ka paguar çdo muaj qiranë. Çmimi i vendosur në kontratë nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni në procesverbalin për vlerësimin e çmimit të tregut që është 60,000 lekë/muaj.

**4.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 145, datë 24.09.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë shoqëria “A.” SHPK me NIPT J.....F në Vlorë, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasen D.C.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 917, datë 28.03.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 917/1, datë 29.03.2022 propozimi i çmimit për shoqërinë “A.” SHPK, të jetë 20,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 947, datë 30.03.2022 midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.A. rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Edhe pse nga ana e qiramarrësit nuk janë respektuar në afat detyrimet kontraktuale, nga ana e AAPSK-së është përsëritur kontrata me këtë qiramarrës. Çmimi i vendosur në kontratë nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe është 35,000 lekë/muaj.

**5.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 174, datë 29.09.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 8/196, zona kadastrale 8270, truall me sipërfaqe 383,6m<sup>2</sup> në Tiranë, në pronësi të shtetasit E.J. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 383, datë 03.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 383/1, datë 05.02.2021, propozimi i çmimit për bodrumin me sipërfaqe 383,6 m<sup>2</sup>, është caktuar 50,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1095, datë 30.03.2021 midis AAPSK-së dhe

Shpëtim Kajës, rezultoi se pagesa nuk është kryer çdo muaj, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

6. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 111, datë 20.07.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 2/357-B4, zona kadastrale 8270, vol. 92, faqe 23, bodrum me sipërfaqe 10 m<sup>2</sup> në Tiranë, në pronësi të shtetasit E.P.S.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1677, datë 28.05.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1677/1 datë 28.05.2021 propozimi i çmimit për bodrumin me sipërfaqe 10 m<sup>2</sup>, është caktuar 49,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1470 datë 17.05.2022 midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.B, rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

7. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 22, datë 23.10.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurive së paluajtshme:

-Pasuria e paluajtshme nr. 6/121-N8, zona kadastrale 8160, vol.22, faqe 4, apartament me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> në Tiranë në pronësi të shtetasit R.R;

-Pasuria e paluajtshme nr. 6/121-N9, zona kadastrale 8160, vol. 22, faqe 25, apartament me sipërfaqe 30m<sup>2</sup> në Tiranë në pronësi të shtetasit R.R;

-Pasuria e paluajtshme nr. 107/49+1-N2, zona kadastrale 3292, vol.60, faqe 140, me sipërfaqe 127.5 m<sup>2</sup> regjistruar në emër të shtetasit M.C, por që është zotërim të tërthortë nga shtetasi R.R.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 3147, datë 16.11.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 3147/1, datë 19.11.2021 propozimi i çmimit për 2 apartamentet (të kthyera në një njësi) me sipërfaqe total 106 m<sup>2</sup>, është caktuar 95,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3322, datë 06.12.2021 midis AAPSK-së dhe Shoqërisë “M.” (R.T.) rezultoi se pagesa nuk është kryer çdo muaj, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Me shkresën nr. 1888 prot., datë 24.06.2022, Shoqëria “M.” (R.T.) i ka njoftuar palës qiradhënëse njoftimin për përfundimin e kontratës së qirasë. Me shkresën nr. 1888/1 prot., datë 13.09.2022, AAPSK i ka dërgon njoftim Shoqërisë “M.” (R. T.), se nuk ka shlyer detyrimet, këstin e qirasë për muajt prill, qershor, në shumën totale 190,000 lekë, referuar kontratës së qirasë kërkon prishjen e saj, shlyerjen e detyrimeve si dhe lirimimin e dorëzimit të ambienteve.

Për pasurinë e paluajtshme nr. 107/49+1-N2, zona kadastrale 3292, vol.60, faqe 140, me sipërfaqe 127.5 m<sup>2</sup>, në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 3147/2, datë 22.11.2021 propozimi i çmimit është caktuar 90,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3231, datë 26.11.2021 midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.K., rezultoi se pagesa nuk është kryer çdo muaj, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe duhet të bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Me shkresën nr. 646 prot., datë 01.03.2022, qiramarrësi F.K., i ka dërguar AAPSK-së, kërkesë për prishje kontrate.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 714, datë 07.03.2022, për prishjen e

kontratës së qirasë nr. 3231, datë 26.11.2021. *Si konkluzion, nuk është zbatuar pika 10-10.5 e kontratës së qirasë ku citohet: Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penaltitet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, penaltiteti sipas Kontratës duhet të ishte në vlerën 90,000 lekë, i cili nuk është llogaritur dhe mbajtur.*

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2031 datë 08.07.2022 midis AAPSK-së dhe qiramarrëses A.M., rezultoi se nuk janë kryer pagesat ,në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë nr.2031, datë 08.07.2022 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Çmimi i kontratës së qirasë është 75,000 lekë në muajin e parë dhe për të 11 muaj të tjerë 150,000 lekë. Ky çmimi nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni në procesverbalin nr. 3147/2, datë 22.11.2021 prej 90,000 lekë.

Me kërkesën drejtuar AAPSK nga qiramarrësja A.M., me nr. 2189 prot., datë 26.07.2022 kërkohet zgjidhja e kontratës së qirasë 08.07.2022. *Si konkluzion, nuk është zbatuar pika 10-10.5 e kontratës së qirasë ku citohet: 10.2-Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penaltitet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, penaltiteti sipas Kontratës është në vlerën 75,000 lekë, shumë e cila nuk është llogaritur dhe mbajtur nga AAPSK.*

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë (e lidhur për të njëjtën pasuri) nr. 2257, datë 12.09.2022 midis AAPSK-së dhe qiramarrëses E.A., rezultoi se nuk janë kryer pagesat ,në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Çmimi i vendosur në kontratën e qirasë nr. 2257, datë 12.09.2022 është 129.500 lekë/muaj bruto dhe nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni në procesverbalin nr. 3147/2, datë 22.11.2021.

**8.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas vendimit nr. 1791, datë 06.10.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 305/318+3-4, zona kadastrale 3866, vol. 102, faqe 80, apartament me sipërfaqe 80.90 m<sup>2</sup> në Tiranë, në pronësi të shtetasve G.L. dhe P.L.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 3293, datë 02.12.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 3293/1, datë 06.12.2021 propozimi i çmimit për apartamentin me sipërfaqe 80.90 m<sup>2</sup>, është caktuar 25,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3329, datë 06.12.2021 midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.S., rezultoi se nuk janë kryer pagesat rregullisht, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Është rilidhur kontratë qiraje nr. 3533, datë 15.12.2022, ku çmimi i qirasë në pikën 5.1 të kontratës është 25, 000 lekë/muaj bruto dhe në pikën 5.2 të kontratës citohet që: Çmimi i qirasë do të jetë 30.000 lekë/muaj, në momentin që qiramarrësi do të përfitoj bonusin e qirasë nga Bashkia e Tiranës, duke vendosur kusht një ngjarje jo të sigurt të së ardhmes.

**9.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 81 datë 02.02.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 8/538, zona kadastrale 8532, vol. 30, faqe 162, truall me sipërfaqe 1580 m<sup>2</sup> mbi të cilin është ndërtuar një objekt me sipërfaqe 1200 m<sup>2</sup> (Dyqane) në Fier, në pronësi të shtetasit A.A.I.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1359, datë 21.04.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1272/3 datë 20.04.2021, propozimi i çmimit për ndërtesën me sipërfaqe 1200 m<sup>2</sup>, e ndarë në 2 njësi të jetë 145,000 lekë/muaj për secilën prej njësive me sipërfaqe 600 m<sup>2</sup>.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1413 datë 28.04.2021 midis AAPSK-së dhe Sh.H. dhe kontratës së qirasë nr. 1414 datë 28.04.2021 midis AAPSK-së dhe P.H., pagesat janë

kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i këtyre kontratave ka qenë 01.05.2021-30.04.2022.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1409, datë 11.05.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit B.B., rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

**10.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 81 datë 02.02.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 11/69-N13, zona kadastrale 8531, faqe 1, njësi me sipërfaqe 55.16 m<sup>2</sup> (nga të cilat 16.56 m<sup>2</sup> ambient i përbashkët), në Fier, në pronësi të shtetasës E.A.B (I.).

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1359, datë 21.04.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë) propozimi i çmimit për ndërtesën me sipërfaqe 38 m<sup>2</sup>, të jetë 10,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1415, datë 28.04.2021 midis AAPSK-së dhe T.E., rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kësaj kontrate ka qenë 01.05.2021-30.04.2022.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 121 datë 27.04.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1281/1 datë 27.04.2022 propozimi i çmimit për njësinë me sipërfaqe 38 m<sup>2</sup>, është caktuar 25,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1285 datë 28.04.2022, midis AAPSK-së dhe T.E., rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Me shkresën nr. 2605 prot., datë 15.09.2022, AAPSK i drejtohet qiramarrësit me njoftimin për mosshlyerje të detyrimeve të tij për muajt qershor, korrik, gusht, shtator, në shumën prej 580,000 lekë. AAPSK ka marr masa për vjeljen e detyrimit përgjatë vitit 2023.

**11.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 174 datë 28.10.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme njësi, me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>, në Urë Vajgurore, në pronësi të shtetasit N.R.H.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 281 datë 28.01.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 281/1 datë 28.01.2021, propozimi i çmimit për ndërtesën me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>, është caktuar 15,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 545 datë 16.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit P.T., rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 632 datë 25.02.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit P.T (rilidhur) rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

**12.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 10 datë 23.04.2021 ka vendosur sekuestrimin e 55% të pasurisë së paluajtshme nr. 35/143, zona kadastrale 8604, vol. 52, faqe 44, trull me sipërfaqe 764 m<sup>2</sup> dhe godinë (objekt

stacion karburanti) me sipërfaqe 57m<sup>2</sup> dhe ½ e pasurisë nr. 23/27-T, zona kadastrale 8602, vol. 12, faqe 77, truall me sipërfaqe 432 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 132,25 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasit S.S.

Për pasurinë nr. 35/143, rezultoi se nuk ka urdhër nga Kryeadministratori “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, neni 19, pika 5 citon: *Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë së sekuestruar, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori.*

Administratori i pasurisë, sipas nenit 19, pika 1 kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira. Administratori i pasurisë, A.B. nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 1, neni 19 të Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1652 datë 24.05.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit “G. C. G.” përfaqësuar nga O.B., rezultoi se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 634,000 lekë/muaj bruto, në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave, për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, i ndryshuar mbi zbatimin e procedurave të dhënies në përdorim të aseteve dhe dhënies me qira të objekteve.

Për pasurinë nr. 23/27-T, rezultoi se nuk ka urdhër nga Kryeadministratori “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara” kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, neni 19, pika 5 citon: *Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë së sekuestruar, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori.* Administratori i pasurisë, sipas nenit 19, pika 1 të Ligjit nr. 34/2019 kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira. Administratori i pasurisë, E.R. nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1727 datë 01.06.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Shoqëria “K.” SHPK përfaqësuar nga z. Sh.K. se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 4700 Euro/Muaj vlerë e cila është konvertuar në monedhën lekë, duke iu referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 referuar më sipër.

**13.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 202 datë 28.11.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 6/324+1-N4, zona kadastrale 8220, vol. 42, faqe 26, njësi shërbimi me sipërfaqe (të shfrytëzueshme) 391.1 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasës B.C.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 494 datë 10.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 494/1, datë 10.02.2021 propozimi i çmimit për ndërtesën me sipërfaqe 391.1 m<sup>2</sup>, është caktuar 290,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i kontratës së qirasë nr. 616 datë 22.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit shoqëria “L.” SHPK përfaqësuar nga P.A., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 3,000 euro/muaj, me një afat 19.02.2021-18.02.2024.

Me kërkesën nr. 277 prot., datë 31.01.2022, shoqëria “L.” SHPK, ka kërkuar zgjidhjen e kontratës së qirasë nr. 616 datë 22.02.2021.

Kryeadministratori nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 378 datë 07.02.2022 për prishjen e kontratës së qirasë nr. 616 datë 22.02.2021.

Nga auditimi i kontratës së qirasë nr. 386 datë 08.02.2022 midis AAPSK-së dhe qiramarrësit shoqëria “M. S. L.” përfaqësuar nga z. A.D. rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 3,000 euro/muaj, me një afat 19.02.2022-18.02.2024.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 53 datë 29.03.2022 ka lënë në fuqi masën e konfiskimit të pasurisë së paluajtshme nr. 6/324+1-N4, zona kadastrale 8220, vol. 42, faqe 26, njësi shërbimi me sipërfaqe (të shfrytëzueshme) 391.1 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetases B.C. Me shkresën nr. 1449 prot., datë 16.05.2022, AAPSK i ka dërguar njoftim shoqërisë “M. S. L.” për zgjidhjen e kontratës nr. 386 datë 08.02.2022.

**14.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas vendimit nr. (11-2020-3797) 404 datë 10.09.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 49/18, zona kadastrale 3852, vol. 2, faqe 129, truall me sipërfaqe 8500 m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe 2100 m<sup>2</sup> ndërtesë, në Durrës disponuar me shitje shtetases gjermane R. D.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 341 datë 03.02.2022 “*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 341/1, datë 10.02.2022 propozimi i çmimit për truall me sipërfaqe 8500 m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe 2100 m<sup>2</sup>, të jetë 616,230 lekë/muaj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 429, datë 14.02.2022, midis AAPSK-së dhe shoqërisë “G. 2 T.” SHPK rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

**15.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 189, datë 12.11.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme e llojit njësi biznesi (bar-kafe) me sipërfaqe 122 m<sup>2</sup>, rruga “Tefta Tashko Koco”, Tiranë, në pronësi të shtetases M.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 526 datë 12.02.2021 “*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 526/1, datë 15.02.2021 propozimi i çmimit për njësinë me sipërfaqe 122 m<sup>2</sup>, të jetë 70,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 641 datë 24.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.I., rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Edhe pse qiramarrësi nuk ka qenë korrekt në zbatimin e kontratës së parë me afat 1 vjeçar, rezulton se është rinovuar kontrata e qirasë nr. 590 datë 23.02.2022 ku rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

**16.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas vendimit nr. 217 datë 09.06.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 4/43, zona kadastrale 8518, vol. 44, faqe 221, njësi me sipërfaqe 35 m<sup>2</sup>, Durrës në pronësi të shtetasit P.T.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1442 datë 08.09.2020 “*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*”. Në procesverbalin

e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1442/1, datë 08.09.2020 propozimi i çmimit për pasurinë të jetë 11,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2516 datë 13.09.2021, midis AAPSK-së dhe shoqërisë “U. G.” SHPK përfaqësuar nga z. K.S. rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Edhe pse qiramarrësi nuk ka qenë korrekt në zbatimin e kontratës së parë me afat 1 vjeçar, rezultoi se është rinovuar kontrata e qirasë nr. 2595 datë 14.02.2022 ku rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë, ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

**17.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 77 datë 25.01.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme:

-Pasurisë së paluajtshme nr. 2/61, zona kadastrale 2392, hotel me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, Gjirokastrë në pronësi të shtetasit L.B;

-Pasurisë së paluajtshme nr. 467/112, zona kadastrale 1413, vol. 2, faqe 96, njësi (tregtim karburanti), me sipërfaqe (të papërcaktuar në Vendim dhe Kontratë), Sarandë, në pronësi të shtetasit E.B;

-Pasurisë së paluajtshme nr. 3832 (fabrikë betoni) në proces legalizimi në bazë të deklaratës për legalizim nr. 3106/1 prot., datë 26.01.2015 aplikuar në emër të “N. B.”, Finiq Sarandë;

-Pasurisë së paluajtshme të llojit “Hotel” dy katësh, me pesë dhoma në katin e dytë, ndërsa kati i parë funksionon si “Bar-Lokal” ndodhur zonën kadastrale 3842, Sarandë;

-Pasurisë së paluajtshme të llojit magazinë, me sipërfaqe 416.9 m<sup>2</sup> (ndodhet në qytet, brenda në katin e parë të një pallati) Sarandë.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1103 datë 12.04.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1103 (po i njëjti nr pa fraksion), datë 12.04.2021 propozimi i çmimit për “Bar-Lokal” ndodhur zonën kadastrale 3842, Sarandë, të jetë 18,900 lekë/muaj, hotel me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, Gjirokastrë të jetë 106,650 lekë/muaj, për pasurinë e paluajtshme nr. 467/112, zona kadastrale 1413, vol. 2, faqe 96, njësi, çmimi i vendosur nga komisioni i vlerësimit është bazuar në qiranë e mëparshme me qiramarrësin dhe është 100,000 lekë/muaj. Për pasurinë e paluajtshme nr. 2/61, zona kadastrale 2392, hotel me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, Gjirokastrë. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1305/1 datë 15.04.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.Ll, rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Për pasurisë e paluajtshme nr. 467/112, zona kadastrale 1413, vol.2, faqe 96, njësi (tregtim karburanti), me sipërfaqe (të papërcaktuar në Vendim dhe Kontratë), Sarandë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1502 datë 06.05.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit shoqëria “G. C. G.” SHPK, pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë për 1 vit.

Për pasurinë e paluajtshme nr. 3832 (fabrikë betoni) në proces legalizimi në bazë të deklaratës për legalizim nr. 3106/1 prot., datë 26.01.2015 aplikuar në emër të “N. B.”, Finiq Sarandë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2999 datë 02.11.2021, midis AAPSK-së dhe F.R, rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Për pasurinë e paluajtshme të llojit “Hotel” dy katësh, me pesë dhoma në katin e dytë, ndërsa kati i parë funksionon si “Bar-Lokal” ndodhur zonën kadastrale 3842, Sarandë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1459 datë 30.04.2021, midis AAPSK-së dhe A.P, rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë, ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Çmimi i qirasë për pasurinë është caktuar 19,000 lekë/muaj neto.

Për pasurinë e paluajtshme të llojit magazinë, me sipërfaqe 416.9 m<sup>2</sup> (ndodhet në qytet, brenda në katin e parë të një pallati) Sarandë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1498 datë 06.05.2021, midis AAPSK-së dhe M.L, rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë, ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Çmimi i qirasë për pasurinë është 74,000 lekë/muaj, neto. Afati i kontratës së qirasë është 06.05.2021-05.05.2022.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 51, datë 15.02.2022 ka vendosur revokimin e pasurive së paluajtshme:

-Pasurisë së paluajtshme nr. 2/61, zona kadastrale 2392, hotel me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, Gjirokastër në pronësi të shtetasit L.B;

-Pasurisë së paluajtshme nr. 467/112, zona kadastrale 1413, vol.2, faqe. 96, njësi (tregtim karburanti), me sipërfaqe (të papërcaktuar në Vendim dhe Kontratë), Sarandë në pronësi të shtetasit E.B;

-Pasurisë së paluajtshme nr. 3832, (fabrikë betoni) në proces legalizimi në bazë të deklaratës për legalizim nr. 3106/1 prot., datë 26.01.2015 aplikuar në emër të "N.B.", Finiq Sarandë;

-Pasurisë së paluajtshme të llojit "Hotel" dy katësh, me pesë dhoma në katin e dytë, ndërsa kati i parë funksionon si "Bar-Lokal" ndodhur zonën kadastrale 3842, Sarandë;

-Pasurisë së paluajtshme të llojit magazinë, me sipërfaqe 416.9 m<sup>2</sup> (ndodhet në qytet, brenda në katin e parë të një pallati) Sarandë;

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, nëpërmjet shkresave nr. 1205, 1206, 1207, 1208, 1209, prot., datë 20.04.2022, ka njoftuar qiramarrësit për prishjen e kontratave të mësipërme.

**18.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 30 datë 11.12.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 6/251+1-2, zona kadastrale 8260, vol. 27, faqe 40, apartament me sipërfaqe totale 69.9 m<sup>2</sup>, i blerë me kontratën nr. 4215, nr. 1306 Kol, datë 13.11.2008 dhe sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 100/11-66, zona kadastrale 3292, vol. 12, faqe 166, garazh me sipërfaqe 23.4 m<sup>2</sup> i blerë me kontratën nr. 117 Rep, nr.10 Kol, datë 18.01.2007, Tiranë në pronësi të shtetasit A.Th.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive E.M, mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira. Nuk ka urdhrin e Brendshëm "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara" dhe procesverbal të mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 471, datë 15.02.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.Sh., rezultoi se nuk janë kryer pagesat, në kundërshtim me pikat 5.4,5.5,5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Çmimi i qirasë për pasuritë është 22,500 lekë/muaj bruto, për apartamentin dhe 4100 lekë/muaj bruto për garazhin.

**19.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 114 datë 23.07.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 218/58-N2, zona kadastrale 3866, vol. 107, faqe 170, njësi me sipërfaqe totale 48.2 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetasit O. (A.) B.



Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1410, datë 03.09.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1410/1, datë 03.09.2020 propozimi i çmimit për njësinë, është caktuar 60,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3160 datë 16.11.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.K., rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati kontratës së qirasë është 12.11.2021- 11.11.2022, data e lidhjes së kontratës është 16.11.2021.

**20.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 148, datë 29.09.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme nr. 9/227+2-11, vol. 35, faqe 50, apartament me sipërfaqe totale 123.3 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetas M.F dhe pasurinë e paluajtshme nr. 10/5, vol. 4, faqe. 147, me sipërfaqe totale 805 m<sup>2</sup> nga të cilat 108 m<sup>2</sup> “trual” dhe 396 m<sup>2</sup> “ndërtesë”, në pronësi të shtetasit R.F.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1069 datë 29.03.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1096/7, datë 27.04.2021, propozimi i çmimit për apartamentin është caktuar 30,000 lekë/muaj dhe për ndërtesën 121,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3208 datë 23.11.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit N.M, rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1896, datë 23.06.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.M., rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë është 23.06.2021-22.06.2022.

**21.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 144, datë 22.09.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 3/281/ND, zona kadastrale nr. 8250, vol. 30, faqe 163, ndërtesë me sipërfaqe 72.5 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetas D.S.D.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 163, datë 18.01.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 163/1 datë 18.01.2021 propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 60,682.5 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 402, datë 04.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit B.M., pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

**22.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 13, datë 09.05.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 2/122+1-3, zona kadastrale nr. 3127, vol. 1, faqe 209, apartament me sipërfaqe 100.5 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetasit F.S. (dhe familjarëve apo subjekteve të tij tregtare).

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2727, datë 06.10.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë) propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 10.000- 20.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 402, datë 04.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit S.M., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është

*parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë është 08.10.2021-07.10.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është caktuar 18,000 lekë/muaj.*

**23.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 11, datë 22.02.2022 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 27/209, zona kadastrale nr. 8502, vol. 14, faqe 132, trull me sipërfaqe totale 129.70 m<sup>2</sup> mbi të cilin është ndërtuar një Hotel, kati i I-rë i këtij hoteli është ambient biznesi, Berat në pronësi të shtetasit K.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1417 datë 11.05.2022 *“Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”*. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1417/1, datë 11.05.2022 propozimi i çmimit për hotelin (3-kate me sipërfaqe 389.1 m<sup>2</sup>) është caktuar 75.000 lekë/muaj. Çmimi për ambientin e biznesit (kati i parë) me sipërfaqe 129.7 m<sup>2</sup> është caktuar 25.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1642, datë 02.06.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.Q., rezultoi se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Çmimi i qirasë për pasurinë është vendosur 50,000 lekë/muaj (nuk përputhet me procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1417/1, datë 11.05.2022. Çmimi për ambientin e biznesit (kati i parë) me sipërfaqe 129.7 m<sup>2</sup> është caktuar 25.000 lekë/muaj). Kjo kontratë është lidhur me afat 1-vjeçar. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2389, datë 15.08.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.Q., pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Kontrata e Qirasë nr. 2389, datë 15.08.2022 është lidhur pa përfunduar afati i Kontratës së Qirasë nr. 1642, datë 02.06.2022 dhe pa asnjë rivlerësim nga ana e AAPSK-së. Çmimi i qirasë për të njëjtën pasuri është vendosur 100,000 lekë/muaj. Theksojmë se Ligji nr. 34/2019 *“Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”*, ndryshuar, neni 19, pika 5 citon: *Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë së sekuestruar, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori. Administratori i pasurisë, sipas nenit 19, pika 1 kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira. Administratori i pasurisë, E.B. nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 34/2019 *“Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”*, i ndryshuar.*

**24.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 149, datë 23.09.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme, e llojit njësi me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, Berat në pronësi të shtetasit G.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 25, datë 02.09.2022 *“Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”*. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 2498/2 datë 19.09.2022 propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 7,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2453, datë 03.09.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Th.G, rezultoi se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, kontrata është zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësi nuk ka paguar penalitetin në kundërshtim me pikën 10.2 të Kontratës së Qirasë ku citohet se qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penalitet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, nuk është kryer pagesa për muajin prill 2022 në vlerën prej 7,000 lekë dhe penaliteti sipas Kontratës është në vlerën prej 7,000 lekë, gjithsej 14,000 lekë.

Nëpërmjet kërkesës nr. 1286/1 prot., datë 29.04.2022 qiramarrësi Th.G. ka kërkuar prishjen e kontratës së qirasë nr. 2453, datë 03.09.2021 për arsye personale. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1321, datë 29.04.2022 për prishjen e kontratës së qirasë nr. 2453, datë

03.09.2021.

**25.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 175, datë 27.10.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 297/3, Zona Kadastrale nr. 3949, vol. 2, faqe 146, objekt me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> Shkodër në pronësi të V.S.C.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 381, datë 03.02.2021 *“Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”*. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë) propozimi i çmimit për pasurinë, është caktuar 50.000- 200.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1352, datë 04.05.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.H., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 05.05.2022-04.05.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është vendosur 130,000 lekë/muaj, bruto. I njëjti qiramarrës ka patur kontratë paraardhëse me AAPSK-në dhe çmimi i qirasë për pasurinë rezulton të jetë 100,000 lekë/muaj.

**26.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 119, datë 03.08.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 58/29, zona kadastrale nr. 8518, vol. 17, faqe 42, truall me sipërfaqe totale 600 m<sup>2</sup> si dhe me sipërfaqe ndërtimi 240 m<sup>2</sup> lloji i pasurisë Hotel me 3- kate (një kat i hotelit në proces legalizimi), Durrës në pronësi të shtetasit R.O.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1945, datë 18.11.2020 *“Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”*. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë) propozimi i çmimit për pasurinë, është caktuar 50,000- 200,000 lekë/muaj, në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimin nr. 132, datë 07.03.2018, duhet të ishte 97,200 lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3415, datë 16.12.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit P.B. pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë 01.01.2022-31.12.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është vendosur 100,000 lekë/muaj.

**27.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 13, datë 09.05.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme nr. 6/559/ND, zona kadastrale nr. 8210, vol. 39, faqe 125, njësi me sipërfaqe 163 m<sup>2</sup> si dhe pasurinë nr. 6/31+1-2 zona kadastrale nr. 8210, vol. 5, faqe 35, apartament me sipërfaqe 76.5 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetasit F.S (dhe familjarëve apo subjekteve të tij tregtare).

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2000/1, datë 02.09.2022 *“Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”*. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2500/2, datë 19.09.2022 propozimi i çmimit për pasuritë është caktuar 150.000-200.000 lekë/muaj, në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 i ndryshuar mbi zbatimin e procedurave të dhënies në përdorim të aseteve dhe dhënies me qira të objekteve që duhet të ishte 63,570 lekë në muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 470, datë 03.02.2022, midis AAPSK-së dhe Qiramarrësit “M.W.” rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 488,000 lekë/muaj, bruto, në mospërputhje me procesverbalin nr. 2500/2, datë 19.09.2022. Referuar kërkesave të Ligjit nr. 34/2019 *“Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”*, i ndryshuar, Administratori i pasurisë, sipas nenit 19, pika 1 kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira.

**28.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 18, datë 26.06.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr.

6/1236-N2, zona kadastrale nr. 8310, vol. 47, faqe 199, njësi me sipërfaqe 51 m<sup>2</sup> Tiranë në pronësi të shtetasit S.D dhe e bllokuar për llogari të bankës O. Albania dhe shtetasës A.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2183, datë 23.07.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë) propozimi i çmimit për pasurinë, është caktuar 20.000-50.000 lekë/muaj, në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimin nr. 132, datë 07.03.2018, i ndryshuar mbi zbatimin e procedurave të dhënies në përdorim të aseteve dhe dhënies me qira të objekteve.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2226, datë 28.07.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit D.Z. pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 01.08.2021-31.07.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është vendosur 40,000 lekë/muaj, bruto. I njëjti qiramarrës ka rilidhur kontratë me AAPSK-në dhe çmimi i qirasë për pasurinë rezulton të jetë 60,000 lekë/muaj.

**29.** Ministria e Financave, sipas urdhrin nr. 8, datë 10.03.2005 ka urdhëruar sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të fondacionit “R. T.”.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 775, datë 21.08.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut pa numër, datë 28.08.2017 propozimi i çmimit për pasuritë, është caktuar 17,500 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3430, datë 01.12.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses I.Rr pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 23.11.2022-22.11.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 20,000 lekë/muaj, bruto. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3207, datë 23.11.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses I.Rr. pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 24.11.2021-23.11.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 20,000 lekë/muaj, bruto. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1955 datë 20.11.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses A.K. pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 24.11.2020-23.11.2021 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është caktuar 20,000 lekë/muaj, bruto.

**30.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 149, datë 23.09.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 13/356, zona kadastrale nr. 8501, vol. 16, faqe 183, njësi me sipërfaqe 82 m<sup>2</sup> Berat, në pronësi të shtetasit K.M. dhe B.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2498/1, datë 02.09.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2498/2, datë 19.09.2022 propozimi i çmimit për pasurinë, është caktuar 17.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2456, datë 03.09.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.K., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5,5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Edhe pse qiramarrësi nuk ka kryer pagesat sipas afateve të përcaktuara në kontratë, AAPSK ka rilidhur kontratën nr. 469, datë 03.02.2022 me të njëjtin qiramarrës ku rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5,5.6 të Kontratës së Qirasë.

Kontrata e qirasë nr.469,datë 03.02.2022 ka efekt prapaveprues pasi afati i saj fillon në 01.09.2022-31-08.2023.

**31.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 115, datë 24.07.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme:

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 27/307, vol. 23, faqe 250, e llojit “truall” me sipërfaqe 190 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 55.5 m<sup>2</sup> në Sarandë, në pronësi të shtetasit M. D.

*-Për pasurinë e paluajjtshme me praktikën në proces legalizimi me nr. 2119 prot., datë 24.12.2006 në Sarandë, në pronësi të shtetasit M.D.*

*-Për pasurinë e paluajjtshme me praktikën në proces legalizimi të datës 29.09.2014 në Sarandë, në pronësi të shtetasit M.D.*

*-Për pasurinë e paluajjtshme katin e 5-të i Hotel P., i cili është ndërtuar nëpërmjet lejes së ndërtimit nr. 1/3, datë 18.10.2010, e lëshuar nga Bashkia Sarandë.*

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive E.M, mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira. Nuk ka urdhër të brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara” dhe procesverbal të mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1817, datë 15.06.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.B. rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë është 08.06.2021-07.06.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 100.100 lekë/muaj, neto.

Nëpërmjet kërkesës nr. 417 prot., datë 11.02.2022 qiramarrësi F.B. ka kërkuar prishjen e kontratës së qirasë nr. 1817, datë 15.06.2021. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 667, datë 02.03.2022 për prishjen e kontratës së qirasë nr. 1817, datë 15.06.2021. Rezulton se kontrata është zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësi nuk ka paguar penalitetin në kundërshtim me pikën 10.2 të Kontratës së Qirasë ku citohet se qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penalitet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, nuk është kryer pagesa për 1 muaj në vlerën prej 100,100 neto ose 115,115 bruto dhe penaliteti sipas Kontratës është në vlerën prej prej 100,100 neto ose 115,115 bruto, gjithsej 230,230 lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1944, datë 01.07.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Xh.B, rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Afati i kontratës së qirasë është 01.07.2022-31.09.2022. dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 500.000 lekë/muaj, neto.

Vlen të theksohet se çmimi i qirasë në kontratën nr. 1944, datë 01.07.2022 është ulur nga 100,100 lekë/muaj neto, në 50.000 lekë/muaj neto, kjo pa ndjekur asnjë procedurë rivlerësimi për pasurinë.

**32.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 3/62, datë 23/03/2021 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajjtshme nr. 14/654, zona kadastrale nr. 8593, vol. 42, faqe 151, vilë tre katëshe me sipërfaqe 247.6 m<sup>2</sup>/kati përdhe, 230 m<sup>2</sup> kati i dytë, 239.6 m<sup>2</sup> kati i tretë, Shkodër në pronësi të shtetasit L.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 130, datë 31.10.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 3138/2, datë 02.11.2022 propozimi i çmimit për pasurinë, është caktuar 125.000 lekë/muaj dhe kati përdhe 44.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 3271, datë 11.11.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit V.S pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 14.11.2022-13.11.2023.

**33.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 23, datë 11.05.2022 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajjtshme nr. 298/211+1-N1, zona kadastrale nr. 3866, vol. 98, faqe 140, njësi me sipërfaqe 230.60 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetasit I.L.P.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 381, datë 08.02.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara” (Urdhri nuk është në praktikë). Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 381/1, datë 08.02.2022 propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 90,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 403 datë 10.02.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit B.P. rezulton se pagesat janë kryer në kundërshtim me pikën 5.1 të kontratës së qirasë që citon çmimin e qirasë 90,000 lekë/muaj, bruto. Qiramarrësi ka paguar nga 86,500 lekë në muajin shkurt, mars, prill, në muajin maj nga 76.500 lekë, në muajin qershor 76.000 lekë, në muajin korrik 76.500 lekë dhe në muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor 51.000 lekë/muaj. Afati i kontratës së qirasë është 21.01.2022-20.01.2023.

**34.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 101, datë 10.07.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 2/162+1-1/2, vol. 14, faqe 130, apartament me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të shtetasit E.C.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1245 datë 07.08.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1245/1, datë 07.09.2020 propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 16.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1347, datë 28.08.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.Q. rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 01.09.2020-31.08.2021.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2364, datë 24.08.2021, rinovuar midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.Q., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 01.09.2021-31.08.2022.

**35.** Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 143, datë 09.11.2018 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajtshme të llojit dyqan, me sipërfaqe 175 m<sup>2</sup>, i ndodhur në objektin me 12 kate, të ndërtuar nga shoqëria “S.” SHPK me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. 202, datë 09.05.2003 të KKRT-së së Bashkisë Tiranë, me pronar trualli familja L.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1074/1, datë 28.12.2016 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë), propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 25,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 642, datë 24.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.G., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë 24.02.2021-23.02.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 50.000 lekë/muaj, bruto.

**36.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, sipas vendimit nr. 9, datë 22.09.2019 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 505/316-G4, zona kadastrale 2460, vol. 48, faqe 54, garazh me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të shtetasit A.A.M.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 17, datë 25.06.2021 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajtshme nr. 505/316-G4, zona kadastrale 2460, vol. 48, faqe 54, garazh me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të shtetasit A.A.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 50, datë 13.01.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 50/1, datë 14.01.2020 propozimi i çmimit për pasurinë, është caktuar 3.500 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 908, datë 28.03.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.LL., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë

*në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë është 28.03.2022-27.03.2023.*

**37.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, sipas vendimit nr. 418, datë 17.10.2019 ka vendosur sekuestrimin e shoqërisë “R. 2.” SHPK me NIPT I.....R me vendndodhje “Buzë Lumit Drin”, rruga Qendër Bërdicë e sipërme, Shkodër, me ortak të vetëm shtetasin A.B.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 28, datë 23.03.2021 ka vendosur konfiskimin e shoqërisë “R. 2.” SHPK me NIPT I.....R me vendndodhje “Buzë Lumit Drin”, rruga Qendër Bërdicë e sipërme, Shkodër, me ortak të vetëm shtetasin A.B.

Në relacionin nr. 1763, datë 07.06.2021, administratori i pasurisë ka propozuar lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin “A. A.” SHPK e cila nëpërmjet shkresës nr. 1746 prot., datë 03.06.2021 ka shprehur interesin për marrje me qira të ambienteve të shoqërisë “R. 2.” SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1930, datë 29.06.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Shoqëria “A. A.” SHPK, *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë 01.07.2021-30.06.2026.*

**38.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-4, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 229, apartament me sipërfaqe 263.8m<sup>2</sup>, Tiranë, në pronësi të shtetasës E.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1704, datë 08.06.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1704/1, datë 10.06.2022 propozimi i çmimit për një prej apartamenteve të pasurisë (1+1, sip 48 m<sup>2</sup>), është caktuar 20.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1788, datë 15.06.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit I.N., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë është 15.06.2022-14.06.2023.*

**39.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 134, datë 28.03.2022 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 26/212/ND-N-4, zona kadastrale 8512, vol. 49, faqe 58, njësi me sipërfaqe 263.8 m<sup>2</sup>, Durrës, në pronësi të shtetasës L.K.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1043, datë 06.04.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1043/1, datë 08.04.2022 propozimi i çmimit për pasurinë të jetë 270.000 lekë/muaj, neto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1326, datë 29.04.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit K.C., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë 01.05.2022-30.04.2023.*

**40.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-4, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 229, apartament me sipërfaqe 263.8 m<sup>2</sup>, Tiranë,

në pronësi të shtetases E.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1704, datë 08.06.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1704/1, datë 10.06.2022 propozimi i çmimit për një prej apartamenteve të pasurisë me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup> (Garsoniere), pjesë e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-4, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 229, apartamente me sipërfaqe 263.8 m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të shtetases E.B.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1817, datë 17.06.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.C., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës së qirasë është 15.06.2022-14.06.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15.000 lekë/muaj, bruto.

Nëpërmjet kërkesës nr. 2450 prot, datë 24.08.2022 qiramarrësi E.C. ka kërkuar prishjen e kontratës së qirasë nr. 1817, datë 17.06.2022 për arsye personale. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 19, datë 30.08.2022 për prishjen e kontratës së qirasë nr. 1817, datë 17.06.2022 dhe rezulton se, *kontrata është zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësi nuk ka paguar penalitetin në kundërshtim me pikën 10.2 të Kontratës së Qirasë ku citohet se qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penalitet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, nuk është kryer pagesa për penalitetin sipas Kontratës në vlerën prej 15,000 lekë.*

**41.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas vendimit nr. 2885, datë 31.05.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 52/44, zona kadastrale 3981, vol. 12, faqe 132, truall me sipërfaqe totale 6134 m<sup>2</sup> dhe 2460.2 m<sup>2</sup> ndërtesë, nga sipërfaqja e të cilës 600 m<sup>2</sup> (kapanon) Fier, në pronësi të subjektit tregtar “C. G. I.” me nr. NIPT K.....E.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2604, datë 06.10.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2604, datë 06.10.2021 propozimi i çmimit për magazinën është caktuar 70.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2901, datë 26.10.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit B.P., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës së qirasë 01.11.2021-31.10.2022.

**42.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 4/521, zona kadastrale 8190, vol. 35, faqe 245, truall me sipërfaqe totale 352.6 m<sup>2</sup> dhe 138.2m<sup>2</sup> ndërtesë, nga sipërfaqja e të cilës 60 m<sup>2</sup> apartament (kati i parë, pjesë e sipërfaqes 138.2 m<sup>2</sup>), Tiranë në pronësi të V.I.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2476/2, datë 01.09.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2476/3, datë 01.09.2022 propozimi i çmimit për apartamentin të jetë 20.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2540, datë 07.09.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses P.S., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 07.09.2022-06.09.2023.

**43.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-4, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 229, apartament me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> në Tiranë, në pronësi të E.Y.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 537, datë 15.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin



e mbajtur nga komisioni për vlerësimet e çmimit të tregut nr. 537/2, datë 17.02.2021 propozimi i çmimit për apartamentet e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-4, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 230, me sipërfaqe totale 263.8 m<sup>2</sup> të jetë 77.320 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 979, datë 31.03.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.P., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.04.2022-31.03.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 18.000 lekë/muaj, bruto.*

**44.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-3, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 229, apartament me sipërfaqe 263.8m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të E.Y.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr.537, datë 15.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimet e çmimit të tregut nr. 537/2, datë 17.02.2021 propozimi i çmimit për apartamentin është caktuar 77.320 lekë/muaj, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 711, datë 01.03.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit K.T., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 10 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.03.2021-28.02.2022.*

**45.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09/12/2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564+1-3, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 230, apartament me sipërfaqe 263.8 m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të E.Y.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 537, datë 15.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimet e çmimit të tregut nr. 537/2, datë 17.02.2021 propozimi i çmimit për apartamentin të jetë 77.320 lekë/muaj, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1099, datë 30.03.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.N., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.04.2021-31.03.2022.*

**46.** Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 1, datë 09.03.2011 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajtshme nr. 8/17, zona kadastrale 3184, vol. 8, faqe 59, trull me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> dhe me një objekt “Bar-Restaurant” me sipërfaqe 130m<sup>2</sup>, i cili është ndërtuar mbi këtë sipërfaqe toke, sipas lejes së ndërtimit nr. 4, datë 22.06.2001 të KKRT Bashkia Durrës, në pronësi të shtetasit A.N.S.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 103/3, datë 30.01.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimet e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë) propozimi i çmimit është caktuar 10,000 lekë për secilën nga pasuritë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1972, datë 30.06.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.Sh., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 10.000 lekë/muaj, bruto.*

**47.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 175, datë 27.10.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 297/3, zona kadastrale 3949, vol. 2, faqe 146, trull me sipërfaqe 900m<sup>2</sup> dhe objekt me sipërfaqe 300m<sup>2</sup> Shkodër, në pronësi të shtetases V.C.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 381, datë 03.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa numër dhe datë) propozimi i çmimit pasurinë të jetë 50.000-200.000 lekë/muaj, në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimit nr. 132, datë 07.03.2018, i ndryshuar, mbi zbatimin e procedurave të dhënies në përdorim të aseteve dhe dhënies me qira të objekteve.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1493, datë 05.05.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.H., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 05.05.2021-04.05.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 100.000 lekë/muaj, bruto. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1352, datë 04.05.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit F.H., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 05.05.2022-04.05.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 130.000 lekë/muaj, bruto. Çmimi i kontratës së qirasë nr. 1352, datë 04.05.2022 është rritur pa rivlerësim nga ana e komisionit.

**48.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 208, datë 09.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/564-N1, zona kadastrale 8190, vol. 40, faqe 225, njësi me sipërfaqe 292,8 m<sup>2</sup> Tiranë, në pronësi të shtetases E.Y.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 869, datë 23.03.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 869/1, datë 25.03.2022 propozimi i çmimit për apartamentin të jetë 110.000 lekë, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 892, datë 28.03.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Shoqëria F./S., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 01.04.2022-31.03.2024 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 93.000 lekë/muaj, bruto. Çmimi i kontratës së qirasë nr. 892 datë 28.03.2022 nuk përkon me çmimin e propozuar nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut.

**49.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas vendimit nr. 2885, datë 31.05.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 3/166, zona kadastrale 8534, vol. 11, faqe 242, godinë me sipërfaqe 290,6 m<sup>2</sup>, Fier në pronësi të C. G. L.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1159, datë 27.11.2019 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1159/1, datë 27.11.2019 propozimi i çmimit për pasurinë të jetë 10.000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1860/1, datë 06.11.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.A., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 01.11.2020-31.10.2021 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 10.000 lekë/muaj, bruto. Rezulton që kontrata është lidhur më datë 06.11.2020 dhe afati i vendosur nga palët është 01.11.2020. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2988, datë 01.11.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.A., rezulton që pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 01.11.2021-31.10.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 10.000 lekë/muaj, bruto.

**50.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 13, datë 27.07.2016 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 5/56+1-64, zona kadastrale 3126, apartament me sipërfaqe 49.3 m<sup>2</sup> në Lezhë.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 241, datë 27.02.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 241/1, datë 27.02.2018, propozimi

i çmimit për apartamentin është caktuar 20,000 lekë, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 283/2, datë 20.03.2017, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit P.T., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 20.03.2017-19.03.2018 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15.000 lekë/muaj, bruto.

**51.** Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 37, datë 31.05.2011 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajtshme “Bar Restaurant” me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>, ndërtuar mbi një truall me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, me adresë, Fshati “Rinia”, në Durrës.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 103/3, datë 30.01.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut (pa nr dhe pa datë), propozimi i çmimit për objektin është caktuar 10.000 lekë, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 805, datë 30.08.2017, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.S., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 01.09.2017-31.08.2018 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 10.000 lekë/muaj, bruto.

**52.** Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 58, datë 15.05.2017 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajtshme nr. 46/184+1-11, zona kadastrale 8518, vol. 31, faqe. 160, apartament me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, Durrës në pronësi të shtetases N.G.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 716, datë 26.07.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 716/1, datë 28.07.2017 propozimi i çmimit për apartamentin është caktuar 25,000 lekë, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 746, datë 15.08.2017, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit H.M., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 15.08.2017-15.07.2018 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 20.000 lekë/muaj.

**53.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 13, datë 27.07.2016 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme e llojit njësi, me sipërfaqe 175 m<sup>2</sup> të ndodhur në objektin me 12 kate të ndërtuar nga shoqëria “S.” SHPK, me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. 202, datë 09.05.2003 të KKRT-së Bashkisë Tiranë, me pronar trualli, familja L.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive, mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira. Nuk ka urdhrin e Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara” dhe procesverbal të mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 445, datë 28.04.2017, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit K.Z., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.05.2017-30.04.2018 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 21.200 lekë/muaj, bruto.

**54.** Ministria e Financave, sipas urdhrit nr. 8, datë 10.03.2005 ka urdhëruar sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të fondacionit “R. T.”.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 775, datë 21.08.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut, pa numër, datë 28.08.2017 propozimi

i çmimit për pasuritë është caktuar 17,500 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1044, datë 24.11.2017, midis AAPSK dhe qiramarrëses A.K. rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 24.11.2017-23.11.2018 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 17.400 lekë/muaj.

**55.** Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, sipas vendimit nr. 217, datë 09.06.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme e llojit pallat, 1 kat nën tokë 4-6 kate mbi tokë ndërtuar në pasurinë nr. 4/43, zona kadastrale 8518, vol. 44, Durrës dhe pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, zona kadastrale 8518, vol. 44, faqe 222, objekt Hotel+Bar C., Durrës, në pronësi të shtetasit P.T.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1442, datë 08.09.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 1442/1, datë propozimi i çmimit për pasuritë të jetë:

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, z.k 8513, Adresa: Lagja 13/Rruga Pavarsia, Durrës e llojit njësi me sipërfaqe 24 m<sup>2</sup> të jetë 7,500 lekë/muaj;

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, z.k 8513, Adresa: Lagja 13/Rruga Pavarësia, Durrës e llojit njësi me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup> të jetë 9,500 lekë/muaj;

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, z.k 8513, Adresa: Lagja 13/Rruga Pavarësia, Durrës e llojit njësi me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup> të jetë 9,500 lekë/muaj;

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, z.k 8513, Adresa: Lagja 13/Rruga Pavarësia, Durrës e llojit njësi me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> të jetë 15,500 lekë/muaj;

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, z.k 8513, Adresa: Lagja 13/Rruga Pavarësia, Durrës e llojit njësi me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> të jetë 15,500 lekë/muaj;

-Për pasurinë e paluajtshme nr. 4/44, z.k 8513, Adresa: Lagja 13/Rruga Pavarësia, Durrës e llojit njësi me sipërfaqe 35 m<sup>2</sup> të jetë 11,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1486, datë 11.09.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.S. për pasurinë e llojit njësi me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup>, rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 11.09.2020-10.09.2021 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 9500 lekë, neto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1485, datë 11.09.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit shoqërisë “U. G.” SHPK përfaqësuar nga K.Sh, për pasurinë e llojit njësi me sipërfaqe 35 m<sup>2</sup> rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 11.09.2020-10.09.2021 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 11.000 lekë/muaj, neto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1484, datë 11.09.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses Xh.T. për pasurinë e llojit njësi me sipërfaqe 24 m<sup>2</sup>, rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Për pasurinë e llojit njësi “Bar Kafe C.” me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> rezulton se është kryer vetëm një pagesë. Afati i kontratës është 29.12.2020-28.12.2021, çmimi i qirasë për pasurinë e llojit njësi me sipërfaqe 24 m<sup>2</sup> është 7.500 lekë/muaj, neto, çmimi i qirasë është 15.500 lekë/muaj, neto.

Nëpërmjet kërkesës nr. 1484/1 prot., datë 11.12.2020 mbi prishjen e Kontratës së Qirasë nr. 1484, datë 11.09.2020, Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr.1 484/2, datë 11.12.2020 “Për prishjen e kontratës së qirasë nr. 1484, datë 11.09.2020 dhe rezulton se kontrata është zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësi nuk ka paguar penalitetin në kundërshtim me pikën 10.2 të Kontratës së Qirasë ku citohet se qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penalitet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, nuk është kryer pagesa për 2 muaj në vlerën prej 31,000 lekë dhe penaliteti sipas Kontratës është në vlerën prej 15,500 lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1487, datë 11.09.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses G.G. për pasurinë e llojit njësi me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 11.09.2020-10.09.2021 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15,500 lekë/muaj, neto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2534, datë 06.09.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrëses V.G., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2576, datë 13.09.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.A., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2613, datë 15.09.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.H., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

**56.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 13, datë 05.03.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 28/323-N4, zona kadastrale 8518, vol. 106, faqe 96, njësi me sipërfaqe 132.3 m<sup>2</sup>, Durrës, pasurisë së paluajtshme nr. 28/323-N5, zona kadastrale 8518, vol. 106, faqe 97, njësi me sipërfaqe 54.6 m<sup>2</sup> Durrës, pasurisë së paluajtshme nr. 28/323-N3, zona kadastrale 8518, vol. 106, faqe 95, njësi me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup> Durrës, në pronësi të shtetasve A.K. dhe N.N.K.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratorja e pasurisë E.O., nuk ka urdher të ngritur nga kryeadministratori për pasurinë. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut pa nr dhe datë 03.04.2020 propozimi i çmimit për pasuritë është caktuar 41,000lekë/muaj.

-Pasurinë e paluajtshme nr. 28/323-N4, zona kadastrale 8518, vol. 106, faqe 96, njësi me sipërfaqe 132.3 m<sup>2</sup> Durrës = 41,000 lekë.

-Pasurinë e paluajtshme nr. 28/323-N5, zona kadastrale 8518, vol. 106, faqe 97, njësi me sipërfaqe 54.6 m<sup>2</sup> Durrës = 25,000 lekë/muaj.

-Pasurinë e paluajtshme nr. 28/323-N3, zona kadastrale 8518, vol. 106, faqe 95, njësi me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup> Durrës = 43,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 420, datë 03.04.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.S. për pasurinë e paluajtshme njësi me sipërfaqe 132.3 m<sup>2</sup> dhe pasurinë e paluajtshme njësi me sipërfaqe 54.6 m<sup>2</sup> rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë

*nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 06.04.2020-05.04.2021, çmimi i qirasë për pasurinë e paluajtshme njësi me sipërfaqe 132.3 m<sup>2</sup> është 41.000 lekë/muaj, bruto, çmimi i qirasë për pasurinë e paluajtshme njësi me sipërfaqe 54.6 m<sup>2</sup> është 25,000 lekë/muaj, bruto.*

*Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1186, datë 06.04.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.S., rezulton që pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.*

*Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1071, datë 08.04.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.L., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 06.04.2022-05.04.2023.*

**57.** Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 5, datë 25.03.2019 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme e llojit apartament, me sipërfaqe 100,5m<sup>2</sup>, zona kadastrave 2183, Vol. 7, faqe. 146, blerë nga shoqëria “A.-K.” në emër të shtetasit A.M. dhe pasurisë së paluajtshme e llojit vilë, me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup> Vorë, në emër të shtetasit A.M. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 559, datë 11.06.2019 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 599/2, datë 13.06.2019 propozimi i çmimit për apartamentin është caktuar 16.000 lekë/muaj duke i zbritur tatimin në burim. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 599/3, datë 14.06.2019 propozimi i çmimit për vilën është caktuar 13.000 lekë/muaj duke i zbritur tatimin në burim.

*Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 600, datë 26.06.2019, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit H.I., për pasurinë e llojit apartament, rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.*

*Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 601, datë 26.06.2019, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Y.H., për pasurinë e llojit vilë, rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.*

**58.** Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 20, datë 15.09.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 27/154-G, zona kadastrale 8605, Vol .37, faqe. 38, e llojit garazh, me sipërfaqe totale 514 m<sup>2</sup> , në pronësi të shtetasit A.H i cili e ka blerë me kontratën e shitjes nr. 2689 Rep dhe 1788/2 Kol. datë 12.09.2014, me vlerë 60,000 euro.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 948, datë 15.10.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 948/1, datë 25.10.2018 propozimi i çmimit për garazhin është caktuar 67,000 lekë/muaj.

*Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 530, datë 03.06.2019, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit V.L., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 06.06.2019-05.06.2020 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 70,000 lekë /muaj,bruto ose 59,950 lekë/muaj neto.*

**59.** Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 20, datë 15.09.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme nr. 2/379, zona kadastrale 8601, vol. 30, faqe. 65, e llojit truall, me sipërfaqe totale 580 m<sup>2</sup> dhe pasurisë së paluajtshme nr. 2/5/3ND, zona kadastrale. 8601, vol. 30, faqe. 56 e llojit ndërtesë me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasve M., F. dhe A.H.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 948, datë 15.10.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 948/1, datë 25.10.2018 propozimi i çmimit për truallin me sipërfaqe 580 m<sup>2</sup> të jetë 33,000 lekë/muaj dhe për ndërtesën me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup> të jetë 25,000 lekë /muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 136, datë 11.02.2019, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.P.M, për të dy pasuritë, rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 11.02.2019-10.02.2020 dhe çmimi i qirasë për pasuritë është 80,000 lekë /muaj, bruto. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 156 datë 10.02.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.P.M, për të dy pasuritë, *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 10.02.2020-09.02.2021 dhe çmimi i qirasë për pasuritë është 80,000 lekë/muaj, bruto. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 318, datë 02.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.P.M *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 10.02.2021-09.02.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 100.000 lekë/muaj.

Nëpërmjet kërkesës nr. 1974 prot., datë 01.07.2021, qiramarrësi R.P.M ka kërkuar prishjen e kontratës së qirasë nr. 318, datë 02.02.2021. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2385, datë 30.08.2021 “Për prishjen e kontratës së qirasë nr. 318, datë 02.02.2021”. Rezulton se *kontrata është zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësi nuk ka paguar penaltetin në kundërshtim me pikën 10.2 të Kontratës së Qirasë nr. 318, datë 02.02.2021 ku citohet se qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penaltet që është sa çmimi mujor i qirasë. Për sa më sipër, nuk është kryer pagesa për 2 muaj në vlerën prej 200,000 lekë dhe penalteti sipas Kontratës është në vlerën prej prej 100,000 lekë .*

**60.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas vendimit nr. 2885, datë 31.05.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr.3/166, zona kadastrale 8534, vol. 11, faqe 242, godinë me sipërfaqe totale 290.6 m<sup>2</sup>.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1159, datë 27.11.2019 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1159/1, datë 27.11.2019 propozimi i çmimit për një apartament 25 m<sup>2</sup> të jetë 10,000 lekë/muaj. Sipas këtij procesverbali kati i parë në godinën 4-katëshe ka një sipërfaqe prej 290.6 m<sup>2</sup>.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1476, datë 11.09.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit B.H., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 01.09.2020-31.08.2021.

**61.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas vendimit nr. 2885, datë 31.05.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 52/44, zona kadastrale 3981, vol. 12, faqe 132, ndërtesë me sipërfaqe totale 1700 m<sup>2</sup> në pronësi të “G. C. I.”.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1159, datë 27.11.2019 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1159/1, datë 27.11.2019 propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 272,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1261, datë 31.12.2019, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit R.A., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.01.2020-31.12.2020.

**62.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 17, datë 25.06.2021 ka vendosur konfiskimin e pasurisë së paluajtshme nr. 197/70+1-16, zona kadastrale nr. 2460, vol. 41, faqe 210, apartament me sipërfaqe 133.4 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të shtetasit A.M.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 50, datë 13.01.2020 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 50/1, datë 14.01.2020 propozimi i çmimit për pasurinë është caktuar 21,500 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 75, datë 16.01.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit B.R. rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 16.01.2020-15.01.2021.

**63.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, sipas vendimit nr. 28, datë 21.11.2017 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme, e llojit apartament (1+1), me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, Sarandë, në pronësi të B.B.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive, mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira. Nuk ka urdhrin e Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 54/1, datë 25.01.2017 propozimi i çmimit për një apartament është caktuar 9,600 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2397, datë 31.08.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.B., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.09.2021-31.08.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 11,200 lekë /muaj, bruto.

**64.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, sipas vendimit nr. 20, datë 15.09.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme, e llojit apartament, me sipërfaqe 69 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “Uji i ftohtë”, Vlorë, e blerë me kontratë paraprake shitje nr. 742 Rep dhe nr. 484 Kol, datë 04.04.2016, në pronësi të shtetasës K.H.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1183, datë 17.12.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 1198/1, datë 19.12.2018 propozimi i çmimit për apartamentin të jetë 13,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 21, datë 06.01.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit M.S., rezulton që pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Çmimi i qirasë për pasurinë është 13,500 lekë /muaj.



65. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, sipas vendimit nr. 28, datë 21.11.2017 dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda me vendim nr. 11, datë 05.02.2018 ka vendosur sekuestrimin e 12 apartamenteve me vendndodhje në Sarandë, në pronësi të shtetasve K. dhe B.B. Apartamentet janë si më poshtë vijon:

- Apartament 1/5, me sipërfaqe 53,5 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 1/6, me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup> i përbërë nga 3 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 1/7, me sipërfaqe 91 m<sup>2</sup> i përbërë nga 3 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 1/13, me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 1/14, me sipërfaqe 42.5 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 1/35, me sipërfaqe 42.5 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 1/46, me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup>
- Apartament 2/2, me sipërfaqe 52.5 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 2/3, me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>
- Apartament 2/13, me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon;
- Apartament 2/22, me sipërfaqe 42.5 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, 1 sallon, 1 depo, banjo dhe ballkon;
- Apartament 2/41, me sipërfaqe 66 m<sup>2</sup> i përbërë nga 2 dhoma, banjo dhe ballkon.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 54, datë 15.01.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 54/1, datë 25.01.2017 propozimi i çmimit për apartamentet të jetë :

- Apartament 1/5, 8990 lekë /muaj;
- Apartament 1/6, 11260 lekë /muaj;
- Apartament 1/7, 15300 lekë /muaj;
- Apartament 1/13, 11260 lekë /muaj;
- Apartament 1/14, 7200 lekë /muaj;
- Apartament 1/35, 7200 lekë /muaj;
- Apartament 1/46, 12,200 lekë /muaj;
- Apartament 2/2, 8850 lekë /muaj;
- Apartament 2/3, 9600 lekë /muaj;
- Apartament 2/13, 11260 lekë /muaj;
- Apartament 2/22, 7200 lekë /muaj;
- Apartament 2/41, 11260 lekë /muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 694, datë 04.07.2018, midis AAPSK-së dhe qiramarrësi Shoqëria “S. Q. P. R.”, me përfaqësues E.R. dhe A.B. rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 04.07.2018-03.01.2019.

Kontrata e Qirasë nr. 694, datë 04.07.2018 midis AAPSK-së, përfaqësuar nga Kryeadministratori dhe Shoqërisë “S. Q. P. R.” me përfaqësues E.R. dhe A.B., e administruar nga AAPSK është lidhur në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

Referuar Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Kreu III, neni 21 citon: Pavarësisht përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk mund të lidhet kontratë ndërmjet institucionit publik, në të cilin ushtron funksionet zyrtari dhe çdo institucioni publik, në varësi të këtij institucioni nga njëra anë, dhe një personi fizik, civil ose tregtar, ose person juridik, si dhe çdo ortakëri ndërmjet këtyre personave, nga ana tjetër, kur:

**a) zyrtari ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vlerësimin e ofruesve dhe të ofertave dhe përcaktimin e termave të kontratës;**

Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara

sipas vendimit nr. 28, datë 21.11.2017 dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda me vendim nr. 11, datë 05.02.2018, ka patur në administrim Shoqërinë “S. Q. P. R.” dhe Apartamentet në pronësi të shtetasve K. dhe B.B. Administratorët e këtyre pasurive A.B. dhe E.R. kanë qenë pjesë e komisionit për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 54/1, datë 25.01.2017 për çmimet e këtyre apartamenteve. *Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, e ndalon lidhjen e kontratave ndërmjet institucionit publik, në të cilin ushtrojnë funksionet zyrtarët dhe personave juridik “Shoqëria, S. Q. P. R.” përfaqësuar nga A.B. dhe E.R., të cilët janë edhe Administrator të AAPSK-së.*

**66.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas vendimit nr. 62-2020-644, datë 11/02/2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 4/66-N3, zona kadastrale 8534, Vol. 17, faqe 62, e llojit njësi Shërbimi, me sipërfaqe totale 139 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasit A.Sh.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 257 datë 28.02.2020 “*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 257/1, datë 28.02.2020 propozimi i çmimit për një njësi është caktuar 35,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 26, datë 06.01.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit “F. Sh. U.” sh.a rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 28 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.05% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 06.01.2020-05.01.2021 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 134,167 lekë/muaj, bruto, çmim i cili nuk përputhet me propozimin e komisionit në procesverbalin nr. 275, datë 28.02.2020.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 38, datë 07.01.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit “F. Sh. U.” sh.a rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 06.01.2021-05.01.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 134,167 lekë /muaj, bruto.

**67.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas vendimit nr. 62-2020-644, datë 11.02.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 4/66-N5, zona kadastrale 8534, Vol. 17, Faqe 64, e llojit njësi shërbimi, me sipërfaqe totale 75m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasve A. dhe L.Sh. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 257, datë 28.02.2020 “*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut nr. 257/1, datë 28.02.2020 propozimi i çmimit për një njësi të jetë 20,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 694, datë 15.05.2020, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.B., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 18.05.2020-17.05.2021 dhe çmimi i qirasë për 10 m<sup>2</sup> të pasurisë është 10,000 lekë/muaj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1544, datë 12.05.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.B., rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 18.05.2021-17.05.2022 dhe çmimi i qirasë për 10 m<sup>2</sup> të pasurisë është 10,000 lekë/muaj.

**68.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 1, datë 09.01.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 23/21, Zona Kadastrale 8642, vol. 4, faqe 103, trull me sipërfaqe 688 m<sup>2</sup> dhe objektin e ndërtuar mbi të “Hotel H.” Turizëm kanali i Cukës, Sarandë në pronësi të shtetasit P.B.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 177, datë 19.01.2021 “*Për ngritjen e*

*komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*". Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 177/1, datë 25.02.2021, propozimi i çmimit është caktuar 125,000 lekë, bruto.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 661, datë 25.02.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit S.D., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Afati i kontratës është 25.02.2021-24.02.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 125,000 lekë/muaj, bruto. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 601, datë 24.02.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit A.P. rezulton që pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

**69.** Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë sipas vendimit nr. 68, datë 27.01.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 17/263, zona kadastrale 8516, Vol. 23, Faqe 34, e llojit truall, me sipërfaqe totale 981,15 m<sup>2</sup>, Shkozet, Durrës në pronësi të shtetasit B.T.H dhe pasurisë me vetëdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj.Vendore Durrës, me aplikues A.U.S, e përfituar nga shtetasi B.H. me deklaratë noteriale nr. 4733 Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019.

Në procesverbalin e mbajtur në datë 15 Prill, ora 11.30, nga Oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë Hetimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Administratorja e Agjencisë së Administrimit të Pronave të sekuestruara dhe Konfiskuara, u konstatua se krahas pasurisë me vetëdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj.Vendore Durrës, me aplikues A.U.S, e përfituar nga shtetasi B.H me deklaratë noteriale nr. 4733 Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019, ndërtuar mbi truallin 981,15 m<sup>2</sup> janë edhe objekte të tjera për të cilat pretendon pronësinë P.S. Këto objekte, P.S. ia ka lënë me qira shtetasit T.N.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2408/2, datë 18.08.2022 "*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*". Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2408, datë 18.08.2022 propozimi i çmimit për ambientin me sipërfaqe 90 m<sup>2</sup>, kati i parë, pjesë anësore e magazinës, ndërtesë në proces legalizimi mbi pasurinë nr. 17/263, zona kadastrale 8516, Vol. 23, Faqe 34, e llojit truall, me sipërfaqe totale 981,15 m<sup>2</sup>, Shkozet, Durrës të jetë 10,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2419, datë 18.08.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit G.C, rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të Kontratës së Qirasë. Afati i kontratës është 18.08.2022-17.08.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 10,000 lekë /muaj, neto.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1427, datë 28.04.2021 "*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara*". Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2408, datë 18.08.2022 propozimi i çmimit për rivlerësimin e magazinës së marrë me qira nga T.N. të jetë 20,250 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2765, datë 12.10.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit T.N., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 01.10.2021-30.09.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 20,250 lekë/muaj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1394, datë 10.05.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit T.N., rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 29.04.2022-28.04.2023 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 35.000 lekë /muaj. Data e nënshkrimit të kontratës dhe fillimi i afatit të kontratës nuk përkojnë.

Nga auditimi i praktikës së ndjekur nga administratori i pasurive dhe kryeadministratori për pasurinë me vetëdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj.Vendore Durrës, me aplikues A.U.S, e përfituar nga shtetasi B.H. me deklaratë noteriale nr. 4733 Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019 e sekuestruar sipas vendimit nr. 68, datë 27.01.2021 nga Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, është në shkelje të Ligjit nr. 34/2019 "*Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara*" i ndryshuar. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara është institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara me vendim të

dhënë nga organet e sistemit të drejtësisë apo organet administrative. Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, efikasitetit, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit.

Objekti me vetdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj. Vendore Durrës, me aplikues A.U.S, e përfituar nga shtetasi B.H. me deklaratë noteriale nr. 4733 Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019 *nuk e ka të përcaktuar sipërfaqen totale dhe veç e veç për çdo hapësirë të shfrytëzueshme.*

*Referuar Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 19 citon: Administratori i pasurisë së sekuestruar kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira. Kryeadministratori, me kërkesë të administratorit të pasurisë, mund të autorizojë, sipas nevojës, ndihmën e specialistëve të fushave të ndryshme apo të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë, brenda kufijve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave dalë për këtë qëllim. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për pasurinë me vetdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj. Vendore Durrës, me aplikues A.U.S, e përfituar nga shtetasi B.H. me deklaratë noteriale nr. 4733. Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019, nuk ka kontraktuar një ekspert të pasurive të paluajtshme për të përcaktuar sipërfaqen totale dhe veç e veç për çdo hapësirë të shfrytëzueshme.*

*Kryeadministratori i AAPSK-së i ka lidhur kontratat në kushtet kur nuk ka informacion për sipërfaqen e objektit me vetdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, as nga ASHK-ja dhe as të shprehur në vendimin gjyqësor nr. 68, datë 27.01.2021.*

Vlen të theksohet që shtetasi P.S. pretendon pronësinë e një pjese të këtyre objekteve të dhëna me qira nga ai shtetasi T.N.

**70.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 76, datë 22.01.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme apartament, nr. 4, shkalla nr. 3, me sipërfaqe totale 51 m<sup>2</sup> dhe verandë 21 m<sup>2</sup>, Tiranë, në pronësi të shtetasi A.A.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2610/2, datë 24.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 2610/1, datë 24.09.2021 propozimi i çmimit për apartamentin të jetë 10,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1935, datë 29.06.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit D.A., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.07.2021-30.06.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15,000 lekë/muaj, bruto.*

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2631, datë 28.09.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit D.S., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Afati i kontratës është 01.10.2021-30.09.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15,000 lekë/muaj, bruto.*

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2778, datë 29.09.2022, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit Xh.H., *rezulton se pagesat janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i kontratës është 01.10.2022-30.09.2023 çmimi i qirasë për pasurinë është 15,000 lekë/muaj, bruto.*

**71.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 84, datë 08.02.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të

subjektit “B. R.”, person fizik, me NIPT nr. L.....V, me adresë fshati Xhafzotaj, Durrës, me status aktiv që prej datës 04.09.2014.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm pa nr, pa datë “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut pa nr, pa datë, propozimi i çmimit për ndërtesën, bar-bufe-restaurant, sipërfaqe 305 m<sup>2</sup> me adresë në Xhaftozaj, Durrës, është caktuar 51,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 2504, datë 13.09.2021, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit E.Z., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 01.10.2021-30.09.2022 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 52,000 lekë/muaj, neto.

**72.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 17, datë 02.08.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 1/2+1-17, zona kadastrale 3126, e llojit apartament, sipërfaqe 87.425 m<sup>2</sup> Lezhë, në pronësi të shoqërisë “K.” SHPK.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 616, datë 28.06.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 617, datë 29.06.2017 propozimi i çmimit për apartamentin të jetë 8,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 628, datë 30.06.2017, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit T.P., *rezulton që pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Me shkresën nr. 583 prot., datë 12.06.2018, AAPSK, njofton qiramarrësin T.P. për ndryshimin e çmimit të kontratës së qirasë nga 8,000 lekë/muaj në 15,000 lekë/muaj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 661, datë 28.06.2018, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit T.P., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 01.07.2018-30.06.2019 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15,000 lekë/muaj, bruto. Me shkresën nr. 1142 prot., datë 05.12.2018, AAPSK i dërgon njoftim për prishjen e kontratës së qirasë, duke qenë se pagesat e qirasë mujore në mënyrë të përsëritur nuk janë bërë sipas pikave 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë.

**73.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 17, datë 02.08.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 1/2+1-4, zona kadastrale 3126, e llojit apartament, sipërfaqe 87.425 m<sup>2</sup> Lezhë, në pronësi të shoqërisë “K.” SHPK.

Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 616, datë 28.06.2017 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 617, datë 29.06.2017 propozimi i çmimit për apartamentin është caktuar 8,000 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 627, datë 30.06.2017, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit S.A., *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 01.07.2017-30.06.2018 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 8,000 lekë/muaj, bruto. Me shkresën nr. 205 prot., datë 20.02.2018, AAPSK-ja i drejtohet qiramarrësit S.A me paralajmërim për prishje të kontratës së qirasë, kjo pasi në rast të përsëritur qiramarrësi nuk paguan qiranë në shumën dhe afatin e caktuar sipas pikës 5 të kësaj kontrate. Me shkresën nr. 584 prot., datë 12.06.2018, AAPSK, njofton qiramarrësin S.A për ndryshimin e çmimit të

kontratës së qirasë nga 8,000 lekë/muaj në 15,000 lekë/muaj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 660, datë 28.06.2018, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit S.A, *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Afati i kontratës është 01.07.2018-30.06.2019 dhe çmimi i qirasë për pasurinë është 15,000 lekë/muaj, bruto. Me shkresën nr. 1141 prot., datë 05.12.2018, AAPSK i dërgon njoftim për prishjen e kontratës së qirasë, duke qenë se pagesat e qirasë mujore në mënyrë të përsëritur nuk janë bërë sipas pikave 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë.

**74.** Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 17, datë 02.08.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 1/31+1-58, zona kadastrale 3126, e llojit apartament, sipërfaqe 67.2 m<sup>2</sup> Lezhë, në pronësi të shoqërisë “K.-I.” SHPK. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 947, datë 15.10.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nr. 947/1, datë 16.10.2018, propozimi i çmimit për apartamentin të jetë referuar vendimit 569, datë 03.06.2015 mbi “Përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, rreth 168 lekë/ m<sup>2</sup> .

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 757, datë 27.07.2018, midis AAPSK-së dhe qiramarrësit G.A, *rezulton se pagesat nuk janë kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratë në kundërshtim me pikat 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.* Çmimi i vendosur nga palët është 12,000 lekë/muaj, bruto. Afati i kontratës është 01.08.2018-31.07.2019. Me shkresën nr. 1143 prot., datë 05.12.2018, AAPSK i dërgon njoftim për prishjen e kontratës së qirasë, duke qenë se pagesat e qirasë mujore në mënyrë të përsëritur nuk janë bërë sipas pikave 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë.

Në datën 09.05.2023, u është kërkuar administratorëve të pasurive që të plotësojnë një pyetësor mbi pasuritë e dhëna dhe të pa dhëna me qira që kanë në administrim. Rezulton se i janë përgjigjur këtij pyetësori vetëm 5 administratorë dhe të dhënat janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

*Pasqyra nr. 21 Pasuri të paluajtshme me qira/pa qira*

<b>Pasuri të paluajtshme me qira/pa qira</b>				
<i>Nr</i>	<i>Administratori</i>	<i>Numri total i pasurive (gjendja 31.12.2022)</i>	<i>Pasuri të dhëna me qira</i>	<i>Pasuri të pa dhëna pa qira</i>
1	A.B	92	16	76
2	E.O	47	17	30
3	B.I	29	12	17
4	E.B	66	16	50
5	S.M	33	13	20

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për sa më sipër konstatohet që nga 267 pasuri të paluajtshme janë dhënë me qira vetëm 74 prej tyre dhe mbeten të pa dhëna me qira **193** pasuri. Nga ana e administratorëve të pasurive publikimet për dhënien me qira janë bërë vetëm në faqen <https://www.merrjep.com/> dhe jo në faqen zyrtare të AAPSK-së, ku gjithashtu mungojnë publikimet në vijimësi për periudhën objekt auditimi. Ky fakt është evidentuar gjithashtu edhe nga specialisti i kontrollit fizik të pasurive.

Për sa më sipër, në mungesë të një informacioni të plotë në lidhje me pasuritë e paluajtshme me qira/pa qira për të gjithë administratorët (informacion i munguar si për shkak të mos-përdorimit të sistemit ashtu dhe për shkak të mos-plotësisimit të pyetësorit) grupi i auditimit shprehet me rezerva në lidhje me raportin të ardhura të siguruara nga pasuritë e dhëna me qira-

shpenzime të kryera për pasuri të paluajtshme të pa dhëna me qira.

Nga ana e grupit të auditimit është e pamundur llogaritja e kamatë-vonesave, për shkak të periudhës së gjatë objekt-auditimi, volumit të madh të kontratave të lidhura dhe ri-lidhura, periudhave mujore pa paguar dhe në vijim pagesave të kryera në total, volumit të madh të statement-bankar etj.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi administratorët të cilët për periudhën objekt auditimi kanë patur në monitorim kontratat e mësipërme të cilat kanë rezultuar me problematika dhe nuk i janë përgjigjur pyetësorit të grupit të auditimit.*

*Nga përfaqësuesit e AAPSK znj. E.O., me shkresën nr. 27/46 datë 11.08.2023 dhe z. S.M., me shkresën nr. 27/44 datë 10.08.2023, janë paraqitur observacione, përkatësisht si në vijim:*

**Pretendimi i subjektit:**

*znj. E.O:* - Për sa i përket konstatimit të grupit të auditimit në lidhje me mungesën e kontraktimit të ekspertit për pasurinë me vetdeklarim nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, njësia Vendore Durrës, sqarojmë se nga ana e AAPSK kontraktimi i ekspertit është menduar në një fazë të mëvonshme kur pasuria të konfiskohet dhe përgatitja e dosjes për shitje do të kërkoj saktësim e kufijve të pasurisë. Agjencia ka vepruar në këtë mënyrë duke pasur parasysh parimin e miradministrimit dhe mundësisht rritjen e vlerës së pasurisë.

*z. S.M:* - Përsa i përket konstatimit të grupit të auditimit në lidhje me pagesat e kryera jo në përputhje me afatet e përcaktuara për kontratat e qirave nr. 642, datë 24.02.2021, nr. 908, datë 28.03.2022, nr. 1930, datë 29.06.2021, nr. 283/2, datë 20.03.2017, nr. 445, datë 28.04.2017, nr. 628, datë 30.06.2017, nr. 661, datë 28.06.2018, nr. 627, datë 30.06.2017, nr. 757, datë 27.07.2018, nr. 75, datë 16.01.2020, sqarojmë se në rregulloren “Për organizmin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, në detyrat e përgjegjësit të sektorit për marrëdhëniet me institucionet, çështjet juridike dhe provat materiale, neni 9, pika f citon që: përgjegjësi i sektorit përgjigjet për kontratat e qiradhënies, huapërdorjes dhe çdo kontratë tjetër e cila ka për qëllim miradministrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara. Kontrata e qirasë sipas rregullores së AAPSK-së është parashikuar të monitorohet dhe mbikëqyret nga të gjithë specialistët, shefat e sektorëve dhe administratori gjithashtu.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se:

- në lidhje me mungesën e kontraktimit të ekspertit për pasurinë me vetdeklarim nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, njësia Vendore Durrës, qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë, sipas argumenteve ligjor, paraqitur në akt-konstatim dhe projekt-raport.

-në lidhje me përgjegjësitë dhe mungesën e bazës ligjore që adreson qartë strukturën/personin përgjegjës pika 18 e rregullores së brendshme nr. 1363 prot., datë 22.04.2021“Për organizmin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, citon: *Kur pasuria jepet me qira administratori i pasurisë ndjek periodikisht mbarëvajtjen e kontratës së qirasë, bën kontrolle të herëpashershme në objekt për të parë gjendjen fizike të pasurisë, eviton problemet dhe merr masa për eliminimin e tyre në rastet kur kanë lindur jo për faj të qiramarrësit, kontrollon pagesat mujore të qirasë, pagesat e faturave të energjisë, ujit të pijshëm si dhe çdo shpenzim që mund të lind nga përdorimi i pasurisë. Kur konstaton se qiraja nuk paguhet në afat nga qiramarrësi propozon masat e propozuara në kontratë deri në zgjidhjen e saj. Për sa më sipër, observacionet nuk merren në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore.*

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	i	Parregullsi në ndjekjen e procedurave për kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme.
<b>Situata:</b>		<b>Nga auditimi i zbatimit të 112 kontratave të qirave për periudhën 01.10.2017-31.12.2022 u konstatua se:</b> -1 kontratë qiraje është lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Kreu III, neni 21/a konkretisht kontrata

e qirasë nr. 694, datë 04.07.2018 lidhur midis AAPSK-së, përfaqësuar nga Kryeadministratori dhe Shoqërisë “S. Q. P. R.” me përfaqësues 2 (dy) administratorë të AAPSK-së.

-Për 77 kontrata qiraje, pagesat e qirasë janë kryer pas datës 5 të çdo muaji, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të kontratave të qirasë ku citohet se: *pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.*

-Për 6 kontrata qiraje çmimi i vendosur në kontratë nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni në procesverbalin për vlerësimin e çmimit të tregut.

-7 kontrata qiraje janë zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësi nuk ka paguar penaltetin në kundërshtim me pikën 10.2 të kontratës së qirasë ku citohet se: *qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në cdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penaltitet që është sa çmimi mujor i qirasë.*

-Është lidhur 1 kontratë qiraje, konkretisht kontrata nr. 3533, datë 15.12.2022, me çmim qiraje 25, 000 lekë/muaj bruto sipas pikës 5.1 të saj ndërkohë që në pikën 5.2 citon se: *çmimi i qirasë do të jetë 30.000 lekë/muaj, në momentin që qiramarrësi do të përfitoj bonusin e qirasë nga Bashkia e Tiranës, duke vendosur kusht një ngjarje jo të sigurt të së ardhmes.*

-Për 2 pasuri, konkretisht për pasurinë nr. 35/143 dhe pasurinë nr. 23/27-T nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 1, nenit 19 të Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” pasi në mungesë të urdhrit të Kryeadministratori “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”, pasi nga ana e administratorëve është kryer një studim fizibiliteti për pasuritë e marra në administrim dhe nuk ia kanë paraqitur atë kryeadministratorit, me qëllim marrjen e vendimit përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë.

-Çmimi i përcaktuar për kontratën e qirasë nr. 1652 datë 24.05.2021 dhe kontratës nr. 1727 datë 01.06.2021 rezulton në kundërshtim me referencat e dhëna mbi pasuritë sipas vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave, për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, i ndryshuar mbi zbatimin e procedurave të dhënies në përdorim të asetëve dhe dhënies me qira të objekteve, neni 2.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1498 datë 06.05.2021 rezulton se mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira, urdhri i brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara” dhe procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut.

-Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për pasurinë me vetëdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj.Vendore Durrës, me deklaratë noteriale nr. 4733. Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019, nuk është kontraktuar ekspert i pasurive të paluajtshme për të përcaktuar sipërfaqen totale dhe veç e veç për cdo hapësirë të shfrytëzueshme, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 34/2019. Kryeadministratori i AAPSK-së i ka lidhur kontratat në



	kushtet kur për sipërfaqen e objektit nuk ka informacion nga ASHK-ja dhe as informacion të të shprehur në vendimin gjyqësor nr. 68 datë 27.01.2021.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji nr. 34/2019, neni 19, pika 1, neni 18 - Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, Kreu III, neni 21/a - Vendimi nr. 132, datë 07.03.2018, neni 2 - Kontratat e Qirasë, pikat 5.1,5.4, 5.5, 5.6, 10.2.
<b>Impakti:</b>	Mosrespektimi i dispozitave ligjore në përcaktimin e çmimit të qirasë sjell keqmenaxhim të të ardhurave dhe shpenzimeve të AAPSK-së dhe si rrjedhojë impakton dhe buxhetin e shtetit. Problematikat në lidhje menaxhimin e pasurive të paluajtshme sjellin risk të shtuar në mirëfunksionimin e institucionit.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i akteve ligjore dhe nën ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: -për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, me qëllim rritjen e të ardhurave të përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme; -për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga auditimi me qëllim shmangien e riskut në mirëfunksionimin e institucionit; -që për shkeljet e konstatuara në kontratat e qirave, të verifikohen rast pas rasti pagesat si të detyrimeve ashtu dhe të penalteteve dhe në vijim për të gjitha rastet e klasifikuara me detyrime të papaguara të kërkohet arkëtimi i vlerave duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	<b>i</b>	Shpenzime më të larta krahasuar me të ardhurat për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.
<b>Situata:</b>		Nga auditimi mbi të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për periudhën objekt auditimi u konstatua si në vijim: -referuar raportit të aktivitetit të AAPSK-së për vitin 2017, totali i të ardhurave paraqitet 53,589 mijë lekë, ku zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga pasuritë e konfiskuara në vlerën 45,000 mijë lekë ose 84% e totalit të të ardhurave. Totali i shpenzimeve paraqitet 39,125 mijë lekë, ku zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën 24,629 mijë lekë dhe pagat/sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 12,241 mijë lekë. -referuar raportit të aktivitetit të AAPSK-së për vitin 2018, totali i të ardhurave paraqitet 5,421 mijë lekë, ku zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pasurive në vlerën 5,049 mijë lekë ose 93% e totalit të të ardhurave. Totali i shpenzimeve paraqitet 51,349 mijë lekë, ku zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën 12,559 mijë lekë dhe pagat&sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 12,428 mijë lekë. -referuar raportit të aktivitetit të AAPSK-së për vitin 2019, totali i të ardhurave paraqitet 69,102 mijë lekë, ku zërin kryesor të të ardhurave e zë e ardhura në buxhet nga konfiskimi i pasurive me vendim komiteti në vlerën 61,400 mijë lekë ose 88.8% e totalit të të ardhurave. Totali i

	<p>shpenzimeve paraqitet 34,701 mijë lekë, ku zërin kryesor të shpenzimeve e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën 18,261 mijë lekë dhe pagat/sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 12,403 mijë lekë.</p> <p>-referuar raportit të aktivitetit të AAPSK-së për vitin 2020, totali i të ardhurave paraqitet 15,771 mijë lekë, ku zërin kryesor të të ardhurave e zë e ardhura nga dhënia me qira e pasurive në vlerën 15,242 mijë lekë ose 96.6% e të ardhurave. Totali i shpenzimeve paraqitet në vlerën 38,060 mijë lekë, ku zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën 17,818 mijë lekë dhe pagat/sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në vlerën 13,060 mijë lekë.</p> <p>-referuar raportit të aktivitetit të AAPSK-së për vitin 2021, totali i të ardhurave paraqitet 84,796 mijë lekë, ku zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve, në shumën 50,327 mijë lekë dhe e ardhura në buxhet nga konfiskimi i pasurive me vendim komiteti në vlerën 27,056 mijë lekë. Totali i shpenzimeve paraqitet në vlerën 51,349 mijë lekë, ku zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në shumën prej 25,952 mijë lekë dhe pagat/sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në shumën prej 14,773 mijë lekë.</p> <p>-referuar raportit të aktivitetit të AAPSK-së për vitin 2022, totali i të ardhurave paraqitet 165,134 mijë lekë, ku zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga konfiskimi i pasurive me vendim komiteti në vlerën 83,000 mijë lekë dhe të ardhurat nga qiraja në vlerën 74,981 mijë lekë. Totali i shpenzimeve paraqitet në vlerën 83,460 mijë lekë, ku zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në vlerën 33,608 mijë lekë dhe paga/sigurimet shoqërore e shëndetësore të administratorëve në shumën prej 18,976 mijë lekë.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se në raportimet e AAPSK-së mbi të ardhurat janë përfshirë edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit për të mbuluar shpenzimet, që nuk përfaqësojnë të ardhura nga vet veprimtaria e tyre, duke i mbivlerësuar në këtë mënyrë këto të fundit.</p> <p>Nisur nga testimet e KLSH-së mbi raportimet e AAPSK-së, të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (pa të ardhurat nga buxheti i shtetit) janë konsiderueshëm më të ulëta se shpenzimet, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 298,044 mijë lekë. Si rrjedhojë diferenca prej 120,686 mijë lekë rezulton kosto për buxhetin e shtetit.</p>
<b>Kriteri:</b>	Të ardhura/shpenzime të raportuara.
<b>Impakti:</b>	<p>Të ardhurat e raportuara nga AAPSK janë të mbivlerësuar, pasi në llogaritje kanë përfshirë edhe të ardhurat nga buxheti i shtetit, që nuk përfaqësojnë të ardhura nga vet veprimtaria e tyre.</p> <p>Shpenzime konsiderueshëm të larta për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara dhe për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore të administratorëve.</p>
<b>Shkaku:</b>	Mos-realizimi i të ardhurave të mjaftueshme nga pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, që lidhen me administrimin e tyre nga ana e administratorëve.

<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: -për një analizë të faktorëve që kanë impakt negativ në realizimin e të ardhurave dhe për një planifikim të kujdesshëm të shpenzimeve që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara; -për shfrytëzimin dhe rritjen e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara aty ku është e mundur, me qëllim administrimin me eficiencë, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

### 2.2.7 Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për dorëzimin e pasurive të revokuara

Për periudhën objekt auditimi, referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga AAPSK, në lidhje me pasuritë e revokuara rezultojnë si në vijim:

*Pasqyra nr. 22 Pasuritë e revokuara 2017-2022*

Viti	Tokë/truall	Apartamente/garazhe/ ndërtesa/magazina	Automjete	Njësi tregtare	Shoqëri	Llogari bankare	Totali Në mijë lekë
2017							68,385
2018	8	79	-	-	-	12	515,291
2019	31	5	3	1	4	34	337,039
2020	-	-	4	3	1	-	32,112
2021	6	6	13	3	3	-	574,850
2022	12	21	11	26	2	6	1,656,144
<b>Totali</b>	<b>57</b>	<b>111</b>	<b>31</b>	<b>33</b>	<b>10</b>	<b>52</b>	<b>3,115,435</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për sa evidentohet dhe më sipër viti 2022, është viti me vlerën më të lartë të pasurive të revokuara.

Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura në lidhje me praktikën e ndjekur për dorëzimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, për periudhën objekt auditimi, u konstatuan parregullsi, veprime dhe mosveprime, në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 28, datë 21.11.2017 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të K. dhe B.B. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar si administratorë z. A.B. dhe z. E.R. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 18, datë 21.09.2020, ka vendosur:

*-konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit në pjesë ideale të 40% të 20 pasurive;*

*-revokimin e sekuestros së vendosur me vendimin nr. 28 datë 21.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;*

*-kthimin pronarëve të tyre për 18 pasuri.*

Ky vendim i ngarkon në mënyrë solidare subjektit të ligjit të posaçëm K.B dhe atyre të lidhur me të, B.B dhe “B. -K.” SHPK, *shpenzimet procedurale të bëra gjatë administrimit të pasurive.*

B.B dhe “B. C.”, nëpërmjet mbrojtësve dhe nga S. P. U., T. B. S. F. S. të S., kanë bërë ankim kundër vendimit nr. 18, datë 21.09.2020, të depozituar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 33 datë 09.02.2021 ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga ankuesit.

Me shkresën nr. 1259 prot., datë 13.04.2021 nga administratorët e AAPSK-së i është dërguar informacion prokurorisë dhe gjykatës mbi administrimin e këtyre pasurive, ku bëjnë me dije Gjykatën se: **Totali i shpenzimeve të kryera deri më datë 12.04.2021 rezultojnë 6,010,857 lekë.**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 9 datë 19.04.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit B.B. duke plotësuar vendimin nr. 18 datë 21.09.2020 me pjesën si vijon: *“Kthimin shtetasit B.B. dhe shoqërisë “B.-K.” SHPK, 60% të vlerës së fruteve civile të krijuara mbi pasuritë objekt gjykimi*

*gjatë gjithë periudhës së administrimit të tyre, pasi të zbriten prej saj të gjitha shpenzimet e kryera gjatë gjithë procedimit pasuror nga Administratorët e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Brendshme, dhe shpenzimet e parapaguara nga shteti”.*

Ky vendim ka marr formë të prerë në datën 30.04.2021.

Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 2147 datë 21.07.2021 për kalim të fondit monetar nga llogaria e shoqërisë “S. Q. P. R.” në llogarinë e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të shifrës së shpenzimeve **6,221,672 lekë**.

Procesverbali i mbajtur në datë 25.03.2022, nga Administratorët e pasurive të marra me vendimin nr. 28 datë 21.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe pronari i “S. Q. P. R.” z. B.B. për kthimin e sendeve të sekuestruara në administrim të Kompleksit Turistik “S. Q. P. R.” me sipërfaqe ndërtimi 1923 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 13000 m<sup>2</sup>, nr pasurie. 23/235, zona kadastrale 862, Sarandë **rezulton në tejkalim të afateve të përcaktuara (rreth 11 muaj vonesë) në Ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 22 i cili citon:**

<i>Me marrjen dijeni të vendimit gjyqësor për revokimin e sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 ditëve, njofton personin që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe për detyrimet që janë parapaguar nga shteti, të shoqëruara me dokumentacionin financiar përkatës.</i>
---

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. A.B, z. E.R në cilësinë e administratorëve të pasurive.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 75 datë 25.01.2021 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit G.V.L. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar znj. E.O., administratore e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 150 datë 12.07.2021, ka vendosur heqjen e masës së sekuestros të vendosur me vendimin nr. 75, datë 25.01.2021. *Në këtë vendim gjykata nuk shprehet për shpenzimet e kryera gjatë gjithë procedimit pasuror nga Administratorët e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Brendshme dhe shpenzimet e parapaguara nga shteti.*

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë 27.09.2021.

Me shkresën nr. 2867 prot., datë 21.10.2021, nga Administratori i AAPSK-së është njoftuar z. E.B., z. G.V.L. dhe znj. Zh.L. në lidhje me vendimin nr. 150, datë 12.07.2021, duke u bërë me dije që pasuritë do t’i dorëzohen me procesverbal në datën e caktuar nga AAPSK, pasi gjykata të jetë shprehur mbi shpenzimet e administrimit. Me shkresën nr. 3023 prot., datë 04.11.2021, Administratori i pasurive, në zbatim të vendimit nr. 75, datë 25.01.2021, ka dërguar njoftim mbi të ardhurat dhe shpenzimet e administrimit për pasuritë e revokuara me vendimin nr. 150, datë 12.07.2021.

Procesverbalet e mbajtura në datën 24.11.2021, midis Administratorit dhe pronarit të pasurive z. G.V.L për kthimin e sendeve të sekuestruara në administrim, **rezulton në tejkalim të afateve të përcaktuara (rreth 2 muaj vonesë) në Ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 22.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. E.O. në cilësinë e administratorit të pasurisë.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 162 datë 07.10.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të shtetasit A.B. dhe familjarëve të tij.

Kjo gjykatë, me vendimin nr. 90 datë 16.07.2021, ka vendosur heqjen e masës së sekuestros të vendosur. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 17.09.2021.

Në këtë vendim gjykata shprehet: **Shpenzimet procedurale të këtij gjykimi dhe shpenzimet e parapaguara që lidhen me pasuritë objekt gjykimi, i mbeten shtetit, sikurse dhe janë kryer.**

Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 01.10.2021, midis Administratorit të pasurive të marra me vendimin nr. 162, datë 07.10.2020 dhe pronarit të pasurive z. A.B. për kthimin e sendeve të sekuestruara në administrim, dhe kërkesës nr. 2737 prot., datë 08.10.2021, nga ky i fundit kërkohen frytet civile të krijuara gjatë administrimit nga AAPSK për pasurinë: *Tokë truall me nr. 3/45, zona kadastrale 8581, vol. 42, faqe 87, me sipërfaqe 551,2 m/katror, ndërtuar mbi të ndërtesë 2 kate me sipërfaqe 320 m/katror në të cilën ushtron aktivitet Bar-Kafe-Hotel "K."*. Me shkresën nr. 2737/1 prot., datë 08.10.2021, AAPSK i kthen përgjigje z. A.B për kthimin e fryteve të krijuara nga administrimi, pasi të mbahen shpenzimet e kryera për këtë pasuri. ***Të ardhurat nga pasuritë rezultojnë 489,600 lekë dhe vlera e kthyeshme duke zbritur shpenzimet e bëra për administrimin e pasurive shkon në vlerën 370,787 lekë.*** Vendimi gjyqësor nr. 90 datë 16.07.2021 i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar shprehet se: *Shpenzimet procedurale të këtij gjykimi dhe shpenzimet e parapaguara që lidhen me pasuritë objekt gjykimi, i mbeten shtetit, sikurse dhe janë kryer. Nga ana e administratorit të pasurisë nuk është ankimuar ky vendim, por është vepruar duke i mbajtur shpenzimet e administrimit nga subjekti.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. E.O. në cilësinë e administratorit të pasurisë.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 22 datë 12.07.2017 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. N.P.J. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar z. A.B., administrator të AAPSK-së.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 3 datë 27.02.2018, ka vendosur revokimin e sekuestros së vendosur me vendimin nr. 22 datë 12.07.2017, vendim i cili ka marr formë të prerë në 15.03.2018.

Gjykata nuk është shprehur për shpenzimet e administrimit të pasurive nga AAPSK.

Procesverbali i mbajtur në datë 23.03.2018 "*Për kthimin e sendit të sekuestruar*", nga Administratori i pasurive, oficeri i policisë gjyqësore E.J. dhe pronari i pasurive (i firmosur nga palët pa asnjë pretendim) rendit 10 pasuri nga 13 pasuri që përmban vendimi i revokimit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive A.B. mbi kartelat e shpenzimeve dhe të ardhurave, **rezulton se shpenzimet e bëra për pasuritë e sekuestruara sipas vendimit nr. 22, datë 12.07.2017 janë në vlerën 816,783 lekë, konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Mungesa e veprimeve nga ana e AAPSK-së, për përfitimin e shpenzimeve në vlerën 816,783 lekë, është në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; ë neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar;

Shpenzimet e nevojshme ose të dobishme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar përballohen nga fondet e siguruara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga çdo burim i ligjshëm. Nëse nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar nuk përfitohen fonde të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve, sipas pikës 1, të këtij neni, ato parapagohen nga shteti nëpërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, **me të drejtën e kthimit të tyre nga personi, të cilit i sekuestrohet pasuria, edhe në rastin e revokimit të sekuestrimit ose të konfiskimit.**

Kur gjykata vendos revokimin e masës së sekuestrimit, zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë frytet e pasurisë, të realizuara gjatë administrimit. Ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin në masën e pakësimit të vlerës së pasurisë ose të dëmit që i është shkaktuar asaj.

Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e sekuestrimit, të administrimit, të konfiskimit, të mbrojtësit, si dhe çdo shpenzim tjetër dokumentuar sipas ligjit.

**Shpenzimet për sekuestrimin, sipas këtij ligji, parapagohen nga shteti dhe pagohen nga personi, ndaj pasurive të të cilit vendoset sekuestrimi i pasurisë.** Gjykata, në vendimin

përfundimtar të kërkesës për konfiskim, cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti. Për ankesat për shpenzimet procedurale vendos gjykata që ka dhënë vendimin. Vendimi i gjykatës për marrjen e masës parandaluese përmban:  
ë) masën e shpenzimeve procedurale, llojin e tyre, si dhe të dhëna për personin, të cilit i ngarkohen ato.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. A.B. në cilësinë e administratorit të pasurisë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2019-5221 (1522), datë 20.10.2019 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasve z. A.Sh, znj. L.Sh, znj. R.V dhe z. G.V. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2020-644 datë 11.02.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasve z. A. dhe znj. L.Sh. Për administrimin e aksioneve, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar z. E.B dhe z. F.A, si administrator të AAPSK-së.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 800 (62-21-5904) datë 01.12.2021, ka vendosur revokimin e sekuestros së vendosur me vendimet nr. 62-2019-5221 (1522) datë 20.10.2019 dhe nr. 62-2020-644 datë 11.02.2020. Ky vendim ka marr formë të prerë në 25.12.2021.

Në këtë vendim Gjykata nuk është shprehur për shpenzimet e administrimit të pasurive nga AAPSK por vetëm për shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Me shkresën nr. 103 prot., datë 14.01.2022, z. A.Sh, është njoftuar mbi detyrimet e administrimit në zbatim të vendimit nr. 800 (62-21-5904) datë 01.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhe i sqarohet se para kthimit të objekteve, z. A.Sh duhet të njihet më parë me shpenzimet që lindin nga administrimi si parashikohet në Ligjin nr. 34/2019, i ndryshuar.

Procesverbali i mbajtur në datë 14.01.2022 “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, midis Administratorit të pasurive të marra me vendimet nr. 62-2019-5221 (1522) datë 20.10.2019, nr. 62-2020-644 datë 11.02.2020, dhe pronarit të pasurive z. A.Sh rezulton në përputhje me nenin 22 të Ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar.

Procesverbali i mbajtur në datë 08.02.2022 “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, midis Administratorit të pasurive, të marra me vendimet nr. 62-2019-5221 (1522) datë 20.10.2019, nr. 62-2020-644 datë 11.02.2020 dhe pronarit të pasurive znj. Resmije Vathi, **rezulton në tejkalim të afateve të përcaktuara (rreth 2 muaj vonesë) në Ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 22.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. E.B. dhe z. F.A., në cilësinë e administratorit të pasurive.

6. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 228 datë 31.12.2020, ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasve z. Z. dhe znj. R.C, të cilët e kanë ankimuar vendimin në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 47 datë 18.02.2021 ka lënë në fuqi vendimin nr. 228 datë 31.12.2020.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit nr. 133 datë 02.06.2021 ka vendosur revokimin e pasurive në pronësi të shtetasve z. Z. dhe znj. R.C. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 21.07.2021. Në këtë vendim gjykata shprehet: **Shpenzimet procedurale dhe ato të mirëmbajtjes së pasurive mbeten si janë bërë.**

Me shkresën nr. 2370 prot., datë 26.08.2021, znj. R. dhe z. Z.C, janë njoftuar mbi detyrimet e administrimit të pasurive nga AAPSK-ja e në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 31, pika 4 citon: Gjykata, në vendimin përfundimtar, cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti, sipas dokumentacionit financiar të përgatitur nga Agjencia. **Rezulton se njoftimi është bërë në tejkalim të afateve të përcaktuara (rreth 1 muaj vonesë) në Ligjin**

**nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 22.**

Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 27.08.2021 “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, midis Administratorit të pasurive të marra me vendimin nr. 228 datë 31.12.2020 dhe pronarit të pasurive R.C rezulton se dorëzimi i pasurive është kryer pasi z. Z.C. ka shlyer shpenzimet e administrimit të pasurive në shumën prej **14,004 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.B në cilësinë e administratorit të pasurive.

7. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 4 datë 05.03.2018 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. L.S. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar z. A.B. dhe z. E.R., administratorë të AAPSK-së.

Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 1 datë 09.01.2019 vendosi revokimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. L.S., vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 21.01.2019.

**Në këtë vendim gjykata nuk shprehet për shpenzimet procedurale dhe ato të mirëmbajtjes së pasurive.**

*Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratorët e pasurive z. A.B. mbi kartelat e shpenzimeve dhe të ardhurave, rezulton se shpenzimet e bëra për pasuritë e sekuestruara sipas vendimit nr. 4 datë 05.03.2018 janë në vlerën 817,089 lekë, konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.*

Mungesa e veprimeve nga ana e AAPSK-së, për përfitimin e shpenzimeve në vlerën 817,089 lekë është në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; ë neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar;

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. A.B.

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 21 datë 15.10.2016 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetaseve znj. M.C dhe znj. S.G.M. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar znj. B.I, administratore e AAPSK-së.

Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 7 datë 27.04.2018 ka vendosur revokimin e pasurive, vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 14.05.2018.

**Në këtë vendim gjykata nuk shprehet për shpenzimet procedurale dhe ato të mirëmbajtjes së pasurive.**

Procesverbali i mbajtur në datë 07.06.2018 “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, nga përmbauesi gjyqësor pranë Zyrës së Përmbaimit Tiranë, Administratori i pasurive të marra me vendimin nr. 21 datë 15.10.2016 dhe pronaret e pasurive rezulton në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në ligj.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratorja e pasurive znj. B.I., mbi kartelat e shpenzimeve dhe të ardhurave, rezulton se shpenzimet e bëra për pasuritë e sekuestruara sipas vendimit nr. 7 datë 27.04.2018 janë në vlerën 850,894 lekë, ndërsa të ardhurat në vlerën 146,065 lekë.

Mungesa e veprimeve nga ana e AAPSK-së, për përfitimin e shpenzimeve në vlerën **704,829 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** dhe është në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; ë neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. B.I në cilësinë e administratorit të pasurisë.

9. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 17 datë 02.08.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. A.N. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar z. K.Xh. dhe z. S. M., administratorë të AAPSK-së.

Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 25 datë 19.11.2018 ka vendosur revokimin e pasurive, vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 05.12.2018.

***Në këtë vendim gjykata shprehet: Për shpenzimet e parapaguara nga shteti për administrimin e pasurive të sekuestruara, AAPSK-ja ka të drejtën e kthimit.***

Vendimi nr. 1139 datë 09.12.2018 për “Për pushimin e Çështjes Përmbartimore nr. 1139 datë 09.12.2018”, është ekzekutuar, në zbatim të vendimit nr. 25 datë 19.11.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për revokimin e masës së sekuestrimit të pasurive në pronësi të shtetasit z. A.N. Kalimi i pasurive pronarëve të saj është bërë nga znj. L.C, përmbartuese gjyqësore dhe administratori i pasurive S.M.

*Nga të dhënat e kartelave të shpenzimeve dhe të ardhurave, të vëna në dispozicion nga administratori i pasurive S.M., rezulton se shpenzimet e bëra për pasuritë e sekuestruara sipas vendimit nr. 17 datë 02.08.2015 janë në vlerën **2,451,732 lekë ndërsa të ardhurat në vlerën 390,000 lekë.***

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara ka vepruar në kundërshtim me Vendimin Gjyqësor nr. 25 datë 19.11.2018, pasi **i ka dorëzuar pasuritë pa marrë shpenzimet e administrimit të bëra nga shteti në vlerën 2,061,732 lekë** e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe është në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; ë neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. S.M. dhe z. F.A., në cilësinë e administratorëve të pasurisë.

10. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 22 datë 28.10.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. F.K, znj. M.C dhe z. F.K. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar z. B.B, administrator i AAPSK-së.

Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 8 datë 03.05.2018 ka vendosur revokimin e pjesshëm të pasurive dhe konfiskimin e pjesshëm të disa prej tyre.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 24 datë 29.01.2019 ka vendosur revokimin e pjesshëm të pasurive dhe konfiskimin e pjesshëm të disa pasurive.

***Në këtë vendim gjykata shprehet: Për shpenzimet gjyqësore, duke përfshirë edhe shpenzimet e ekspertëve, të parapaguara nga gjykata u ngarkohen të paditurve. Në këtë vendim gjykata nuk shprehet për shpenzimet e mirëmbajtjes së pasurive.***

Procesverbalet e mbajtura në datë 03.04.2019 “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, midis përmbartuesit gjyqësor pranë Zyrës së Përmbartimit Fier, Administratorit të pasurive të marra me vendimin nr. 22 datë 28.10.2015 dhe pronaret e pasurive **janë në tejkallim të afateve ligjore të përcaktuara (rreth 2 muaj vonesë) në Ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, neni 28/2, sipas të cilit vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.**

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive z. B.B., mbi të ardhurat dhe shpenzimet rezulton se shpenzimet e bëra për pasuritë e sekuestruara janë në vlerën **2,562,518 lekë.**

**Mungesa e veprimeve nga ana e AAPSK-së, për përfitimin e shpenzimeve në vlerën 2,562,518 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** dhe është në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; e neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar;

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.B në cilësinë e administratorit të pasurive.

11. Gjykata e Posaçme e Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 226 datë 30.12.2020 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. D.L. dhe të afërmeve të tij. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme,



gjykata ka ngarkuar z. A.B., administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 46/154 datë 10.03.2022 ka vendosur revokimin e pasurive, vendim i cili ka hyr në fuqi në datë 26.05.2022.

***Në këtë vendim gjykata shprehet: shpenzimet gjyqësore dhe ato të mirëmbajtjes së pasurive të sekuestruara siç janë bërë.***

Procesverbali i mbajtur në datë 01.06.2022 “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, rezulton në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në ligj.

Shpenzimet e kryera nga ana e agjencisë gjatë administrimit të pasurive të sekuestruara me vendimin nr. 226 datë 30.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në masën prej 416,902 lekë, janë likuiduar nga shtetasi z. K.L, e vërtetuar kjo me urdhër transfertën e datës 23.05.2022.

12. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 13 datë 27.07.2016 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit M.F. Për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, gjykata ka ngarkuar z. S.M, administrator i AAPSK-së. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 92 datë 13.10.2016 ka lënë në fuqi vendimin nr. 13 datë 27.07.2016.

Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 5 datë 16.03.2018 ka vendosur revokimin e pjesëshëm të pasurive dhe konfiskimin e pjesëshëm të disa prej tyre. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 143 datë 09.11.2018 ka lënë në fuqi vendimin nr. 5 datë 16.03.2018, përse ka disponuar në pikën “1” dhe ka ndryshuar vendimin nr. 5 datë 16.03.2018 për disa pasuri në pikën “2” duke vendosur revokimin e 4 pasurive.

***Në këtë vendim gjykata nuk shprehet për shpenzimet e mirëmbajtjes së pasurive.***

Procesverbalet e mbajtura në datat 28.02.2019 dhe 25.02.2019 “Për kthimin e sendit të sekuestruar” nga përmbaruesi gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lezhë, znj. L.C, Administratori i pasurive të marra me vendimin nr. 13 datë 27.07.2016 dhe pronari i pasurive ***janë në tejkalim të afateve ligjore të përcaktuara (rreth 4 muaj vonesë) në Ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, neni 28/2***, sipas të cilit ***vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.*** Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga administratori i pasurive S.M, mbi të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për pasuritë e sekuestruara rezulton se shpenzimet janë në vlerën ***1,314,277 lekë ndërsa të ardhurat e pasurive të sekuestruara në vlerën 710,270 lekë.***

***Mungesa e veprimeve nga ana e AAPSK-së, për përfitimin e shpenzimeve në vlerën 604,007 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit*** dhe është në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; ë neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.M. në cilësinë e administratorit të pasurive.***

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

Moskryerja e kërkesës për plotësim vendimi, në rastet kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, apo mosmbajtja e shpenzimeve përpara dorëzimit të pasurisë, në moszbatim të vendimit të gjykatës, është me efekt financiar negativ në arkëtimin e të ardhurave buxhetin e shtetit nga burime të tjera të paplanifikuara. Në çdo rast, kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, administratori përkatës nuk duhet të mjaftohet me raportimin e kryer periodikisht pranë gjykatës dhe prokurorisë. Kërkesa për plotësim vendimi duhet të jetë e formalizuar juridikisht në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Në këtë mënyrë, nga sekuestrimi i pasurive, marrja në administrim e tyre nga shteti dhe në fund revokimi i tyre, rezulton që të jetë me humbje për buxhetin e shtetit, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të AAPSK.

Nga përfaqësuesit e AAPSK znj. E.O., me shkresën nr. 27/46 prot., datë 11.08.2023, z. S. M, me shkresën nr. 27/44 prot., datë 10.08.2023 dhe znj. B.I, me shkresën nr. 27/45 prot., datë 11.08.2023, janë paraqitur observacione, përkatësisht si në vijim:

**Pretendimi i subjektit:**

**znj. E.O:-** Observacion 1: ...AAPSK pasi ka njoftuar subjektet për kthimin e pasurisë ka pritur gjykatën të dalë me një vendim për shpenzimet me të cilat i ka njohur me shkresën datë 28.10.2022, nr. 2738, shkresë më të cilën i ka kërkuar gjykatës plotësimin e vendimit. Revokimi i pasurisë do të realizohej brenda këtij afati nëse pronari të cilit i është kthyer prona do të pranonte kryerjen e shpenzimeve të lindura gjatë administrimit për të cilat është njoftuar në datë me shkresën nr. 2867 prot., datë 21.10.2021, nga Administratori i AAPSK-së. Ky pronar dhe pse ka marr njoftimin nuk ka shfaqur asnjë interes deri në datën 24.11.2021 kur sipas jush kemi një kalim të afateve të dorëzimit të pasurisë. Afati brenda 15-ditëve i parashikuar nga ligji 34/2019 i ndryshuar, nuk merr parasysh faktin kur pronari nuk ka marrë apo nuk do të marrë dijeni.

Observacion 2: ...Pasuritë janë revokuar nga administratori i pasurisë, në zbatim të vendimit të gjykatës me procesverbal më datë 01.10.2021, pa i mbajtur pronarit asnjë shpenzim në momentin e dorëzimit të pasurisë. Më pas, AAPSK mori në shqyrtim kërkesën për vjeljen e të ardhurave të krijuar gjatë administrimit paraqitur nga z. A.B. në AAPSK. Në shqyrtim të kësaj kërkesë, AAPSK duke marrë parasysh faktin se pasuritë e këtij personi janë vendosur në sekuestro në kuadër të zbatimit të aktit normativ 1, datë 31.01.2020, dhe ky akt, në asnjë nen të tij nuk shprehet për të ardhurat e krijuara gjatë administrimit AAPSK që njësor si mbajtja e shpenzimeve dhe kthimi i fryteve civile do të bëhej vetëm me vendim gjykate. Duke u gjendur përballë këtij fakti në kartelën shoqëruese të AAPSK, përgjegjësi i sektorit ekonomik financiar në kërkesën për kthimin e të ardhurave dërguar nga z. A.B. ka cikluar "...që të kthehen të ardhurat e kërkuara pasi t'i mbahen shpenzimet e administrimit..." e konfirmuar dhe nga kryeadministratori në atë kohë z. Q.Th.

**z. S.M:-** (Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për dorëzimin e pasurive të revokuara) sqarojmë se: Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 17 datë 02.08.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit z. A.N. Revokimin e masës së sekuestrimit të pasurisë të vendosur me vendimin nr. 17, datë 02.08.2015, të kësaj gjykate dhe të zgjatur me vendimet nr. 25, datë 15.09.2017, nr. 9 akti, datë 13.03.2018 dhe nr. 9 akti, datë 14.09.2018, të po kësaj gjykate, duke urdhëruar kthimin e pasurisë së sekuestruar pronarëve të saj. Në lidhje me shpenzimet e pambajtura sipas kreut III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar gjykojmë se: Ndryshimet e ndodhura në ligjin anti-mafia 2017, duhet të shoqëroheshin me ndryshime të tjera akte nënligjore me të cilat AAPSK-ja të vepronte, gjë që nuk ndodhi deri në krijimin e ligjit 34 në vitin 2019. Institucioni ka një hierarki sipas së cilës ndahen kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës.

-Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 13 datë 27.07.2016 ka vendosur sekuestrimin e pasurive në pronësi të shtetasit M. F. Në lidhje me tejkallim të afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, neni 28/2, sipas të cilit vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara, ju bëjmë me dije se AAPSK-ja ka kërkuar nga Gjykata vendimin e formës së prerë. Pas konfirmimit nga gjykata në zbatim të vendimit të sipërcituar, në vijim të kërkesës së AAPSK-s Zyra Përmbartimore Lezhë, me shkresën nr. 179 prot., datë 27.02.2019, ka kërkuar prezencën e AAPSK-së më datë 28.02.2019, në mënyrë që të bëhet kthimi i pasurive pronarëve të saj.

**Znj. B.I:-** Në lidhje me kthimin e shumave monetare të subjektit pa mbajtur shpenzimet, dosja e subjektit M.C. etj. Argumenti im: Neni 29 i Kushtetutës së RSH parashikon: ... Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. Ligji penal favorizues ka fuqi prapaveprues. Ky nen ka sanksionuar si parim kushtetues parimin që ligji penal nuk ka fuqi prapavepruese. Pasuritë e M.C. etj., janë

*sequestruar me vendimin nr. 21 datë 15.10.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se:

- Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga znj. I., z. M., znj. O., në lidhje me situatën, observacionet nuk merren në konsideratë, pasi përveçse janë të njëjtat argumente të paraqitura mbi akt-konstatimet dhe të reflektuara në projekt-raport, gjithashtu referuar rasteve konkrete nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në ndjekjen dhe zbatimin e procedurave për revokimin e masës së sequestrimit të pasurive.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura në bazë risku i dokumentacionit përbërës, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur për dorëzimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, për periudhën objekt auditimi, u konstatuan parregullsi, veprime dhe mosveprime, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesverbalet e mbajtura nga administratorët AAPSK-së dhe pronarët e pasurive, për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimeve gjyqësore nr.18 datë 21.09.2020, nr.150 datë 12.07.2021, nr.800 (62-21-5904) datë 01.12.2021, nr.133 datë 02.06.2021, nr. 90 datë 16.07.2021, rezultojnë në tejkalim të afateve të përcaktuara në ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sequestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 22;</li> <li>-Procesverbalet e mbajtura nga administratorët AAPSK-së dhe pronarët e pasurive, për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimeve gjyqësore nr. 24 datë 29.01.2019 dhe nr. 5 datë 16.03.2018 rezultojnë në tejkalim të afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 10192, datë. 03.12.2009, i ndryshuar, neni 28/2;</li> <li>- Nga ana e administratorëve të AAPSK-së nuk është ankimuar vendimi gjyqësor nr. 90 datë 16.07.2021 i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në dispozitën në lidhje me shpenzimet proceduriale dhe shpenzimet e parapaguara të pasurive të objekt gjykimit, por është vepruar në kundërshtim të tij, duke mos përmbushur përcaktimin që: <i>Shpenzimet proceduriale të këtij gjykimi dhe shpenzimet e parapaguara që lidhen me pasuritë objekt gjykimi, i mbeten shtetit, sikurse dhe janë kryer.</i></li> <li>- Në lidhje me kthimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, nga ana e administratorëve të AAPSK-së janë <b>dorëzuar pasuritë pa llogaritur dhe mbajtur paraprakisht shpenzimet e administrimit të bëra nga shteti</b>, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me pikat 1, 2, 4 të nenit 20, pikat 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, dhe shkronjën “ë”, neni 26 kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar. Nga auditimi u përlllogaritën në total 7,566,958 lekë, dëm shkaktuar buxhetit të shtetit, konkretisht:             <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 3 datë 27.02.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 816,783 lekë.</li> <li>2. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 1 datë 09.01.2019, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 817,089 lekë.</li> <li>3. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 7 datë 27.04.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 704,829 lekë.</li> </ol> </li> </ul>

	<p>4. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 8 datë 03.05.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 2,562,518 lekë.</p> <p>5. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 5 datë 16.03.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 604,007 lekë.</p> <p>6. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 25 datë 19.11.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 2,061,732 lekë.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar, neni 20, pika 1, 2, 4, neni 25, pika 1, 2, 3, 4, 5, neni 26, pika “ë”, neni 28/2.</p> <p>- Ligji nr. 34/2019, neni 11, pika d, dh, neni 22.</p>
<b>Impakti:</b>	Moskryerja e kërkesës për plotësim vendimi, në rastet kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, apo mosmbajtja e shpenzimeve përpara dorëzimit të pasurisë, në moszbatim të vendimit të gjykatës, impakton buxhetin e shtetit.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i akteve ligjore dhe nën ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa që:</p> <p>-të kryhet verifikimi i të gjitha rasteve ku nuk janë mbajtur shpenzimet e administrimit dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, arkëtimi i vlerës prej <b>7,566,958 lekë</b>.</p> <p>-në çdo rast, kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, të kërkojnë plotësim vendimi, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit të bëhet brenda afateve në përputhje me kërkesat e akteve ligjore.</p>

### 2.2.8 Mbi procedurat për tjetërsimin/shitjen e pasurive të konfiskuara me vendim gjyqësor

Nga auditimi është konstatuar se për periudhën objekt auditimi vendimet e konfiskimit rezultojnë si në vijim:

*Pasqyra nr. 23 Vendime konfiskimi*

Vendime konfiskimi						
Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Nr.</b>	25	6	5	5	48	86
<b>Vlerë/Lekë</b>	184,503,128	3,302,868	106,981,794	20,169,835	508,714,584	608,964,011

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se viti 2018 rezulton viti me vlerën më të ulët të vendimeve të konfiskimit, konkretisht me 6 vendime në vlerë pasurie 3,303 mijë lekë. Viti 2022 rezulton viti me vendime konfiskimi në numër dhe në vlerë më të lartë të pasurive, konkretisht, me 86 vendime në vlerën 608,964 mijë lekë. Rritja e pasurive të konfiskuara përkthehet në të ardhura më të larta për përballimin e shpenzimeve të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi zbatimin e tjetërsimit/shitjes së pasurive të konfiskuara me vendim gjyqësor, përgatitja e dokumentacionit, respektimi i procedurave të vlerësimit dhe verifikimi i arkëtitimit të vlerave nga shitja, për periudhën 01.10.2017-31.12.2022, nga auditimi i dosjeve të dërguara për shitje u konstatua se përgjatë periudhës objekt auditimi rezulton si në vijim:

## **Viti 2018**

Janë shqyrtuar procedurat si në vijim:

- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 46/184+1-11, zona kadastrale 8518, vo. 31, faqe 160, me vendndodhje Iliria-Plazh/13, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 2930 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 27/44, zona kadastrale 3225, vol. 4, faqe 78, me vendndodhje Fshati Rreth, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “njësi” me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 24/211-N9, zona kadastrale 8512, vol. 35, faqe 176, me vendndodhje Rruga Taulantia, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 1485 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 193/8, zona kadastrale 3866, vol. 10, faqe 174, me vendndodhje Yzberisht, Tiranë.

### **Nga auditimi rezulton se:**

- është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar.
- nga ana e Kryeadministratorit është nxjerrë Urdhri i Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimit të shitjes të pasurisë së konfiskuar”.
- komisioni ka bërë vlerësim në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010 “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.
- dosja e pasurisë e dërguar për shitje rezulton në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010.
- AAPSK ka marrë njoftim nga Drejtoria e Pronës Publike në lidhje me zhvillimin e ankandëve.
- për ankandet e zhvilluara të pasurive të mësipërme nuk ka patur asnjë kërkesë për blerje dhe komisioni i ka deklaruar të mbyllura.

## **Viti 2019**

Janë shqyrtuar procedurat si në vijim:

- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 80.6 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 2/343+6-38, zona kadastrale 8270, vol. 7, faqe 131, me vendndodhje në rrugën Muhamet Gjollësja, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 82.4 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 2/343+5-27, zona kadastrale 8270, vol. 7, faqe 131, me vendndodhje në rrugën “Muhamet Gjollësja”, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 1200 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 133/210, zona kadastrale 3266, vol. 16, faqe 209, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 13000 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 133/16, zona kadastrale 3266, vol. 5, faqe 133, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 745 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 177/27, zona kadastrale 2375, vol. 4, faqe 8, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 1515 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 177/22, zona kadastrale 2375, vol. 4, faqe 5, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 355 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 7/47, zona kadastrale 3266, vol. 9, faqe 247, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 7/51, zona kadastrale 3266, vol. 10, faqe 1, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.

### **Nga auditimi rezulton se:**

- është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar.
- nga ana e Kryeadministratorit është nxjerrë Urdhri i Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimit të shitjes të pasurisë së konfiskuar”.
- komisioni ka bërë vlerësim në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010 “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.

- dosja e pasurisë e dërguar për shitje rezulton në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010.

- AAPSK ka marr njoftim nga Drejtoria e Pronës Publike në lidhje me zhvillimin e ankandeve. - për ankandet e zhvilluara të pasurive të mësipërme nuk ka patur asnjë kërkesë për blerje dhe komisioni i ka deklaruar të mbyllura me përjashtim të pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 745 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 177/27, zona kadastrale 2375, vol. 4, faqe 8, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm, Durrës.

Për këtë pasuri, sipas procesverbalit të mbajtur në datë 18.06.2019, ora 10.00, “Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, rezulton se komisioni vendosi të shpallë fitues z. A.SH.

Në kundërshtim me pikën 17 të VKM-së nr. 632, datë 23.7.2010, pika 17, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe AAPSK nuk kanë lidhur kontratë me fituesin e ankandit të pasurisë së paluajtshme.

### **Viti 2020**

Përgjatë vitit 2020 rezulton se nuk është zhvilluar asnjë ankand, duke qenë se Vendimi nr. 888 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, në zbatim të ndryshimeve ligjore, ka dal në datën 11.11.2020.

### **Viti 2021**

Janë shqyrtuar procedurat si në vijim:

- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 2930 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 27/44, zona kadastrale 3225, vol. 4, faqe 78, me vendndodhje në Rreth, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 355 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 7/47, zona kadastrale 3266, vol. 9, faqe 247, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 1515 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 177/22, zona kadastrale 2375, vol. 4, faqe 5, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm, Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 145/48, zona kadastrale 1574, vol. 6, faqe 248, me vendndodhje në Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “ullishte” me sipërfaqe 1500 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 156/1, zona kadastrale 3385, vol. 15, faqe 44, me vendndodhje në Durrës.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 7/51, zona kadastrale 3366, vol. 10, faqe 1, me vendndodhje në Sauk, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së luajtshme “Asete të Shoqërisë C.” SHPK Fier.
- Për shitjen e pasurisë së luajtshme “Asete të Shoqërisë A.” SHPK Fier.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bodrum” me sipërfaqe 11.6 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 5/56, zona kadastrale 8632, me vendndodhje në Shëngjin, Lezhë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bodrum” me sipërfaqe 58.30 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 16/110+1-B1, Vol. 10, faqe. 95, zona kadastrale 2917, me vendndodhje në Përmet.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bar Restorant Hotel A.” me sipërfaqe gjithsej 3320 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 638 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 32/24, zona kadastrale 3183, me vendndodhje në Rinas, Krujë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 2/162+1-1/3, zona kadastrale 8350, me vendndodhje në Tiranë.

### **Nga auditimi rezulton se:**

- është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar.
- nga ana e Kryeadministratorit është nxjerrë Urdhri i Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimit të shitjes të pasurisë së konfiskuar”.
- me përjashtim të 6 procedurave të fundit, urdhri i ngritur nga Kryeadministratori për vlerësimin e çmimit të shitjes të pasurisë së konfiskuara i është referuar në VKM-së nr. 632

datë 23.07.2010 (e shfuqizuar) dhe jo VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara". Sipas kërkesave të VKM-së nr. 888, Kreu IV, pika 1, 2, 3 citon: Kryeadministratori i AAPSK-së, në rastet e tjetërsimit të pasurisë së konfiskuar, ngre një komision për vlerësimin e pasurive të konfiskuara që përbëhet nga:

- a) një specialist i AAPSK-së;
- b) një specialist ekonomist/jurist i AAPSK-së;
- c) një ekspert vlerësues i licencuar.

Përfaqësuesit e komisionit të ngritur nga AAPSK, janë referuar VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010 (shfuqizuar), duke përzgjedhur në komision: një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë.

- komisioni ka bërë vlerësim në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010 "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara".

-dosjet 6 pasurive të paluajtshme të fundit janë shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga një grup ekspertësh të jashtëm, për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut IV, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020.

- AAPSK ka marr njoftim nga Drejtoria e Pronës Publike në lidhje me zhvillimin e ankandëve.  
- për ankandet e zhvilluara të pasurive të mësipërme nuk ka patur asnjë kërkesë për blerje dhe komisioni i ka deklaruar të mbyllura, me përjashtim të pasurisë së luajtshme "Asete të Shoqërisë A." SHPK Fier.

**Për shitjen e pasurisë së luajtshme "Asete të Shoqërisë A." SHPK Fier, rezulton se:**

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 27.10.2021, ora 10.00, 'Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme', komisioni vendosi të deklarojë ankandin e mbyllur, kjo pasi nuk u paraqit asnjë kërkesë për blerje.

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 22.12.2021, ora 10.00, 'Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme', rezulton se komisioni vendosi të deklarojë ankandin e mbyllur, kjo pasi nuk u paraqit asnjë kërkesë për blerje.

Çmimi i propozuar për vlerën e përgjithshme të pasurisë është prej **1,344,662 lekë.**

Sipas shkresës nr. 1592 prot., datë 14.07.2022, AAPSK ka ridërguar dosjen për shitjen e pasurisë së luajtshme "Asete të Shoqërisë A." SHPK Fier, me vendimin e KNMKKO nr. 50, datë 29.04.2022.

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 21.11.2022, ora 16.00 "Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme", rezulton se ankandi është zhvilluar në datë 18.11.2022 ora 12.00 me çmim 50% me të ulët se 30% e çmimit fillestar. Çmimi i propozuar për vlerën e përgjithshme të pasurisë është prej **627,330,75 lekë.**

Në ankand u paraqitën dy kërkesa, konkretisht kërkesa e shoqërisë "C. M." SHPK e përfaqësuar nga z. A.C dhe kërkesa e z. N.B. Ankandi shpalli fitues z. N.B me dhënien e ofertës më të lartë prej 1,400,001 lekë. Duke qenë se përfaqësuesi i shoqërisë "C. M." SHPK nuk u paraqit për të firmosur procesverbalin, komisioni vendosi që të mos i kthehet shuma e 20% e paguar për pjesëmarrje në ankand në llogarinë e I. S. P. Bank më datë 21.10.2022 në vlerën prej 134,466 lekë, derisa përfaqësuesi i shoqërisë të paraqitet për të firmosur procesverbalin. **Ky veprim është kryer në kundërshtim me VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020, Kreu V, pika 21:**

*Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, përveç fituesit, iu kthehet 20% e vlerës fillestare, e ngurtësuar paraprakisht. Nga ana e AAPSK-së nuk është kthyer shuma në vlerën prej 134,466 lekë, e paguar nga përfaqësuesi i shoqërisë "C. M." SHPK në llogarinë e I. S. P. Bank të AAPSK-së.*

Sipas shkresës nr. 22136/1 prot., datë 04.01.2023, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar konfirmim për kryerjen e pagesave dhe në

përgjigje të kësaj shkresë, AAPSK, ka konfirmuar pagesat për blerjen e pasurisë së paluajtshme me shkresën nr. 3217/4 prot., datë 11.01.2023.

Sipas shkresës nr. 22136 prot., datë 01.12.2022, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka autorizuar për kryerje pagese dhe kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme në pronësi të z. N.B.

Rezultoni se janë arkëtuar në llogarinë e AAPSK-së me nr. 2022330703 “*Të ardhura nga shitja e pasurive të Konfiskuara*” të dy këstet për blerjen e pasurisë nga z. N.B. Pagesa e parë është kryer më datë 17.11.2022 për vlerën 134,466 lekë dhe pagesa e dytë është kryer më datë 23.12.2022 për vlerën 1,265,535 lekë.

Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe AAPSK, nuk kanë lidhur kontratë me blerësin N.B., veprim ky në kundërshtim me VKM-në nr. 888, datë 11.11.2020, Kreu V, pika 26:

*Përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, përfaqësuesi i AAPSK-së janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal, të objektit që shitet, brenda 35 (tridhjetë e pesë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, nga struktura përgjegjëse për pronat publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, blerësit.*

## **Viti 2022**

Sipas raportit të aktivitetit për vitin 2022, pasuritë e shitura me ankand nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për llogari të AAPSK, rezultoni si në vijim:

*Pasqyra nr. 24 Pasuritë e shitura me ankand*

Nr.	Emërtimi pasurisë	Vlera fituese e ankandit Në lekë	Situata
1	Market Orikum	3,392,272	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar objekti
2	Market Orikum	4,673,700	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar objekti
3	Ndërtesë dy/katëshe në Grudë, e Re Shkodër	9,560,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar objekti
4	Njësi biznesi Bar-Kafe në Përmet	3,000,000	Nuk është lidhur akoma kontrata e shitjes
5	“Bodrum” në Përmet	740,000	Nuk është lidhur akoma kontrata e shitjes
6	Apartament në Tiranë	7,900,000	Nuk është lidhur akoma kontrata e shitjes
7	Hotel “A.” në Rinas, Tiranë	16,400,000	Kësti i dytë i pagesës ka kaluar në vitin 2023
8	Garazh, Linzë, Tiranë	120,000	Kësti i dytë i pagesës ka kaluar në vitin 2023
9	Bodrum me nr. pas 5/56-B2 në Shëngjin Lezhë	45,031.40	Shuma 45,031.40 është konfiskuar pasi nuk është paguar kësti i dytë brenda afatit
10	Bodrum me nr. pas 5/56-B3 ne Shëngjin Lezhe	45,031.40	Shuma 45,031.40 është konfiskuar pasi nuk është paguar kësti i dytë brenda afatit
11	Kamio Volvo + Rimorkio	420,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
12	Land Rover “Discovery I”	70,500	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
13	Mercedes Benz E 220 CDI	44,400	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
14	Nisan Primera Beap	31,500	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
15	“Asete te Shoqërisë “A.” 2. sh.p.k	14,000,000	Akoma nuk është lidhur kontrata
16	Hekur per skrap, “Laguna e Karavastasë “	91,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
17	Benz Mercedes 200 D	30,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
18	Mercedes Benz 190	30,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
19	Mercedes Benz S 350 D	120,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
20	Traktor	70,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
21	Mitsubishi “Pajero”	170,000	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
22	Mercedes Benz C Class 220	44,400	Lidhur kontrata e shitjes, dorëzuar pasuria
	<b>Totali</b>	<b>60,927,834.8</b>	

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Janë shqyrtuar procedurat si në vijim:

- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bodrum” me sipërfaqe 58.30 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 16/110+1-B1, Vol. 10, faqe. 95, zona kadastrale 2917, me vendndodhje në Përmet.
- Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bar Restorant Hotel A.” me sipërfaqe gjithsej 3320 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 638 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 32/24, zona kadastrale 3183, me vendndodhje në Rinas, Krugë.



➤ Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 2/162+1-1/3, zona kadastrale 8350, me vendndodhje në Tiranë.

**Nga auditimi rezulton se:**

-është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar.

-nga ana e Kryeadministratorit është nxjerrë Urdhri i Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimit të shitjes të pasurisë së konfiskuara”.

-urdhri i ngritur është në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 888 datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, Kreu IV, pika 1, 2, 3.

-komisioni ka bërë vlerësim në përputhje me kërkesat e Kreut IV, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020.

-AAPSK ka marr njoftim nga Drejtoria e Pronës Publike në lidhje me zhvillimin e ankandeve. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë rezulton se:

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 28.12.2022, ora 10.00 “Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, meqenëse për blerjen e këtij objekti u paraqit vetëm një kërkesë, komisioni vendosi të administroj kërkesën dhe në zbatim të VKM-së nr. 888 datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, Kreu V, pika 1 si edhe VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes” Kapitulli III, pika 16, duke bërë një njoftim të ri për një periudhë 10-ditore.

Sipas shkresës nr. 3483/1 prot., datë 07.12.2022 AAPSK ka autorizuar z. A.A.Ll të depozitojë pranë I. S. P. Bank, vlerën prej 120,000 lekë e cila shërben si garanci bankare dhe është 20% e vlerës fillestare të ankandit për pasurinë e paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë.

Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 24.01.2023, ora 10.00 “Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, rezulton se komisioni shpall fitues z. A.Ll. për blerjen e pasurisë së paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë me vlerën e ofruar prej 600,000 lekë.

Sipas shkresës nr. 451/1 prot., datë 03.02.2023, AAPSK ka autorizuar z. A.A.Ll të depozitojë pranë I.S.P. Bank, vlerën prej 480,000 lekë e cila shërben si garanci bankare dhe është 80% e vlerës fillestare të ankandit për pasurinë e paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë me vlerë fillestare 600,000 lekë. Sipas statement të Bankës I. S. P. janë arkëtuar në llogarinë e AAPSK-së me nr. 2022330703 “Të ardhura nga shitja e pasurive të Konfiskuara” të dy këstet për blerjen e pasurisë nga z. A.Ll.

Sipas shkresës nr. 2923 prot., datë 10.02.2023 Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar konfirmim për kryerjen e pagesave dhe në përgjigje të kësaj shkrese, AAPSK, ka konfirmuar pagesat për blerjen e pasurisë së paluajtshme me shkresën nr. 454/3 prot., datë 17.02.2023

Sipas shkresës nr. 1595 prot., datë 26.01.2023, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka autorizuar për kryerje pagese dhe kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme në pronësi të z. A.Ll.

*Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe AAPSK, nuk kanë lidhur kontratë me blerësin A.A.D, veprim ky në kundërshtim të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020, Kreu, pika 26.*

Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bar Restorant Hotel A.” rezulton se:

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 30.11.2022, ora 11.00, ‘Për mbylljen e publikimit të

kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme’, rezulton se meqenëse për blerjen e këtij objekti u paraqit vetëm një kërkesë, komisioni vendosi të administroj kërkesën dhe në zbatim të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020, Kreu V, pika 1 si edhe Vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, Kapitulli III, pika 16, duke bërë një njoftim të ri për një periudhe 10-ditore.

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 21.12.2022, ora 11.00 “Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, rezulton se meqenëse për blerjen e këtij objekti u paraqit vetëm një kërkesë e cila ka qenë e administruar më parë në ankandin e datës 30.11.2022 komisioni vendosi të shpall fitues Shoqërinë “R. G.”, me vlerën e ofruar prej **82,000,000 lekë**.

Me shkresën nr. 23550 prot., datë 22.12.2022, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka autorizuar për kryerje pagese dhe kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme në pronësi të Shoqërisë “R. G.”.

Rezultoni se janë arkëtuar në llogarinë e AAPSK-së me nr. 2022330703 “Të ardhura nga shitja e pasurive të Konfiskuara” të dy këstet për blerjen e pasurisë. Në datë 18.11.2022, në bankën I. S. P., sipas Formularit Urdhër Transferte është derdhur shuma prej 16,400.000 lekë, në datë 09.01.2023 dhe 10.01.2023, janë derdhur shumat prej 50,076,000 lekë dhe 15,524,000 lekë.

Procesverbali i dorëzimit për pasurinë i mbajtur në datë 07.03.2023 është në tejkalim të afateve, të pikës 26, kreut V, i vendimit nr. 888, datë 11.11.2020.

Me shkresën nr. 4703 prot., datë 09.03.2023, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka dërguar pranë AAPSK-së një kopje origjinale të kontratës së shitjes nr. 1441 Rep., Nr. 627 Kol. datë 07.03.2023 për pasurinë e paluajtshme me vendndodhje në Rinas, Krujë.

Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup>, Tiranë rezultoni se: Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 09.11.2022, ora 11.00 “Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, meqenëse për blerjen e këtij objekti u paraqit vetëm një kërkesë, komisioni vendosi të administroj kërkesën dhe në zbatim të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020, Kreu V, pika 1 si edhe VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes” Kapitulli III, pika 16, duke bërë një njoftim të ri për një periudhë 10-ditore.

Sipas Procesverbalit të mbajtur në datë 14.12.2022, ora 10.30 “Për mbylljen e publikimit të kërkesave dhe zhvillimit të ankandit për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, rezultoni se komisioni shpall fituese znj. A.A. për blerjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 2/162+1-1/3, zona kadastrale 8350, me vendndodhje në Tiranë me vlerën e ofruar prej 7,900,000 lekë.

Sipas shkresës nr. 2989/1 prot., datë 19.10.2023, AAPSK ka autorizuar znj. A.A. të depozitojë pranë I.S. P. B., vlerën prej 1,580,000 lekë e cila shërben si garanci bankare dhe është 20% e vlerës fillestare të ankandit për pasurinë e paluajtshme “apartament”. Sipas statement të Bankës I. S. P. janë arkëtuar në llogarinë e AAPSK-së me nr. 2022330703, kësti i parë në vlerën prej 1,580,000 lekë në datën 19.10.2022 dhe kësti i dytë në vlerën prej 6,320,000 lekë në datën 29.12.2022.

Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe AAPSK, nuk kanë lidhur kontratë me blerësin Anila Arshimi, veprim ky në kundërshtim me VKM-në nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, Kreu V, pika 26.

Nga auditimi konstatohet se për pasuritë e shitura, nuk janë përlllogaritur detyrime të mbartura nga pasuritë e konfiskuara me vendim gjykate, në kundërshtim me pikën 28 të Vendimit nr. 888 datë 11.11.2020 i cili citon se “Të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të

konfiskuara, pasi u zbriten detyrimet, derdhen në llogarinë e AAPSK-së. Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar realizon ndarjen e fondit, si më poshtë vijon:

a) në buxhetin e shtetit;

b) në fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;

c) në përdorim të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” Nga auditimi, është konstatuar gjithashtu se administratorët e pasurive pasi përgatisin raportin tekniko-financiar për ta dorëzuar në Komitetin Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, nuk përgatisin procedurat për tjetërsimin e pasurive, në kundërshtim kjo me pikën ç, neni 13, i Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, i cili citon: Administrator i Pasurisë së Konfiskuar... “Harton të gjitha shkresat zyrtare dhe mban korrespondencën me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për administrimin, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara” 3. “Administratori i pasurisë së sekuestruar, i caktuar nga agjencia, në rastet kur pasuria në administrim të tij konfiskohet me vendim gjyqësor, vazhdon ushtrimin e detyrave, në emër dhe për llogari të Agjencisë, për aq kohë sa nuk është zëvendësuar prej saj me administratorin e pasurisë së konfiskuar”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për mos realizimin e shitjes finale të pasurive.

Nga përfaqësuesit e AAPSK z. A.K, z. Q.Th dhe z. A.K, me shkresën nr. 27/43 datë 04.08.2023, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:

**Pretendimi i subjektit:**

z. A.K, z. Q.Th dhe z. A.K: -Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 745 m2 me nr. Pasurie me nr. 177/27, zona kadastrale 2375, vol. 4, faqe 8, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm, Durrës ju sqarojmë se megjithë përpjekjet e bëra nga Drejtoria e Shitjes së Pronave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për njoftimin e z. A.Sh. për të ardhur dhe lidhur kontratën, ky i fundit akoma dhe sot nuk është paraqitur pranë institucionit për të lidhur kontratën. Për shitjen e pasurisë së luajtshme “Asete të Shoqërisë A.” SHPK Fier, shpjegojmë se kontrata nuk është lidhur akoma për arsye se nuk është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që është institucioni i ngarkuar me ligj për shitjen e pasurive të paluajtshme pronë shtetërore. Përsa i përket konstatimit tuaj për kthimin 20% të shumës për pjesëmarrje në ankand për përfaqësuesin e shoqërisë “C. M.” SHPK, nuk ka ndonjë VKM apo udhëzim që na obligon të lajmërojmë pjesëmarrësit që marrin pjesë në ankande të shitjes së pasurive për të ardhur dhe tërhequr shumën prej 20% për pjesëmarrje në ankand. Theksojmë se me t’u paraqitur personi apo ndonjë përfaqësues i shoqërisë “C. M.” SHPK, AAPSK do të kthejë shumën prej 134,466 lekë. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m2 me nr. pasurie 505/316-G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë, ju bëjmë me dije se kontrata e shitjes së pasurisë është konkretizuar më datën 10.07.2023, përcjellë me shkresën nr 12626, datë 10.07.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 51.70 m2, ju bëjmë me dije se kontrata e shitjes së pasurisë është konkretizuar më datën 16.06.2023, përcjellë me shkresën nr. 11085/1, datë 16.06.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nga auditimi konstatohet se për pasuritë e shitura, nuk janë përlllogaritur detyrime të mbartura nga pasuritë e konfiskuara me vendim gjykate, në periudha të caktuara sipas gjendjes financiare AAPSK-ja paraqet kërkesën për kalimin e një pjesë të të ardhurave të krijuara gjatë administrimit të pasurive në komitet për t’i kaluar nga llogaria “Të ardhurat nga pasuritë e sekuestruara dhe te konfiskuara nga tjetërsimi i pasurive” (llog.703) në llog, 702 “Të ardhurat dhe shpenzime të AAPSK” Në këtë kuptim Agjencia merr jo vetëm shpenzimet e kryera për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, por edhe fonde shtesë të parashikuara mbi

*perspektivën e vendimeve gjyqësore në të ardhmen. Theksojmë se Administratorët e pasurive janë pjesë e përgatitjes së procedurave të tjetërsimit të pasurive.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se:

-Përsa i përket konstatimit të grupit të auditimit për kthimin 20% të shumës për pjesëmarrje në ankand për përfaqësuesin e shoqërisë “C. M.” SHPK, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon pasi referuar ligjit nr. 9874 datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, neni 10, pika 2 citohet që : “Autoriteti shitës vë në dijeni sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit: b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;

-Përsa i përket konstatimit të grupit të auditimit se për pasuritë e shitura, nuk janë përlllogaritur detyrime të mbartura nga pasuritë e konfiskuara me vendim gjykate, pika 28 e Vendimit nr. 888 datë 11.11.2020 citon se “Të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi u zbriten detyrimet, derdhen në llogarinë e AAPSK-së”. Për këtë konstatim, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

-Përsa i përket konstatimit mbi procedurat për tjetërsimin e pasurive, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon pasi nga auditimi i praktikave të ndjekura nga AAPSK për shitjen e pasurive të konfiskuara rezultoi se përgatita e procedurave nuk kryhej nga administratorët e pasurive.

-Përsa i përket konstatimit të grupit të auditimit se për pasuritë për të cilat AAPSK dhe Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk kanë lidhur kontratë me blerësit, grupi i auditimit merr në konsideratë observimin dhe reflektoi qëndrimin në raportin përfundimtar të auditimit.

Për sa më sipër që observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë sipas sqarimeve të mësipërme.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në ndjekjen e zbatimit e procedurave për shitjen/tjetërsimin e pasurive të konfiskuara me vendim gjykate.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi zbatimin e tjetërsimit/shitjes së pasurive të konfiskuara me vendim gjykate, përgatitjes së dokumentacionit, respektimit të procedurave të vlerësimit dhe verifikimit të arkëtimit të vlerave nga shitja, për periudhën 01.10.2017-31.12.2022, u konstatua se përgjatë periudhës objekt auditimi rezultoi si në vijim:</p> <p>-Në kundërshtim me pikën 17 të VKM-së nr. 632, datë 23.7.2010, AAPSK dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike nuk kanë lidhur kontratë me fituesin e ankandit të pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sipërfaqe 745 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 177/27, zona kadastrale 2375, vol.4, faqe 8, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm.</p> <p>-Për shitjen e 6 (gjashtë) pasurive të paluajtshme të llojit “tokë arë” dhe “ullishte” Urdhri i Brendshëm i Kryeadministratorit “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimit të shitjes të pasurisë së konfiskuar”, i është referuar në VKM-së nr. 632 datë 23.07.2010 (e shfuqizuar) dhe jo VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.</p> <p>-Në rastin e shitjes së pasurisë së luajtshme “Asete të Shoqërisë A.” SHPK Fier, përfaqësuesit të shoqërisë “C. M.”, nuk i është kthyer shuma prej 134,466 lekë e paguar për pjesëmarrje në ankand, në kundërshtim me pikën 2, neni 10, i ligjit nr. 9874 datë 14.02.2008, i ndryshuar dhe me pikën 21, kreu V të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020.</p> <p>-Për 3 pasuri konkretisht për: pasurinë e luajtshme “Asete të Shoqërisë A.”, pasurinë e paluajtshme “Garazh” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-</p>

	<p>G4, zona kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë, pasurinë e paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 2/162+1-1/3, zona kadastrale 8350, me vendndodhje në Tiranë, AAPSK dhe Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk kanë lidhur kontratë me blerësit, veprim ky në kundërshtim me pikën 26, kreu V, të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.</p> <p>-Procesverballi i dorëzimit për për shitjen e pasurisë së paluajtshme “Bar Restorant Hotel A.”, i mbajtur në datë 07.03.2023 është dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara në pikën 26, kreu V, të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020.</p> <p>Nga auditimi u konstatua gjithashtu se administratorët e pasurive pasi përgatisin raportin tekniko-financiar për ta dorëzuar në Komitetin Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, nuk përgatisin procedurat për tjetërsimin e pasurive, në kundërshtim me pikën 4, neni 13, i Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar. Për pasuritë e shitura, nuk janë përllogaritur detyrime të mbartura nga pasuritë e konfiskuara me vendim gjykate, veprim ky në kundërshtim me pikën 28 të VKM-së nr. 888 datë 11.11.2020.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>-Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 13, pika 4.</p> <p>-Ligji nr. 9874 datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, neni 10, pika 2.</p> <p>-VKM nr. 632, datë 23.7.2010, pika 17.</p> <p>-VKM nr. 888 datë 11.11.2020, pika 21, 26, 28.</p>
<b>Impakti:</b>	<p>Pas ndjekjes së gjithë procedurave dhe shlyerjes së detyrimeve nga ana e blerësve të pasurive të konfiskuara me vendim gjykate, mos dorëzimi i objekteve të shitura nga ana e AAPSK dhe DDPP lë hapësirë për abuzim në shkelje të kriterëve të mirëpërcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Moszbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E mesme</p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marr masa që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, të marrin masa të menjëhershme për dorëzimin e objekteve të shitura.</li> <li>-fondet e ngurtësuara të pjesëmarrësve që nuk shpallen fitues në ankandet për shitjet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, t’i kthejë në llogaritë e tyre bankare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</li> <li>-të hartojë të gjitha shkresat zyrtare dhe të mbajë korrespondencë me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për administrimin, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore.</li> <li>-të realizojë ndarjen e fondit të të ardhurave të realizuara nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi u zbriten detyrimet.</li> </ul>

## 2.2.9 “Mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”

Fondi i posaçëm shërben për:

a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të

*Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme dhe të Ministrisë së Drejtësisë;*  
*b) përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik;*  
*c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale;*  
*ç) dëshmipërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor.*

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar për periudhën objekt auditimi, rezulton se janë financuar 10 projekte me vlerë gjithsej prej **93,403,412 lekë**, detajuar si në vijim:

*Pasqyra nr. 25 Projekte të financuara nga Fondi i Posaçëm (2020-2022)*

<i>Projekte të financuara nga Fondi i Posaçëm (2020-2022) Në lekë</i>					
Nr.	Institucioni/OJF	Projekti	Financimi		Vlera e përfituar
			Nisja	Përfundimi	
1	D.	“Për blerjen e pajisjeve....”	Maj 2021	2022	41,081,542
2	S.	“Për blerjen e ....”	Maj 2021	2022	30,241,187
3	Q. K. P. V. T.	“Rehabilitimi social, ...”	Maj 2021	-	3,400,000
4	G.	“Për rehabilitimin e ....”	Maj 2021	-	5,000,000
5	S.	“Bashkë për ....”	Maj 2021	Dhjetor 2021	2,280,000
6	A.	“Për shërbime efektive.....”	Maj 2021	Maj 2022	2,280,000
7	T.&T.	“Asistencë .....	Maj 2021	Maj 2022	2,280,000
8	A.	“Shërbime emergjence .....	Maj 2021	Maj 2022	2,280,000
9	V.	“Asistencë direkte .....	Maj 2021	Maj 2022	2,280,000
10	C.	“Rehabilitimi.....”	Maj 2021	Nëntor 2021	2,280,000

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga auditimi i 4 dosjeve të përzgjedhura mbi procedurat për afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, me vlerë gjithsej 12,960,000 lekë që përfaqëson rreth 14% të fondeve gjithsej, rezulton si në vijim:

1. Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 2260, datë 29.12.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve të Financuara nga Fondi i Posaçëm”. Sipas procesverbalit nr. 80 prot., datë 11.01.2021, mbajtur për OJF-të që kanë marrë pjesë për përfitimin nga Fondi i Posaçëm, komisioni ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga Fondacioni “A. C. I.” (C...), për propozimin e projektit “Rehabilitimi....” është në përputhje me Udhëzimin nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”. Në vijim Komiteti Ndërinstitucional sipas Vendimit nr. 11, datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm subjektin “C.” në shumën e 2,280,000 lekë, për projektin “Rehabilitimi....”.

Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 682, datë 26.02.2021, midis AAPSK-së dhe Fondacionit “A. C. I.” (C.) rezulton se Autoriteti Financues (AAPSK) e ka kryer pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin në tejkalim të afateve të parashikuara në Kontratën nr. 682, datë 26.02.2021, neni 4 që citon: Autoriteti Financues do të kryejë pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin, jo më vonë se 45 ditë nga shpallja e Vendimit për financimin e projektit, vonesë si rezultat i ndryshimit të titullarit.

Vendimi është shpallur në datë 27.01.2021 dhe Urdhër pagesa është kryer në datën 22.04.2021. Me shkresën nr. 2323/2 prot., datë 25.10.2021, Fondacioni ka raportuar mbi zbatimin

afatmesëm të projektit “Rehabilitimi.....”. Rezulton se Fondacioni A. C. I. (C.), në datë 25.06.2021 për realizimin e projektit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën “P. I.”, në kundërshtim me nenin 9 të Kontratës nr. 682, datë 26.02.2021 ku citohet se përfituesi nuk lejohet të kryejë nënkontraktime për realizimin e aktiviteteve me qëllim përmbushjen e objektivit të kontratës. Sipas relacionit nr. 3091 prot., datë 10.11.2021, komisioni i verifikimit ka konstatuar se faturat justifikuese janë në emër të Qendrës “P. I.”.

Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, me procesverbalin nr. 53, datë 29.12.2021, ka propozuar që të prishet kontrata me Fondacionin “A. C. I.” (C.), e cila është njoftuar me shkresën nr. 91 prot, datë 12.01.2022 nga AAPSK.

AAPSK nuk ka marr asnjë masë të mëtijshme për kthimin në buxhet të shumës së nënkontraktuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 16 dhe 17 të kontratës e cila citon si në vijim:

*16) Në rastin e konstatimit të nënkontraktimit/ve për realizimin e aktiviteteve të projektit, përfituesi duhet të kthejë shumën/at e nënkontraktuar/a.*

*17) Në rastet e mosmarrëveshjeve dhe mospërmbushjes së detyrimeve nga palët, për çështjet e financimit, raportimit, dhe monitorimit të zbatimit të projektit objekt i kësaj kontrate, ata do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.*

Vlera prej 1,140,000 lekë, e disbursuar nga AAPSK, konsiderohet si dëm për Buxhetin e Shtetit.

**2.** Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 2260, datë 29.12.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve të Financuara nga Fondi i Posaçëm”, komisioni me procesverbalin nr. 80 prot., datë 11.01.2021, ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga fondacioni “T.” për propozimin e projektit “Asistencë për ...”, është në përputhje me Udhëzimin nr. 374 datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondit i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”. Në vijim Komiteti Ndërinstitucional sipas Vendimit nr. 09, datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm subjektin “T.” në shumën e 2,280,000 lekë, për projektin “Asistencë për ....”.

Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 676, datë 26.02.2021, midis AAPSK-së dhe fondacionit “T.” rezulton se Autoriteti Financues (AAPSK) e ka kryer pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin në tejkallim të afateve të parashikuara në Kontratën nr. 676, datë 26.02.2021, neni 4, vonesë si rezultat i ndryshimit të titullarit.

Vendimi është shpallur në datë 27.01.2021 dhe Urdhër pagesa është kryer në datën 20.04.2021. Me shkresën nr. 2337/1 prot., datë 30.08.2021 fondacioni ka raportuar mbi zbatimin afatmesëm të projektit. Sipas relacionit nr. 3088 prot., datë 10.11.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar nuk janë konstatuar problematika.

Me shkresën nr. 32 prot., datë 23.03.2022 fondacioni ka raportuar mbi zbatimin e projektit për periudhën 26.02.2021-26.02.2022. Sipas relacionit nr. 1689 prot., datë 06.06.2022 nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar nuk janë konstatuar problematika.

**3.** Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 2260 prot., datë 29.12.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve të Financuara nga Fondi i Posaçëm”, komisioni me procesverbalin nr. 80 prot., datë 11.01.2021 ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga Fondacioni “G.” për propozimin e projektit “Për rehabilitimin .....” është në përputhje me Udhëzimin nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondit i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”.

Në vijim Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, sipas Vendimit nr. 06 datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm subjektin “G.” në shumën 5,000,000 lekë, për projektin “Për rehabilitimin .....”.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky fondacion në lidhje me këtë projekt rezulton se nuk janë paraqitur kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore dhe dokumenti që vërteton se subjekti aplikues ka paguar

rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” pika 9, germa “d” dhe “e” ku citohet:

Organizatat e shoqërisë civile apo Organizatat jofitimprurëse, sipas pikës 5, gërma “c” dhe “d” e këtij udhëzimi, së bashku me kërkesën për financimin dhe projekt-propozimin me kostot financiare përkatëse, duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme:  
d) Kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore;  
e) Dokumenti që vërteton se subjekti aplikues ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar.

Pasqyrat financiare dhe dokumenti që vërteton se subjekti aplikues ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar, të paraqitura në dokumentacionin e dorëzuar nga Fondacioni “G.” për propozimin e projektit “Për rehabilitimin ....”.

Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 679 datë 26.02.2021, midis AAPSK-së dhe Fondacionit “G.” rezulton se Autoriteti Financues (AAPSK) e ka kryer pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin në tejkalim të afateve të parashikuara në Kontratën nr. 679, datë 26.02.2021, neni 4, vonesë si rezultat i ndryshimit të titullarit.

Vendimi është shpallur në datë 27.01.2021 dhe Urdhër pagesa është kryer në datën 21.04.2021. Me shkresën nr. 2328/1 prot., datë 31.08.2021 Fondacioni “G.”, nuk ka raportuar mbi zbatimin e projektit, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” pika 19 ku citohet: Raportimi bëhet me shkresë zyrtare dhe përmban: vlerën e përfituar, fondin e përdorur, mënyrën e përdorimit, produktin/produkte e realizuara, vlerën e mbetur, afatin e përfundimit të projektit.

Sipas relacionit nr. 3086 prot., datë 10.11.2021 nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar rezulton se projekti nuk ka dhënë një rezultat vizibël mbi kryerjen e aktiviteteve.

Me shkresën nr. 3411 prot., datë 15.12.2021, fondacioni “G.” i ka kërkuar AAPSK-së shtyrje afati të projektit. Me shkresën nr. 2802 prot., datë 30.09.2022, AAPSK ka kërkuar raportim për vijueshmërinë e realizimit të projektit, kërkesë e përsëritur me shkresën nr. 197 prot., datë 20.01.2023.

Me relacionin nr. 712 prot., datë 24.02.2023, specialisti i projekteve dhe marrëdhënieve me institucionet ka njoftuar titullarin se Fondacioni “G.” nuk ka zbatuar detyrimet e Kontratës nr. 679, datë 24.02.2023, konkretisht detyrimin e raportimit financiar dhe përshkrues.

Nga auditimi i urdhër pagesave rezulton se AAPSK ka derdhur në llogari të Fondacionit “G.”:

- shumën prej 2,500.000 lekë, me urdhër pagesën nr. 69 datë 21.04.2021;

- shumën prej 2,000,000 lekë, me urdhër pagesën nr. 88 datë 24.05.2022;

- shumën prej 500,000 lekë, me urdhër pagesën nr. 122 datë 06.07.2022.

Dy pagesat e fundit në shumën 2,500,000 lekë rezultojnë në kundërshtim me Kontratën nr. 679 datë 26.02.2021, konkretisht nenin 4 që citon: Autoriteti Financues do të kryejë pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin, jo më vonë se 45-ditë nga shpallja e Vendimit për financimin e projektit. Pjesa prej 40% e fondit të posaçëm do të finanohet pas miratimit të raportit afatmesëm (që përkon me gjysmën e periudhës së zbatimit të Projektit) dhe pjesa e mbetur prej 10% jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të raportit final, pasi nuk janë justifikuar me fatura kësti i parë dhe i dytë, duke mos lejuar si rrjedhojë dhe pagesën e këstit të tretë.

Me shkresën nr. 197/1 datë 28.02.2023, AAPSK ka njoftuar Fondacionin mbi mospërmbushjen e detyrimeve të kontratës. Në vijim me relacionin nr. 1292 prot., datë 11.04.2023, specialisti i projekteve dhe marrëdhënieve me institucionet ka njoftuar titullarin mbi situatën dhe tejkalimin e afateve nga fondacioni.

AAPSK, në vijim nuk ka marrë asnjë masë në kundërshtim me nenin 16 e 17 të kontratës.

Vlera prej 2,500,000 lekë, e disbursuar nga AAPSK, konsiderohet si dëm për Buxhetin e Shtetit.



4. Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, sipas Vendimit nr. 09, datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm “Q.K.P.V.T.” në shumën e 3,400,000 lekë, për projektin “Rehabilitimi .....”, ku në fokus të jenë kurse dhe trajnime. Dokumentacioni i paraqitur nga kjo qendër është në përputhje me Udhëzimin nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” pika 8. Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 684, datë 26.02.2021, midis AAPSK-së dhe “Q.K.P.V.T.” rezultoi se Autoriteti Financues (AAPSK) e ka kryer pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin në tejkallim të afatave të parashikuara në Kontratën nr. 684, datë 26.02.2021, neni 4 që citon: *Autoriteti Financues do të kryejë pagesën paraprake prej 50% të fondit për përfituesin, jo më vonë se 45-ditë nga shpallja e Vendimit për financimin e projektit, vonesë si rezultat i ndryshimit të titullarit.* Vendimi është shpallur në datë 27.01.2021 dhe Urdhër pagesa është kryer në datën 26.04.2021. Me shkresën nr. 2330 prot., datë 18.08.2021, AAPSK i ka kërkuar “Q.K.P.V.T.” raportim për vijueshmërinë e realizimit të projektit, e cila me shkresën nr. 2330/1 prot., datë 30.08.2021 ka bërë raportimin.

Nga auditimi konstatohet se ky raportim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” pika 19 e cila citon se: *Raportimi bëhet me shkresë zyrtare dhe përmban: vlerën e përfituar, fondin e përdorur, mënyrën e përdorimit, produktin/produktet e realizuara, vlerën e mbetur, afatin e përfundimit të projektit.* Ky raportim nuk përmban mënyrën e përdorimit dhe produktet e realizuara të justifikuara me faturat financiare përkatëse.

Me shkresën nr. 2330/3 prot., datë 30.09.2021 “Q.K.P.V.T.” ka raportuar sërish mbi zbatimin e projektit dhe sipas relacionit nr. 684/1 prot., datë 10.11.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar nuk janë konstatuar problematika.

Me shkresën nr. 130 prot., datë 15.12.2021 “Q.K.P.V.T.” ka raportuar mbi planin e veprimit për projektin ku njofton se disa nga zërat e projektit kanë mbetur pa u konsumuar sepse janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe të shtrirë në kohë.

Në vijim me shkresën nr. 737 prot., datë 08.03.2022 ka kërkuar akordimin e pjesës së dytë të fondit në vlerën prej 40% të kontratës. AAPSK në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 737/1, datë 10.03.2022, ka kërkuar faturën e likuiduar të supervizimit për të vijuar me lëvrimin e pjesës tjetër të fondit për realizimin e projektit.

Me shkresën nr. 737/3 datë 28.03.2022, “Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit” ka kërkuar shtyrje afati pasi nuk ka hapësira fizike për realizimin e disa zërave të projektit duke qenë se janë në pritje të ndërtimit të një godine të re, ndërtimi i së cilës nuk është në kontrollin e tyre.

Me shkresën nr. 66 prot., datë 30.05.2022 kjo qendër ka informuar AAPSK se institucioni ka lidhur një kontratë me U. A. të cilët do të investojnë duke ndërtuar një godine të re dhe për këtë arsye disa nga zërat që kanë mbetur do të mbeten pa realizuar deri në krijimin e kushteve të përshtatshme në godinën e re. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit ka kërkuar fond për ato zëra të projektit, që mund ti realizoj në godinën ekzistuese. Totali i vlerës së kërkuar sipas zërave është 675,000 lekë. Sipas relacionit nr. 1691/1 prot., datë 16.06.2022, specialisti i projekteve dhe marrëdhënieve me institucionet i ka sugjeruar Kryeadministratorit që të lëvrohet vlera prej 500,000 lekë dhe pjesa tjetër e fondit të lëvrohet në momentin që Q.K.P.V.T do të njoftojë për ndërtimin e godinës së re. Me Urdhër Pagesën nr. 164 datë 19.09.2022, AAPSK i ka kaluar vlerën prej 500,000 lekë.

Me shkresën nr. 1488 datë 03.05.2023 AAPSK ka kërkuar raportim nga Qendra për vijueshmërinë e realizimit të projektit, e cila me shkresën nr. 78 prot., ka raportuar se nga shuma e akorduar nga ana e AAPSK-së prej 500,000 lekë, kanë arritur të realizojnë aktivitete në vlerën 310,000 lekë. Diferenca prej 190,000 lekë është ende zë i pa-shpenzuar. *Nga auditimi konstatohet se ky projekt rezultoi me vonesa të konsiderueshme në realizimin e plotë të tij si në afat ashtu dhe në zërat e parashikuara, në kundërshtim me nenin 10 dhe 12 të kontratës nr.*

684 prot., datë 26.02.2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.Th në cilësinë e Titullarit të AAPSK-së dhe z. A.K. në cilësinë e Titullarit të AAPSK-së sipas periudhave përkatëse të rasteve të mësipërme për mos-marrjen e masave me qëllim arkëtimin e vlerave të disbursuar nga AAPSK-së për projektet e konstatuara me problematika në zbatim.

Nga përfaqësuesit e AAPSK z. Q.Th. dhe z. M.H., me shkresën nr.27/42 datë 04.08.2023, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:

**Pretendimi i subjektit:**

**z. Q.Th. dhe z. M.H:** - Projekti “Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritetit dhe punësimit” i fondacionit “A. C. I.” (C.). Në relacionin me nr. 3091, datë 10.11.2021 AAPSK evidenton parregullsi në kundërshtim me nenin 9 të Kontratës nr. 682, datë 26.02.2021 dhe i kërkon juristit të institucionit interpretimin dhe arsyetimin mbi vlerësimin e problemit. KNMKKO në mbledhjen e rradhës me nr. 53, datë 29.12.2021 saktëson dhe shpreh dakortësinë për njohjen e shpenzimeve të bëra dhe mosdisbursimin e fondeve për pjesën tjetër, duke ndërprerë menjëherë kontratën. Projekti “Për rehabilitimin .....” paraqitur nga Fondacioni “G.”. Konkluzioni i grupit të auditimit është plotësisht i drejtë, por i përmbushur nga ana jonë pasi me tonën me nr. 1980 prot., datë 13.06.2023 është ngritur Kërkesë Padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me objekt “Detyrim kthimin e shumës prej 2.500.000 lekë”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se: - Për projektin “Rehabilitimi .....” i fondacionit “A. C. I.” (C.) qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon, kjo pasi AAPSK nuk ka marr asnjë masë të mëtejshme për kthimin në buxhet të shumës së nënkontraktuar edhe pas vlerësimit të parregullsive nga ana juaj, veprim ky në kundërshtim me pikën 16, 17 të kontratës e cila citon: “Në rastin e konstatimit të nënkontraktimit/ve për realizimin e aktiviteteve të projektit, përfituesi duhet të kthejë shumën/at e nënkontraktuar/a. Në rastet e mosmarrëveshjeve dhe mospërmbushjes së detyrimeve nga palët, për çështjet e financimit, raportimit, dhe monitorimit të zbatimit të projektit objekt i kësaj kontrate, ata do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente”.

Në lidhje me kërkesë padinë nr. 1980 prot., datë 13.06.2023 është kërkuar kthimi i shumës në vlerën 2,500,000 lekë. Grupi i auditimit e vlerëson qëndrimin tuaj për përmirësimin e situatës në vijim, por vlen të theksohet që padia nr. 1980 prot., datë 13.06.2023 është ngritur jashtë periudhës objekt auditimi dhe pas konstatimit nga ana e KLSH-së.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Problematika në lidhje me rregullshmërinë e procedurave administrative për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm.
<b>Situata:</b>	<p>Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për periudhën objekt auditimi, rezulton se janë financuar 10 projekte me vlerë prej 93,403,412 lekë, nga të cilat u audituan 4 projekte në vlerën 12,960,000 lekë.</p> <p><b>Nga auditimi mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar (KNMKKO) konstatohet se:</b></p> <p>-KNMKKO, sipas Vendimit nr. 11, datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm subjektin F. A. C. I. “C.” në shumën e <b>2,280,000 lekë</b>, për projektin “Rehabilitimi .....”. Midis AAPSK-së dhe Fondacionit “A. C. I.” (C.) është lidhur kontrata nr. 682, datë 26.02.2021. Nëpërmjet Urdhër Pagesës së kryer nga AAPSK në datë 22.04.2021, subjekti përfitues ka marrë pagesën paraprake prej 50% të fondit që është 1,140,000 lekë. Rezulton se nga ana e fondacionit, në datë 25.06.2021, për realizimin e projektit është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me</p>

Qendrën “P. I.”, në kundërshtim me nenin 9. Pavarësisht se ky fakt është evidentuar nga ana e komisionit të verifikimit me relacionin nr. 3091 prot., datë 10.11.2021, AAPSK nuk ka marr asnjë masë të mëtejshme për kthimin në buxhet të shumës së nënkontraktuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 16, 17 të kontratës.

- KNMKKO, sipas Vendimit nr. 06 datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm subjektin “G.” në shumën **5,000,000 lekë**, për projektin “Për rehabilitimin e .....”. Midis AAPSK-së dhe subjektit “G.” është lidhur kontrata nr. 679 datë 26.02.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky fondacion në lidhje me këtë projekt rezulton **se nuk janë paraqitur kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit**, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore dhe dokumenti që vërteton se subjekti aplikues ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” pika 9.

Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 679 datë 26.02.2021, rezulton se Fondacioni “G.” nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit financiar dhe përshkrues për shumën prej 2,500,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” pika 18,19.

Nga auditimi i urdhër pagesave rezulton se AAPSK ka derdhur në llogari të Fondacionit “Gjurmët” shumën prej **5,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 4 të kontratës që citon:** Pjesa prej 40% e fondit të posaçëm do të financohet pas miratimit të raportit afatmesëm (që përkon me gjysmën e periudhës së zbatimit të Projektit) dhe pjesa e mbetur prej 10% jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të raportit final”.

Për pjesën prej 50% të financimit, subjekti përfitues nuk ka përcjellë asnjë raportim financiar dhe përshkrues dhe nga AAPSK, në vijim nuk është marrë asnjë masë për kthimin në buxhet të vlerës prej 2,500,000 lekë, veprim ky në kundërshtim me nenin 16,17 të kontratës.

-KNMKKO, sipas Vendimit nr. 09, datë 27.01.2021, ka vendosur të financoj nga Fondi i Posaçëm “Q. K. P. V. T.” në shumën e **3,400,000 lekë**, për projektin “Rehabilitimi dhe .....”. Midis AAPSK-së dhe “Q. K. P. V. T.” është lidhur kontrata nr. 684, datë 26.02.2021. Nëpërmjet Urdhër Pagesës së kryer nga AAPSK në datë 22.04.2021, subjekti përfitues ka marrë pagesën paraprake prej 50% të fondit që është 1,700,000 lekë. Nga auditimi rezulton se me shkresën nr. 130 prot., datë 15.12.2021 “Q. K. P. V. T.” ka raportuar mbi planin e veprimit për projektin ku njofton se disa nga zërat e projektit kanë mbetur pa u realizuar dhe në vijim me shkresën nr.737/3 datë 28.03.2022, ka kërkuar shtyrje afati pasi nuk ka hapësira fizike për realizimin e disa zërave të projektit duke qenë se janë në pritje të ndërtimit të një godine të re, ndërtimi i së cilës nuk është në kontrollin e tyre. Nëpërmjet Urdhër Pagesës nr.164, date 19.09.2022, AAPSK i ka kaluar “Q. K. P. V. T.” **vlerën prej 500,000 lekë**. Subjekti përfitues nuk ka raportuar pranë AAPSK në tejkallim të afateve të parashikuara në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i

	<p><i>posaçëm për parandalimin e kriminalitetit</i>”pika 18 dhe nenit 10 të kontratës nr. 684, datë 26.02.2021.</p> <p>Me shkresën nr. 1488 datë 03.05.2023 AAPSK ka kërkuar raportim nga Qendra për vijueshmërinë e realizimit të projektit, e cila me shkresën nr. 78 prot., ka raportuar se nga shuma e akorduar nga ana e AAPSK-së prej 500,000 lekë, kanë arritur të realizojnë aktivitete në vlerën 310,000 lekë. Diferenca prej 190,000 lekë është ende zë i pa-shpenzuar. Ky projekt ka vonesa të konsiderueshme në realizimin e plotë të tij si në afat ashtu dhe në zërat e parashikuar, në kundërshtim me nenin 10 dhe 12 të kontratës nr. 684 prot., datë 26.02.2021.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>-Udhëzimi nr. 374 datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”pika 9,18,19.</p> <p>-Kontrata nr. 682, datë 26.02.2021, neni 9, 16, 17.</p> <p>-Kontrata nr. 679 datë 26.02.2021, neni 4,16,17.</p> <p>-Kontrata nr. 684 datë 26.01.2021, neni 10, 12.</p>
<b>Impakti:</b>	Mospërmbushja e detyrimeve të Kontratës, faturat e pajustificuara dhe konstatimi i nënkontraktimit për realizimin e aktiviteteve sjellin dëm për buxhetin e shtetit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kritereve ligjore dhe nënligjore të përcaktuara për rregullat dhe procedurat për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe shkelja e detyrimeve kontraktuale midis palëve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p><b>Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara:</b></p> <p>-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës <b>prej 1,140,000 lekë</b>, nga Fondacioni “A. C. I.” (C.)” për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 682, datë 26.02.2021 për projektin “Rehabilitimi dhe ....”.</p> <p>-Të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës <b>prej 2,500,000 lekë</b>, nga Fondacioni “G.” për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 679, datë 26.02.2021 për projektin “Për rehabilitimin e ....”.</p> <p>-Të mos të vijohet me disbursimin e këstit të dytë të financimit për projektin “Rehabilitimi dhe .....”, pa dokumentuar realizimin e zërave të fazës së parë me dokumentacion justifikues në përmbushje të të gjitha detyrimeve kontraktuale.</p>

## **2.3 Mbi menaxhimin financiar dhe ligjor të fondeve buxhetore të përdorura nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.**

### ***2.3.1 Mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit***

#### **Viti 2017**

Tavanet për këtë institucion janë miratuar me VKM nr. 230, datë 30.03.2016:

Paga e sigurime (600-601) për 10,000 mijë lekë;

Shpenzime korrente (602-606) për 5,000 mijë lekë;

Shpenzime për investime (230-231) për 1,000 mijë lekë.

**-Programimi në fazën e I-rë të PBA 2017-2019** është bërë me shkresën nr. 300/1, datë 21.04.2016, pra brenda afatit ligjor dhe duke mbajtur parasysh limitin e përcaktuar nga Ministria e Financës për përcjelljen e kërkesave buxhetore.

**-Programimi në fazën e II-të të PBA 2017-2019** është bërë brenda limitit të përcaktuar nga Ministria e Financës, në vlerën 16,000 mijë lekë dhe struktura buxhetore paraqitet me një program.

**Shpenzimet buxhetore për PBA 2017-2019**, në të dyja fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2017, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1.** Shpenzimet buxhetore PBA 2017-2019

Në mijë lekë

	Struktura Buxhetore	Realizimi i 2016	PBA Faza e parë 2017	PBA Faza e dytë 2017	Aprovimi i projekt buxhetit 2017
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	7,746	8,330	8,330	<b>8,330</b>
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,191	1,670	1,670	<b>1,670</b>
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	4,991	5,000	5,000	<b>5,000</b>
<b>231</b>	Shpenzime për investime	-	1,000	1,000	<b>1,000</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>13,928</b>	<b>16,000</b>	<b>16,000</b>	<b>16,000</b>

Burimi: Të dhënat e institucionit përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit të vitit 2017 është në vlerën 16,000 mijë lekë, nga 13,928 mijë lekë të realizuar një vit më parë, pra është programuar më shumë për 2,072 mijë lekë, ose 14.9% më shumë se realizimi i një viti më parë.

### Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2017

Shuma e shpenzime korrente dhe shpenzime për investime:

a. Shpenzimet korrente (artikujt 600-606), me shkresën e Ministrisë së Financave nr.17911/125, datë 17.01.2017 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2017”, janë miratuar në vlerën 13,300 mijë lekë, të ndara me artikuj:

Paga e shtesa (artikulli 600), në vlerë 7,000 mijë lekë;

Sigurime shoqërore (artikulli 601), në vlerë 1,300 mijë lekë;

Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), në vlerë 5,000 mijë lekë;

b. Shpenzime kapitale (artikulli 231), sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17911/343, datë 08.02.2017 “Mbi detajimin e shpenzimeve kapitale të vitit 2017”, nuk janë çelur.

### Ndryshimet e buxhetit (rialokime) gjatë 3/mujorit të fundit të vitit 2017.

Nga ana e institucionit është bërë kërkesë me shkresën nr. 1006 datë 15/11/2017 dhe ndryshimet kanë rezultuar në këto zëra të buxhetit:

-Paga e shtesa (artikulli 600), shtuar për 800 mijë lekë;

-Sigurime shoqërore (artikulli 601), shtuar për 526 mijë lekë;

-Blerja mallra dhe shërbime (artikulli 602), pakësuar për 1,326 mijë lekë.

### Zbatimi i buxhetit të 3/mujorit të fundit të vitit 2017.

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar, ndryshimet e tij gjatë periudhës 3 mujore dhe realizimi i tyre për vitin 2017, paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 2.** Zbatimi i buxhetit Tetor-Dhjetor 2017 Në mijë lekë

	Struktura Buxhetore	Fakt 2016	Plan 2017	Ndryshimet gjatë 3/mujorit	Plani i rish 3 muj 2017	Realizm 2017	Dif	Në %
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	7,746	8,197	800	8,997	8,997	-	<b>100</b>
<b>601</b>	Sig.shoq / shëndet	1,191	1,990	526	2,516	1,386	1,130	<b>55</b>
<b>602</b>	Blerje mallra shërbime	4,991	5,000	(1,326)	3,674	3,341	333	<b>91</b>
<b>231</b>	Shpenzime për invest	-	-	-	-	-	-	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>13,928</b>	<b>15,187</b>	<b>0</b>	<b>15,187</b>	<b>13,724</b>	<b>1,463</b>	<b>90</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Pra shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600) për vitin 2017 janë çelur në vlerën 8,197 mijë lekë, nga 7,746 mijë lekë realizuar një vit më parë apo 5.8% më shumë; Janë shtuar gjatë tre

mujorit të fundit 2017 në vlerë 800 mijë lekë, ose 9.8% krahasuar me planin fillestar; Janë realizuar në vlerën 8,997 mijë lekë, pra 100% të planit me ndryshime dhe 16.2% më shumë se realizimi i një viti më parë.

*-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601)* janë çelur në vlerën 1,990 mijë lekë nga 1,191 mijë lekë realizuar një vit më parë apo 67% më shumë; Janë shtuar gjatë kësaj periudhe për 526 mijë lekë, ose 26.4% më shumë se plani fillestar; Janë realizuar në vlerën 1,386 mijë lekë, pra 1,130 mijë lekë më pak se plani i ndryshuar dhe 604 mijë lekë më pak se planifikimi fillestar. (Shtesë jo e nevojshme)

*-Shpenzimet për blerje mallra e shërbime (artikulli 602)*, janë çelur në vlerën 5,000 mijë lekë nga 4,991 mijë lekë realizuar një vit më parë; Janë pakësuar gjatë kësaj periudhe për 1,326 mijë lekë, ose 26.5% më pak se plani fillestar; Janë realizuar në vlerën 3,341 mijë lekë, ose 9.06% më pak se plani i ndryshuar dhe 33% më pak se plani fillestar.

*-Shpenzime për investime (artikulli 231)*, nuk janë çelur për këtë periudhë.

### Viti 2018

Nga MFE me shkresën nr. 2739/10, datë 13.04.2017 janë dërguar tavanet e PBA-së 2018-2020 të miratuara si më poshtë:

Paga e sigurime (600-601) për 11,000 mijë lekë;

Shpenzime korrente (602-606) për 5,000 mijë lekë;

Shpenzime për investime (230-231) 1,000 lekë.

**-Programimi në fazën e I-rë të PBA-së 2018-2020** është bërë me shkresën nr. 475/1, datë 05.05.2017, pra nuk është respektuar afati 20.04.2017 i përcaktuar nga Ministria e Financave në udhëzimin nr. 10 datë 28.02.2017 “Përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”. Është mbajtur parasysh limiti i përcaktuar nga Ministria e Financës për përcjelljen e kërkesave buxhetore.

**-Programimi në fazën e II-të të PBA-së 2018-2020** është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 815 datë 05.09.2017 “Dërgohet projekt buxheti për vitin 2018” duke mbajtur parasysh limitet të përcaktuara nga Ministria e Financës, në vlerë 17,000 mijë lekë dhe struktura buxhetore paraqitet me një program.

Shpenzimet buxhetore për PBA 2018-2020, në të dyja fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2018, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 3. Shpenzimet buxhetore PBA 2018-2020**

*Në mijë lekë*

	Struktura Buxhetore	Realizimi i 2017	PBA Faza e parë 2018	PBA Faza e dytë 2018	Aprovimi i projekt buxhetit 2018
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	8,997	9,163	9,163	9,200
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,386	1,837	1,837	1,200
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	3,341	5,000	5,000	6,000
<b>231</b>	Shpenzime për investime	-	1,000	1,000	1,500
	<b>TOTALI</b>	<b>13,724</b>	<b>17,000</b>	<b>17,000</b>	<b>17,900</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Të dyja fazat e programimit janë në vlerën 17,000 mijë lekë, ndërsa miratimi i projekt buxhetit është në vlerë 17,900 mijë lekë, nga 13,724 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më shumë për 3,276 mijë lekë, ose 23.87% më shumë se realizimi i një viti më parë.

### Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2018

a. Shpenzimet korrente (artikujt 600-606), me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 19650/3, datë 30.01.2018 “Dërgohet detajimi i fondeve të buxhetit të shpenzimeve korrente për vitin 2018”, në vlerë 16,400 mijë lekë, pra janë miratuar shpenzimet korrente, më tepër se një vit më parë, të ndara me artikuj:

*-Paga e shtesa (artikulli 600), gjithsej në vlerë 9,200 mijë lekë;*

-Sigurime shoqërore (artikulli 601), në vlerë 1,200 mijë lekë;

-Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), në vlerë 6,000 mijë lekë;

b. Shpenzimet për investime (artikulli 231), me shkresën nr. 19650/1, datë 20.02.2018 “Dërgohet detajimi i fondeve buxhetore të shpenzimeve korrente për vitin 2018”, në vlerën 1,500 mijë lekë, janë çelur për blerje pajisje.

**Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime, rialokime) gjatë vitit 2018**

Agjencia ka bërë kërkesë për rialokim fondesh me shkresën nr. 944/1 datë 15.10.2018. Ndryshimet kanë rezultuar në këto zëra të buxhetit:

-Paga e shtesa (artikulli 600), shtuar për 100 mijë lekë;

-Sigurime shoqërore (artikulli 601), shtuar për 240 mijë lekë;

-Blerja mallra dhe shërbime (artikulli 602), pakësuar për 340 mijë lekë miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 18471/3, datë 26.10.2018, “Mbi një transferim fondesh të shpenzimeve korrente për vitin 2018”;

-Blerja mallra dhe shërbime (artikulli 602), pakësuar për 2,000 lekë.

### Zbatimi i buxhetit të vitit 2018

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij gjatë këtij viti dhe realizimi i tyre, paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 4. Zbatimi i buxhetit Janar-Dhjetor 2018**

*Në mijë lekë*

	Struktura Buxhetore	Fakt 2017	Plan 2018	Ndryshime gjatë vitit	Plani i rish 2018	Realizim 2018	Dif	Në %
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	8,997	9,100	200	9,300	9,265	35	<b>99.6</b>
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,386	1,300	140	1,440	1,438	2	<b>99.9</b>
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	3,341	6,000	(2,340)	3,660	2,177	1,483	<b>59.5</b>
<b>231</b>	Shpenzime për investime	-	1,500	0	1,500	1,500	-	<b>100</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>13,724</b>	<b>17,900</b>	<b>(2000)</b>	<b>15,900</b>	<b>14,380</b>	<b>1,520</b>	<b>90.5</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

- Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600) janë çelur në vlerën 9,100 mijë lekë, nga 8,997 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 1.2% më shumë; Janë shtuar gjatë periudhës në vlerë 200 mijë lekë, ose 2.2% më shumë krahasuar me planin fillestar; Janë realizuar shpenzimet për pagat në vlerë 9,265 mijë lekë, pra 0.4% më pak se plani me ndryshime dhe 3% më shumë se një vit më parë.

-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601) janë çelur në vlerën 1,300 mijë lekë, nga 1,386 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 6.2% më pak; Janë shtuar për 140 mijë lekë, ose 10.8% më shumë; Janë realizuar në vlerë 1,438 mijë lekë, pra 2 mijë lekë më pak se plani i ndryshuar dhe 3.8% më shumë se realizimi i një viti më parë.

-Shpenzimet për blerje mallra e shërbime (artikulli 602), janë çelur në vlerën 6,000 mijë lekë nga 3,341 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 80 % më shumë; Janë pakësuar për 2,340 mijë lekë, ose 39% më pak; Janë realizuar në vlerën 2,177 mijë lekë, ose 41% më pak se plani i ndryshuar dhe 34.8% më pak se një vit më parë.

-Shpenzime për investime (artikulli 231), janë çelur në vlerën 1,500 mijë lekë dhe janë realizuar 100%.

### Viti 2019

Tavanet e miratuara me VKM nr. 128, datë 07.03.2018 për këtë institucion rezultojnë:

Paga e sigurime (600-601) për 10,420 mijë lekë;

Shpenzime korrente (602-606) për 6,000 mijë lekë;

Shpenzime për investime (230-231) për 1,000 lekë.

-**Programimi në fazën e I-rë të PBA 2019-2021** është realizuar duke mbajtur parasysh udhëzimin plotësues nr. 7/2, datë 09.07.2018, PBA 2019-2021 si dhe brenda limitit të

përcaktuara nga Ministria e Financës, në vlerë 16,420 mijë lekë, dhe kërkesat e institucionit janë po në këtë vlerë.

**-Programimi në fazën e II-të të PBA 2019-2021** dhe projekt buxheti i vitit 2019, është bërë në mbështetje të VKM-së nr. 128 datë 07.03.2018 “Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”. AAPSK me shkresën nr. 776/1 datë 15.08.2018 “Tabelat e PBA 2019-2021” ka përcjellë kërkesat për shpenzimet buxhetore. Shpenzimet buxhetore për PBA 2019-2021, në të dyja fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2019, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 5. Shpenzimet buxhetore PBA 2019-2021**

*Në mijë lekë*

	Struktura Buxhetore	Realizimi i 2018	PBA Faza e parë 2019	PBA Faza e dytë 2019	Aprovimi i projekt buxhetit 2019
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	9,265	9,200	9,200	8,320
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,438	1,210	1,210	2,000
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	2,177	6,000	6,000	6,100
<b>231</b>	Shpenzime për investime	1,500	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>14,380</b>	<b>16,420</b>	<b>16,420</b>	<b>16,420</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit është në vlerë 16,420 mijë lekë, nga 14,380 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më shumë për 2,040 mijë lekë, ose 14.2% më shumë se realizimi i një viti më parë.

#### **Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2019**

Me shkresën nr. 23016/3, datë 14.02.2019 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2019 për shpenzimet korrente”, shpenzimet korrente janë miratuar në vlerë 16,420 mijë lekë pra, më tepër se një vit më parë, të ndara me artikuj:

-Paga e shtesa (artikulli 600), gjithsej në vlerë 8,320 mijë lekë;

-Sigurime shoqërore (artikulli 601), në vlerë 2,000 mijë lekë;

-Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), në vlerë 6,100 mijë lekë;

-Shpenzimet për investime (artikulli 231), nuk janë çelur për vitin 2019.

**Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime)** gjatë vitit 2019, kanë rezultuar në këto zëra të buxhetit:

-Fond i veçantë në vlerën 50,000 lekë, përcjellë me shkresën nr. 2401/3 datë 11.03.2019.

-Blerja mallra dhe shërbime (artikulli 602), shtuar me 10,500 mijë lekë me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17343/148, datë 07.11.2019, “Mbi detajimin e ndryshimeve për shpenzimet korrente në buxhetin e vitit 2019, sipas Aktit Normativ nr. 2 datë 02.10.2019”.

#### **Zbatimi i buxhetit të vitit 2019**

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij gjatë këtij viti dhe realizimi i tyre, paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 6. Zbatimi i buxhetit viti 2019**

*Në mijë lekë*

	Struktura Buxhetore	Fakt 2018	Plan 2019	Ndryshime gjatë vitit	Plani i rishik 2019	Realizimi 2019	Dif	Në %
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	9,265	8,320	-	8,320	6,604	1,716	<b>79.4</b>
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,438	2,000	-	2,000	1,059	941	<b>52.95</b>
<b>602</b>	Blerje mallra / shërbime	2,177	6,100	10,550	16,650	11,303	5,347	<b>67.9</b>
<b>231</b>	Shpenzime për invest	1,500	-	-	-	-	-	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>14,380</b>	<b>16,420</b>	<b>10,550</b>	<b>26,970</b>	<b>18,966</b>	<b>8,004</b>	<b>70.3</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600) janë çelur për vitin 2019, në vlerën 8,320 mijë lekë, nga 9,265 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 10.2% më pak;



Janë realizuar në vlerë 6,604 mijë lekë, pra 20.6% më pak se plani dhe 28.7% më pak se një vit më parë.

-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601) janë çelur në vlerën 2,000 mijë lekë nga 1,438 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 39% më shumë; Janë realizuar në vlerën 1,059 mijë lekë, pra 47% më pak se plani i ndryshuar dhe 26% më pak se realizimi i një viti më parë.

-Shpenzimet për blerje mallra e shërbime (artikulli 602), janë çelur në vlerën 6,100 mijë lekë nga 2,177 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 180 % më shumë; Janë shtuar gjatë vitit me 10,550 mijë lekë; Janë realizuar në vlerën 11,303 mijë lekë, ose 32% më pak se plani i ndryshuar dhe 419% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

-Shpenzime për investime (artikulli 231), nuk janë çelur për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 janë realizuar për 1,500 mijë lekë.

## Viti 2020

Buxheti i këtij viti realizohet në zbatim të legjislacionit të mësipërm dhe udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, i cili është dërguar nga MFE me shkresën nr. 3221/2 datë 02.04.2019 si dhe me shkresën nr. 13217/2 datë 13.08.2019 dërgohet udhëzimi plotësues i PBA 2020-2022. Tavanet e vitit 2020 për këtë institucion janë miratuar:

*Paga e sigurime (600-601) për 10,400 mijë lekë;*

*Shpenzime korrente (602-606) për 6,000 mijë lekë;*

*Shpenzime për investime (230-231) për zero lekë.*

**-Programimi në fazën e I-të të PBA 2020-2022** është bërë duke mbajtur parasysh limitin e përcaktuar nga Ministria e Financës, për përcjelljen e kërkesave buxhetore në vlerë 16,400 mijë lekë.

**-Programimi në fazën e II-të të PBA 2020-2022** është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 781 datë 28.08.2019 “Tabelat e PBA 2020-2022”.

Gjithashtu me shkresën nr. 2835/1 prot. datë 17.02.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2020 që është në vlerën 85,000 lekë.

Shpenzimet buxhetore për PBA 2020-2022, në të dyja fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2020, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 7. Shpenzimet buxhetore PBA 2020-2022**

*Në mijë lekë*

	<b>Struktura Buxhetore</b>	<b>Realizimi 2019</b>	<b>PBA Faza e parë 2020</b>	<b>PBA Faza e dytë 2020</b>	<b>Aprovimi i projekt buxhetit 2020</b>
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	6,604	8,674	8,674	8,674
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,059	1,726	1,726	1,726
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	11,303	6,000	6,000	6,000
<b>231</b>	Shpenzime për investime	-	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>18,966</b>	<b>16,400</b>	<b>16,400</b>	<b>16,400</b>

*Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit janë në vlerë 16,400 mijë lekë, nga 18,966 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më pak për 2,566 mijë lekë, ose 13.5% më pak se realizimi i një viti më parë.

### **Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2020**

Shuma e shpenzime korrente dhe shpenzime për investime, janë çelur këtë vit në vlerë 16,400 mijë lekë, të ndara për:

a. Shpenzimet korrente (artikujt 600-606), me shkresën e Ministrisë së Financave “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2020 dhe limiti mujor i tij”, në vlerë 16,400 mijë lekë, pra janë miratuar shpenzimet korrente, më tepër se një vit më parë, të ndara me artikuj:

Paga e shtesa (artikulli 600), gjithsej në vlerë 8,674 mijë lekë;

Sigurime shoqërore (artikulli 601), në vlerë 1,726 mijë lekë;  
 Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), në vlerë 6,000 mijë lekë;  
 b. Shpenzimet për investime (artikulli 231) nuk janë çelur.

**Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime)** gjatë vitit 2020, kanë rezultuar në këto zëra të buxhetit:

Me shkresën nr. 7040/8 prot. datë 10.12.2020 është bërë rishpërndarje fondi në zbatim të VKM nr. 830 datë 21.10.2020 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë dhe të fondeve buxhetore në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore, për vitin 2020”, në vlerën 3,073 mijë lekë.

### Zbatimi i buxhetit të vitit 2020

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij.

Tabela 8. Zbatimi i buxhetit viti 2020

Në mijë lekë

Art	Struktura Buxhetore	Fakt 2019	Plan 2020	Ndrysh. të vitit	Dhjetor 2020 MB	Plani i rishik 2020	Realiz 2020	Dif	Në %
600	Paga dhe shtesa	6,604	8,674	-	685	9,359	8,219	(1,140)	87.8
601	Sig.shoq.shëndet.	1,059	1,726	-	120	1,846	1,329	(517)	72
602	Blerje mallra shërb	11,303	6,100	85	2,268	8,453	3,369	(5,084)	39.9
231	Shpenz për inve	-	-	-	-	-	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	18,966	16,500	85	3,073	19,658	12,917		65.7

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

*-Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600)* janë çelur për vitin 2020, në vlerën 8,674 mijë lekë, nga 6,604 mijë lekë realizuar një vit më parë apo 31.3% më shumë; Në dhjetor të vitit 2020 me kalimin në varësi të Ministrisë së Brendshme i është akorduar shtesë fondi në vlerën 685 mijë lekë ose 8% krahasuar me planin; Janë realizuar në vlerën 8,219 mijë lekë, ose 12% më pak se plani dhe 24.5% më pak se realizimi i vitit 2020.

*-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601)* janë çelur në vlerën 1,726 mijë lekë nga 1,059 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 63% më shumë; Janë shtuar në vlerën 120 mijë lekë ose 10% krahasuar me planin; Realizuar në vlerën 1,236 mijë lekë, pra 35% më pak se plani i ndryshuar dhe 7% më pak se realizimi i një viti më parë.

*-Shpenzimet për blerje mallra e shërbime (artikulli 602)*, janë çelur në vlerën 6,100 mijë lekë nga 11,303 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 56% më pak; Janë shtuar gjatë vitit me 85 mijë lekë; Gjithashtu janë shtuar në muajin dhjetor me 2,268 mijë lekë ose me 37% krahasuar me planin; Janë realizuar në vlerën 3,369 mijë lekë, ose 60% më pak se plani i ndryshuar dhe 70% më pak se një vit më parë.

*-Shpenzime për investime (artikulli 231)*, nuk janë çelur për vitin 2020.

### Viti 2021

Në zbatim të legjislacionit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit dhe udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”, janë dërguar tavanet buxhetore për PBA 2021-2023. Me shkresën nr. 9136, datë 22.12.2020 është dërguar nga Ministria e Brendshme detajimi i buxhetit për vitet 2021-2023. Ndërkohë me shkresën nr. 13077/1 datë 10.08.2020 Ministria e Financave ka përcjellë tavanet sipas programeve buxhetore. Tavanet e vitit 2021 për këtë institucion janë miratuar:

*Paga e sigurime (600-601) për 10,400 mijë lekë;*

*Shpenzime korente (602-606) për 6,100 mijë lekë;*

*Shpenzime për investime (230-231) 0*

**-Programimi në fazën e I-rë të PBA 2021-2023** është dërguar me email duke mbajtur parasysht kërkesat buxhetore të Ministrisë së Financës në vlerën 16,500 mijë lekë.

**-Programimi në fazën e II-të të PBA 2021-2023** dhe projekt buxheti i vitit 2021 është dërguar me email në datë 26.08.2020, pra brenda afatit dhe në mbështetje të tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023.

Shpenzimet buxhetore për PBA 2021-2023, në të dyja fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2021, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 9. Shpenzimet buxhetore PBA 2021-2023**

Në mijë lekë

	Struktura Buxhetore	Realizimi i 2020	PBA Faza e parë 2021	PBA Faza e dytë 2021	Aprovimi i projekt buxhetit 2021
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	8,219	8,674	8,674	<b>8,674</b>
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,329	1,726	1,726	<b>1,726</b>
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	3,369	6,100	6,100	<b>6,100</b>
<b>231</b>	Shpenzime për investime	0	0	0	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>12,917</b>	<b>16,500</b>	<b>16,500</b>	<b>16,500</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit janë në vlerën 16,500 mijë lekë nga 12,917 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më shumë për 1,583 mijë lekë, ose 12.3% më shumë se realizimi i një viti më parë.

#### **Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2021**

Shuma e shpenzime korrente dhe shpenzime për investime, janë çelur këtë vit në vlerën 16,500 mijë lekë, të ndara për: a. Shpenzimet korrente (artikujt 600-606), me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr. 9136/8 datë 25.01.2021 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2021”, janë miratuar:

- Paga e shtesa (artikulli 600), gjithsej në vlerë 8,674 mijë lekë;
- Sigurime shoqërore (artikulli 601), në vlerë 1,726 mijë lekë;
- Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), në vlerë 6,100 mijë lekë;
- Shpenzimet për investime (artikulli 231), në vlerë zero lekë.

**Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime)** gjatë vitit 2021, kanë rezultuar në ulje për 2,000 mijë lekë në këto zëra të buxhetit:

- Paga e shtesa (artikulli 600), pakësuar për 900 mijë lekë
- Sigurime shoqërore (artikulli 601), shtuar për 184 mijë lekë
- Blerja mallra dhe shërbime (artikulli 602), pakësuar për 1,284 mijë lekë

#### **Zbatimi i buxhetit të vitit 2021**

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij.

**Tabela 10. Zbatimi i buxhetit viti 2021**

Në mijë lekë

Art	Struktura Buxhetore	Fakti viti 2020	Plani 2021	Ndryshime viti	Plani rishik 2021	Realizmi 2021	Dif	Në %
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	8,219	8,674	(900)	7,774	7,381	393	<b>95</b>
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,329	1,726	184	1,910	1,236	674	<b>64.7</b>
<b>602</b>	Blerje mallra shërb	3,369	6,100	(1,284)	4,816	3,134	1,682	<b>65</b>
<b>231</b>	Shpenzime për invest	-	-		-	-	-	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>12,917</b>	<b>16,500</b>	<b>(2,000)</b>	<b>14,500</b>	<b>11,751</b>	<b>2,749</b>	<b>81</b>

Burimi: Të dhënat e AAPSK-së, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-*Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600)* janë çelur për vitin 2021, në vlerën 8,674 mijë lekë, nga 8,219 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 6% më shumë; Janë pakësuar në vlerën 900 mijë lekë, pra 10.4% krahasuar se plani; Janë realizuar në vlerën 7,381 mijë lekë, ose 5% më pak se plani dhe 10% më pak se realizimi i vitit 2020.

-*Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601)* janë çelur në vlerën 1,726 mijë lekë nga 1,329 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 30% më shumë; Janë shtuar në

vlerën 184 mijë lekë ose 10% krahasuar me planin; Realizuar në vlerën 1,236 mijë lekë, pra 35% më pak se plani i ndryshuar dhe 7% më pak se realizimi i një viti më parë.

*-Shpenzimet për blerje mallra e shërbime (artikulli 602)*, janë çelur në vlerën 6,100 mijë lekë nga 3,369 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 56 % më pak; Janë shtuar gjatë vitit me 85 mijë lekë; Gjithashtu janë shtuar në muajin dhjetor me 2,268 mijë lekë ose me 37% krahasuar me planin; Janë realizuar në vlerën 3,369 mijë lekë, ose 60% më pak se plani i ndryshuar dhe 70% më pak se një vit më parë.

*-Shpenzime për investime (artikulli 231)*, nuk janë çelur për vitin 2020.

## Viti 2022

Në zbatim të legjisllacionit të mësipërm dhe udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, janë dërguar tavanet buxhetore për PBA 2022-2024. Tavanet e vitit 2022 për këtë institucion janë miratuar:

Paga e sigurime (600-601) për 15,341 mijë lekë;

Shpenzime korente (602-606) për 6,100 mijë lekë;

Shpenzime për investime (230-231) për zero lekë.

**-Programimi në fazën e I-rë të PBA 2022-2024** është bërë duke mbajtur parasysh limitin e përcaktuar nga Ministria e Brendshme për përcjelljen e kërkesave buxhetore në vlerën 21,441 mijë lekë.

**-Programimi në fazën e II-të të PBA 2022-2024** dhe projekt buxheti i vitit 2022, është bërë në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Brendshme nr. 6132/2 datë 23.09.2021 “Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Shpenzimet buxhetore për PBA 2022-2024, në të dyja fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2022, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 11. Shpenzimet buxhetore PBA 2022-2024*

*Në mijë lekë*

	Struktura Buxhetore	Realizimi i 2021	PBA Faza e parë 2022	PBA Faza e dytë 2022	Aprovimi i projekt buxhetit 2022
<b>600</b>	Paga dhe shtesa	7,381	13,146	13,146	13,146
<b>601</b>	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,236	2,195	2,195	2,195
<b>602</b>	Blerje mallra dhe shërbime	3,134	6,100	6,100	6,100
<b>231</b>	Shpenzime për investime	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>11,751</b>	<b>21,441</b>	<b>21,441</b>	<b>21,441</b>

*Burimi: Të dhënat e institucionit përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit është në vlerën 21,441 mijë lekë, nga 11,751 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më shumë për 9,690 mijë lekë, ose 82,5% më shumë se realizimi i një viti më parë. Evidentohet se planifikimi në fazën e parë është gati dyfishi i planifikimit të vitit paraardhës, duke akorduar fonde shtesë të paargumentuar, konstatim i cili mbështetet nga ndryshimi përgjatë vitit dhe nga realizimi përfundimtar.

## Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2022

Shuma e shpenzime korrente dhe shpenzime për investime, janë çelur këtë vit në vlerën 21,441 mijë lekë, të ndara për:

a. Shpenzimet korrente (artikujt 600-606), me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr. 10084/4 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2022”, në vlerë 21,441 mijë lekë, të ndara me artikuj:

*-Paga e shtesa (artikulli 600)*, gjithsej në vlerë 13,146 mijë lekë;

*-Sigurime shoqërore (artikulli 601)*, në vlerë 2,195 mijë lekë;

*-Blerje mallra e shërbime (artikulli 602)*, në vlerë 6,100 mijë lekë;

b. Shpenzimet për investime (artikulli 231), zero lekë.

**Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime)** gjatë vitit 2022, kanë rezultuar në këto zëra të buxhetit:

*-Paga dhe shtesa (artikulli 600)*, pakësuar për 3,000 lekë

-Blerja mallra dhe shërbime (artikulli 602), shtuar me 160 mijë lekë

### Zbatimi i buxhetit të vitit 2022

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij gjatë vitit dhe realizimi për vitin 2022, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12. Zbatimi i buxhetit viti 2022

Në mijë lekë

	Struktura Buxhetore	Fakti viti 2021	Plani 2022	Ndryshimet gjatë vitit	Plani rishik 2022	Realizmi 2022	Dif	Në %
600	Paga dhe shtesa	7,381	13,146	(3,000)	10,146	10,135	11	99.9
601	Sig.shoq.dhe shëndet.	1,236	2,195	-	2,195	1,690	505	76.9
602	Blerje mallra dhe shërbime	3,134	6,150	160	6,310	6,241	69	98.9
231	Shpenzime për investime	-	-	-	-	-	-	0
	<b>TOTALI</b>	<b>11,751</b>	<b>21,491</b>	<b>(2,840)</b>	<b>18,651</b>	<b>18,066</b>	<b>585</b>	<b>96.9</b>

Burimi: Të dhënat e institucionit përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600) janë çelur në vlerën 13,146 mijë lekë, nga 7,381 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 78% më pak; Janë pakësuar gjatë vitit me 3,000 mijë lekë ose 22.8% krahasuar me planin; Janë realizuar në vlerë 10,135 mijë lekë, pra 11 mijë lekë më pak se plani dhe 37,3% më pak se një vit më parë.

- Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601) janë çelur në vlerën 2,195 mijë lekë nga 1,236 mijë lekë realizuar një vit më parë apo 77,6% më shumë; Janë realizuar në vlerën 1,690 mijë lekë, pra 23% më pak se plani fillestar dhe 36,7% më pak se realizimi i një viti më parë.

Për sa më sipër konstatohet se nga ana e AAPSK-së rishikimet janë bërë vetëm për llogarinë 600, pa i reflektuar këto rishikime dhe në llogarinë 601, si llogari që ecin në përpjestim të drejtë me njëra tjetrën.

- Shpenzimet për blerje mallra e shërbime (artikulli 602) janë çelur në vlerën 6,150 mijë lekë nga 3,134 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 96,2 % më shumë; Janë shtuar gjatë vitit me 160 mijë lekë ose 2,6% më shumë se plani fillestar; Janë realizuar në vlerën 6,241 mijë lekë, ose 1,1% më pak se plani i ndryshuar dhe 99% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

-Shpenzime për investime (artikulli 231), nuk janë çelur për vitin 2022.

### Monitorimi i Buxhetit

Sa i përket monitorimit të buxhetit për të gjitha vitet objekt auditimi 2017-2022 evidentohet e njëjta problematikë. Paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, specifikisht sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Vërejmë që të dhënat e raportuara në raportin e këtij institucioni për vitet 2017-2022, nuk janë raporte monitorimi sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim. Raporti i monitorimit të këtyre viteve ka të plotësuar tabelat e raportimit sipas anekseve, *por jo relacionin shpjegues*, ku mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit. Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës, si në udhëzimin e mësipërm është e rëndësishme edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arrijtjet edhe problematikat.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mangësi në planifikimin e buxhetit për vitin 2022 dhe hartimi i raportit të monitorimit jo në përputhje me udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit u konstatua se për vitet 2017-2022 raporti i monitorimit të buxhetit nuk është shoqëruar me relacionin e tij dhe mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit, duke mos mundur një

	<p>paraqitje të mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performances.</p> <p>Raportet e monitorimit të buxhetit janë përgatitur jo në përputhje me formatet e përcaktuara në paragrafin 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.</p> <p>Nga auditimi i planifikimit të buxhetit u konstatuan mangësi, për periudhën objekt auditimi viti 2022, të lidhura kryesisht me fazën e parë, gjatë së cilës planifikimi rezultoi pothuajse sa dyfishi i planifikimit të vitit paraardhës, duke akorduar fonde shtesë të paargumentuar. Ky konstatim mbështetet dhe nga ndryshimi përgjatë vitit dhe nga realizimi përfundimtar, konkretisht:</p> <p><i>-Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600)</i> janë çelur në vlerën 13,146 mijë lekë, nga 7,381 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 78% më pak; Janë pakësuar gjatë vitit me 3,000 mijë lekë ose 22.8% krahasuar me planin;</p> <p>Janë realizuar në vlerë 10,135 mijë lekë, pra 11 mijë lekë më pak se plani dhe 37,3% më pak se një vit më parë.</p> <p><i>-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601)</i> janë çelur në vlerën 2,195 mijë lekë nga 1,236 mijë lekë realizuar një vit më parë apo 77,6% më shumë;</p> <p>Janë realizuar në vlerën 1,690 mijë lekë, pra 23% më pak se plani fillestar dhe 36,7% më pak se realizimi i një viti më parë.</p> <p>Për sa më sipër konstatohet se nga ana e AAPSK-së rishikimet janë bërë vetëm për llogarinë 600, pa i reflektuar këto rishikime dhe në llogarinë 601, si llogari që ecin në përpjesëtim të drejtë me njëra tjetrën.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, paragrafi 49.
<b>Impakti:</b>	<p>Nuk mundësohet një paraqitje e qartë e lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës.</p> <p>Mungesa e një planifikimi jo të argumentuar sjell akordimin e fondeve shtesë të panevojshme dhe rishikimin e tyre përgjatë vitit.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatimi i udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”</p> <p>Planifikim jo i kujdesshëm nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.</p>
<b>Rëndësia:</b>	E ulët
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AAPSK, të merren masa:</p> <p>-për hartimin e raporteve të monitorimit, shoqëruar me relacionet shpjeguese në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, me qëllim përmirësimin e evidentimit të përdorimit të fondeve buxhetore.</p> <p>-për planifikimin dhe përgatitjen e kërkesave buxhetore në përputhje me nevojat e Institucionit.</p>

### 2.3.2 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit

#### Viti 2017

Me shkresën nr. 104 prot., datë 19.01.2017, të Autoritetit Kontraktor, “Dërgohen parashikimet për prokurimet publike për vitin 2017”, drejtuar Degës së Thesarit është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korrente për procedurat me burim financiar buxhetin e shtetit dhe të ardhurat e AAPSK-së.

Në regjistër janë të përcaktuara objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet e financimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 si dhe Udhëzimeve të APP-së.

Regjistri i parashikimeve publike për vitin 2017, është hartuar me vonesë, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 4, pika 1 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet “Brenda datës 15 janar të çdo viti, titullari i autoritetit kontraktor miraton dhe dërgon një kopje të regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik në APP ose në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë. Si dhe me Kreun I, pika 2, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.01.2015, të APP “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik” ku citohet “Autoriteti kontraktor, pasi ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik, në rast se është organ varësie, e dërgon atë brenda datës 15 janar të çdo viti pranë institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore.”

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2017 ka nxjerrë Urdhër të Brendshëm nr. 3 datë 04.01.2017, “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël”, të përbërë nga: z. M.H. në cilësinë e Kryetarit, z. Q.Th. në cilësinë e anëtarit dhe z. S.Sh. në cilësinë e anëtarit.

#### Përputhshmëria ligjore në realizimin e prokurimit të fondeve nga Autoriteti Kontraktor për periudhën 01.10.2017 deri 31.12.2017

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vazhdim AK), AASPK, për periudhën Tetor-Dhjetor të vitit 2017 janë kryer 3 procedura prokurimi, me vlerë 428,332 lekë, të gjitha Blerje me vlerë të vogël. Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, nga 3 procedura janë përzgjedhur 2 procedura, që zënë 83.4% të totalit si fond.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

Tabela nr. 13 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	Operatori Ekonomik fitues	Data e Publikimit
1	Blerje Karburanti	137,500	Blerje Vlerë të Vogël	129,000	30/10/2017	A. D.	27/10/2017
2	Blerje toner për printer	219,832	Blerje Vlerë të Vogël	173,660	05/12/2017	I. O.	01/12/2017 08

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga komisioni i prokurimeve, konstatohet:

#### 1- Procedura e prokurimit “Blerje Karburanti”

Urdhër prokurimi nr. 877/2, datë 26.10.2017	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H z. Q.Th z. S.Sh (sipas Urdhër i Brendshëm nr 3. prot., datë 04.01.2017)	-Fitues: OE “A. D.” -Vlera fituese 129,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 21, datë 31.10.2017 me vlerë 129,000 lekë pa TVSH
Fondi limit 137,500 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “A. D.”	-Diferenca nga fondi limit 8,500 lekë
Data e hapjes së tenderit 30.10.2017	Marrin pjesë 3 OE S’ kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – A.K

## 2- Procedura e prokurimit “Blerje Toner për Printer”

Urdhër prokurimi nr. 1045, datë 30.11.2017	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H z. Q.Th z. S.Sh (sipas Urdhër i Brendshëm nr 3. prot., datë 04.01.2017)	-Fitues: OE “I. O. SHPK” -Vlera fituese 173,660 lekë -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 228932407 datë 18.12.2017 me vlerë 173,660 lekë pa tvsh
Fondi limit 219,832 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “I. O. SHPK”	-Diferenca nga fondi limit 46,172 lekë
Datë e hapjes së tenderit 05.12.2017	Marrin pjesë 20 OE S’kualifikuar 2 OE	Titullar i AK – A.K

Në lidhje me procedurat e audituara u evidentua se dosjet e procedurave ishin arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të procedurës së prokurimit “Blerje Karburanti” është mbajtur procesverbal, ku përlllogaritjet janë bazuar në VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59, pika 2, gërma a) “Çmimet e tregut”, veprim në përputhje me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pikat 1 dhe 2 dhe Udhëzimin e APP nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, pika 2.

Për procedurën e prokurimit “Blerje Toner për Printer” evidentohet mangësi në përlllogaritjen dhe argumentimin e fondit limit, duke qenë se rezulton fond limit dukshëm më i lartë se vlera e kontratës.

### Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 5 operatorë ekonomikë, ku nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është vepruar sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, pika 5 “Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik” dhe Udhëzimin e APP nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, pika 3.

### Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit “Blerje karburanti” u konstatua se kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë vetëm çmimi.

Në përfundim janë renditur:

- 1) A. D. me vlerë 129,000 lekë
- 2) A.T. me vlerë 129,166 lekë
- 3) D. J. me vlerë 137,000 lekë.

Fitues është shpallur operatori ekonomik me ofertën më të ulët, A. D..

Në procedurën e prokurimit “Blerje Toner për Printer” u konstatua se kanë marrë pjesë 20 operatorë ekonomik, nga të cilët janë skualifikuar 2 operatorë ekonomik. Fitues është shpallur “4. T. A.” me vlerën e ofertës më të ulët 117,590 lekë pa tvsh. Ky operator është tërhequr nga tenderi në datë 06.12.2017. Fitues përfundimtar është shpallur OE “I. O.” SHPK me vlerë 173,660 lekë pa tvsh.

### Zbatimi i kontratës

Përsa më sipër, nga ana e subjektit “A. D.” SHPK me NIPT L....V është lëshuar fatura tatimore nr. 21, datë 31.10.2017 në vlerën 129,000 lekë pa tvsh. Bashkëlidhur dosjes fletëhyrja në magazinë nr. 2 datë 31.10.2017 për marrjen në dorëzim të mallit.

Nga ana e subjektit “I. O.” SHPK me NIPT K....K është lëshuar fatura tatimore nr. 228932407 datë 18.12.2017 në vlerën 173,660 lekë pa tvsh. Bashkëlidhur dosjes fletëhyrja nr. 3 datë 18.12.2017 për marrjen në dorëzim të mallit.



## Viti 2018

Me shkresën nr. 445 prot, datë 27.04.2018, të AK, “Dërgohet regjistri i parashikimeve të prokurimit publik viti 2018”, drejtuar degës së Thesarit është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korrente për procedurat me burim financimi buxhetin e shtetit dhe fonde të tjera.

Në regjister janë të përcaktuara objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Udhëzimeve të APP-së.

Regjistri i parashikimeve publike për vitin 2018, është hartuar me vonesë, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 4, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP.

Për vitin 2018 janë realizuar 9 procedura prokurimi me fond limit 31,216,332 lekë. Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, u përcaktuan për t’u audituar procedurat sipas Tabelës nr. 14.

Nga 9 procedura janë përzgjedhur 2 procedura, që zënë 96% të totalit si fond.

Tabela nr. 14 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	Operatori Ekonomik fitues	Data e Publikimit
1	Blerje e shërbimit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme	780,000	Blerje vlerë e vogël	402,000	13.03.2018	T.	12.03.2018
2	Ruajtja fizike e pasurive të sekuestruara me shërbim roje	29,159,265	E hapur	29,159,265	13.04.2018	G. S. SHPK	21.03.2018

## Procedura 1 - Procedura e prokurimit “Blerje e shërbimit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme”

Urdhër prokurimi nr. 284, datë 09.03.2018	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 01 prot., datë 03.01.2018)	-Fitues: OE “T.” -Vlera fituese 402,000 lekë pa TVSH -Vlera e kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 41748692, datë 05.04.2018 me vlerë 402,000 lekë pa TVSH
Fondi limit 780,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “T.”	-Diferenca nga fondi limit 378,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 10.03.2018	Marrin pjesë 7 OE S’kualifikuar 2 OE	Titullar i AK – A.K

## Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

## Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbal datë 08.03.2018, ku përlllogaritja është bazuar në urdhrin nr. 71, datë 23.02.2018 “Për shitjen e pasurive të konfiskuara në kuadër të masave kundër krimit të organizuar” dhe në VKM-në nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, pika 4, paragrafi i dytë: *Pagesa e ekspertit do të jetë 2% e vlerës së objektit apo të grup-objekteve të vlerësuara, por jo më pak se 60,000 lekë dhe jo më shumë se 300,000 lekë me TVSH. Sipas urdhërit nr. 71 përfshihen 13 pasuri të paluajtshme të konfiskuara.*

## Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 5 operatorë ekonomikë, ku nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është vepruar sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, pika 5.

## Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomikë, prej të cilëve janë skualifikuar 2, për arsye se nuk kishin të përfshirë si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e kërkuar në procedurën e prokurimit. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë vetëm çmimi. Subjekt fitues u shpall operatori “T.” me vlerën e ofertës më të ulët 402,000 lekë pa TVSH.

## Zbatimi i kontratës

Përsa më sipër, nga subjekti “T.” me NIPT J.....L është lëshuar fatura tatimore nr. 41748692 datë 05.04.2018 e lëshuar nga në vlerën 402,000 lekë me tvsh.

## Procedura 2 - Procedura e prokurimit “Ruajtja fizike e pasurive të sekuestruara me shërbim roje”

Urdhër prokurimi nr. 304, datë 12.03.2018	<b>Komisioni i Prokurimit procedurë e hapur</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. E. D Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 273 prot., datë 06.03.2018)	-Fitues: OE “G. SHPK” -Vlera fituese 29,159,265 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 455, datë 02.05.2018 me vlerë 29,159,265 lekë pa TVSH
Fondi limit 29,159,265 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – e hapur		
Burimi i Financimit: Buxheti i AAPSK	Fitues: OE “G. SHPK”	-Diferenca nga fondi limit 0 lekë
Datë e hapjes së tenderit: 13.04.2018	Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 3 OE	Titullar i AK – A.K

## Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

## Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbali me shkresën nr. 273/1 prot., datë 09.03.2018, ku përlllogaritja është bazuar duke marrë parasysh shpenzimet dhe kostot ligjore të parashikuara në legjislacionin mbi SHPSF, si dhe rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe KPP-së datë 20.12.2017. Është marrë parasysh paga bazë, shtesa mbi pagë, sigurimet shoqërore, numri i rojeve për 1 vend-roje etj.

**Përcaktimi i kriterëve kualifikuese:** Kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe specifikimet teknike, hartimi dhe miratimi i DT.

Sipas të dhënave në sistemin e prokurimit elektronik, nga AK janë hedhur DT, ku pjesë përbërëse janë:

- Kriteret e përgjithshme;
- Kriteret e veçanta (kapaciteti ekonomik, financiar dhe kapaciteti teknik)
- Termet e referencës
- Kushtet dhe termet e kontratës
- Shtojcat, etj.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese është bërë në përputhje me llojin dhe madhësinë e objektit të prokurimit. Konkretisht:

- Kriteret e përgjithshme, sipas VKM-së nr. 194/2014, neni 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” dhe neni 16 “Deklarimi i konfliktit të interesit”
- Kapaciteti financiar: Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit të ketë një vlerë sa 40 % e fondit limit të Marrëveshjes Kuadër; Bilancet e tre viteve të fundit;
- Kapaciteti teknik profesional: Licencë e shoqërisë për “Shërbimin e ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”; certifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit; certifikata për punonjës shërbimi

për të paktën 70 punonjës shërbimi; Numri mesatar vjetor i punonjësve jo më pak se 70 persona; Të jetë i pajisur me Autorizim Individual radiokomunikimi me mbulim në të gjithë territorin e vendit; Të disponojë 8 salla operative për kontrollin e shërbimeve, të vërtetuara nga 8 Drejtori të Policisë së Qarqeve dhe Akt Miratimet e Sallave operative; Të disponojë së paku 8 automjete për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi ose më qira; Të disponojë jo më pak se 8 armë të shkurtra (B1), e vërtetuar me kontratë ose faturë blerje.

-Specifikimet teknike, janë vendosur në përputhje me nenin 23 “Specifikimet teknike”, pika 1, data 09.03.2018 “Për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Për ruajtjen fizike të pasurive në administrim të AAPSK”.

### Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë, konkretisht G. S. SHPK, A. sha, B. 2., A. P. 1. Nga këta OE 2 janë skualifikuar pasi pasur mungesë dokumentacioni dhe 1 OE nuk përmbushte të gjitha kriteret e përcaktuara në DST (Nën minimumin ligjor të këtij shërbimi, nuk ka autorizim individual radiokomunikimi për të gjithë territorin e vendit).

Subjekt fitues u shpall operatori G. S. SHPK me vlerën e ofertës 29,159,265 lekë pa TVSH.

### Zbatimi i kontratës

Është lidhur kontrata e shërbimit nr. 455 datë 02.05.2018 midis operatorit fitues dhe agjencisë.

### Viti 2019

Me shkresën nr. 43 prot., datë 17.01.2019, të Agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, “Dërgohet regjistri i realizimit të prokurimeve publike të vitit 2018 dhe parashikimit të prokurimeve për vitin 2019”, drejtuar Ministrisë së Financave është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korente për procedura me burim financimi buxhetin e shtetit dhe të ardhurat e agjencisë.

Regjistri i parashikimeve publike për vitin 2019, është dërguar me vonesë, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 4, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP.

Për vitin 2019 janë realizuar 7 procedura prokurimi me fond limit 917,420 lekë. Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, u përcaktuan për t’u audituar procedurat sipas Tabelës nr. 15.

Nga 7 procedura janë përzgjedhur 3 procedura, që zënë 60% të fondit.

Tabela nr. 15 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	Operatori Ekonomik fitues	Data e Publikimit
1	Blerje Kancelarie	99,016	Blerje e vogël	65,000	20/03/2019	I. S.	19/03/2019
2	Shërbim mirëmbajtje dhe riparim autoveture	292,200	Blerje e vogël	199,000	05/04/2019	B. L.	04/04/2019
3	Pjesë këmbimi dhe shërbim riparimi	162,400	Blerje e vogël	160,000	30/10/2019	B. L.	01/11/2019

### Procedura 1 - Procedura e prokurimit “Blerje kancelarie”

Urdhër prokurimi nr. 234/1, datë 18.03.2019	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar	-Fitues: OE “I. S.” -Vlera fituese 65,000 lekë pa TVSH
Fondi limit 99,016 lekë (pa TVSH)	z. Q.Th Anëtar	-Vlera kontratës ose faturës:
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël	z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 07 prot., datë 07.01.2019)	Fatura tatimore nr. 101 datë 25.03.2019 me vlerë 65,000 lekë pa TVSH ose 78,000 me TVSH
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “I. S.”	-Diferenca nga fondi limit 34,016 lekë
Datë e hapjes së tenderit 20.03.2019	Marrin pjesë 16 OE S kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – A.K

### Procedura 2 - Procedura e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje dhe riparim autoveture”

Urdhër prokurimi nr. 300/1, datë 02.04.2019	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar	-Fitues: OE “B. L.” -Vlera fituese 199,000 lekë pa TVSH
---	---	--

Fondi limit 292,200 lekë (pa TVSH)	z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 07 prot., datë 07.01.2019)	-Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 74 datë 16.04.2019 me vlerë 199,000 lekë pa TVSH ose 238,800 me TVSH
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “B.L.”	-Diferenca nga fondi limit 93,010 lekë
Datë e hapjes së tenderit 05.04.2019	Marrin pjesë 8 OE S kualifikuar 3 OE	Titullar i AK – A.K

### Procedura 3 - Procedura e prokurimit “Pjesë këmbimi dhe shërbim riparimi”

Urdhër prokurimi nr. 1052, datë 25.10.2019	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 07 prot., datë 07.01.2019)	-Fitues: OE “B.L.” -Vlera fituese 160,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 173 datë 11.11.2019 me vlerë 160,000 lekë pa TVSH ose 192,000 me TVSH
Fondi limit 162,400 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “B. L.”	-Diferenca nga fondi limit 2,400 lekë
Datë e hapjes së tenderit 30.10.2019	Marrin pjesë 8 OE S kualifikuar 6 OE	Titullar i AK – A.K

### Dosja e Tenderit

Për procedurat e audituara evidentohet se dosjet e procedurave nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratave janë mbajtur procesverbale, ku përlllogaritja është bazuar në VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59, pika 2, germa a) “Çmimet e tregut” Pra ky veprim është në përputhje me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pikat 1 dhe 2 dhe Udhëzimin e APP nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, pika 2.

### Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratave janë administruar ofertat nga 5 operatorë ekonomikë, ku nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është vepruar sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, pika 5 dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar pika 5.

### Vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave

-Në procedurën e prokurimit “Blerje kancelarie” u konstatua se kanë marrë pjesë 16 operatorë ekonomikë dhe nuk ka pasur të skualifikuar. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë vetëm çmimi. Subjekti “I. S.” operatori me vlerën më të ulët u shpall fitues me vlerë 65,000 lekë pa Tvsh. Nga subjekti “I. S.” SHPK me NIPT K.....L është lëshuar fatura tatimore nr. 101 datë 25.03.2019 në vlerën 65,000 lekë pa tvsh. Bashkëlidhur në dosje fletëhyrja nr. 2 datë 25.03.2019.

-Në procedurën e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje dhe riparim autoveture” u konstatua se kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë, prej të cilëve 3 OE janë skualifikuar për shkak se nuk e kanë të plotësuar në ekstrakt objektin e prokurimit (mosplotësim i kritereve). Sistemi ka shpallur fitues operatorin ekonomik “B. M.” me ofertën më të ulët me vlerë 97,000 lekë pa TVSH. Ky operator është tërhequr nga procedura me arsyetimin se ka llogaritur gabim ofertën. Bashkangjitur në dosje gjendet proces-verbali i tërheqjes nga tenderi dhe rishpallje fituesi i datës 08.04.2019. Fitues u shpall OE “N.” i dyti në rradhë me ofertë me vlerë 170,000 lekë pa TVSh. Ky operator nuk u paraqit në datën 09.04.2019 dhe u skualifikua nga procedura. Fitues

u shpall OE” B. L.” me ofertë me vlerë 199,000 lekë pa Tvsh. Nga subjekti “B. L.” SHPK me NIPT K.....R është lëshuar fatura tatimore nr. 74 datë 16.04.2019 në vlerën 238,800 lekë me tvsh.

-Në procedurën e prokurimit “Pjesë këmbimi dhe shërbim riparimi” u konstatua se kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë, prej të cilëve janë skualifikuar 6 për shkak se nuk e kanë të plotësuar në ekstrakt objektin e prokurimit (mosplotësim i kriterëve). Sistemi ka shpallur fitues operatorin ekonomik “B. M.” me ofertën më të ulët me vlerë 148,900 lekë pa TVSH. Ky operator nuk u paraqit në datën 30.10.2019 dhe komisioni shpalli fitues operatorin “B. L.” me ofertën me vlerë 160,000 lekë pa tvsh. Bashkangjitur proces-verbali i tërheqjes nga tenderi dhe rishpallje fituesi i datës 31.10.2019. Nga subjekti “B. L.” SHPK me NIPT K.....R është lëshuar fatura tatimore nr. 173 datë 11.11.2019 në vlerën 192,000 lekë me tvsh.

## Viti 2020

Me shkresën nr. 58 prot., datë 13.01.2020, të Agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, “Dërgohet regjistri i planifikimit të prokurimit publik viti 2020”, drejtuar Ministrisë së Financave është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, me burim financimi buxhetin e shtetit dhe të ardhurat e agjencisë. Regjistri i parashikimeve publike për vitin 2020, është hartuar në përputhje me nenin 4, pika 1, VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP-së.

Për vitin 2020 janë realizuar 9 procedura prokurimi me fond limit 36,589,090 lekë pa Tvsh. Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, u përcaktuan për t’u audituar procedurat sipas Tabelës nr. 16.

Nga 9 procedura janë përzgjedhur 3 procedura, që zënë 96% të vlerës së fondit.

Tabela nr. 16 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	Operatori Ekonomik fitues	Data e Publikimit
1	Blerje Karburanti	800,000	Blerje e vogël	722,925	14.02.2020	G. C. G.	12.02.2020
2	Ruajtja fizike e pasurive të sekuestruara e shërbim roje	2,632,433	Me negocim, pa njoftim	2,632,431	12.05.2020	G. s. SHPK	08.05.2020
3	Shërbim i ruajtjes së sigurisë fizike të pasurive të sekuestruara	31,589,194	E hapur	31,589,184	02.06.2020	G. s. SHPK	29.04.2020

## Procedura 1 - Procedura e prokurimit “Blerje Karburanti”

Urdhër prokurimi nr. 160, datë 10.02.2020	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 52 prot., datë 13.01.2020)	-Fitues: OE “G. C. G.” -Vlera fituese 722,925lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 232 dhe 233 datë 18.02.2020 me vlerë respektive 349,987 lekë dhe 372,938 lekë pa TVSH
Fondi limit 800,000 lekë (pa TVSH) Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “G. C. G.”	-Diferenca nga fondi limit 77,075 lekë
Datë e hapjes së tenderit 14.02.2020	Marrin pjesë 7 OE Skualifikuar 1 OE	Titullar i AK – A.K

## Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

## Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbal datë 10.02.2020, ku përllogaritja është bazuar në VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59, pika 2, germa a) “Çmimet e tregut” të marra në datën

10.02.2020 në 3 karburante në qytetin e Tiranës, veprim në përputhje me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar.

### **Ftesa për ofertë**

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 7 operatorë ekonomikë, ku nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është vepruar sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, pika 5.

### **Vlerësimi i ofertave**

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomikë dhe 1 prej tyre është skualifikuar duke qenë se nuk e ka pasur të plotësuar në ekstrakt objektin e prokurimit (mosplotësimi i kriterëve). Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë vetëm çmimi. Sistemi përzgjodhi fitues dy operatorë ekonomikë me të njëjtën ofertë ekonomike 722,925 lekë pa TVSH. Procedura e përzgjedhjes së fituesit u realizua me short dhe fitoi OE “G. C. G.”.

### **Zbatimi i kontratës**

Përsa më sipër, nga subjekti “G. C. G.” SHPK me NIPT K.....T janë lëshuar faturat tatimore nr. 232 dhe 233 datë 18.02.2020 me vlerat respektive 349,987 lekë dhe 372,938 lekë pa TVSH. Fatura nr. 232 është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 25 datë 24.02.2020 dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. Gjithashtu fatura nr. 233 është likuiduar nga llogaria rrjedhëse e AAPSK me urdhër transfertën datë 24.02.2020. Bashkëlidhur fletëhyrjet nr. 1 dhe 2 datë 18.02.2020.

### **Procedura 2**

Procedura e prokurimit “Ruajtja fizike e pasurive të sekuestruara me shërbim roje”.

Sipas dokumenteve dhe në urdhrin e prokurimit nr. 640 datë 04.05.2020 është specifikuar se është përdorur kjo procedurë prokurimi pasi në regjistrin e parashikimeve të vitit 2020 ishte miratuar fondi limit në vlerën 35,000,000 lekë dhe procedura do të zhvillohej në muajin Prill 2020. APP nuk e ka miratuar procedurën, mbështetur në VKM nr. 177, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë “I. G.” sha, pasi AK ka detyrim ligjor që t’i paraqesë kërkesë kësaj shoqërie për përfitimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurimit. Shoqëria “I. G.” mund të ofrojë shërbimin nisur nga data 28.09.2020, si rrjedhojë dhe për periudhën e mbetur pa mbulim me roje është zhvilluar procedura me negocim pa shpallje.

Urdhër prokurimi nr. 640, datë 04.05.2020	<b>Komisioni i Prokurimit me Negocim, pa njoftim</b> z. S.Sh Kryetar z. E.T Anëtar z. M.H Anëtar (sipas Urdhër prokurimit nr. 640 prot., datë 04.05.2020)	-Fitues: BOE “G. S. SHPK” & “A. S. SHPK” -Vlera fituese 2,632,433 lekë pa TVSH
Fondi limit 2,632,433 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – Me negocim, pa njoftim		
Burimi i Financimit: buxheti i AAPSK	Fitues: BOE “G. S. SHPK” & “A. S. SHPK”	-Diferenca nga fondi limit 0 lekë
Datë e hapjes së tenderit 12.05.2020	Marrin pjesë 1 OE Skualifikuar 0 OE	Titullar i AK – A.K

### **Dosja e Tenderit**

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

### **Argumentimi i fondit limit**

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbal me shkresën nr. 622, prot., datë 04.05.2020, ku përlllogaritja është bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik” dhe nenet 9 dhe 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”. Është marrë parasysh kontrata e mëparshme e vitit 2018 në përputhje me germën b të nenit 59 të VKM-së 914/2014. Është bërë një përlllogaritje e kostos

për shërbimin e ruajtjes me roje 24/7 për 2 muaj, referuar VKM-ve përkatëse për pagën minimale, shtesa mbi pagë dhe sigurimet shoqërore. Pra ky veprim është në përputhje me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018 “*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*” i ndryshuar.

**Përcaktimi i kriterëve kualifikuese:** Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, specififikimet teknike, hartimi dhe miratimi i DT.

Sipas të dhënave në SPE, nga AK janë hedhur DT, ku pjesë përbërëse janë:

- Kriteret e përgjithshme;
- Kriteret e veçanta (kapaciteti ekonomik financiar dhe kapaciteti teknik)
- Termet e referencës
- Kushtet dhe termet e kontratës
- Shtojcat, etj.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese është bërë në përputhje me llojin dhe madhësinë e objektit të prokurimit. Konkretisht:

-Kriteret e përgjithshme, sipas VKM nr. 194/2014, neni 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” dhe neni 16 “Deklarimi i konfliktit të interesit”

-Kapaciteti financiar: Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit, të ketë një vlerë sa 40 % e fondit limit të Marrëveshjes Kuadër;

-Kapaciteti teknik profesional: Numri mesatar vjetor i punonjësve jo më pak se 25 persona; Të jetë i pajisur me Autorizim Individual radiokomunikimi me mbulim në 4 qarqet e vendit; Të disponojë 4 salla operative për kontrollin e shërbimeve, të vërtetuara nga 4 Drejtori të Policisë së Qarqeve dhe Akt Miratimet e Sallave operative; Të disponojë së paku 4 automjete për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi ose më qira; Të disponojë jo më pak se 5 armë të shkurtra (B1), e vërtetuar me kontratë ose faturë blerje; Kontratë e punës me mjekun, licenca e mjekut; 1 inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni/Elektronik (diplomë, kontratë pune).

-Specifikimet teknike, janë vendosur në përputhje me nenin 23 “Specifikimet teknike”, pika 1, si dhe janë dokumentuar në procesverbalin e mbajtur me shkresën nr. 622 datë 04.05.2020 “Për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe llogaritjen e fondit limit për shërbimin “Blerje e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të pasurive të sek/konf, në administrim të AAPSK”.

#### **Ftesa për ofertë**

Nga auditimi u konstatua se njësia e prokurimit vendosi t’u dërgojë ftesë për pjesëmarrje 3 kandidatëve: I. S. A., K. S., G.S. SHPK.

#### **Vlerësimi i ofertave**

Në procedurën e prokurimit u konstatua se ka marrë pjesë vetëm një BOE me pjesëmarrës OE “G. S. SHPK” & “A. S. SHPK”. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë çmimi i ofertës ekonomike më e favorshme. Ka rezultuar se ky BOE ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit, si ato të përgjithshme, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike, të përcaktuara në DT, në përputhje me ligjin nr. 9643/2006, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 ku cilësohet: “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*”.

Janë lidhur 5 kontrata shërbimi me objektet për të cilat është rënë dakord të ofrohet shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për pasuritë e sekuestruara.

#### **Zbatimi i kontratës**

Bashkangjitur në dosje gjendet monitorimi i likuidimeve të bëra për BOE “G. S.” & “A.”, në bazë të kontratave dhe faturave të lëshuara në vlerë totale 2,308,471,09 lekë pa tvsh.

**Procedura 3** - Procedura e prokurimit “Shërbim i ruajtjes së sigurisë fizike të pasurive të sekuestruara” .

Urdhër prokurimi nr. 576, datë 24.04.2020	<b>Komisioni i Prokurimit procedurë e hapur</b> z. S.Sh Kryetar z. E.T Anëtar z. M.H Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 573 prot., datë 23.04.2020)	-Fitues: OE "G. S. SHPK" -Vlera fituese 31,589,184 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës:
Fondi limit 31,589,194 lekë (pa TVSH) Procedura e prokurimit – e hapur		
Burimi i Financimit: Llogaria e administrimit të pasurive të sekuestruara / konfiskuara te ardhurat e veta	Fitues: BOE "G. S. SHPK", "A. S.", "N.-2000"	-Diferenca nga fondi limit 10 lekë
Datë e hapjes së tenderit 02.06.2020	Marrin pjesë 1 BOE Skualifikuar 0 OE	Titullar i AK – A.K

## Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 36 "Arkivat e numerizuara", të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik" "Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë".

Me anë të Urdhër Prokurimit nr. 576, datë 24.04.2020, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës "Shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes fizike të ndërtesës me roje private", me procedurë "Marrëveshje Kuadër 2 (dy) vjeçare - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj". Në dokumentet e tenderit janë dhënë arsyet e përzgjedhjes së kësaj procedurë prokurimi.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbal me shkresën nr. 574, prot., datë 23.04.2020, ku përlllogaritja është bazuar në shpenzimet dhe kostot ligjore të parashikuara në legjislacionin mbi SHPSF dhe në rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe KPP-së të datës 20.12.2017 sipas të cilit: "Llogaritja e koeficientit për 1 vendroje me shërbim 24/7 është përcaktuar 4.98 roje." Është bërë një përlllogaritje e kostos për shërbimin e ruajtjes me roje 24/7 për 24 muaj, referuar VKM-ve përkatëse për pagën minimale, shtesa mbi pagë dhe sigurimet shoqërore.

**Përcaktimi i kriterëve kualifikuese:** Kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe specifikimet teknike, hartimi dhe miratimi i DT.

Sipas të dhënave në SPE, nga AK janë hedhur DT, ku pjesë përbërëse janë:

- Kriteret e përgjithshme;
- Kriteret e veçanta (kapaciteti ekonomik financiar dhe kapaciteti teknik)
- Termet e referencës
- Kushtet dhe termat e kontratës
- Shtojcat, etj.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese është bërë në përputhje me llojin dhe madhësinë e objektit të prokurimit. Konkretisht:

-Kriteret e përgjithshme, sipas VKM nr. 194/2014, neni 15 "Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes" dhe neni 16 "Deklarimi i konfliktit të interesit"

-Kapaciteti financiar: Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit, të ketë një vlerë sa 40 % e fondit limit të Marrëveshjes Kuadër; Dorëzimi i bilanceve të tre viteve të fundit;

-Kapaciteti teknik profesional: Numri mesatar vjetor i punonjësve të siguruar për periudhën Dhjetor 2019, Janar - Shkurt 2020 jo më pak se 50 persona; Të jetë i pajisur me Autorizim Individual radiokomunikimi me mbulim në të gjitha qarqet e vendit; Të disponojë 8 salla operative për kontrollin e shërbimeve, të vërtetuara nga 8 Drejtori të Policisë së Qarqeve dhe Akt Miratimet e Sallave operative; Të disponojë së paku 8 automjete për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi ose më qira; Të disponojë jo më pak se 8 armë të shkurtra (B1), e vërtetuar me kontratë ose faturë blerje; Kontratë e punës me mjekun, licenca e mjekut; 1 inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni/Elektronik (diplomë, kontratë pune).

-Kushte të tjera: Licencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit " Shërbim i ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike", nënkategoria 1.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe



veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”. Certifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”; Certifikatë për të paktën 50 punonjës shërbimi.

-Specifikimet teknike, janë vendosur në përputhje me nenin 23 “Specifikimet teknike”, pika 1, si dhe janë dokumentuar në procesverbalin e mbajtur me shkresën nr. 574 datë 23.04.2020 “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të pasurive të sek/konf, në administrim të AAPSK”.

-*Dokumentet e tenderit kanë pësuar modifikime me shtojcën nr. 1 datë 20.05.2020, ku sa i takon kapacitetit teknik, numri mesatar i punonjësve për periudhën Shkurt-Prill 2020 duhet të jetë jo më pak se 50 punonjës; Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit, të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të Marrëveshjes Kuadër; Kriteri i disponimit të 1 mjeku në listëpagesë hiqet; Duhet të vërtetohet me vërtetime performance të lëshuara nga Drejtoritë e Policisë së 12 (dymbëdhjetë) Qarqeve, se disponon jo me pak se 50 punonjës shërbimi ku 6 (gjashtë) prej tyre grupe të gatshme dhe 5 (pesë) prej tyre Përgjegjës Shërbimi; Duhet të disponojë 12 (dymbëdhjetë) salla operative për kontrollin e shërbimeve, të vërtetuara me vërtetim nga 12 (dymbëdhjetë) Drejtori të Policisë së Qarqeve dhe Akt Miratimet e Sallave Operative lëshuar nga DPQ-të; Duhet të disponojë së paku 12 (dymbëdhjetë) automjete për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qira; Të disponojë jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) armë të shkurtra (B1), e vërtetuar kjo me kontrate dhe/ose faturë blerje. Modifikimet kanë ardhur si rezultat i rekomandimeve të APP-së duke iu përmbajtur përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik.*

#### **Vlerësimi i ofertave**

Në procedurën e prokurimit u konstatua se ka marrë pjesë vetëm një BOE me pjesëmarrës OE “G. S. SHPK”, “A. S. SHPK” dhe “N.-2.”. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë çmimi i ofertës ekonomike më e favorshme.

Sa më sipër ka rezultuar se ky BOE ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit, si ato të përgjithshme, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike, të përcaktuara në DT, në përputhje me ligjin nr. 9643/2006, i ndryshuar neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 ku cilësohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.*

Me shkresën nr. 897 datë 19.06.2020 është hartuar raporti përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së hapur, ku 2 nga 3 anëtarët e KVO-së e kanë kualifikuar dhe vlerësuar ofertën ekonomike nga BOE “G. S. SHPK”, “A. S. SHPK” dhe “N. 2. SHPK”.

Me shkresën nr. 971 datë 30.06.2020 është lidhur marrëveshja kuadër midis BOE-së fituese dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Në datë 27.09.2021 janë lidhur 6 kontrata shërbimi për 6 pasuri që do t’u vendoset në dispozicion shërbimi i ruajtjes fizike nga BOE fitues.

#### **Zbatimi i kontratës**

Bashkangjitur dokumenteve të dosjes së procedurës gjendet formulari i raportimit për zbatimin e kontratës.

#### **Viti 2021**

Me shkresën nr. 78 prot., datë 11.01.2021, të Autoritetit Kontraktor, *“Dërgohet regjistri i planifikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2021”*, drejtuar Ministrisë së Brendshme, është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime. Regjistri i parashikimeve publike për vitin 2021, është hartuar në përputhje me nenin 4, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe me Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018 të APP-së.

Për vitin 2021 janë realizuar 11 procedura prokurimi me fond limit 3,827,179 lekë pa Tvsh. Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, u përcaktuan për t’u audituar procedurat sipas Tabelës nr. 17. Nga 11 procedura janë përzgjedhur 5 procedura, që zënë 55% të vlerës së fondit.

Tabela nr. 17 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	Operatori Ekonomik fitues	Data e Publikimit
1	Blerje e shërbimit dhe riparimit të automjetit tip Daimler Crysler 220 CDI	138,840	Blerje e vogël	80,000	21.05.2021	A. S.	19.05.2021
2	Blerje karburanti diesel pa Plumb (10 ppm)	800,000	Blerje e vogël	730,300	27.01.2021	G. C. G.	25.01.2021
3	Blerje Tonera për printer dhe fotokopje	123,800	Blerje e vogël	87,000	25.02.2021	A.	23.02.2021
4	Blerje shërbim ekspertize për vlerësimin e pasurive	800,000	Blerje e vogël	310,000	04.03.2021	G. E. C.	26.02.2021
5	Blerje shërbim autoveture	245,400	Blerje e vogël	144,500	10.05.2021	B. L.	05.05.2021

### Procedura 1 - Procedura e prokurimit “Blerje e shërbimit dhe riparimit të automjetit tip Daimler Crysler 220 CDI”

Urdhër prokurimi nr. 1614, datë 19.05.2021	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. F.A Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 28 prot., datë 06.01.2021)	-Fitues: OE “A. S.” -Vlera fituese 80,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 17/2021 datë 02.06.2021 me vlerë 80,000 lekë pa TVSH
Fondi limit 138,840 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “A. S.”	-Diferenca nga fondi limit 58,840 lekë
Datë e hapjes së tenderit 19.05.2021.	Marrin pjesë 9 OE S’kualifikuar 4 OE	Titullar i AK – Q.Th

### Procedura 2 - Procedura e prokurimit “Blerje karburanti diesel pa Plumb (10 ppm)”

Urdhër prokurimi nr. 173, datë 19.01.2021	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 28 prot., datë 06.01.2021)	-Fitues: OE “G. C. G.” -Vlera fituese 730,300 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Faturat tatimore nr. 21/2021 dhe 22/2021 datë 28.01.2021 me vlerë respektivisht 319,364.76 dhe 410,935.24 lekë pa TVSH
Fondi limit 800,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “G. C. G.”	-Diferenca nga fondi limit 69,700 lekë
Datë e hapjes së tenderit 27.01.2021.	Marrin pjesë 10 OE S’kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – A.K

### Procedura 3 - Procedura e prokurimit “Blerje Tonera për printer dhe fotokopje”

Urdhër prokurimi nr. 596, datë 22.02.2021	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 28 prot., datë 06.01.2021)	-Fitues: OE “A.” -Vlera fituese 87,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Faturat tatimore nr. 2/2021 me vlerë 87,000 lekë pa TVSH
Fondi limit 123,800 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “A.”	-Diferenca nga fondi limit 36,800 lekë
Datë e hapjes së tenderit 25.02.2021.	Marrin pjesë 27 OE S’kualifikuar 19 OE	Titullar i AK – A.K

### Procedura 4 - Procedura e prokurimit “Blerje shërbim ekspertize për vlerësimin e pasurive”

Urdhër prokurimi nr. 639, datë 24.02.2021	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. Q.Th Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 28 prot., datë 06.01.2021)	- Fitues: OE “G. E. C.” -Vlera fituese 310,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Faturat tatimore nr. 1/2021 me vlerë 310,000 lekë pa TVSH
Fondi limit 800,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “G. E. C.”	-Diferenca nga fondi limit 490,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 04.03.2021.	Marrin pjesë 3 OE S’kualifikuar 1 OE	Titullar i AK – A.K

## Procedura 5 - Procedura e prokurimit “Blerje shërbim autoveture”

Urdhër prokurimi nr. 1472/1, datë 05.05.2021	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. M.H Kryetar z. F.A Anëtar z. S.Sh Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 28 prot., datë 06.01.2021)	-Fitues: OE “B. L.” -Vlera fituese 144,500 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Faturat tatimore nr. 11/2021 me vlerë 144,500 lekë pa TVSH
Fondi limit 245,400 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “B. L.”	-Diferenca nga fondi limit 100,900 lekë
Datë e hapjes së tenderit 10.05.2021.	Marrin pjesë 25 OE S’kualifikuar 6 OE	Titullar i AK – Q.Th

### Dosja e Tenderit

Dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratave janë mbajtur procesverbale, ku citohet se përlllogaritja është bazuar në VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59, pika 2, germa a) “Çmimet e tregut” dhe pika b) “Çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë ose autoritete të tjera”.

Në bazë të pasqyrimin të mësipërm në disa nga rastet e marra në auditim, fondi limit rezulton dukshëm më i lartë se vlera e kontratës. Pra ky veprim nuk është në përputhje me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratave janë administruar ofertat nga 5 operatorë ekonomikë, ku nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është vepruar sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, pika 5.

### Vlerësimi i ofertave

-Në procedurën e prokurimit “Blerje e shërbimit dhe riparimit të automjetit tip Daimler Crysler 220 CDI”, u konstatua se kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomik prej të cilëve 4 OE janë skualifikuar për shkak se kanë ofertuar mbi fondin limit (mosplotësim i kriterëve). Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë vetëm çmimi. Subjekti K. operatori me vlerën më të ulët, i cili u shpall fitues është tërhequr nga tenderi me justifikimin e llogaritjes gabim të ofertës. Bashkëlidhur në dosje gjendet procesverbali datë 24.05.2021, për kalimin te operatori ekonomik i radhës. Në përfundim është shpallur fitues operatori A.S me vlerë 80,000 lekë pa Tvsh.

-Në procedurën e prokurimit “Blerje karburanti diesel pa Plumb (10 ppm)” u konstatua se kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik të cilët janë kualifikuar të gjithë dhe fitues ka rezultuar OE “G.C GKG” me vlerën e ofertës më të ulët 730,300 lekë pa Tvsh.

-Në procedurën e prokurimit “Blerje Tонера për printer dhe fotokopje” u konstatua se kanë marrë pjesë 27 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë skualifikuar 19. Fitues ka rezultuar OE “A.”, me vlerën e ofertës më të ulët 87,000 lekë pa Tvsh.

-Në procedurën e prokurimit “Blerje shërbim ekspertize për vlerësimin e pasurive” u konstatua se kanë marr pjesë 3 operatorë ekonomikë, nga të cilët është skualifikuar 1 dhe fitues ka rezultuar OE “G. E. C.” me vlerën e ofertës më të ulët 310,000 lekë pa Tvsh. -Në procedurën e prokurimit “Blerje shërbim autoveture” u konstatua se kanë marrë pjesë 25 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë skualifikuar 6 dhe fitues ka rezultuar OE “A. M.” me vlerën e ofertës më të ulët vlerë 98,000 lekë pa Tvsh. Ky operator është tërhequr nga angazhimi dhe procedura e shpalljes së fituesit ka vazhduar me operatorin e 8 në radhë, subjekti “B. L.”.

## Zbatimi i kontratës

Për sa më sipër, subjekti “A.-S.” SHPK me NIPT L.....0G ka lëshuar faturën tatimore nr. 17/2021 datë 02.06.2021 në vlerën 96,000 lekë me tvsh. Në dosje gjendet procesverbali datë 27.05.2021 i realizimit të shërbimit.

Nga subjekti “G. C. G.” SHPK me NIPT K.....T janë lëshuar faturat tatimore nr. 21/2021 dhe 22/2021 datë 28.01.2021 me vlerë respektivisht 319,364.76 dhe 410,935.24 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur fletëhyrjet e magazinës për marrjen në dorëzim të mallit nr. 1 dhe 2 datë 28.01.2021 në vlerë 493,122.29 dhe 383,240 lekë.

Nga subjekti “A.” me NIPT L.....M është lëshuar fatura tatimore nr. 2/2021 me vlerë respektivisht 87,000 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur fletëhyrjet e magazinës për marrjen në dorëzim të mallit nr. 2 dhe 3 datë 01.03.2021 në vlerë 93,840 dhe 10,560 lekë.

Fatura tatimore nr. 1/2021 me vlerë respektivisht 310,000 lekë pa TVSH e lëshuar nga subjekti “G. E. C.” me NIPT L.....A është likuiduar nga llogaria rrjedhëse e AAPSK me urdhër transfertën datë 12.04.2021 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve.

Nga subjekti “B. L.” me NIPT K.....R me faturën tatimore nr. 11/2021 me vlerë respektivisht 144,500 lekë pa TVSH.

## Viti 2022

Me shkresën nr. 129 prot., datë 17.01.2022, të Autoritetit Kontraktor, “Dërgohet regjistri i planifikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2022”, drejtuar Ministrisë së Brendshme, është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime. Regjistri i parashikimeve publike për vitin 2022, është hartuar me vonesë, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 3, pika 3 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet “Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.”

Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me Urdhrin nr. 30, datë 06.01.2022 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, ka urdhëruar KP si më poshtë:

-S.S, Kryetar

-E.R, anëtar;

-E.K, anëtar.

Për vitin 2022 janë realizuar 22 procedura prokurimi me fond limit 10,801,745 lekë pa Tvsh. Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, u përcaktuan për t’u audituar procedurat sipas Tabelës nr. 18.

Nga 22 procedura janë përzgjedhur 3 procedura, që zënë 52% të vlerës së fondit.

Tabela nr. 18 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	Operatori Ekonomik fitues	Data e Publikimit
1	Blerje karburanti gazoil super pa plumb (10ppm)	1,000,000	Blerje e vogël	959,900	31.01.2022	G. C. G.	27.01.2022
2	Blerje Shërbim me karrotrec	996,830	Blerje e vogël	838,300	08.09.2022	B. R.	07.09.2022
3	Shërbim ekspert vlerësim pasur.	3,601,000	E hapur, e thjesht.	2,151,750	26.07.2022	S. K.	13.07.2022

## Procedura 1 - Procedura e prokurimit “Blerje karburanti gazoil super pa plumb (10ppm)”

Urdhër prokurimi nr. 217, datë 25.01.2022	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. S.S Kryetar z. E.R Anëtar z. E.K Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 30 prot., datë 06.01.2022)	-Fitues: OE “G. C. G.” -Vlera fituese 959,900 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Faturat tatimore nr. 844 & 845/2022 me vlera respektive 384,166.67 lekë dhe 575.650 lekë pa TVSH
Fondi limit 1,000,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit & Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “G. C. G.”	-Diferenca nga fondi limit 40,183 lekë

Datë e hapjes së tenderit 31.01.2022	Marrin pjesë 9 OE S'kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – Q.Th
--------------------------------------	---	----------------------

### Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbal me shkresën nr. 216 datë 25.01.2022, ku përllogaritja është bazuar në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, “Studimi paraprak i tregut”, Çmimet e Tregut dhe neni 76, pika b) “Studime të tregut bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”.

### Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 5 operatorë ekonomikë.

### Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomikë, nga të cilët nuk është skualifikuar asnjë OE dhe fitues ka rezultuar OE “G. C. G.” me vlerën e ofertës më të ulët 959,900 lekë pa Tvsh. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qënë vetëm çmimi.

### Zbatimi i kontratës

Për sa më sipër, nga subjekti “G. C. G.” me NIPT K.....T janë lëshuar faturat tatimore nr. 844 & 845/2022 me vlera respektive 384,166.67 lekë dhe 575,650 lekë pa TVSH. Fatura nr. 844 është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 22 datë 10.02.2022 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. Fatura nr. 845 është likuiduar me urdhër transfertën datë 09/02/2022. Bashkëlidhur fletëhyrjet nr. 1 dhe nr. 3 datë 08.02.2022 e magazinës për marrjen në dorëzim të mallit në vlerat respektive 461,000 lekë dhe 690,780 lekë.

### Procedura 2 - Procedura e prokurimit “Blerje Shërbim me karrotrec”

Urdhër prokurimi nr. 18, datë 30.08.2022	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b> z. S.S Kryetar z. E.R Anëtar	-Fitues: OE “B.R.” -Vlera fituese 838,300 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Faturat tatimore: 15 fatura
Fondi limit 996,830 lekë (pa TVSH)	z. E.K Anëtar (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 30 prot., datë 06.01.2022)	
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “B.R.”	-Diferenca nga fondi limit 40,183 lekë
Datë e hapjes së tenderit 08.09.2022	Marrin pjesë 11 OE S'kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – Q.Th.

### Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur procesverbal me shkresën nr. 2465/1 datë 30.08.2022, ku përllogaritja është bazuar në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 13, “Studimi paraprak i tregut”, pika 4.

### Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 5 operatorë ekonomikë.

### Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 12 operatorë ekonomikë, nga të cilët OE fitues ka rezultuar “R. N. M. me vlerën e ofertës më të ulët 875,500 lekë pa tvsh. Ky operator nuk u paraqit pranë AK dhe u skualifikua.

Procedura e prokurimit është anuluar më datë 06.09.2022 pasi dokumentat përmbanin gabime. Te procedura e rihapur morën pjesë 11 OE dhe fitues u shpall OE “L. S.” me ofertën më të ulët në vlerë 798,000 lekë pa tvsh. Ky operator nuk u paraqit pranë AK, gjithashtu dhe OE të tjerë u tërhoqën ose nuk u paraqitën. Procedura vazhdoi me OE të 5 në radhë dhe shpalli fitues “B. R.” me ofertë në vlerën 838,800 lekë pa tvsh.

### Zbatimi i kontratës

Në dokumentat e dosjes gjendet evidenca për faturat e lëshuara nga subjekti “B. R.” me NIPT M.....R si dhe urdhër transfertat përkatëse. Bashkëlidhur dhe formular raportimi për zbatimin e kontratës.

**Procedura 3** - Procedura e prokurimit “Shërbim eksperti për vlerësim pasurie” (*procedurë e rishpallur pas anulimit për mungesë ofertash*)

Urdhër prokurimi nr. 1486, datë 18.05.2022	<b>Komisioni i Prokurimit procedurë e hapur e thjeshtuar</b> z. M.H Kryetar z. S.S Anëtar z. E.K Anëtar (sipas Urdhër nr. 1369 prot., datë 09.05.2022)	-Fitues: OE “S. K.” -Vlera fituese 2,151,750 lekë pa TVSH
Fondi limit 3,601,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – e hapur e thjeshtuar		
Burimi i Financimit: Të ardhurat e AAPSK	Fitues: OE “S. K.”	-Diferenca nga fondi limit 1,449,250 lekë
Datë e hapjes së tenderit 26.07.2022	Marrin pjesë 4 OE S kualifikuar 1 OE	Titullar i AK – A.K.

### Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të procedurës së prokurimit marrëveshje kuadër është mbajtur procesverbal me shkresën nr. 1368/1 datë 09.05.2022, ku përlllogaritja është bazuar në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika b) studimit të tregut bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim.

Gjithashtu, në zbatim të VKM-së sipërcituar, janë marrë oferta nga:

- B.O. në shumën 1,178,000 lekë për apartament/ndërtesa dhe 450,000 lekë për arë/truall;
- E.G. në shumën 1,160,000 lekë dhe 465,000 lekë;
- Xh.B. në shumën 1,124,000 lekë dhe 405,000 lekë;
- B.K. në shumën 1,085,000 lekë dhe 435,000 lekë;
- E.Xh. në shumën 225,000 lekë për mjete motorike/lundruese.

Njësia e prokurimit ka përcaktuar fondin limit duke ju referuar vlerës mesatare të ofertave për vlerësimin e ndërtesave, tokave dhe mjeteve motorike. Dhe si fond limit është gjykuar të merret dyfishi i përlllogaritjes së vlerës mesatare. Sa më sipër si mënyrë për përlllogaritjen e fondit limit është marrë mesatarja e çmimeve, por duke qënë se numri i pasurive për të cilat do të bëhet vlerësimi nuk mund të përcaktohet që në fillim, nuk përcaktohen në mënyrë të saktë nevojat e njësisë. Si rrejdhim fondi limit rezulton më i lartë se vlera e kontratës dhe se sa zbatimi i kontratës.

**Përcaktimi i kriterëve kualifikuese:** Kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe specifikimet teknike, hartimi dhe miratimi i DT.

Sipas të dhënave në SPE, nga AK janë hedhur DT, ku pjesë përbërëse janë:

- Kriteret e përgjithshme
- Kriteret e veçanta (kapaciteti ekonomik financiar dhe kapaciteti teknik)
- Termet e referencës
- Kushtet dhe termet e kontratës

-Shtojcat, etj.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese është bërë në përputhje me llojin dhe madhësinë e objektit të prokurimit. Konkretisht:

-Kriteret e përgjithshme, sipas VKM nr. 285/2021, neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” dhe neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”;

-Kapaciteti financiar: Xhiro vjetore për vitet financiare 2019-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një vit të jetë jo më shumë se 40 % e fondit limit;

-Kapaciteti teknik profesional: Dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës. OE duhet të dorëzojë dëshmi për përvojën e mëparshme me sektorin publik dhe licenca të shkallës së parë ose të dytë për vlerësim ndërtese, tokë bujqësore, linja teknologjike etj.

-Specifikimet teknike, janë vendosur në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike”, pika 1 ku cilësohet: *“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet”,* si dhe janë dokumentuar në proces verbalin e mbajtur më datë 12.07.2022 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

**Mbi modifikimin e DT.** Sa i takon procedurës së mësipërme të prokurimit është shpallur dhe anuluar disa herë. AK ka anuluar procedurën për shkak se nuk u paraqit asnjë ofertë. Më pas janë bërë ndryshimet në dokumentet standarde të tenderit (DST) dhe procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike.

Sipas nenit 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 4 cilësohet “Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

#### **Vlerësimi i ofertave**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në SPE dhe ato të paraqitura pranë AK, u konstatua se kanë marrje pjesë 4 operatorë ekonomikë, nga të cilët është skualifikuar 1 OE. Fitues ka rezultuar B.O.E “S. K. PF.” dhe “L. K.” me vlerën e ofertës më të ulët në vlerë 2,151,750 lekë pa Tvsh. Ka rezultuar se ky BOE ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit, si ato të përgjithshme, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike, të përcaktuara në DT, në përputhje me ligjin nr. 162/2021, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 ku cilësohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.*

#### **Zbatimi i kontratës**

Nga titullari i AK, kanë dalë Urdhra respektiv për ngritje komisioni marrje në dorëzim për ekzekutimin e kontratës me objekt “Blerje shërbim ekspert vlerësim pasurie”, për një periudhë 6 mujore. (Urdhri nr. 54 datë 23.09.2022; nr. 128 datë 27.10.2022; nr. 180 datë 29.12.2022)

Në bazë të kontratës marrëveshje kuadër, në varësi të nevojave të AK janë realizuar 3 minikontrata me operatorin fitues. Është mbajtur:

-procesverbali nr. 2714/1 datë 23.09.2022 për marrjen në dorëzim të shërbimit sipas minikontratës së parë;

-procesverbali nr. 3111/1 datë 27.10.2022 për marrjen në dorëzim të shërbimit sipas minikontratës së dytë;

-procesverbali nr. 26/1 datë 17.01.2023 për marrjen në dorëzim të shërbimit sipas minikontratës së tretë;

Afati i zbatimit të kontratës ka përfunduar dhe vlera e shërbimeve të realizuara për vlerësimin e pasurive rezulton 561,000 lekë pa tvsh, nga 3,601,000 lekë që ka qenë fondi limit. Sikurse evidentohet nga zbatimi i kontratës fondi limit është përcaktuar në vlerë shumë më të lartë krahasuar me kontratën fituese, si dhe me nivelin e zbatimit të kontratës. Kjo tregon se përlogaritja e fondit limit nuk ka rezultuar e arsyetuar dhe e saktë.

Në dosje gjenden dhe raportet përkatëse të vlerësimit.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Problematika lidhur me argumentimin e fondit limit dhe mos kryerja e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve të prokurimeve, periudha 2019-2021.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi përputhshmërinë e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit të AAPSK u konstatua se: -në 5 procedura prokurimi evidentohet diferencë e konsiderueshme ndërmjet fondit limit të përlogaritur dhe vlerës së kontratës fituese. -Dosjet e procedurave të prokurimit të audituara për vitet 2019-2021 nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.
<b>Kriteri:</b>	-VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar - Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, neni 36 - Udhëzimi nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.
<b>Impakti:</b>	Diferenca të konsiderueshme ndërmjet fondit limit dhe vlerës së kontratës fituese. Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për: -argumentimin e fondit limit duke reflektuar nevojat reale të institucionit si dhe bazuar në përcaktimet ligjore për prokurimet; -sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike me qëllim saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit në përputhje me ligjin e arkivave.

### 2.3.3 Mbi përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin financiar

#### Viti 2017

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 178 prot., datë 13.02.2018. Kryeadministratori që është njëkohësisht NA i AAPSK-së rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Bilanci kontabël është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit, pra brenda muajit mars 2018.



## Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2017

Në lekë

NR.LLOG.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
<b>12</b>	<b>Rezultate të mbartura</b>		
<b>A</b>	<b>AKTIVE TË QËNDRUESHME</b>	<b>18,977,207</b>	<b>21,453,357</b>
<b>20, 230</b>	<b>I. Të pa trupëzuara</b>	<b>137,187</b>	<b>117,788</b>
205	Koncensione, patenta, licenca e tjera ngjashme	548,748	548,748
209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara(-)	-411,561	-430,960
<b>21,23,24,28</b>	<b>II.Akt.Qëndr.të Trupëzuara</b>	<b>18,840,020</b>	<b>21,335,569</b>
210	Toka, troje, terrene	0	0
211	Pyje, plantacione	0	0
212	Ndërtime e konstruksione	16,926,300	16,926,300
213	Rruge, rrjete,vepra ujore	0	0
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla	755,800	755,800
215	Mjete transporti	4,389,348	4,389,348
218	Inventar ekonomik	4,666,997	5,240,966
219	Amortizimi aktiv.Qëndr.të trupëzuara(-)	-7,898,425	-5,976,845
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>2,587,173</b>	<b>1,671,399</b>
<b>Klasa 3</b>	<b>I.Gjendja e Inventarit</b>	<b>1,665,958</b>	<b>933,949</b>
31	Materiale	1,180,668	933,949
32	Objekte inventari	573,969	0
39	Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit (-)	-88,679	
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët</b>	<b>921,215</b>	<b>737,450</b>
4342	Të tjera operacione me shtetin(debitor)	921,215	737,450
<b>X</b>	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>21,564,380</b>	<b>23,124,756</b>

### Aktivi

Llogaria 205 “Koncensione, patenta, licenca e tjera ngjashme” ka vlerë të njëjtë me vitin e kaluar, 548,748 lekë.

Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara”, ka një vlerë prej 19,399 lekë, si rezultat i sistemimit nga viti i kaluar.

Llogaritë aktive, duke i krahasuar me një vit më parë rezultojnë se janë pakësuar me 2,476,150 lekë. Në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, llogaria 211 “Pyje, plantacione” llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqiten në vlerën 0 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 16,926,300, sa vlera e vitit të kaluar, pa i zbritur amortizimin vjetor.

Llogaria 214 është paraqitur me vlerën e vitit të kaluar 755,800 lekë, sa vlera e vitit të kaluar, pa i zbritur amortizimin vjetor.

Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 4,389,348 lekë, pa diferencë nga viti i kaluar.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 4,666,997 lekë, paraqitet sa vlera e një viti më parë minus amortizimin vjetor.

Llogaria 219 “Amortizimi aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (-)” rezulton me një diferencë nga viti i kaluar në vlerën 1,919,580 lekë dhe përfaqëson llogaritjen e amortizimit.

Llogaritë e aktiveve afatshkurtër, në vlerën 2,587,173 lekë (llogaria klasa 3, 4 dhe 5), me një shtesë në vlerën 915,774 lekë e analizuar si më poshtë:

Nga analiza e debi-kredive rezultoi se, në këtë institucion ka të evidentuar debitorët dhe kreditorët e krijuar në dhjetor të vitit 2017 e të pa likuiduar, si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llogaritë	Emërtimi	Debitorë	Kreditore
421 – 427	Personeli e llogari të lidhura me to		801,214
435	Sigurime shoqërore		94,564
436	Sigurime shëndetësore		25,437
4342/1	Të tjera operacione me shtetin debitor kreditor	921,215	0
	<b>Shuma</b>	<b>921,215</b>	<b>921,215</b>

Gjendje debitore në vlerë 921,215 lekë, paraqet detyrimet për paga e shtesa, tatime e sigurimet e muajit dhjetor 2017.

Llogaria 31 “Materiale” në vlerën 1,180,668 lekë, është më shumë se një vit më parë, në vlerë 245,719 lekë.

Llogaria 32 “Objekte inventari” në vlerën 573,969 lekë, shtuar me vlerën 573,969 lekë në krahasim me vitin e kaluar.

Llogaria 39 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit”, pasqyron amortizimin e llogarisë 327.

Llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin (debitor)”, është më shumë se një vit më parë, në vlerë 183,765 lekë.

#### Pasivi:

Në lekë

NR.LLOG.	EMËRTIMI I LLLOGARIVE TË PASIVIT	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>20,643,165</b>	<b>22,387,306</b>
<b>10</b>	<b>I. Fonde të veta</b>	<b>20,643,165</b>	<b>22,387,306</b>
101	Fonde bazë	460,071	2,204,212
105	Grante të brendshme kapitale	2,619,694	2,619,694
106	Grante të huaja kapitale	637,100	637,100
107	Akt.Qënd.të caktuara në përdorim	16,926,300	16,926,300
<b>B</b>	<b>D E T Y R I M E</b>	<b>921,215</b>	<b>737,450</b>
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Detyrime afatshkurtër</b>	<b>921,215</b>	<b>737,450</b>
421,424,425,427,428	Personeli e llogari të lidhura me to	801,214	514,179
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa		55,643
435	Sigurime shoqërore	94,564	145,187
436	Sigurime shëndetësore	25,437	22,441
<b>X</b>	<b>T O T A L I I P A S I V I T</b>	<b>21,564,380</b>	<b>23,124,756</b>

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më pak se një vit më parë për 1,744,141 lekë (që ka të bëjë kryesisht me pakësim të llog. 101 “fonde bazë”, ndërsa me grupe e klasa, janë si më poshtë:

Llogaritë e fondeve bazë janë pakësuar për këtë vit për -1,744,141 lekë;

Llogaritë e grandeve të brendshme kapitale nuk kanë ndryshim.

Llogaritë e grandeve të huaja kapitale nuk kanë ndryshuar për këtë vit;

Llogaritë Vlera e AQ të caktuara në përdorim, nuk kanë ndryshuar për këtë vit.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtra, janë shtuar në vlerë 183,765 lekë, si më poshtë:

Llogaria 421-428 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është shtuar këtë vit në vlerë 287,035 lekë;

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” rezulton në vlerën 0 lekë, pra pakësuar me 55,643 lekë.

Llogaria 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, është pakësuar këtë vit në vlerë 50,623 lekë.

Llogaria 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore”, është shtuar këtë vit, në vlerë 2,996 lekë.

#### Viti 2018

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 229 prot., datë 13.03.2019. Kryeadministratori që është njëkohësisht NA i AAPSK-së rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Bilanci kontabël është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit, pra brenda muajit mars 2019.

#### Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2018

Në lekë

NR.LLOG.	EMËRTIMI I LLLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
<b>12</b>	<b>Rezultate të mbartura</b>		
<b>A</b>	<b>AKTIVE TË QËNDRUESHME</b>	<b>19,591,345</b>	<b>18,977,207</b>
<b>20, 230</b>	<b>I.Të pa trupëzuara</b>	<b>0</b>	<b>137,187</b>
205	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	78,000	548,748
209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara(-)	-78,000	-411,561
<b>21,23,24,28</b>	<b>II.Akt.Qëndr.të Trupëzuara</b>	<b>19,591,345</b>	<b>18,840,020</b>
210	Toka, troje, terrene	0	0
211	Pyje, plantacione	0	0
212	Ndërtime e konstruksione	16,926,300	16,926,300
213	Rruge, rrjete,vepra ujore	0	0
214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla	755,800	755,800

215	Mjete transporti	4,389,348	4,389,348
218	Inventar ekonomik	5,454,888	4,666,997
219	Amortizimi aktiv.Qëndr.të trupëzuara(-)	-7,934,991	-7,898,425
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>2,880,343</b>	<b>2,587,173</b>
<b>Klasa 3</b>	<b>I.Gjendja e Inventarit</b>	<b>2,064,282</b>	<b>1,665,958</b>
31	Materiale	1,548,612	1,180,668
32	Objekte inventari	515,670	573,969
39	Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit (-)		-88,679
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët</b>	<b>816,061</b>	<b>921,215</b>
4342	Të tjera operacione me shtetin(debitor)		921,215
<b>X</b>	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>22,471,688</b>	<b>21,564,380</b>

## Aktivi

Llogaria 205 “Koncensione, patenta, licenca e tjera ngjashme” ka vlerën 78,000, krahasuar me vitin e kaluar që rezultonte 548,748 lekë, diferenca janë nxjerrje jashtë përdorimi.

Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara”, ka një vlerë prej 331,561 lekë, më pak, vlerë që i përket amortizimit të mjeteve të nxjerrja jashtë përdorimit.

Në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, llogaria 211 “Pyje, plantacione” llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqiten në vlerën 0 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 16,926,300.

Llogaria 214 është paraqitur me vlerën e vitit të kaluar 755,800 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 4,389,348 lekë.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 5,454,888 lekë, paraqitet më shumë se vitin e kaluar pasi janë bërë blerje të reja në vlerën 1,494,018 lekë dhe nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën 706,126 lekë.

Llogaria 219 “Amortizimi aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (-) 7,934,991 lekë.

Llogaria e aktiveve qarkulluese (klasa 3 dhe 4) paraqitet në vlerën 309,645 lekë më shumë se një vit më parë, detajuar si më poshtë:

Llogaria 311 “Materiale” është më shumë se një vit më parë në vlerën 367,944 lekë.

Llogaria 327 “Objekte inventari” është më pak se një vit më parë në vlerën 58,299 lekë.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor) në vlerën 816,061 lekë.

Nga analiza e debi-kredive rezultoi se, në këtë institucion ka të evidentuar debitorët dhe kreditorët e krijuar në dhjetor të vitit 2018 e të pa likuiduar, si në tabelën e mëposhtme:

*Në lekë*

Llogaritë	Emërtimi	Debitore	Kreditore
421 - 427	Personeli e llogari të lidhura me to		575,101
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa		57,870
435	Sigurime shoqërore		176,865
436	Sigurime shëndetësore		6,225
4342/1	Të tjera operacione me shtetin debitor kreditor	816,061	
	<b>Shuma</b>	<b>816,061</b>	<b>816,061</b>

Gjendje debitorë në vlerë 816,061 lekë, paraqet detyrimet për paga e shtesa, tatime e sigurimet dhe detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, muajt dhjetor 2018.

## Pasivi:

*Në lekë*

NR.LLOG.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË PASIVIT	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>21,665,627</b>	<b>20,643,165</b>
<b>10</b>	<b>I. Fonde të veta</b>	<b>21,665,627</b>	<b>20,643,165</b>
101	Fonde bazë	1,472,533	460,071
105	Grante të brendshme kapitale	2,619,694	2,619,694
106	Grante të huaja kapitale	637,100	637,100
107	Akt.Qëndr.të caktuara në përdorim	16,926,300	16,926,300
<b>B</b>	<b>D E T Y R I M E</b>	<b>816,061</b>	<b>921,215</b>
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Detyrime afatshkurtër</b>	<b>816,061</b>	<b>921,215</b>
421,424,425,427,428	Personeli e llogari të lidhura me to	575,101	801,214
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	57,870	
435	Sigurime shoqërore	176,865	94,564
436	Sigurime shëndetësore	6,225	25,437
<b>X</b>	<b>T O T A L I P A S I V I T</b>	<b>22,471,688</b>	<b>21,564,380</b>

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 907,308 lekë (që ka të bëjë kryesisht me pakësim të llog. 101 “fonde bazë”, ndërsa me grupe e klasa, janë si më poshtë:

Llogaritë e fondeve bazë janë pakësuar për këtë vit për 1,472,533 lekë;  
 Llogaritë e grandeve të brendshme kapitale nuk kanë ndryshim.  
 Llogaritë e grandeve të huaja kapitale nuk kanë ndryshuar për këtë vit;  
 Llogaritë Vlera e AQ të caktuara në përdorim, nuk kanë ndryshuar për këtë vit.  
 Llogaritë e detyrimeve afatshkurtra, janë pakësuar në vlerë 105,154 lekë, si më poshtë:  
 Llogaria 421-428 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit në vlerë 226,113 lekë;  
 Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” rezulton në vlerën 57,870 lekë, pra shtuar me 57,870 lekë.  
 Llogaria 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit në vlerë 82,301 lekë.  
 Llogaria 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore”, është pakësuar këtë vit, në vlerë 19,212 lekë.

### Viti 2019

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 286 prot., datë 03.03.2020. Kryeadministratori që është njëkohësisht NA i AAPSK-së rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Bilanci kontabël është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit, pra brenda muajit mars 2020.

### Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2019

Në lekë

NR.LLOG.	EMËRTIMI I LLLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
<b>12</b>	<b>Rezultate të mbartura</b>		
<b>A</b>	<b>AKTIVE TË QËNDRUESHME</b>	<b>18,757,910</b>	<b>19,591,345</b>
<b>20, 230</b>	<b>I.Të pa trupëzuara</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
205	Koncensione, patenta, licenca e tjera ngjashme		78,000
209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara(-)		-78,000
<b>21,23,24,28</b>	<b>II.Akt.Qëndr.të Trupëzuara</b>		<b>19,591,345</b>
210	Toka, troje, terrene		0
211	Pyje, plantacione		0
212	Ndërtime e konstruksione	15,910,722	16,926,300
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		0
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla	529,060	755,800
215	Mjete transporti	87,787	4,389,348
218	Inventar ekonomik	2,230,341	5,454,888
219	Amortizimi aktiv.Qëndr.të trupëzuara(-)		-7,934,991
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>2,380,350</b>	<b>2,880,343</b>
<b>Klasa 3</b>	<b>I.Gjendja e Inventarit</b>	<b>1,581,320</b>	<b>2,064,282</b>
31	Materiale	1,065,650	1,548,612
32	Objekte inventari	515,670	515,670
39	Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit (-)		
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët</b>	<b>799,030</b>	<b>816,061</b>
4342	Të tjera operacione me shtetin(debitor)		
<b>X</b>	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>21,138,260</b>	<b>22,471,688</b>

### Aktivi

Llogaria 205 “Koncensione, patenta, licenca e tjera ngjashme” ka vlerën 0.  
 Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara”, ka vlerën 0.  
 Në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, llogaria 211 “Pyje, plantacione” llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqiten në vlerën 0 lekë.  
 Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 15,910,722.  
 Llogaria 214 është paraqitur me vlerën e vitit të kaluar 529,060 lekë.  
 Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 87,787 lekë.  
 Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 2,230,350 lekë, në vlerën më pak 3,224,547 krahasuar me vitin e parë.

Llogaria e aktiveve qarkulluese e detajuar si më poshtë:

Llogaria 311 “Materiale” është më pak se një vit më parë në vlerën 482,962 lekë.

Llogaria 327 “Objekte inventari” nuk ka ndryshim.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor) në vlerën 799,030 lekë.

Nga analiza e debi-kredive rezultoi se, në këtë institucion ka të evidentuar debitorët dhe kreditorët e krijuar në dhjetor të vitit 2019 e të pa likuiduar, si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llogaritë	Emërtimi	Debitorë	Kreditorë
421 - 427	Personeli e llogari të lidhura me to		575,102
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa		57,870
435	Sigurime shoqërore		176,865
436	Sigurime shëndetësore		6,225
4342/1	Të tjera operacione me shtetin debitor kreditor	799,030	
	<b>Shuma</b>	<b>799,030</b>	<b>799,030</b>

Gjendje debitorë në vlerë 799,030 lekë, paraqet detyrimet për paga e shtesa, tatime e sigurimet dhe detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, muajit dhjetor 2019.

**Pasivi:**

Në lekë

NR.LLOG.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË PASIVIT	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>20,339,230</b>	<b>21,665,627</b>
<b>10</b>	<b>I. Fonde të veta</b>	<b>20,339,230</b>	<b>21,665,627</b>
101	Fonde bazë	30,759	1,472,533
105	Grante të brendshme kapitale	19,355,303	2,619,694
106	Grante të huaja kapitale	637,100	637,100
107	Akt.Qënd.të caktuara në përdorim		16,926,300
<b>B</b>	<b>D E T Y R I M E</b>	<b>799,030</b>	<b>816,061</b>
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Detyrime afatshkurtër</b>	<b>799,030</b>	<b>816,061</b>
421,424,425,427,428	Personeli e llogari të lidhura me to	554,709	575,101
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	58,437	57,870
435	Sigurime shoqërore	162,504	176,865
436	Sigurime shëndetësore	23,380	6,225
<b>X</b>	<b>T O T A L I P A S I V I T</b>	<b>21,138,260</b>	<b>22,471,688</b>

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më pak se një vit më parë për 1,333,428 lekë (që ka të bëjë kryesisht me pakësim të llog. 101 “fonde bazë”, ndërsa me grupe e klasa, janë detajuar si më lart.:

Llogaritë e fondeve bazë janë pakësuar për këtë vit për 1,441,774 lekë;

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtra, janë pakësuar në vlerë 17,031 lekë, si më poshtë:

Llogaria 421-428 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit në vlerë 20,392 lekë;

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” rezulton në vlerën 58,437 lekë.

Llogaria 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, është pakësuar këtë vit në vlerë 14,361 lekë.

Llogaria 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore është rritur këtë vit, në vlerë 17,155 lekë.

## Viti 2020

Evidentohet se për shkak të ristrukturimit, nga ana e AAPSK-s janë përgatitur 2 pasqyra financiare, konkretisht:

-për periudhën 01.01.2020-31.11.2020, periudhë e cila ka qenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-për periudhën 01.12.2020-31.12.2020, periudhë në të cilën AAPSK ka kaluar në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 793 dhe 794 prot., datë 10.03.2022.

Kryeadministratori që është njëkohësisht NA i AAPSK-së rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Brendshme. Bilanci kontabël është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit, pra brenda muajit mars 2021

### Pasqyra e pozicionit financiar periudha 01.01.2020-31.11.2020

Në lekë

Referenca e	EMËRTIMI	Ushtrimi	Ushtrimi
Llogarive		i	Paraardhës
<b>A</b>	<b>A K T I V E T</b>	<b>20,609,685</b>	<b>21,138,260</b>
	<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>2,503,403</b>	<b>2,380,350</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>1,652,053</b>	<b>1,581,320</b>
31	Materiale	1,136,383	1,065,650
32	Inventar I imët	515,670	515,670
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	682,620	554,709
431	Tatim e Taksa	58,437	58,437
435	Sigurime Shoqerore	98,690	162,504
436	Sigurime Shëndetësore	11,603	23,380
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Aktivët Afat gjata</b>	<b>18,106,282</b>	<b>18,757,910</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>18,106,282</b>	<b>18,757,910</b>
210	Toka, T,roje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndërtesa e Konstruksione	15,741,459	15,910,722
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	483,712	529,060
215	Mjete Transporti	87,787	87,787
218	Inventar ekonomik	1,793,324	2,230,341
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
42	Detyrime ndaj personelit	682,620	554,709
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	58,437	58,437
435	Sigurime Shoqërore	98,690	162,504
436	Sigurime Shëndetësore	11,603	23,380
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>19,758,335</b>	<b>20,339,230</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>19,758,335</b>	<b>20,339,230</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	-851,370	30,759
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	922,103	316,068
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	19,050,502	19,355,303
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	637,100	637,100
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>20,609,685</b>	<b>21,138,260</b>

### Pasqyra e pozicionit financiar periudha 01.12.2020-31.12.2020

Referenca e	EMËRTIMI	Ushtrimi	Ushtrimi
Llogarive		i	Paraardhës
<b>A</b>	<b>A K T I V E T</b>	<b>20,609,685</b>	<b>21,138,260</b>
	<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>2,503,403</b>	<b>2,380,350</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>1,652,053</b>	<b>1,581,320</b>
31	Materiale	1,136,383	1,065,650
32	Inventar I imët	515,670	515,670
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	682,620	554,709
431	Tatim e Taksa	58,437	58,437
435	Sigurime Shoqërore	98,690	162,504
436	Sigurime Shëndetësore	11,603	23,380
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Aktivët Afat gjata</b>	<b>18,106,282</b>	<b>18,757,910</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>18,106,282</b>	<b>18,757,910</b>
210	Toka, Troje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndërtesa e Konstruksione	15,741,459	15,910,722
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		

214	Instalime teknike, makineri e pajisje	483,712	529,060
215	Mjete Transporti	87,787	87,787
218	Inventar ekonomik	1,793,324	2,230,341
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>851,350</b>	<b>799,030</b>
42	Detyrime ndaj personelit	682,620	554,709
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	58,437	58,437
435	Sigurime Shoqërore	98,690	162,504
436	Sigurime Shëndetësore	11,603	23,380
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>19,758,335</b>	<b>20,339,230</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>19,758,335</b>	<b>20,339,230</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	-851,370	30,759
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	922,103	316,068
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmen	19,050,502	19,355,303
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	637,100	637,100
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>20,609,685</b>	<b>21,138,260</b>

Nga auditimi konstatohet se nuk është ruajtur paraqitja e fragmentizuar në të gjitha veprimet rregulluese dhe te mbylljes konkretisht:

**Klasa e AAM** paraqitet e njëjtë si në 30.11.2020 dhe në 31.12.2020, duke mos bërë amortizimin me bazë mujore. Zërat që paraqiten më të njëjtën vlerë janë si më poshtë:

- Ndërtesa e Konstruksione
- Instalime teknike, makineri e pajisje
- Mjete Transporti
- Inventar ekonomik

Një paraqitje e tillë ndikon në pasqyrat e konsoliduara të institucionit të cilit i bashkohet Agjencia Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Paraqitja e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve nuk paraqitet me problematika, pasi zërat reflektojnë periudhat përkatëse.

## Viti 2021

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 743/2 prot., datë 17.03.2022.

Kryeadministratori që është njëkohësisht NA i AAPSK-së rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Brendshme. Bilanci kontabël është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit, pra brenda muajit mars 2022.

## Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2021

*Në lekë*

Referenca e Llogarive	EMËRTIMI	Ushtrimi	
		I	Paraardhës
		Mbyllur	
A	<b>A K T I V E T</b>	26,437,003	20,609,685
	Aktivët Afat shkurtra	8,712,349	2,503,403
	Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	6,485,682	0
520	Disponibilitete në Thesar	6,485,682	
	Gjendje Inventari qarkullues	1,390,061	1,652,053
31	Materiale	874,391	1,136,383
32	Inventar i imët	515,670	515,670
	Llogari të Arkëtushme	836,606	851,350
411	Klientë e llogari të ngjashme		
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	673,553	682,620
431	Tatim e Taksa	52,860	58,437
435	Sigurime Shoqërore	98,690	98,690
436	Sigurime Shëndetësore	11,503	11,603
	<b>4.Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Aktivët Afat gjata</b>	<b>17,724,654</b>	<b>18,106,282</b>

20	Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
21	Aktive Afatgjata materiale	17,724,654	18,106,282
210	Toka, Troje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndërtesa e Konstruksione	15,572,196	15,741,459
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	438,364	483,712
215	Mjete Transporti	357,787	87,787
218	Inventar ekonomik	1,356,307	1,793,324
25-26	Aktive Afatgjata Financiare	0	0
	Investime	0	0
B	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	7,287,877	851,350
	Pasivet Afat shkurtra	7,287,877	851,350
	Llogari të Pagueshme	7,287,877	851,350
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	673,553	682,620
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	52,860	58,437
435	Sigurime Shoqërore	64,279	98,690
436	Sigurime Shëndetësore	11,503	11,603
466	Kreditorë për mjete ne ruajtje	6,485,682	
	Të tjera pasive afatshkurtra	0	0
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
C	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	19,149,126	19,758,335
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	19,149,126	19,758,335
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	-1,348,679	-851,370
85	Rezultati i Veprimtarisë ushtrimore	540,203	922,103
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme	19,320,502	19,050,502
106	Teprica e Granteve kapitale te Huaja	637,100	637,100
E	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	26,437,003	20,609,685

## Aktivi

Llogaritë aktive, duke i krahasuar me një vit më parë rezultojnë se janë shtuar me 5,827,318 lekë. Në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, llogaria 211 “Pyje, plantacione” llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqiten në vlerën 0 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 15,572,196 lekë vlera e vitit të kaluar minus amortizimin vjetor.

Llogaria 214 është paraqitur me vlerën e vitit të kaluar minus amortizimin vjetor.

Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 357,787 lekë, është shtuar në vlerën 270,000 lekë, rezulton se është marr një mjet transporti në vlerën 1,270,000 lekë dhe i është kaluar kapital Gardës së Republikës së Shqipërisë një mjet në vlerën 1,000,000 lekë. Me vendimin e Komitetit Ndërinstitucional për masat kundër krimit të organizuar nr. 22 datë 07.04.2021 “Për kalimin e automjeteve në pronësi të Gardës së Republikës dhe të AAPSK” është kaluar automjeti me targë A.....T, me fletë dalje nr. 54 datë 26.10.2021.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,356,307 lekë, paraqitet sa vlera e një viti më parë minus amortizimin vjetor.

Llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, është llogaritur në vlerën 651,219 lekë.

Llogaritë e aktiveve afatshkurtër, në vlerën 8,712,349 lekë (llogaria klasa 3, 4 dhe 5), me një shtesë në vlerën 6,208,946 lekë e analizuar si më poshtë:

Llogaria 512 “Disponibilitete në thesar”, shtuar në vlerën 6,485,682 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me mjetet monetare të depozituara në ruajtje të sekustrimeve monetare.

Nga analiza e debi- kredive rezultoi se, në këtë institucion ka të evidentuar debitorët dhe kreditorët e krijuar në dhjetor të vitit 2021 e të pa likuiduar, si në tabelën e mëposhtme:

*Në lekë*

Llogaritë	Emërtimi	Debitorë	Kreditorë
421	Personeli e llogari të lidhura me to		673,553
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa		52,860
435	Sigurime shoqërore		98,690
436	Sigurime shëndetësore		11,503
4342/1	Të tjera operacione me shtetin debitor kreditor	836,606	0
	<b>Shuma</b>	<b>836,606</b>	<b>836,606</b>

Gjendje debitorë në vlerë 836,606 lekë, paraqet detyrimet për paga e shtesa, tatime e sigurimet e muajit dhjetor 2021.



Llogaria 31 “Materiale” në vlerën 874,391 lekë, është më pak se një vit më parë, në vlerë 261,992 lekë. Llogaria 32 “Materiali i imët” në vlerën 515,670 lekë, është e njëjtë si një vit më parë (nuk ka ndryshime)

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, është më shumë se një vit më parë, në vlerë 14,744 lekë.

**Pasivi:** Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 6,436,527 lekë (që ka të bëjë kryesisht me llog. 466 “Kreditorë për mjete ne ruajtje”, ndërsa me grupe e klasa, janë si më poshtë:

Llogaritë e fondeve të veta janë pakësuar për këtë vit për - 609,209 lekë, dhe është rezultante e:

Llogaritë e fondeve bazë janë pakësuar për këtë vit për -609,209 lekë;

Llogaritë e grandeve të brendshme kapitale janë shtuar për këtë vit për 270,000 lekë;

Llogaritë e grandeve të huaja kapitale nuk kanë ndryshuar për këtë vit;

Llogaritë Vlera e AQ të caktuara në përdorim, nuk kanë ndryshuar për këtë vit.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtra, janë shtuar në vlerë 6,436,527 lekë, si më poshtë:

Llogaria 424,425 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit në vlerë 9,067 lekë;

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, është pakësuar këtë vit në vlerë 5,577 lekë;

Llogaria 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, është pakësuar këtë vit në vlerë 34,411 lekë.

Llogaria 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore”, është pakësuar këtë vit, në vlerë 100 lekë.

Ndërsa është shtuar në krahasim me një vit më parë llog. 466 në vlerën 6,485,682 lekë.

## Viti 2022

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1028 prot., datë 10.03.2023.

Kryeadministratori që është njëkohësisht NA i AAPSK-së rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit Tiranë dhe Ministrinë e Brendshme. Bilanci kontabël është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit, pra brenda muajit mars 2023.

## Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022

Në lekë

Referenca e	EMERTIMI	Ushtrimi I	Ushtrimi Paraardhës
Llogarive		Mbyllur	
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>	<b>28,894,547</b>	<b>26,437,003</b>
	<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>14,021,634</b>	<b>8,712,349</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>11,075,178</b>	<b>6,485,682</b>
520	Disponibilitete ne Thesar	11,075,178	6,485,682
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>1,560,794</b>	<b>1,390,061</b>
31	Materiale	1,045,124	874,391
32	Inventar i imët	515,670	515,670
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>1,385,662</b>	<b>836,606</b>
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	1,022,930	673,553
431	Tatim e Taksa	81,704	52,860
435	Sigurime Shoqërore	244,146	98,690
436	Sigurime Shëndetësore	36,882	11,503
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Aktivët Afat gjata</b>	<b>14,872,913</b>	<b>17,724,654</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>14,872,913</b>	<b>17,724,654</b>
210	Toka, Troje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		

212	Ndërtesa e Konstruksione	12,017,673	15,572,196
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	235,240	438,364
215	Mjete Transporti	2,400,000	357,787
218	Inventar ekonomik	220,000	1,356,307
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>12,460,840</b>	<b>7,287,877</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>12,460,840</b>	<b>7,287,877</b>
	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>12,460,840</b>	<b>7,287,877</b>
42	Detyrime ndaj personelit	1,022,930	673,553
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	81,704	52,860
435	Sigurime Shoqërore	244,146	64,279
436	Sigurime Shëndetësore	36,882	11,503
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	11,075,178	6,485,682
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>16,433,707</b>	<b>19,149,126</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>16,433,707</b>	<b>19,149,126</b>
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	-6,039,557	-1,348,679
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	1,385,662	540,203
105	Teprica e Granteve kapitale te Brendshme	20,450,502	19,320,502
106	Teprica e Granteve kapitale te Huaja	637,100	637,100
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim	0	
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>28,894,547</b>	<b>26,437,003</b>

## Aktivi

Llogaritë aktive, duke i krahasuar me një vit më parë rezultojnë se janë shtuar me 2,457,544 lekë. Në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, llogaria 211 “Pyje, plantacione” llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqiten në vlerën 0 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 12,017,673 lekë vlera e vitit të kaluar minus amortizimin vjetor.

Llogaria 214 është paraqitur me vlerën e vitit të kaluar minus amortizimin vjetor.

Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 2,400,000 lekë, është shtuar në vlerën 2,042,213 lekë, rezultat i hyrjes së një autoveture Audi A6.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,136,307 lekë, paraqitet sa vlera e një viti më parë minus amortizimin vjetor.

Llogaritë e aktiveve afatshkurtër, në vlerën 14,021,634 lekë (llogaria klasa 3, 4 dhe 5), me një shtesë në vlerën 5,309,285 lekë e analizuar si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”, shtuar në vlerën 4,589,496 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me mjetet monetare të depozituara në ruajtje të sekuestrimeve monetare.

Nga analiza e debi- kredive rezultoi se, në këtë institucion ka të evidentuar debitorët dhe kreditorët e krijuar në dhjetor të vitit 2022 e të pa likuiduar, si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llogaritë	Emërtimi	Debitore	Kreditore
421	Personeli e llogari të lidhura me to		1,022,930
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa		81,704
435	Sigurime shoqërore		244,146
436	Sigurime shëndetësore		36,882
4342/1	Të tjera operacione me shtetin debitor kreditor	1,385,662	0
	<b>Shuma</b>	<b>1,385,662</b>	<b>1,385,662</b>

Gjendje debitore në vlerë 1,385,662 lekë, paraqet detyrimet për paga e shtesa, tatime e sigurimet e muajit dhjetor 2022.

Llogaria 31 “Materiale” në vlerën 1,045,124 lekë, është më shumë se një vit më parë, në vlerë 170,733 lekë.

Llogaria 32 “Materiali i imët” në vlerën 515,670 lekë, është e njëjtë si një vit më parë (nuk ka ndryshime).

**Pasivi:** Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 5,172,963 lekë (që ka të bëjë kryesisht me llog. 466 “Kreditore për mjete ne ruajtje”, ndërsa me grupe e klasa, janë si më poshtë:

42	Detyrime ndaj personelit	1,022,930	673,553
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	81,704	52,860

435	Sigurime Shoqërore	244,146	64,279
436	Sigurime Shëndëtsore	36,882	11,503
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	11,075,178	6,485,682

Format 3 (pasqyra e cash flow) pasqyron planin e buxhetit, të ardhurat e krijuara, përdorimin e tyre, si dhe fondet e derdhura në buxhet dhe fondet e trashëguara për vitin 2023.

Formati 6,7 japin ndryshimet e Aktiveve të Qëndrueshme për shtesat dhe pakësimet, amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme.

Ndryshimet e mësipërme janë të barabarta me ndryshimet e fondit në Aktiv dhe Pasiv të Bilancit.

Formati 4 "Fondet Neto" pasqyron ndryshimet e Aktiveve të Qëndrueshme dhe gjendjen e fondeve, e barabartë me fondet në pasiv të bilancit, për të cilat nuk konstatohen problematika.

#### **Nga auditimi konstatohet se:**

Llogaritja e amortizimit vjetor për periudhën 2017-2021 është bërë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 36 të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, konkretisht:

- Për ndërtesat (Ilog. 212) është llogaritur amortizim në masën 1% të kostos historike ndërkohë që duhet të llogaritej në masën 5% të vlerës së mbetur;

- Për inventarin ekonomik (Ilog. 218) është llogaritur në masën rreth 0.3% të kostos historike për pajisjet me afat të gjatë përdorimi ndërkohë që duhet të ishin llogaritur në masën 5% të vlerës së mbetur. Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni janë amortizuar me 25% të vlerës historike ndërkohë që duhet të ishin amortizuar mbi bazë grupimi me normën 25% të vlerës së mbetur;

- Për instalime pajisje (Ilog. 214) është llogaritur amortizimi në masën 6% të kostos historike ndërkohë që duhet të llogaritej në masën 5% të vlerës së mbetur.

Për vitin 2020, gjithashtu se për shkak të ristrukturimit, nga ana e AAPSK-së janë përgatitur 2 raportime financiare, konkretisht:

- për periudhën 01.01.2020-31.11.2020, periudhë e cila ka qenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- për periudhën 01.12.2020-31.12.2020, periudhë në të cilën AAPSK ka kaluar në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Nga auditimi konstatohet se klasa e AAM (ndërtesa e konstruksione, instalime teknike, makineri e pajisje, mjete transporti, inventar ekonomik) paraqitet e njëjtë si në datën 30.11.2020 ashtu dhe në datën 31.12.2020, duke mos llogaritur saktë amortizimin me bazë mujore, si rrjedhojë as paraqitjen e fragmentizuar në veprimet rregulluese dhe të mbylljes së pasqyrave financiare.

Për llogaritjet gabim të amortizimit ngarkohet me përgjegjësi znj. E.H., në cilësinë e specialistes për përgatitjen e pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Pasqyrat financiare nuk reflektojnë plotësisht vlerën e drejtë të AAGJ-ve.
<b>Situata:</b>	<p><b>Nga auditimi mbi përgatitjen e pasqyrave financiare konstatohet se:</b></p> <p>Llogaritja e amortizimit vjetor për përgatitjen e pasqyrave financiare të periudhës objekt auditimi 2017-2021 është bërë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 36 të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, konkretisht:</p> <p>-Për ndërtesat (Ilog. 212) është llogaritur amortizim në masën 1% të kostos historike ndërkohë që duhet të llogaritej në masën 5% të vlerës së mbetur;</p> <p>-Për inventarin ekonomik (Ilog. 218) është llogaritur në masën rreth 0.3% të kostos historike për pajisjet me afat të gjatë përdorimi ndërkohë që duhet të ishin llogaritur në masën 5% të vlerës së mbetur. Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni janë</p>

	<p>amortizuar me 25% të vlerës historike ndërkohë që duhet të ishin amortizuar mbi bazë grupimi me normën 25% të vlerës së mbetur;</p> <p>-Për instalime pajisje (Ilog. 214) është llogaritur amortizimi në masën 6% të kostos historike ndërkohë që duhet të llogaritej në masën 5% të vlerës së mbetur.</p> <p>Për vitin 2020, gjithashtu se për shkak të ristrukturimit, nga ana e AAPSK-së janë përgatitur 2 raportime financiare, konkretisht:</p> <p>-për periudhën 01.01.2020-31.11.2020, periudhë e cila ka qenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>-për periudhën 01.12.2020-31.12.2020, periudhë në të cilën AAPSK ka kaluar në varësi të Ministrisë së Brendshme.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se klasa e AAM (ndërtesa e konstruksione, instalime teknike, makineri e pajisje, mjete transporti, inventar ekonomik) paraqitet e njëjtë si në datën 30.11.2020 ashtu dhe në datën 31.12.2020, duke mos llogaritur saktë amortizimin me bazë mujore, si rrjedhojë as paraqitjen e fragmentizuar në veprimet rregulluese dhe të mbylljes së pasqyrave financiare.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36.
<b>Impakti:</b>	Pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë plotësisht vlerën e drejtë të AAGJ-ve.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i akteve ligjore në llogaritjen e amortizimit të aktiveve.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për rishikimin e gjithë veprimeve korrigjuese me qëllim paraqitjen e saktë dhe të drejtë të vlerave të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

### 2.3.4 Inventarizimi i Aktiveve dhe Materialeve në AAPSK

#### Viti 2017

Kryeadministratori z. A.K, në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ka nxjerrë Urdhrin nr. 1148 datë 21.12.2017 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK”. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 26.12.2017 dhe përfundon në datën 29.12.2017.

#### Viti 2018

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 1201 datë 20.12.2018 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK”, i përbërë nga 3 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 24.12.2018 dhe përfundon në datën 28.12.2018.

#### Viti 2019

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 1219 datë 16.12.2019 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK”, i përbërë nga 3 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 26.12.2019 dhe përfundon në datën 31.12.2019.

## Viti 2020

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 2192 datë 21.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK”, i përbërë nga 3 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 21.12.2020 dhe përfundon në datën 31.12.2020.

## Viti 2021

Kryeadministratori z. Q.Th, ka nxjerrë Urdhrin nr. 3381 datë 14.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK”, i përbërë nga 3 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 21.12.2021 dhe përfundon në datën 31.12.2020.

## Viti 2022

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 3504 datë 07.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK”, i përbërë nga 3 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 12.12.2022 dhe përfundon në datën 31.12.2022.

### **Nga auditimi për periudhën e aktivitetit 2017-2022 konstatohet se:**

- Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit ka mbajtur procesverbal (pv nr. 1) me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit në përputhje me përcaktimet në UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 83.

- Në përfundim të inventarizimit, janë përgatitur listat për çdo llogari dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale, si dhe përmbledhësja e të gjitha kartelave të inventarit, të firmosura nga personat përgjegjës dhe anëtarët e komisionit të inventarizimit.

- Në përfundim të procesit të inventarizimit është përgatitur relacioni, me përjashtim të vitit 2021, për të cilin nuk është përgatitur relacion në kundërshtim me pikën c të nenit 85 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar e cila citon: *Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve....dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.*

- Përfundimi i inventarizimit fizik të AQT në AAPSK, brenda muajit Mars, bën që bilanci vjetor dhe pasqyrat financiare të viteve 2017-2022, të paraqiten sipas gjendjeve kontabël dhe të krahasuara me gjendjen fizike, në përputhje me nenin 15 të ligjit nr. 25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pika 1 citohet “*Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.*

## **Inventarizimi i Fizik i Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK**

### **Viti 2017**

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 1101 datë 14.12.2017 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të pronave dhe llogarive në administrim të AAPSK-së”, i përbërë nga 3 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 25.12.2017 dhe përfundon në datën 29.12.2017.

### ***Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar të inventarizimit, konstatohet se:***

Komisioni në prani të administratorëve në datën 25.12.2017, ka fiksuar numrin e pasurive në kartelat e secilit administrator, ku rezultojnë si në vijim:

<b>Emërtimi</b>	<b>Nr</b>
Pasuri të konfiskuara	63
Pasuri të sekuestruara	142
<b>Total</b>	<b>205</b>

Nga 205 pasuri në administrim: 109 pasuri janë të paluajtshme, 82 janë llogari

rrjedhëse/depozita dhe 14 janë Automjete dhe pajisje në lagunën e Karavastasë të cilat janë skrap për shitje.

Llogaritë e rrjedhëse në administrim në datën **31.12.2017** rezultojnë si në vijim:

Nr.	Llogaria/Monedha	Teprica 31.12.2017
1	I.S. Bank / lekë	1,773.04
2	R. Bank / lekë	0
3	V. Bank / lekë	1,586,368
4	V. Bank / euro	128,402.34
5	V. Bank / usd	26,562.70
6	V. Bank / lekë	31,496,811.18

Bashkëlidhur procedurës së inventarizimit gjenden ekstraktet bankare dhe kartelat e inventarit të pasurive në administrim.

Me shkresën nr. 18 prot., datë 05.01.2018 është përgatitur relacioni drejtuar Kryeadministratorit në lidhje me procedurën e inventarizimit.

Në përfundim të 2 procedurave të inventarizimit, ka dal Urdhri i brendshëm nr. 122 datë 31.01.2018 “Për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimin e aktiveve dhe materialeve të dëmtuara në AAPSK”, në vlerën 4,624,523 lekë.

Sipas pikës 3 të Urdhrit, ngarkohet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin. Konstatohet se ky komisioni është ngritur rreth 6 muaj pas daljes së Urdhrit, konkretisht me shkresën nr. 742 datë 20.07.2018 dhe shkresën nr. 742/1 datë 20.07.2018.

Në datën 23.07.2018 është mbajtur procesverbali nga komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e 24 aktiveve të qëndrueshme.

Në datën 25.07.2018 është mbajtur procesverbali nga komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve.

Bashkëlidhur procesverbaleve gjenden foto të asgjësimit të tyre në Sharrë.

#### **Nga auditimi konstatohet se:**

Komisioni nuk ka bërë asgjësim të Autoveturës tip Opel Frontera, me argumentin se nuk mund të bënin vlerësim teknik të saj duke qenë se në komision nuk ka inxhiner mekanik, duke vijuar në këtë mënyrë regjistrimin në kontabilitet.

Ky veprim është në kundërshtim me pikën 1 dhe 3 të Urdhrit nr. 742/1 prot., datë 20.07.2018 të cilat citojnë:

**Pika 1:** Të ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e automjeteve, pajisjeve të zyrave si dhe materialeve të tjera...

**Pika 3:** Për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin, komisioni të bazohet në proces verbalet e hartuara nga Komisioni i Inventarizimit.

#### **Viti 2018, 2019 dhe 2021**

-Për vitin 2018-2019 dhe 2021 nuk ka dal urdhër dhe si rrjedhojë nuk është kryer Inventarizimi fizik i Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK, duke sjellë risk të humbjes apo tjetërsimit të tyre, veprim ky në kundërshtim me pikën 26 dhe 28 të kreut III, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

#### **Viti 2020**

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 2190 datë 21.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të pronave dhe Llogarive në administrim të AAPSK-së”, i përbërë nga 3 anëtarë.

Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 21.12.2020 dhe përfundon në datën 31.12.2020.

#### **Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të inventarizimit, konstatohet se:**

Me shkresën e Kryeadministratorit nr. 2190/1 prot., datë 21.12.2020 “Autorizim brenda vendit”, është autorizuar grupi i punës për të kryer kontrollin fizik dhe inventarizimin e

pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në rrethet Lezhë dhe Shkodër, periudha 22.12.2020 deri në 24.12.2020.

Me shkresën e Kryeadministratorit nr. 2190/2 prot., datë 21.12.2020 “Autorizim brenda vendit”, është autorizuar grupi i punës për të kryer kontrollin fizik dhe inventarizimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në rrethet Vlorë dhe Sarandë, periudha 28.12.2020 deri në 30.12.2020.

Me shkresën e Kryeadministratorit nr. 2190/3 prot., datë 21.12.2020 “Autorizim brenda vendit”, është autorizuar grupi i punës për të kryer kontrollin fizik dhe inventarizimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në rrethin e Dibrës, periudha 24.12.2020 deri në 25.12.2020.

Me shkresën e Kryeadministratorit nr. 2190/4 prot., datë 21.12.2020 “Autorizim brenda vendit”, është autorizuar grupi i punës për të kryer kontrollin fizik dhe inventarizimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në rrethet Vlorë dhe Sarandë, periudha 28.12.2020 deri në 30.12.2020.

Shkresa nr. 2190/4 prot., datë 21.12.2020, ka të njëjtin objekt kontrolli dhe periudhë me shkresën nr. 2190/2 prot., datë 21.12.2020, vetëm se në shkresën nr. 2190/4 është shtuar në grup pune edhe Kryeadministratori.

*Nga auditimi konstatohet se, Bashkëlidhur dosjes së inventarizimit nuk gjendet dokumentacion, procesverbal apo relacion në lidhje me rezultatet e kontrollit fizik dhe inventarizimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, sipas shkresave të mësipërme, duke sjellë risk të humbjes apo tjetërsimit të tyre, veprim ky në kundërshtim me pikën 26 dhe 28 të kreut III, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, përgjegjësi e grupeve të autorizuar të punës.*

## **Viti 2022**

Kryeadministratori z. A.K, ka nxjerrë Urdhrin nr. 169 datë 07.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të pronave dhe Llogarive në administrim të AAPSK-së”, i përbërë nga 7 anëtarë. Sipas Urdhrit të mësipërm, inventari fillon në datën 07.12.2022 dhe përfundon në datën 31.12.2022.

Është mbajtur procesverbali më datë 13.12.2022, mbi inventarizimin e pasurive të Administratorit z. S.M, bashkëlidhur procesverbalit gjenden të dokumentuara edhe fotot e pasurive.

Është mbajtur procesverbali më datë 22.12.2022, mbi inventarizimin e pasurive të Administratorit z. E.B, z. E.M, z. B.B, z. A.B, bashkëlidhur procesverbalit gjenden të dokumentuara edhe fotot e pasurive.

Me shkresën nr. 358 prot., datë 30.01.2023 është përgatitur raporti “Mbi gjendjen e inventarit fizik të pasurive të sekuestruara/konfiskuara dhe të paluajtshme në administrim të AAPSK”. Sipas këtij raporti, mbështetur dhe në kartelat e pasurive të administratorëve, rezulton se në datën 31.12.2022 gjendja e pasurive është:

*-Nr total i pasurive të sekuestruara 534, me një vlerë totale prej 13,812,092,873 lekë.*

*-Nr total i pasurive të konfiskuara 175, me një vlerë totale prej 1,729,959,780 lekë.*

Sipas këtij raporti, sqarohet se vlerësimi i pasurive është kryer dhe pasqyruar nga Administratorët e pasurive, mbështetur në vlera të përafërta tregu.

### **Nga auditimi konstatohet se:**

*-Bashkëlidhur procedurës së inventarizimit nuk gjenden ekstraktet bankare dhe kartelat e inventarit të pasurive në administrim sipas administratorëve.*

*-Bashkëlidhur dosjes së inventarizimit nuk gjenden procesverbale në lidhje me pasuritë e administratorëve të tjerë.*

*-Mungon organizimi dhe dokumentimi i veprimeve kontabël i aktivitetit të administratorëve dhe pronat që kanë ata në administrim.*

**Si konkluzion nuk është kryer një inventarizim i detajuar dhe i plotë në lidhje me pasuritë dhe llogaritë në administrim nga AAPSK.**

*Për mos-nxjerrjen e Urdhrave të inventarizimit fizik të Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK për vitin 2018, 2019 dhe 2021 ngarkohen me përgjegjësi z. A.K dhe z. Q.Th në cilësinë e Kryeadministratorit të AAPSK-së.*

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Nuk është kryer inventarizimi fizik i Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK-së për vitin 2018-2019 dhe 2021; Për vitin 2020 mungon relacioni me rezultatet e procesit të inventarizimit dhe-për vitin 2022 komisioni i inventarizimit nuk ka përgatitur relacion përfundimtar.
<b>Situata:</b>	<p><b><i>Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit fizik të Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK-së u konstatua se:</i></b></p> <p>-Për vitin 2018-2019 dhe vitin 2021 nuk është ka dal urdhër dhe si rrjedhojë nuk është kryer Inventarizimi fizik i Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK, duke sjellë risk të humbjes apo tjetërsimit të tyre, veprim ky në kundërshtim me pikën 26 dhe 28 të kreut III, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.</p> <p>-Për vitin 2020 nga ana e Kryeadministratorit është nxjerrë Urdhri nr. 2190 datë 21.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të pronave dhe Llogarive në administrim të AAPSK-së. Bashkëlidhur dosjes së inventarizimit nuk gjendet asnjë dokumentacion, procesverbal apo relacion në lidhje me rezultatet e kontrollit fizik dhe inventarizimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, veprim ky në kundërshtim me Urdhrin nr. 2190 datë 21.12.2020.</p> <p>Për vitin 2022 konstatohet se nuk është kryer një inventarizim i detajuar dhe i plotë në lidhje me pasuritë dhe llogaritë në administrim nga AAPSK, duke qenë se:</p> <p><i>-Bashkëlidhur procedurës së inventarizimit nuk gjenden ekstraktet bankare dhe kartelat e inventarit të pasurive në administrim sipas administratorëve.</i></p> <p><i>-Bashkëlidhur dosjes së inventarizimit nuk gjenden procesverbale në lidhje me pasuritë e të gjithë administratorëve.</i></p> <p><i>-Mungon organizimi dhe dokumentimi i veprimeve kontabël i aktivitetit të administratorëve dhe pronat që kanë ata në administrim.</i></p> <p><b><i>Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK u konstatua se:</i></b></p> <p>-Për vitin 2022 nga ana e komisionit të inventarizimit nuk është përgatitur relacion në përfundim të procesit të inventarizimit në kundërshtim me shkronjën c të pikës 85 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011.</p>
<b>Kriteri:</b>	- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 26, 28, shkronja c e pikës 85
<b>Impakti:</b>	Mungesa e kryerjes së inventarizimit fizik të Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK sjellë risk të humbjes apo tjetërsimit të tyre.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i akteve ligjore në fushën e administrimit të pasurisë.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	<p>-Nga ana e Kryeadministratorit të AAPSK-së të merren masa për kryerjen e inventarizimit vjetor fizik të pronave dhe llogarive në administrim të AAPSK-së me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre.</p> <p>-Nga ana e komisioneve të inventarizimit të merren masa që në përfundim të procedurave të inventarizimit të përgatisin relacionin përmbledhës drejtuar Kryeadministratorit, me qëllim përcjelljen e rezultateve dhe problematikave të konstatuara.</p>



### **2.3.5 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Nga AAPSK nuk është ngritur një sistem funksional dhe efektiv për menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm siç përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin të sipërcituar, detajuar si në vijim:

#### **Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi**

##### **1. Mjedisi i kontrollit:**

a) AAPSK funksionon në zbatim të:

-Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, ndryshuar me ligjin nr. 19/2020, datë 05.03.2020;

-VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”;

-VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

-Urdhrit të Kryeministrit nr. 67 datë 13.04.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AAPSK”;

-Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”;

-Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 324, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara”;

-Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 323, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara”;

-Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 80, datë 06.03.2020 “Për kushtet e zbatimit të urdhrimit për evakuimin e ndërtesave që janë objekt i masës së sekuestros” etj.

Nga auditimi evidentohet se ka mospërputhje ligjore ndërmjet ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, për afatet e dorëzimit të pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit, përkatësisht: Sipas nenit 22 “Dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit”, pika 1 e ligjit nr. 34/2019 përcaktohet: “Me marrjen dijeni të vendimit gjyqësor për revokimin e sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 ditëve, njofton personin që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe për detyrimet që janë parapaguar nga shteti, të shoqëruara me dokumentacionin financiar përkatës”.

Ndërkohë që sipas nenit 28, pika 2 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 përcaktohet: “Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara”, pra referuar këtij neni AAPSK-ja duhet të dorëzojë pasurinë brenda 15 ditëve nga njoftimi i palëve të interesuar nga gjykata, çka nxjerr në pah mungesën e harmonizimit të këtyre dispozitave ligjore në lidhje me afatet e revokimit.

- Gjithashtu, lidhur me marrjen në dorëzim të provave materiale, kryesisht për disa sende specifike si: bizhuteri, armë, ilaçe etj, veprimtaria e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk gjen trajtim ligjor si në ligjin 10192, datë 03.12.2009 të ndryshuar, me ligjin nr. 70/2017 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ashtu dhe në ligjin 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” të ndryshuar.

b) Institucioni ka të miratuar rregulloren e brendshme nr. 1371/1, prot., datë 07.06.2022. Në rregulloren e miratuar u konstatua, të jenë trajtuar qëllimi, objekti, strukturën organizative, funksionet, detyrat e përgjegjësitë për çdo sektor dhe funksion të punonjësve të institucionit. Lidhur me përmbajtjen e rregullores, konstatohet se:

-Nuk është marrë në konsideratë ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe manuali i dalë në zbatim të tij, lidhur me përgjegjësitë e menaxherëve për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Nuk është parashikuar mbajtja e një protokollit të brendshëm nga specialisti i protokollit për lëvizjet e çdo shkrese nga poshtë-lart/lart-poshtë dhe paralel, si kriter i rëndësishëm për të adresuar përgjegjësitë por edhe për të matur performancës e punës (për të vlerësuar mendime, relacione apo kërkesa secilit punonjës, etj.).

-Kontrata e qirasë, sipas rregullores së AAPSK-së është parashikuar të monitorohet dhe mbikëqyret nga gjithë specialistët, Shefat e sektorëve dhe nga administratori gjithashtu, pa adresuar qartë strukturën/personin përgjegjës të monitorimit të kontratave.

-Nuk përcaktohen qartë me procedurë të shkruar kriteret e trajtimit të kërkesave të administratorëve për shpenzime për pasuritë që administrojnë dhe që lidhen me anën financiare, (mirëmbajtja, ruajtja, investimi) me qëllim adresimin e përgjegjësive në rastet e problematikave të hasura me këto pasuri.

-Janë përcaktuar detyrat e specialistit për kontrollin fizik të pasurive dhe provave materiale por nuk përcaktohet detyrimi për të mbajtur inventarin e pasurive sipas statusit të tyre dhe për të kryer rakordimet mujore e progresive të gjendjes fizike të tyre dhe rakordimin me administratorët, për t'i dhënë vlerë raportimit të Kryeadministratori të gjendjes së pasurive;

-Në nenin 25 thuhet se marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës ndërkohë që rregullohen edhe me statusin e nëpunësit civil për administratën e AAPSK-së.

-Nuk parashikohen në rregullore kërkesat e ligjit për sinjalizimin, ndjekja e procedurave antikorrupsion, e cila përfshin procedurën e regjistrimit dhe raportimit tek strukturat kompetente; masat që janë marrë për parandalimin e mashtrimeve dhe të parregullsive; Sigurimi, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

-Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e këtij institucioni është miratuar Kodi i Etikës së Agjencisë më 01.06.2011, ku përcaktohen normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë midis tyre, nëpunësve të institucionit i është kërkuar të respektojnë rregullat e kodit të etikës të hartuar referuar ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” i ndryshuar.

c) AAPSK për periudhën objekt auditimi ka funksionuar fillimisht me Urdhrin e Kryeministrit nr. 206 datë 31.12.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”. Sipas këtij Urdhri numri i punonjësve rezulton **8**, pa përfshirë administratorët e pasurive.

Në vijim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 14 datë 13.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” kjo strukturë ka ndryshuar dhe numri i punonjësve rezulton **14**. Në vijim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 67 datë 13.04.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” kjo strukturë ka ndryshuar sërish por pa ndryshuar numri total i punonjësve.

-Referuar strukturës aktuale konstatohet se struktura përgjegjëse për financat është e shpërndarë në dy sektorë të pavarura nga njëri-tjetri (Sektori i administrimit ekonomiko-financiar i pasurive dhe provave materiale me Përgjegjësin e sektorit si Nëpunës zbatues si dhe Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse), nga të cilët Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse nuk drejtohet nga Nëpunësi zbatues megjithëse merret me planifikimin, monitorimin, zbatimin e buxhetit, kontabilitetit si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të AAPSK-së.

Në funksion të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, në neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), është niveli menaxherial në vartësi direkt të Kryeadministratorit por në funksionet e tij, duhet të mbulojë edhe funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

ç) Marrëdhëniet/ose kriteret e pranimit në punë të punonjësve organike të Agjencisë janë të rregulluara me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet në zbatim të tij ndërsa marrëdhëniet e punës për administratorët/ndihmës administratorët janë të rregulluara me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë të përcaktuara rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin, kohën e punës etj.

d) Në lidhje me trajnimin e stafit gjatë periudhës nën auditim, për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale janë zhvilluar trajnime dhe seminare me tematika në fushën e veprimtarisë së Agjencisë, si psh me GIZ, OSCE, ASHK, KE, Undoc, DAP etj.

## **2. Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Nga auditimi u konstatua se AAPSK nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut dhe nuk ka autorizuar punonjës në rolin e Koordinatorit të riskut, veprim në kundërshtim me:

-pikën 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, *“Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.”*;

-pikën 3.2, “Përgjegjësitë menaxheriale të aktorëve në MR”, të udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrit të Financave, ku përcaktohet se: 3.2.1 *“Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut”*. 3.2.2 *“Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...)”*.

## **3. Aktivitetet e kontrollit**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave.

Nga auditimi u konstatua se sistemi i nënshkrimeve nuk është përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

Gjithashtu, në rregulloren e brendshme nuk janë të përcaktuara rregullat që lidhen me dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e agjencisë, në kundërshtim me përcaktimet e pikave nr. 1, 2 dhe 3, të nenit 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

## **4. Informacioni dhe komunikimi**

Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korrespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave, veprim në mospërputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010. Mos kryerja e këtyre veprimeve përbëjnë risk në këtë institucion, pasi nuk lihen gjurmë për auditimin e veprimtarisë të nëpunësve të saj. Agjencia ka faqen e saj zyrtare por nuk ka person përgjegjës për mirëmbajtjen e saj.

Megjithëse AAPSK-ja ka një sistem të informatizuar në të cilin duhet të jepen të dhëna historike lidhur me procedurat e administrimit, sekuestrimet, konfiskimet, revokimet si dhe gjithë shpenzimet që kryhen gjatë administrimit të këtyre pasurive, rezultoi se ky sistem nuk përdoret, por të dhënat mbahen në Excel.

### 5. Monitorimi dhe Raportimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të agjencisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilën është krijuar agjencia.

Nëpunësit e AAPSK zotërojnë informacion, por jo të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar në të gjitha elementët e tij.

Titullarët e njësive publike, referuar nenit 24 të ligjit të MFK-së, janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, nëpërmjet monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. *Monitorimi nëpërmjet vetëvlerësimit dhe hartimit të raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm: Nga ana e institucionit të AAPSK-së nuk ishin përgatitur Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm.*

Respektimi i dispozitave ligjore mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin është përgjegjësi e strukturave drejtuese të AAPSK-së, konkretisht e z. A.K. në cilësinë e Titullarit, periudha 01.10.2017-09.03.2021, z. Q.Th në cilësinë e Titullarit, periudha 09.03.2021-01.04.2022, z. A.K. në cilësinë e Titullarit, periudha 01.04.2022-31.12.2022.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Nga AAPSK nuk është ngritur një sistem funksional dhe efektiv për menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi evidentohet se ka mospërputhje ligjore ndërmjet ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, për afatet e dorëzimit të pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit, përkatësisht: Sipas nenit 22 “Dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit”, pika 1 e ligjit nr. 34/2019 përcaktohet: “Me marrjen dijani të vendimit gjyqësor për revokimin e sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 ditëve, njofton personin që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe për detyrimet që janë parapaguar nga shteti, të shoqëruara me dokumentacionin financiar përkatës”.</p> <p>Ndërkohë që sipas nenit 28, pika 2 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 përcaktohet: “Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara”, pra referuar këtij neni AAPSK-ja duhet të dorëzojë pasurinë brenda 15 ditëve nga njoftimi i palëve të interesuar nga gjykata, çka nxjerr në pah mungesën e harmonizimit të këtyre dispozitave ligjore në lidhje me afatet e revokimit. Gjithashtu, lidhur me marrjen në dorëzim të provave materiale, kryesisht për disa sende specifike si: bizhuteri, armë, ilaçe etj, veprimtaria e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk gjen trajtim ligjor si në ligjin 10192, datë 03.12.2009 të ndryshuar, me ligjin nr. 70/2017 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ashtu dhe në ligjin 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” të ndryshuar.</p> <p><b>-marrjen në dorëzim të provave materiale.</b> Bazuar në ligjin 10192, datë 03.12.2009 të ndryshuar, me ligjin nr. 70/2017 “Për parandalimin dhe</p>

	<p><i>goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë</i>” dhe ligjit 34/2019 të ndryshuar “<i>Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara</i>” <i>Për marrjen në dorëzim të provave materiale</i>”, AAPSK-ja nuk ka një bazë ligjore, kryesisht për disa sende specifike si: bizhuteri, armë, ilaçe etj.</p> <p>2. Nga ana e AAPSK-së nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, veprim ky jo në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar. Gjithashtu nuk ka autorizuar punonjës në rolin e Koordinatorit të riskut, jo në përputhje me pikën 3.2 të udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016.</p> <p>3. Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e agjencisë, veprim ky jo në përputhje me pikën 3, neni 16 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.</p> <p>4. Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korrespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave, veprim ky jo në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.</p> <p>5. Nëpunësit e AAPSK zotërojnë informacion, por jo të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar në të gjitha elementët e tij.</p> <p>Për sa më sipër evidentohet se nga ana e AAPSK-së nuk janë marr masa për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv për kontrollin e brendshëm.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 16, neni 21, neni 23.
<b>Impakti:</b>	Mospërmbushja e detyrimeve menaxheriale për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv të kontrollit të brendshëm paraqet risk të shtuar për realizimin e objektivave të AAPSK-së.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Strukturat drejtuese në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrin masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm me qëllim ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv.

## 2.4 Të tjera

### 2.4.1 Mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës me stafin e punësuar me kontratë “administratorët” si dhe procedurat e krijimit dhe administrimit të dosjeve të personelit.

Në zbatim të këtij drejtimi u auditua dokumentacioni përbërës, pjesë e dosjeve të personelit, në lidhje me stafin e punësuar me kontratë (administratorët), për gjithsej 12 administratorë të punësuar me kontratë, në bazë të Kodit të Punës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, u konstatuan disa parregullsi, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

#### **Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

##### ***a-Mbi Procedurën e Krijimit dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit.***

- Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, në të gjitha dosjet personelit (gjithsej 12 administratorë) **mungon “fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit”**,

në mospërputhje me lidhjen nr. 2 të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”.

- Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, për administratorët: z. E.B, z. E.A, z. S.M, znj. E.S, **nuk është kryer plotësimi apo përditësimi i librezës së punës**, në mospërputhje me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020.

- Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, për administratorët: z. Gj.D, z. F.A, z. B.B, z. T.Ç, znj. E.O, **mungojnë librezat e punës**, në kundërshtim me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, e cila në pikën 3 të lidhjes 1 të saj cilëson “librezën e punës” si një dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit me qëllim vërtetimin e pohimit të bërë në fletën prezantuese.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **z. S.Sh.** me detyrë përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse. Përgjegjësitë në rastin konkret rrjedhin nga pika II/3 e VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit” sipas të cilës: “Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar” si dhe Rregulloren e AAPSK-së e cila në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit përcakton, ndër të tjera, në nenin 12, pika 1, germa (i) atë të: “Hartimit dhe administrimit të regjistrave dhe dosjeve të punonjësve të Agjencisë dhe të administratoreve të pasurive”.

**b-Në lidhje me vlerësimin periodik të performancës së administratorëve.**

Në lidhje me mënyrën e vlerësimit periodik të performancës së administratorëve dhe nd/administratorëve Rregullorja e AAPSK-së përcakton, ndër të tjera, në kreun VIII, neni 27, pika 1, se: “Për vlerësimin e performancës të punës kryeadministratori mbështetet në relacionin e analizës së punës 6-mujore dhe vjetore të administratorëve, nga sektori i administrimit ekonomik-financiar të pasurive”.

**Së pari**, nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se vlerësimet e performancës, fizikisht, nuk janë pjesë e tyre. Këto të fundit administrohen të gjitha së bashku në një dosje më vete në mospërputhje me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1 sipas të cilës: “Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera...”.

**Së dyti**, nga verifikimi i përmbajtjes së formularit të vlerësimit të performancës, rezultojnë se ky akt administrativ krijohet pas një raportimi që përgjegjësi i sektorit të administrimit ekonomik-financiar i bën kryeadministratorit. Këta të fundit janë të vetmit persona (punonjës) të cilët nënshkruajnë formularin e vlerësimit të performancës. Mungesa e nënshkrimit të formularit të vlerësimit nga administratori apo nd/administratori përkatës e bën të pamundur konfirmimin e faktit në qoftë se këta të fundit janë njohur apo jo me vlerësimin si dhe qëndrimin e tyre (pro/kundra) kundrejt tij.

Vlen të theksohet se, sipas rregullores nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 27, pika 4: “Kur vlerësimet e punës për administratorin dhe ndihmës administratorin e pasurisë për dy herë radhazi janë jo kënaqshëm, titullari i agjencisë ka të drejtë e **prishjes së kontratës së punës së lidhur ndërmjet tyre**”. Gjithashtu pika 5 përcakton se: “Kundër vendimit të titullarit të agjencisë, administratori dhe ndihmës administratori i pasurisë i drejtohet gjykatës në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, që rregullojnë këto marrëdhënie”.

Nga sa më sipër, rezultojnë se vlerësimi i performancës është një akt i cili prek ose ndikon në interesat ligjorë të subjekteve punëmarrës dhe si i tillë mungesa e njoftimit të tij është në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Si konkluzion**, keqadministrimi i formularëve të vlerësimit të performancës si dhe mungesa e njoftimit të tyre, ndikon negativisht në menaxhimin e marrëdhënies së punës midis palëve si

dhe përbën një risk eventual të shtuar për institucionin e AAPSK-së kundrejt një legjitimiteti pasiv procesual.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **z. S.Sh.** me detyrë përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse si dhe **titullari i institucionit** (sipas periudhës: z. A.K 01.10.2017-09.03.2021; z. Q.Th 09.03.2021-01.04.2022; z. A.K 01.04.2022-31.12.2022).

**c-Në lidhje me vijimin e marrëdhënieve të punës me punonjësit (administratorët) të cilët kanë arritur moshën për dalje në pension pleqërie.**

Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, institucioni i AAPSK-së, në 2 (dy) raste, vijon marrëdhënien e punës me administratorët punëmarrës edhe pse këta të fundit, duke filluar nga një periudhë relativisht të gjatë kohore, kanë arritur moshën për dalje në pension pleqërie. Konkretisht:

**-Z. F.A.**, me detyrë “*administrator i pasurive të sekuestruara dhe/ose konfiskuara*”, i datëlindjes 20.10.1949, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, rezulton të ketë arritur moshën për dalje në pension pleqërie duke filluar nga viti 2014 (prej gati më shumë se 8 vite).

**-Z. B.B.**, me detyrë “*administrator i pasurive të sekuestruara dhe/ose konfiskuara*”, i datëlindjes 21.02.1954, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, rezulton të ketë arritur moshën për dalje në pension pleqërie duke filluar nga viti 2019 (prej gati më shumë se 3 vite).

Vijimi i marrëdhënies së punës me administratorët e sipërcituar së pari konsiderohet si një veprim apo mosveprim në mospërputhje me kontratën individuale të punës midis palëve, e cila në nenin 6 të saj përcakton “*arritjen e moshës për dalje në pension*” si një kriter i cili legjitimon (titullarin) punëdhënësin për largimin e punëmarrësit nga puna.

Nga ana tjetër, vijimi i marrëdhënies së punës përtej (datës) afatit të “*arritjes së moshës për dalje në pension*” rezulton të jetë një veprim apo mosveprim në kundërshtim me VKM-në nr. 478, datë 16.6.2010 “*Për Ndërprerjen e Marrëdhënieve të Punës, nga Organet e Administratës Shtetërore, pas Plotësimit të Kushteve për Pension Pleqërie*”. Ky vendim rregullon procedurat që do të ndiqen nga organet e administratës shtetërore, të financuara tërësisht apo pjesërisht nga Buxheti i Shtetit, në rastet e plotësimit, nga ana e nëpunësit/punonjësit të siguruar, të kushteve për pension pleqërie, në përputhje me dispozitat e ligjit “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”. Konkretisht, pika 4 e VKM-së nr. 478, datë 16.6.2010 përcakton se: “*Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës për këtë kategori nëpunësish/punonjësish*”.

**Si konkluzion**, vazhdimi i marrëdhënieve të punës përtej (datës) afatit të “*arritjes së moshës për dalje në pension*”, përveçse bije ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në miradministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **titullari i institucionit** (sipas periudhës: z. A.K. 01.10.2017-09.03.2021; z. Q.Th. 09.03.2021-01.04.2022; z. A.K. 01.04.2022-31.12.2022).

**ç-Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë AAPSK-së.**

AAPSK është agjenci buxhetore në varësi të “*ministrit përgjegjës të rendit dhe sigurisë publike*” dhe aktualisht funksionon sipas strukturës të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 67, datë 13.04.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të sekuestruara dhe të Konfiskuara*” dhe përbëhet nga:

**I-Kryeadministratori**

**II. Sektori i administrimit ekonomik-financiar i pasurive .**

2.1 Përgjegjësi i sektorit.

- 2.3 Specialist për marrjen në administrim të pasurive.
- 2.4 Specialist për ndjekjen e shpenzimeve dhe të ardhurave të pasurive.
- 2.5 Specialist për regjistrin e të dhënave dhe sistemit informativ.

### **III-Sektori i marrëdhënieve me institucionet, çështjeve juridike dhe provave materiale.**

- 3.1 Përgjegjësi i sektori.
- 3.2 Specialist për marrëdhëniet me institucionet dhe ndjekjen e projekteve.
- 3.3 Specialist për kontrollin fizik të pasurive dhe provave materiale.
- 3.4 Specialist për çështje juridike.

### **IV. Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse.**

- 4.1. Përgjegjës sektori.
- 4.2 Specialist (financë/ buxhet/ burime njerëzore)
- 4.3 Specialist protokollist-arkivist
- 4.4 Magazinier.

Organizimi dhe funksionimi për të gjithë stafin e agjencisë është rregulluar, ndër të tjera, edhe me rregulloren e brendshme të institucionit nr. 1371/1, datë 07.06.2022, aktualisht në fuqi.

Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Përveç sa më sipër, pjesë e stafit të AAPSK-së janë edhe administratorët dhe ndihmës administratorët e pasurive, për të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Aktualisht AAPSK ka të kontraktuar 23 punonjës me kontratë pune, nga të cilët 12 administratorë dhe 11 ndihmës administratorë.

Ligji 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara...”, i ndryshuar, në nenin 6, pika 4 të tij, përcakton se: “Kriteret profesionale, si dhe ato për autorizimin dhe/ose kontraktimin e personelit të jashtëm përcaktohen me udhëzim të “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, ka dalë Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 323, dt. 02.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

Ndër të tjera, në pikën 2 të urdhrin të sipërcituar, janë të përcaktuara edhe kriteret ku AAPSK duhet të bazohet për punësimin e administratorëve, si vijon:

-Arsimin e administratorit, i cili duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, në shkenca Ekonomike, Juridike dhe Inxhinierike.

-Preferencë të veçantë kanë ekspertët ekonomistë dhe vlerësues të licencuar.

-Vjetërsia në punë duhet të jetë jo më pak se 5 vite.

Vlen të theksohet se në pikën 9 të urdhrin të sipërcituar është përcaktuar se: “Kriteret e përcaktuara në këtë urdher nuk aplikohen për administratorët e pasurisë së sekuestruar e të konfiskuara të cilët janë në marrëdhënie pune me AAPSK-në para hyrjes në fuqi të këtij urdhri”.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e AAPSK-së për rekrutimin (punësimin) e 4 administratorëve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:

**1-Për punësimin e administratorit z. E.M,** nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: AAPSK në datën 03.06.2022 ka kryer dhe dokumentuar shpalljen e konkurimit të hapur për vendin vakant; Në datën 02.06.2022 me urdhrin nr. 1644 prot., titullari i institucionit ka ngritur komisionin për vlerësimin e kandidatëve; Në datën 13.06.2022 nga komisioni përkatës është kryer vlerësimi i kandidatëve dhe është shpallur fitues z. E. M.;

Grupi i auditimit vlerëson se, procedura e rekrutimit për administratorin z. E. M. është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe se nga punëmarrësi plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr. 323, dt. 02.10.2020.

**2-Për punësimin e administratorit z. E.A,** nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: Pavarësisht se nga ana e punëmarrësit plotësohen kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr. 323, dt. 02.10.2020, nga ana e AAPSK nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurimi e hapur për këtë pozicion pune.



Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i administratorit z. E. A., pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

**3-Për punësimin e administratorit z. Gj.D.**, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: **a)** Nga ana e AAPSK nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurimi e hapur për këtë pozicion pune.

**b)** Përveç mungesës së një procedurë konkurimi të hapur për këtë pozicion, nga administratori z. Gj.D, nuk plotësohet kriteri i arsimit në lidhje me pozicionin e punës. Konkretisht, niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet është “*diplomë të nivelit të dytë, në shkenca Ekonomike, Juridike apo Inxhinierike*”. Rezulton se z. Gj.D. është pajisur me diplomën nr. 1069 pasi ka kryer studimet në vitet 2000-2004 pranë fakultetit të Shkencave të Natyrës “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, në degën Matematikë-Fizikë nga ku ka marrë titullin “*Mësues i Matematikës dhe Fizikës*”.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i administratorit z. Gj.D., në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

**4-Për punësimin e administratorit z. T.Ç.**, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se:

**a)** Nga ana e AAPSK nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurimi e hapur për këtë pozicion pune.

**b)** Përveç mungesës së një procedurë konkurimi të hapur për këtë pozicion, nga administratori z. T.Ç, nuk plotësohet kriteri i arsimit në lidhje me pozicionin e punës. Konkretisht, niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet është “*diplomë të nivelit të dytë, në shkenca Ekonomike, Juridike apo Inxhinierike*”. Rezulton se z. T.Ç. është pajisur me diplomën nr. 4153 pasi **ka kryer studimet e Ciklit të Parë (BACHELOR)** pranë fakultetit jo publik të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale “K.”, në degën Drejtësi.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i administratorit z. T.Ç., në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

**Si konkluzion**, punësimi pranë AAPSK i administratorëve të cilët nuk plotësojnë kriteret e kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në miradministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R.Sh., Ligjin nr. 34/2019 dhe Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 323, dt. 02.10.2020, veprime për të cilat, ndër të tjera, referuar Ligjit 34/2019 “*Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara...*”, i ndryshuar, neni 9, pika 2, gërma c, ç dhe d, ngarkohet me përgjegjësi titullari i institucionit (sipas periudhës: z. A.K. 01.10.2017-09.03.2021; z. Q.Th. 09.03.2021-01.04.2022; z. A.K. 01.04.2022-31.12.2022).

**d-Në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore kundrejt punonjësve (administratorëve) të AAPSK-së.**

Organizimi dhe funksionimi për të gjithë stafin e agjencisë është rregulluar, ndër të tjera, edhe me rregulloren e brendshme të institucionit, nr. 1371/1, datë 07.06.2022, aktualisht në fuqi.

Marrëdhëniet e punës së Agjencisë me stafin e administratorëve dhe ndihmës administratorëve rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Në dispozitat e sipërcituara janë përcaktuar gjithashtu edhe llojet, kompetencat si dhe procedurat që duhet të ndiqen në rastet e dhënies së masave disiplinore. Konkretisht, Rregullorja e AAPSK-së përcakton, ndër të tjera, në nenin 29 “*Llojet e masave disiplinore*” për të vijuar me nenin 30 ku përcaktohen gjithashtu “*Procedurat për dhënien e masave disiplinore*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se titullari i institucionit për disa nga administratorët ka dhënë masa disiplinore në mospërputhje me rregulloren e brendshme të institucionit, konkretisht:

-Për administratorin **z. E.B.**, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se, titullari i institucionit ka dhënë masën “vërejtje” me shkresën “*Njoftim për dhënien e masës disiplinore*” nr. 1257/1 prot., datë 26.04.2022. Kjo shkresë, e hartuar në një fletë formati të vetme, rezulton të përbëjë të gjithë praktikën apo veprimtarinë e titullarit për dhënien e masës. Nga intervistat e kryera me punonjësit të cilët kanë marrë masën disiplinore por edhe sipas përmbajtjes së dokumentacionit në dosjen e personelit rezulton se nga ana e titullarit: **a)** punonjësi nuk është informuar paraprakisht për procedimin disiplinor të filluar kundrejt tij; **b)** punonjësi nuk është dëgjuar apo thirrur për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit; **c)** punonjësit nuk i është dhënë mundësia për t’u mbrojtur.

-Për administratorin **z. S.M.**, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se, titullari i institucionit ka dhënë masën “vërejtje” me shkresën “*Njoftim për dhënien e masës disiplinore*” nr. 1258/1 prot., datë 26.04.2022. Kjo shkresë, e hartuar në një fletë formati të vetme, rezulton të përbëjë të gjithë praktikën apo veprimtarinë e titullarit për dhënien e masës. Nga intervistat e kryera me punonjësit të cilët kanë marrë masën disiplinore por edhe sipas përmbajtjes së dokumentacionit në dosjen e personelit rezulton se nga ana e titullarit: **a)** punonjësi nuk është informuar paraprakisht për procedimin disiplinor të filluar kundrejt tij; **b)** punonjësi nuk është dëgjuar apo thirrur për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit; **c)** punonjësit nuk i është dhënë mundësia për t’u mbrojtur.

-Për administratorin **z. T.Ç.**, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se, titullari i institucionit ka dhënë masën “vërejtje” me shkresën “*Njoftim për dhënien e masës disiplinore*” nr. 1260/1 prot., datë 26.04.2022. Kjo shkresë, e hartuar në një fletë formati të vetme, rezulton të përbëjë të gjithë praktikën apo veprimtarinë e titullarit për dhënien e masës. Nga intervistat e kryera me punonjësit të cilët kanë marrë masën disiplinore por edhe sipas përmbajtjes së dokumentacionit në dosjen e personelit rezulton se nga ana e titullarit: **a)** punonjësi nuk është informuar paraprakisht për procedimin disiplinor të filluar kundrejt tij; **b)** punonjësi nuk është dëgjuar apo thirrur për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit; **c)** punonjësit nuk i është dhënë mundësia për t’u mbrojtur.

-Për administratorin **znj. E.S.**, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se, titullari i institucionit ka dhënë masën “vërejtje me paralajmërim për shkelje të rregullores” me shkresën “*Njoftim për dhënien e masës disiplinore*” nr. 1049 prot., datë 07.04.2022. Kjo shkresë, së bashku me “*urdhrin e brendshëm*” nr. 1048 prot., datë 07.04.2022, rezulton të përbëjë të gjithë praktikën apo veprimtarinë e titullarit për dhënien e masës. Nga intervistat e kryera me punonjësit të cilët kanë marrë masën disiplinore por edhe sipas përmbajtjes së dokumentacionit në dosjen e personelit rezulton se nga ana e titullarit: **a)** punonjësi nuk është informuar paraprakisht për procedimin disiplinor të filluar kundrejt tij; **b)** punonjësi nuk është dëgjuar apo thirrur për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit; **c)** punonjësit nuk i është dhënë mundësia për t’u mbrojtur.

**Së pari**, nga verifikimi i përmbajtjes së praktikës të ndjekur nga titullari për dhënien e masës, që do të thotë, gjithë veprimtaria administrative që kryhet nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, rezulton të jetë në mospërputhje me rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 30, ku përcaktohet se: “*Masat disiplinore jepen nga Kryeadministratori me propozim të eprorit direkt, sipas një procedure që garanton të drejtën për tu informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar*”.

**Së dyti**, nga verifikimi i përmbajtjes së “*Njoftimit për dhënien e masës disiplinore*” për administratorët z. E.B., z. S.M. dhe z. T.Ç. rezulton se përveç pikës 1 të dhënies së masës “vërejtje”, me arsyen e paraqitjes me vonesë në punë, nga titullari është vendosur edhe pika 2 sipas të cilës, “*punonjësve të sipërcituar ju ndalohet një ditë nga paga e tyre mujore*”. Nga intervistat e kryera me punonjësit, këta të fundit pretendojnë se, pavarësisht paraqitjes në punë me disa minuta vonesë, kanë vijuar punën për pjesën tjetër të orarit. Gjithashtu rezulton se “*ndalimi i pagës ditore në rast paraqitje me vonesë në punë*” nuk është një masë e përcaktuar as në kontratën e punës dhe as në rregulloren e brendshme të AAPSK. Kjo e fundit, në nenin

29, përcakton “llojet e masave” të cilat janë: “a) vërejtje; b) vërejtje me shkrim; c) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra; c) ulje e përkohshme në detyrë për 1 deri në 2 vjet, në një nivel me të ulët; d) shkarkim nga detyra”.

Ndalimi i pagës për pjesën e orarit në të cilin punonjësit kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në shërbim të punëdhënësit nuk gjen mbështetje ligjore.

**Së treti**, në lidhje me masat e dhëna nga titullari i institucionit rezultojnë gjithashtu të mos jetë zbatuar plotësisht procedura e përcaktuar në aspektin e kompetencës. Në rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 30, përcaktohet se: “Masat disiplinore jepen nga Kryeadministratori me propozim të eprorit direkt, sipas një procedure që garanton të drejtën për tu informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar”.

Nga intervistat e kryera me punonjësit të cilët kanë marrë masën disiplinore por edhe sipas përmbytjes së dokumentacionit në dosjen e personelit rezultojnë se nga ana e eprorit direkt nuk është propozuar (nuk ka të dokumentuar) asnjë masë disiplinore.

Vlen të theksohet se, sipas rregullores nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, në rastet kur punonjësi merr dy masa disiplinore brenda 6 muajve punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme marrëdhënien e punës.

Nga sa më sipër, rezultojnë se “masa disiplinore” është një akt i cili prek ose ndikon në interesat ligjorë të subjekteve punëmarrës, dhe si e tillë, veprimtaria procedurale për dhënien e saj, me qëllim shmangien e paligjshmërisë, duhet të kryhet, ndër të tjera, në përputhje me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Si konkluzion**, dhënia e masave disiplinore, nëpërmjet një veprimtarie administrative, në kundërshtim me procedurat e kërkuara nga kuadri ligjor rregullator, ndikon negativisht në menaxhimin e marrëdhënies së punës midis palëve si dhe përbën një risk eventual të shtuar për institucionin e AAPSK-së kundrejt një legjitimiteti pasiv procesual.

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **z. S.Sh.** me detyrë përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse si dhe titullari i institucionit (z. A.K 01.04.2022-31.12.2022).

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në trajtimin e marrëdhënieve të punës me stafin e punësuar me kontratë “administratorët” si dhe në procedurat e krijimit dhe administrimit të dosjeve të personelit.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi rregullshmërinë e procedurave të marrëdhënieve të punës dhe administrimit të dosjeve të personelit në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, u konstatua se: 1-Në të gjitha dosjet e personelit (gjithsej 12 administratorë) mungon “fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit”, në 4 raste nuk është kryer plotësimi apo përditësimi i librezës së punës, ndërsa për 5 raste librezat e punës mungojnë. Në lidhje me këtë situatë VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/3 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbytjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit” përcakton se: “Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar”, gjithashtu pika II/1 përcakton se: “Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij”. 2-Vlerësimet e performancës, nuk janë pjesë e dosjeve të personelit por administrohen të gjitha së bashku në një dosje më vete në mospërputhje me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1. Nga verifikimi i përmbytjes së formularit të vlerësimit të performancës, rezultojnë se ky

	<p>akt administrativ krijohet pas një raportimi që përgjegjësi i sektorit të administrimit ekonomik-financiar i bën kryeadministratorit. Këta të fundit janë të vetmit persona (punonjës) të cilët nënshkruajnë formularin e vlerësimit të performancës. Mungesa e nënshkrimit të formularit të vlerësimit nga administratori apo nd/administratori përkatës e bën të pamundur konfirmimin e faktit në qoftë se këta të fundit janë njohur apo jo me vlerësimin si dhe qëndrimin e tyre (pro/kundra) kundrejt tij.</p> <p>3-Për 2(dy) punonjës, ka vijuar marrëdhënia e punës edhe pse prej një periudhe relativisht të gjatë kohore, kanë arritur moshën për dalje në pension pleqërie. Në lidhje me këtë situatë VKM nr. 478, datë 16.6.2010, pika 4, përcakton se: <i>“Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës për këtë kategori nëpunësish/punonjësish”;</i></p> <p>4- Në 1 rast punësimi në pozicionin administrator, nga verifikimi i dosjes së personelit nuk rezulton të jetë zhvilluar një procedurë konkurimi e hapur për këtë pozicion pune. Në 2 raste të tjera, po në pozicionin administrator, përveçse nuk rezulton të jetë zhvilluar një procedurë konkurimi e hapur, rezulton gjithashtu se nuk plotësohet kriteri i arsimit në lidhje me pozicionin e punës. Në lidhje me këtë situatë është vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor në vijim: <i>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, ku përcaktohet se: “Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.”;</i></p> <p><i>Ligji 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara...”, i ndryshuar, neni 6, pika 4, ku përcaktohet se: “Kriteret profesionale, si dhe ato për autorizimin dhe/ose kontraktimin e personelit të jashtëm caktohen me udhëzim të “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”;</i> <i>Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 323, dt. 02.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, ku ndër të tjera, në pikën 2 janë të përcaktuara edhe kriteret ku AAPSK duhet të bazohet për punësimin e administratorëve, si vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Arsimin e administratorit, i cili duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, në shkenca Ekonomike, Juridike dhe Inxhinierike.</li> <li>-Preferencë të veçantë kanë ekspertët ekonomistë dhe vlerësues të licencuar.</li> <li>-Vjetërsia në punë duhet të jetë jo më pak se 5 vite.</li> </ul> <p>5-Nga ana e titullarit të institucionit, në katër raste, është dhënë masa disiplinore në mospërputhje me rregulloren e brendshme të institucionit nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 30 sipas të cilës: <i>“Masat disiplinore jepen nga Kryeadministratori me propozim të eprorit direkt, sipas një procedure që garanton të drejtën për tu informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar”.</i></p>
<p><b>Kriteri:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2;</li> <li>-Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 4, 147 pika 1 dhe 3;</li> <li>-Ligji 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara...”, i ndryshuar, neni 6, pika 4;</li> </ul>

	<p>-VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/ 1 dhe 3 “Për Rregullat e Hollësishtme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrimit Qendror të Personelit”;</p> <p>-VKM-së nr. 478, datë 16.6.2010, pika 4,</p> <p>-Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 323, dt. 02.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve...”;</p> <p>Rregullorja nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK-së, neni 30.</p>
<b>Impakti:</b>	<p>-Mangësitë e konstatuara në keqadministrimi i dosjeve të personelit, keqadministrimin e formularëve të vlerësimit të performancës, dhënien e masave disiplinore, nëpërmjet një veprimtarie administrative, në kundërshtim me procedurat e kërkuara nga kuadri ligjor rregullator, ndikojnë negativisht në raportimin, zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore si dhe përbëjnë një risk eventual të shtuar për institucionin e AAPSK-së kundrejt një legjitimiteti pasiv procesual.</p> <p>-Vazhdimi i marrëdhënieve të punës përtej afatit të “arritjes së moshës për dalje në pension”, dhe punësimi pranë AAPSK i administratorëve të cilët nuk plotësojnë kriteret e kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në miradministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.</p>
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimit i kuadrit ligjor rregullator në fuqi.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga ana e Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: që punësimi i administratorëve të kryhet me një procedurë konkurimi të hapur dhe në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës; që gjatë dhënies së masave disiplinore, të respektohet procedura administrative duke i garantuar të drejtën e subjektit për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar; që administratorët dhe ndihmës administratorët, të njihen me formularin përkatës të vlerësimit të performancës dhe ky i fundit të jetë pjesë e dosjeve të personelit; Gjithashtu të merren masa për plotësimin dhe përditësimin e librezave të punës si dhe për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit që arrijnë moshën për dalje në pension pleqërie.</p>

#### **2.4.2 Mbi shpërndarjen dhe përballimin e shpenzimeve të administrimit që lindin nga pagesa e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës**

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se pagat e administratorëve dhe ndihmës/adm për periudhën objekt auditimi janë si vijon:

Vitet (periudha)	Paga dhe sigurime
3/mujori I katërt 2017	3,052,418.00
2018	13,182,651.00
2019	11,570,493.00
2020	12,928,827.00
2021	14,747,208.00
2022	18,951,575.00
<b>TOTALI:</b>	<b>74,433,172.00</b>

Për sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur rezulton se, paga e administratorit dhe ndihmës/adm përbën një shpenzim i cili parapaguhet nga shteti dhe në rast të revokimit të sekuestrimit ky shpenzim “paga”, sipas nenit 31 të ligjit nr. 34/2019, i ngarkohet sipas kartelës personit që i është rikthyer pasuria. Mospagimi i detyrimeve nga personi që i është rikthyer prona e sekuestruar, sjell si pasojë mosdorëzimin e pasurisë nga Agjencia, deri në momentin e plotësimit të vendimit nga gjykata dhe/ose të pagimit të plotë të të gjitha detyrimeve nga personi.

Duke qenë se një administrator ka në administrim disa pasuri, në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së këtij zëri “shpenzimi”, administratorë të ndryshëm krijojnë shpërndarje në mënyra të ndryshme dhe me subjektivitet. Konkretisht, disa administratorë e shpërndajnë këtë zë shpenzimi si në kartelat e pasurive të luajtshme ashtu edhe në ato të paluajtshme, disa të tjerë vetëm tek pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu, në rastet e shpërndarjes midis kartelave të pasurive të paluajtshme, kjo shpërndarje është kryer në përpjesëtim me numrin e pasurive pa i'u referuar vlerës përkatëse të pasurisë. Kjo situatë, nga intervistat e kryera me stafin e administratorëve, rezulton se ka krijuar problematika në marrëdhënie me subjektet “pronarë” (veçanërisht për mjetet motorike).

**Psh:** Në rast se një administrator merr në administrim 2 pasuri, në lidhje me shpenzimin “pagë”, do të ngarkojë secilën nga kartelat e pasurive me 50% të vlerës së pagës. Në të njëjtën kohë, në qoftë se, një administrator tjetër merr në administrim 10 pasuri, në lidhje me shpenzimin “pagë”, do të ngarkojë secilën nga kartelat e pasurive me 10% të vlerës së pagës. Në këto kushte, rezulton se, pasuri të ndryshme por të njëjta nga lloji (psh. mjete) ngarkohen me një vlerë të ndryshme shpenzimi.

Nga ana tjetër, në rast se një administrator merr në administrim 2 pasuri (psh. një hotel dhe një apartament), në lidhje me shpenzimin “pagë”, do të ngarkojë secilën nga kartelat e pasurive me 50% të vlerës së pagës. Në këto kushte, rezulton se, pasuri me vlera të ndryshme, të cilat kërkojnë një kohë/dedikim jo të njëjtë për administrimin e tyre ngarkohen me një vlerë të njëjtë shpenzimi.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Problematika në lidhje me mënyrën e shpërndarjes dhe përballimit të shpenzimeve të administrimit që lindin nga pagesa e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi shpërndarjen dhe përballimin e shpenzimeve të administrimit ka rezultuar se, në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”, administratorë të ndryshëm krijojnë shpërndarje të ndryshme me subjektivitet dhe në shkelje të parimit të proporcionalitetit. Konkretisht, disa administratorë e shpërndajnë këtë zë shpenzimi si në kartelat e pasurive të luajtshme ashtu edhe në ato të paluajtshme, disa të tjerë vetëm tek pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu, në rastet e shpërndarjes midis kartelave të pasurive të paluajtshme, kjo shpërndarje është kryer në përpjesëtim me numrin e pasurive pa i'u referuar vlerës përkatëse të pasurisë.
<b>Kriteri:</b>	-Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 11, 12 dhe 13;
<b>Impakti:</b>	Veprimtaria e sipërcituar rezulton të jetë në mospërputhje me parimin e proporcionalitetit, ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, drejtësisë dhe paanësisë.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e kriteve të qarta lidhur me shpërndarjen e zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të ngrejë një grup pune për analizimin e situatës dhe më

pas të përcaktojë kritere të qarta lidhur me shpërndarjen e zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”.
--

#### IV GJETJET DHE REKOMANDIMET

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi evidentohet se ka mospërputhje ligjore ndërmjet ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, për afatet e dorëzimit të pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit, përkatësisht: Sipas nenit 22 “Dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit”, pika 1 e ligjit nr. 34/2019 përcaktohet: “Me marrjen dijani të vendimit gjyqësor për revokimin e sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 ditëve, njofton personin që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe për detyrimet që janë parapaguar nga shteti, të shoqëruara me dokumentacionin financiar përkatës”.

Ndërkohë që sipas nenit 28, pika 2 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 përcaktohet: “Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara”, pra referuar këtij neni AAPSK-ja duhet të dorëzojë pasurinë brenda 15 ditëve nga njoftimi i palëve të interesuar nga gjykata, çka nxjerr në pah mungesën e harmonizimit të këtyre dispozitave ligjore në lidhje me afatet e revokimit.

- Gjithashtu, lidhur me marrjen në dorëzim të provave materiale, kryesisht për disa sende specifike si: bizhuteri, armë, ilaçe etj, veprimtaria e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk gjen trajtim ligjor si në ligjin 10192, datë 03.12.2009 të ndryshuar, me ligjin nr. 70/2017 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ashtu dhe në ligjin 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” të ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.5 faqe 188-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1Rekomandimi:** Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të marrin masa për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet për përmirësim ligjor me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor në fuqi në lidhje me afatet e revokimit dhe marrjes në dorëzim të provave materiale.

**Brenda vitit 2023**

### B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka një sistem elektronik për mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara (RPSK), por nuk aksesohet nga administratorët për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, duke sjellë për pasojë mungesën e një baze të dhënash për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mangësi në monitorimin e

tyre dhe risk të shtuar në keqadministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 33 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar dhe me kërkesat e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

Ky regjistër është instaluar nga AKSHI në vitin 2018 dhe sipas informacioneve të vëna në dispozicion, AAPSK nuk e administron kontratën e lidhur, vlerën e shpenzuar për sistemin dhe mirëmbajtjen e tij, pasi procedura e prokurimit është zhvilluar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Mungesa e kontratës vështirëson ndjekjen, monitorimin e zbatimit të saj dhe vlerësimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale. Mungesa e aksesimit në sistem nga ana e administratorëve nuk ka mundësuar marrjen e informacioneve në lidhje me institucionin, administratorët, numrin dhe datën e vendimit, subjektin, numrin e pasurive të sekuestruara, konfiskuara, revokuara, vendimet gjyqësore që kanë prekur pasurinë, statuset e tyre, kontratat e qirave dhe të ardhurat e shpenzimet e bëra për çdo pasuri, etj. Përgjatë viteve 2018-2022, ky regjistër nuk ka shërbyer për mbikëqyrjen e proceseve, ka shtuar volumin shkresor, ndërkohë që nuk ka mundësuar kryerjen e veprimeve online nga ana e administratorëve. Mungesa e krijimit të një baze të dhënash në lidhje me një informacion të përgjithshëm për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mungesa e regjistrimit dhe monitorimit të të gjithë objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara të dhëna me qira, është tregues i qartë që ky regjistër elektronik nuk ka arritur qëllimin për të cilin është konceptuar dhe ka sjellë shpenzime pa efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit.

Nga AAPSK, regjistri i të dhënave është mbajtur në format Excel, i cili ka pasur përdorim të brendshëm, pa i krijuar akses institucioneve që kanë të drejtën e marrjes së informacionit të drejtpërdrejtë apo statistika raportuese në RPSK, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 14 të VKM nr. 835, datë 28.10.2020.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1 faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mungesën e aksesimit të regjistrimit elektronik, si dhe të komunikojë me strukturat drejtuese të Ministrisë së Brendshme dhe AKSHI-t, me qëllim vënien në përdorim dhe përditësimin e regjistrimit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

### **Brenda vitit 2023**

**2. Gjetje nga auditimi:** a) Nga shqyrtimi i praktikës, në lidhje me procedurat e ndjekura nga administratori në funksion të qiradhënies së pasurisë, rezulton se përpara lidhjes kontratës së qirasë, në një rast, nuk është kërkuar deklaratë me shkrim nga qiramarrësi, ku ky i fundit të deklarojë se nuk ka lidhje me shtetasin të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës. Në këtë rast, administratori ka vepruar në kundërshtim të Rregullores nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25.

b) Nga shqyrtimi i praktikës së ndjekur nga administratorët përkatës, rezulton se, në një rast, nuk janë marrë masa për zbatimin e plotë të vendimit të gjykatës. Në informacionin e përgatitur nga administratori citohet ndër të tjera se: “*Subjekti “T.T. B.” me NIPT K.....E nuk mund të merret në administrim pasi ka rezultate negative (mungesë fitimi) dhe për pasojë mund të ketë impakt social negativ...*”. Vendimi i marrë në mënyrë diskrecionale nga ana e administratorit për të mos marrë një pasuri në administrim rezulton në kundërshtim me nenin 11, pika 2 (a, c) të ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”. Nga ana tjetër, në rastin konkret, justifikimi i fitimit të munguar të subjektit nuk qëndron pasi, sipas ekstraktit të shoqërisë, kjo e fundit ka deklaruar 16,680,084 lekë fitim për vitin 2020 dhe 216,767,616 lekë fitim për vitin 2021.

c) Administratori i pasurisë, në lidhje me veprimet e “bllokimit” të pasurive pranë ASHK-së përkatëse, ka vepruar me një vonesë prej më shumë se 8 muaj, nisur nga fakti se emërimi i tij



është kryer në datën 29.10.2020, ndërsa kërkesa drejtuar ASHK-së është e datës 28.07.2021. Në lidhje me këto veprime, në kuadrin ligjor rregullator, parashikohet se administratori duhet të veprojë menjëherë, pra administratori ka vepruar në kundërshtim me nenin 11, pika 2/a, e ligjit nr. 34/2019 *“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*.

- Administratori i pasurisë, në lidhje pasurinë “truall 900 m<sup>2</sup>” nga të cilat 300 m<sup>2</sup> ndërtesë, në të cilën kryhet aktiviteti “hotel, restorant, bar-kafe”, pasi e ka marrë në dorëzim, i ka lënë administrimin e saj shtetases e cila është subjekt i vendimit të sekuestrimit. Edhe pse sipas procesverbalit citohet se *“këto pasuri i janë lënë në ruajtje...”* disponimi i pasurisë në rastin konkret përkon me administrimin e saj, veprime në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 14, pika 25, sipas të cilës: *“Administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në lidhjen e kontratave të qirasë të pasurive, të kërkojnë deklaratë me shkrim nga personat fizik apo juridik, të cilët do të marrin me qira pasurinë, që nuk kanë lidhje me shtetasit apo subjektet e përfshira në vendimin e gjykatës, të cilëve ju është bërë sekuestrimi apo konfiskimi i pasurisë”*.

d) Nga auditimi i kryer, rezultoi se në 2 raste, për një kohë të gjatë, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive të paluajtshme, të konfiskuara me vendim gjykate, konkretisht:

-Për pasurinë e konfiskuar me vendimin nr. 4, datë 18.01.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda”, për një periudhë 12-vjeçare (2008-2022) nuk është kryer asnjë veprim. Gjithashtu, duke filluar që nga data e emërimit të administratores së pasurisë më 07.09.2022 deri në mbylljen e auditimit në terren, edhe pse procedurat paraprake të nevojshme janë kryer, kjo pronë, në tejkallim të afateve (90 ditë), ende nuk i është kaluar për vendimmarrje destinimi Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimet të Organizuar.

-Për pasurinë e konfiskuar me vendimin nr. 37, datë 13.07.2021 të GJKKO, për një periudhë 9-mujore pas datës së komunikimit të vendimit të formës së prerë të konfiskimit nuk është kryer asnjë veprim. Moskryerja e veprimeve brenda afatit ligjor rezulton në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 23, pika 2 të ligjit nr. 34/2019 *“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*, çka ndikon negativisht në mirëadministrimin e pasurive, përkundër parimit të efektivitetit, efijencës, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë.

e) Nga auditimi i kryer, konstatohet se pas marrjes në dorëzim të pasurive të paluajtshme, nga ana e administratorit nuk rezulton të jenë kryer raportime te kryeadministratori, gjykata apo prokurorit të çështjes mbi gjendjen e pasurive. Gjithashtu nuk rezulton e dokumentuar, të jetë kryer ndonjë veprim me qëllim rritjen e vlerës së pasurive, duke i dhënë ato me qira, në kundërshtim me nenin 11, pika 2/(ç dhe e) të ligjit nr. 34/2019 *“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*.

f) Nga auditimi i kryer, konstatohet se pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara me vendimin nr. 112, datë 20.07.2020 të GJKKO, nga ana e administratorit, në raportimin kundrejt kryeadministratorit, gjykatës dhe prokurorit të çështjes, ndër të tjera, citohet se: *“është kryer ekzekutimi i plotë i vendimit të gjykatës...”*. Pavarësisht këtij pohimi, nuk rezulton të jetë marrë në administrim automjeti me targë A.....Y, i markës “Audi” model A6, në kundërshtim me nenin 11, pika 2/(dh) të ligjit nr. 34/2019 *“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*.

g) Pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara, në të gjitha rastet apo praktikat e shqyrtuara nga grupi i auditimit rezulton se, në asnjë rast, nga administratori i pasurisë së sekuestruar, nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë, për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Gjithashtu, nuk rezultojnë të jenë kryer nga administratorët veprime paraprake për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kontrate të vlefshme sigurimi të pasurisë përpara marrjes së tyre në administrim, çka do të justifikonte apo përlligjte mosveprimin në rastin konkret, veprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht: Ligjin nr. 34/2019 *“Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*, neni 18; VKM nr. 687, datë 05.10.2011 *“Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*, kreu VI, pika 2/b; Udhëzimin nr. 324, datë

02.10.2020 “Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave për Administrimin e të Ardhurave dhe Limiteve të Kryerjes së Shpenzimeve për Pasuritë e Sekuestruara dhe Konfiskuara”, kreu II, pika 2/3; Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 e AAPSK-së, neni 17, pika 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1Rekomandimi:** Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për problematikat e konstatuara në administrimin e pasurive. Administratorët, të marrin masa për plotësimin e deklaratës me shkrim para lidhjes së kontratës së qirasë; marrjen në administrim në afatet përkatëse; njoftimin e menjëhershëm të masës së sekuestrimit, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; për paraqitjen në afat të pasurive të konfiskuara me vendim gjykatë të formës së prerë pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar; për paraqitjen e raporteve dhe kërkesave në afatet respektive, si dhe sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer, konstatohet se, të gjitha dosjet fizike të administrimit të audituara (25), të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbale, shkresa të dala, kthim përgjigje, etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes ose ky i fundit pasqyron vetëm pjesërisht përmbajtjen, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi kërkohet që për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1Rekomandimi:** Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nga ana e administratorit përkatës dhe ndihmësit të tij, të merren masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke cilësuar të gjithë procesin apo veprimtarinë administrative në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer, konstatohet se, në 14 raste, në lidhje me veprimet e kryera në kuadër të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, për sa i përket mjeteve motorike të cilat ende nuk janë marrë në administrim, administratorët janë mjaftuar vetëm me kërkesën “për bashkëpunim” drejtuar Policisë së Shtetit. Nga sa më sipër, rezulton se administratorët nuk kanë marrë masa për të shmangur mundësinë e tjetërsimit të mjeteve të cilat ende nuk janë marrë në administrim, situatë e cila nuk reflekton zbatimin e nenit 5 të Ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”. Konkretisht, bllokimi i mundësisë së tjetërsimit të mjetit, mbi të cilin është vendosur një masë sekuestro, realizohet nga Regjistri i Barreve Siguruese (R.B.S).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1Rekomandimi:** Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe nga ana e administratorit përkatës, në lidhje me mjetet motorike, të cilat ende nuk janë marrë në administrim (dorëzim), të merren masa, për njoftimin e DPSHTRR-së si dhe për vendosjen e RBS-së.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i ekstraktit historik dhe dokumentacionit përbërës të tij, në lidhje me dhjetë shoqëri tregtare në administrim të drejtpërdrejtë nga administratorët, u konstatuan disa parregullsi, në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht:

a-Në 7 (shtatë) raste rezultoi se QKB ka regjistruar vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë, vendim me të cilin, përveçse janë miratuar “Pasqyrat Financiare”, është vendosur gjithashtu edhe për destinimin e fitimit të shoqërisë. Referuar përmbajtjes së vendimeve në fjalë, rezultoi se, personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, ka marrë dhe ka nënshkruar vendimin është subjekti kundrejt të cilit gjykata ka vendosur masën e sekuestros preventive. Në

rastet e sipërcituara, subjektet rezultojnë të kenë kryer një vendimmarrje në mungesë të plotë të kompetencës për sa kohë janë subjekt i një vendimi gjykate me të cilin, veç të tjerave, është vendosur sekuestrimi i kuotave/aksioneve duke kaluar këto të fundit në administrim të AAPSK. Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, neni 16, pika 1, me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5;

b-Në 3 (tre) raste rezultoi se, nuk është regjistruar bilanci vjetor kontabël për vitin 2021. Nga administratorët përkatës, nuk janë marrë masat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit të të dhënave në regjistrin tregtar sipas përcaktimeve të nenit 22 dhe 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rastin konkret, edhe pse administrimi dhe menaxhimi i shoqërive kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një institucion shtetëror (AAPSK), në zbatim të ligjit nr. 34/2019, neni 19, pika 4, duhet të zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë, pra të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 95, pika 3 (dh) dhe ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 57-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1Rekomandimi:** Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, administratorët përkatës, në lidhje me shoqëritë tregtare të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë, të merren masa që:

- Vendimmarrja për administrimin e tyre të jetë e pavarur dhe e pandikuar nga subjekti mbi të cilin rëndon masa e sekuestros apo konfiskimit;
- Regjistrimi i bilancit vjetor kontabël pranë QKB-së, të kryhet brenda afateve ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë e procedurave të marrëdhënieve të punës dhe administrimit të dosjeve të personelit në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, rezultoi se:

a-Në të gjitha dosjet e personelit (për 12 administratorë) mungon “fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit”, në 4 raste nuk është kryer plotësimi apo përditësimi i librezës së punës, ndërsa për 5 raste librezat e punës mungojnë. Situata e konstatuar është në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/3 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”.

b-Vlerësimet e performancës, nuk janë pjesë e dosjeve të personelit por administrohen të gjitha së bashku në një dosje më vete në mospërputhje me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1. Nga verifikimi i përmbajtjes së formularit të vlerësimit të performancës, rezultoi se ky akt administrativ krijohet pas një raportimi që përgjegjësi i sektorit të administrimit ekonomik-financiar i bën kryeadministratorit. Këta të fundit janë të vetmit persona (punonjës), të cilët nënshkruajnë formularin e vlerësimit të performancës. Mungesa e nënshkrimit të formularit të vlerësimit nga administratori apo nd/administratori përkatës e bën të pamundur konfirmimin e faktit në qoftë se këta të fundit janë njohur apo jo me vlerësimin, si dhe qëndrimin e tyre (pro/kundra) kundrejt tij.

c-Për 2 (dy) punonjës, ka vijuar marrëdhënia e punës edhe pse është arritur moshja për pension pleqërie, në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.6.2010, pika 4.

d-Në 1 (një) rast punësimi në pozicionin administrator, nga verifikimi i dosjes së personelit nuk rezulton të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune. Në 2 raste të tjera, po në pozicionin administrator, përveçse nuk rezulton të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur, rezulton gjithashtu se nuk plotësohet kriteri i arsimit në lidhje me pozicionin e punës. Në lidhje me këtë situatë është vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor, konkretisht, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2; Ligjin 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara”, i ndryshuar, neni 6, pika 4; Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 323, dt. 02.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe

*rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.*

e-Nga ana e titullarit të institucionit, në 4 (katër) raste, është dhënë masa disiplinore në kundërshtim me nenin 30 të Rregullores së brendshme të institucionit nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 192-200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1Rekomandimi:** Nga ana e Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: që punësimi i administratorëve të kryhet me një procedurë konkurrimi të hapur dhe në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës; që gjatë dhënies së masave disiplinore, të respektohet procedura administrative duke i garantuar të drejtën e subjektit për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar; që administratorët dhe ndihmës administratorët, të njihen me formularin përkatës të vlerësimit të performancës dhe ky i fundit të jetë pjesë e dosjeve të personelit. Gjithashtu, të merren masa për plotësimin dhe përditësimin e librezave të punës, si dhe për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me punonjësit që arrijnë moshën për dalje në pension pleqërie.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi administrimin dhe destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara konstatohet se: Përgjatë viteve 2017-2020, nuk është marrë asnjë vendim për destinacionin e pasurive të luajtshme të sekuestruara apo të konfiskuara. Me formatimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, prej datës 20.10.2020- 31.12.2022, janë marrë vendime për destinimin dhe shitjen e pasurive të luajtshme si në vijim:

- Përgjatë vitit 2021 i janë dhënë institucioneve publike 20 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 35,193,750 lekë.

- Përgjatë vitit 2022 i janë dhënë institucioneve publike 37 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 31,646,590 lekë. Me vendim të KNMKKO, janë shitur 10 automjete të konfiskuara me një vlerë të përafërt prej 1,030,800 lekë.

Pasuritë e luajtshme (automjetet) të sekuestruara, të cilat kanë një vlerë të konsiderueshme dhe që për to nuk është marrë asnjë vendim destinimi, jo vetëm që amortizohen me kohën, por janë rënduar edhe me shpenzimet e pagave të administratorëve të pasurive, duke u rënë vlera e tyre, në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 të nenit 21, të ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar.

Si konkluzion, administrimi i pasurive të luajtshme për periudhën 2017-2022 ka rritur koston e administrimit, duke ndikuar negativisht dhe në buxhetin e shtetit, krahas mungesës së efektivitetit në luftën kundër krimin të organizuar. Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga përgjegjësi i sektorit të marrëdhënieve me institucionet, çështjeve juridike dhe provave materiale të AAPSK-së, gjendja e automjeteve të marra në dorëzim nga administratorët deri më datë 31.12.2022 rezulton si vijon: 23 automjete të konfiskuara dhe 80 automjete të sekuestruara. Ndërkohë, sipas përgjegjësit të magazinës gjendja e automjeteve deri më datë 31.12.2022 rezulton: **79** automjete të sekuestruara/konfiskuara të magazinuara. Pra, 24 automjete nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga administratorët në ambientet magazinuese të AAPSK-së, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 20, të ligjit 34/2014, I ndryshuar dhe pikën 7, të nenit 14, të Rregullores së Brendshme të AAPSK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 64-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1Rekomandimi:** Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për shitjen e pasurive të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme, ose dalin jashtë përdorimit, duke respektuar parimin e mirëadministrimit, si edhe shmangien e shpërdorimit të tyre.

-për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurive të luajtshme dhe provave materiale në administrim me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre.

-dorëzimin e pasurive të luajshme në mjediset e caktuara magazinuese.  
-nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mosdorëzimin e automjeteve në ambientet magazinuese.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi zbatimin e tjetërsimit/shitjes së pasurive të konfiskuara me vendim gjykatë, përgatitjes së dokumentacionit, respektimit të procedurave të vlerësimit dhe verifikimit të arkëtimit të vlerave nga shitja, për periudhën 01.10.2017-31.12.2022, u konstatuan problematikat si në vijim:

-AAPSK dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike nuk kanë lidhur kontratë me fituesin e ankandit të pasurisë së paluajshme “tokë arë”, me sipërfaqe 745 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 177/27, Zona Kadastrale 2375, vol. 4, faqe 8, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Njësia Administrative Ishëm, në kundërshtim me pikën 17 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009”.

-Për 3 (tre) pasuri konkretisht për: pasurinë e luajshme “Asete të Shoqërisë A.”, pasurinë e paluajshme “Garazh”, me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup> me nr. Pasurie 505/316-G4, Zona Kadastrale 2460, me vendndodhje në Linzë, Tiranë; pasurinë e paluajshme “apartament”, me sipërfaqe 51.70 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 2/162+1-1/3, Zona Kadastrale 8350, me vendndodhje në Tiranë, AAPSK dhe Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk kanë lidhur kontratë me blerësit, veprim ky në kundërshtim me pikën 26, kreu V, të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.

-Procesverbali i dorëzimit për shitjen e pasurisë së paluajshme “Bar Restorant Hotel A.”, i mbajtur në datë 07.03.2023 është dorëzuar rreth 1 muaj jashtë afateve të përcaktuara në pikën 26, kreu V, të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, administratorët e pasurive pasi përgatisin raportin tekniko-financiar për ta dorëzuar në Komitetin Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, nuk përgatisin procedurat për tjetërsimin e pasurive, në kundërshtim me pikën ç, neni 13, i Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar.

Për pasuritë e shitura, nga ana e administratorëve nuk janë përllogaritur detyrime të mbartura nga pasuritë e konfiskuara me vendim gjykatë, veprim ky në kundërshtim me pikën 28 të VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.8 faqe 127-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa:

-në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike për dorëzimin e objekteve të shitura;

-të hartojë të gjitha shkresat zyrtare dhe të mbajë korrespondencë me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për administrimin, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore.

-të realizojë ndarjen e fondit të të ardhurave nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi t’u zbriten detyrimet.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** KNMKKO, sipas Vendimit nr. 09, datë 27.01.2021, ka vendosur të financojë nga Fondi i Posaçëm “Q. K. P. V T.” për projektin “Rehabilitimi dhe ....”, në shumën e 3,400,000 lekë. Midis AAPSK-së dhe “Q. K. P. V T.” është lidhur kontrata nr. 684, datë 26.02.2021 dhe me urdhër pagesën e datës 22.04.2021, subjekti përfitues ka marrë pagesën paraprake prej 50% të fondit, në shumën 1,700,000 lekë. Nga auditimi rezulton se, me shkresën nr. 130 prot., datë 15.12.201 “Q. K. P. V T.” ka raportuar mbi planin e veprimit për projektin

ku njofton se, disa nga zërat e projektit kanë mbetur pa u realizuar dhe në vijim me shkresën nr. 737/3, datë 28.03.2022, ka kërkuar shtyrje afati, pasi nuk ka hapësira fizike për realizimin e disa zërave të projektit duke qenë se janë në pritje të ndërtimit të një godine të re, ndërtimi i së cilës nuk është në kontrollin e tyre. Me Urdhër Pagesën nr. 164, datë 19.09.2022, AAPSK i ka kaluar Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit dhe vlerën prej 500,000 lekë. Subjekti përfitues nuk ka raportuar pranë AAPSK në tejkallim të afateve të parashikuara, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”, pika 18 e nenit 10 të kontratës nr. 684, datë 26.02.2021.

Me shkresën nr. 1488, datë 03.05.2023 AAPSK ka kërkuar raportim nga Qendra për vijueshmërinë e realizimit të projektit, e cila me shkresën nr. 78 prot., ka raportuar se nga shuma e akorduar nga ana e AAPSK-së prej 500.000 lekë, kanë arritur të realizojnë aktivitete në vlerën 310,000 lekë, diferenca prej 190,000 lekë është ende zë i pa-shpenzuar. Ky projekt ka vonesa të konsiderueshme në realizimin e plotë të tij, si në afat ashtu dhe në zërat e parashikuar, në kundërshtim me nenin 10 dhe 12 të kontratës nr. 684 prot., datë 26.02.2021.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.9 faqe 136-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1Rekomandimi:** Të ndërpritet disbursimi i kështit të dytë të financimit për projektin “Rehabilitimi dhe fuqizimi i viktimave të trafikimit nëpërmjet aktiviteteve informuese, kreative, okupacionale dhe argëtuese”, pa administruar dokumentacionin justifikues për realizimin e zërave të fazës së parë, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura dhe dokumentacionit përbërës, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur për dorëzimin e pasurive të revokuara me vendim gjyqate, për periudhën objekt auditimi, u konstatuan parregullsi, veprime dhe mosveprime, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht si vijon:

- Procesverbalet e mbajtura nga administratorët AAPSK-së me pronarët e pasurive, për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimeve gjyqësore nr. 18, datë 21.09.2020, nr. 150, datë 12.07.2021, nr. 800 (62-21-5904), datë 01.12.2021, nr. 133, datë 02.06.2021, nr. 90 datë 16.07.2021, rezultojnë në tejkallim të afateve të përcaktuara në ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar, neni 22;

-Procesverbalet e mbajtura nga administratorët AAPSK-së me pronarët e pasurive, për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimeve gjyqësore nr. 24, datë 29.01.2019 dhe nr. 5, datë 16.03.2018 rezultojnë në tejkallim të afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, neni 28/2;

- Nga ana e administratorëve të AAPSK-së nuk është ankimuar vendimi gjyqësor nr. 90, datë 16.07.2021 i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dispozitën në lidhje me shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e parapaguara të pasurive objekt gjykimi, por është vepruar në kundërshtim të tij, duke mos përmbushur përcaktimin që: *Shpenzimet procedurale të këtij gjykimi dhe shpenzimet e parapaguara që lidhen me pasuritë objekt gjykimi, i mbeten shtetit, sikurse dhe janë kryer.*

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.7 faqe 117-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1Rekomandimi:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në çdo rast, kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, të kërkojë plotësim vendimi, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit të bëhet brenda afateve në përputhje me kërkesat e akteve ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të 112 kontratave të qirave për periudhën 01.10.2017-31.12.2022 u konstatua se:

-1 kontratë qiraje është lidhur në kundërshtim me nenin 21/a, Kreun III të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, konkretisht kontrata e qirasë nr. 694, datë 04.07.2018 lidhur midis AAPSK-së, përfaqësuar nga Kryeadministratori dhe Shoqërisë “S. Q.P. R.” me përfaqësues 2 administratorë të AAPSK-së, me afat 04.07.2018-03.01.2019 dhe vlerë mujore 121,580 lekë.

-për 77 kontrata qiraje, pagesat e qirasë janë kryer pas datës 5 të çdo muaji, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të kontratave të qirasë ku citohet se: pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji, si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

-për 6 kontrata qiraje çmimi i vendosur në kontratë nuk përkon me çmimin e vendosur nga komisioni në procesverbalin për vlerësimin e çmimit të tregut, pasi në 4 raste çmimi i kontratës rezulton më i lartë se çmimi në procesverbal, në 1 rast më i ulët dhe në 1 rast tjetër komisioni në procesverbal nuk është shprehur me çmim fiks.

-4 kontrata qiraje janë zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë dhe qiramarrësit nuk kanë paguar penaltetin në vlerën 590,730 lekë, në kundërshtim me pikën 10.2 të kontratës së qirasë ku citohet se: “qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penaltitet që është sa çmimi mujor i qirasë”.

-Është lidhur 1 kontratë qiraje, konkretisht kontrata nr. 3533, datë 15.12.2022, me çmim qiraje 25,000 lekë/muaj bruto sipas pikës 5.1 të saj, ndërkohë që në pikën 5.2 citon se: çmimi i qirasë do të jetë 30,000 lekë/muaj, në momentin që qiramarrësi do të përfitoj bonusin e qirasë nga Bashkia e Tiranës, duke vendosur kusht një ngjarje jo të sigurtë të së ardhmes.

-Për 2 pasuri, konkretisht për pasurinë nr. 35/143 dhe pasurinë nr. 23/27-T Kryeadministratori nuk ka nxjerrë Urdhër “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara”, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 19 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”. Gjithashtu, nga ana e administratorëve nuk është kryer studim fizibiliteti për pasuritë e marra në administrim dhe nuk ia kanë paraqitur atë kryeadministratorit, me qëllim marrjen e vendimit përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë”, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 19 të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.

-Çmimi i përcaktuar për kontratën e qirasë nr. 1652, datë 24.05.2021 dhe kontratën nr. 1727, datë 01.06.2021 rezulton në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave, për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” i ndryshuar.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 1498, datë 06.05.2021 rezulton se mungon procedura e ndjekur për dhënien e pasurisë me qira, urdhri i brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e sekuestruara” dhe procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut, duke krijuar hapsirë për abuzim në lidhje me çmimin e vendosur në kontratë dhe si rrjedhojë dhe në mirëadministrimin e pasurive.

-Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për pasurinë me vetëdeklarim me nr. 8420 dhe nr. 9509 prot., datë 23.11.2006, Nj.Vendore Durrës, me deklaratë noteriale nr. 4733. Rep dhe nr. 1677 Kol, datë 20.12.2019, nuk është kontraktuar ekspert i pasurive të paluajtshme për të përcaktuar sipërfaqen totale dhe veç e veç për çdo hapësirë të shfrytëzueshme, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 34/2019. Kryeadministratori i AAPSK-së i ka lidhur kontratat në kushtet kur për sipërfaqen e objektit nuk ka informacion nga ASHK-ja dhe as informacion të shprehur në vendimin gjyqësor nr. 68, datë 27.01.2021. Mungesa e përcaktimit të sipërfaqes së saktë ka sjellë pasoja në vlerësimin dhe përlllogaritjen e qirasë në përputhje me këtë të dhënë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 74-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga auditimi me qëllim shmangien e riskut në mirëfunksionimin e institucionit;

-që për shkeljet e konstatuara në kontratat e qirave, të verifikohen rast pas rasti pagesat si të detyrimeve ashtu dhe të penalteteve dhe në vijim për të gjitha rastet e klasifikuara me detyrime të papaguara të kërkohet arkëtimi i vlerave, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative.

-për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, me qëllim rritjen e të ardhurave të përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluatjshme.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të ardhurat/shpenzimet e veprimtarisë dhe me burim buxhetin e shtetit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara u konstatua se, në raportimet e AAPSK-së mbi të ardhurat janë përfshirë edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit për të mbuluar shpenzimet, që nuk përfaqësojnë të ardhura nga veprimtaria kryesore e tyre, duke i mbivlerësuar në këtë mënyrë këto të fundit.

Nisur nga testimet e KLSH-së mbi raportimet e AAPSK-së, të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (pa të ardhurat nga buxheti i shtetit) janë konsiderueshëm më të ulëta se shpenzimet, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë në shumën 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në shumën 298,044 mijë lekë, me diferencë prej 120,686 mijë lekë, e cila përbën kosto për buxhetin e shtetit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 74-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për një analizë të faktorëve, që kanë impakt negativ në realizimin e të ardhurave dhe për një planifikim të kujdesshëm të shpenzimeve që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

-për shfrytëzimin dhe rritjen e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara aty ku është e mundur, me qëllim administrimin me eficiencë, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2016 deri 31.09.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 185, datë 22.12.2017, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 999/7 prot., datë 26.12.2017, rezulton se: Janë lënë gjithsej 10 rekomandime masa organizative.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është konstatuar se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:

-Janë pranuar 9 masa organizative dhe janë realizuar 7. Nuk janë zbatuar plotësisht 2 masa, konkretisht masa nr. 6 dhe nr. 7, për të cilat është kërkuar zbatimi i plotë i tyre brenda 4-mujorit të parë të vitit 2019 dhe raportimi mbi ecurinë e tyre brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 1219/31 prot., datë 21.12.2018.

Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me shkresën me nr. 275 prot., datë 26.03.2019 është dërguar statusi i zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6-mujor, nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e ligjit nr. 154/2014. Nga auditimi mbi zbatimin e tyre, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të 2 rekomandimeve rezulton: të pranuar dhe pjesërisht të zbatuara.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



**13.1Rekomandimi:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masat e nevojshme me qëllim zbatimin e dy rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht të zbatuara.

**Brenda vitit 2023**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përgatitjen e pasqyrave financiare konstatohet se: Llogaritja e amortizimit vjetor për përgatitjen e pasqyrave financiare të periudhës objekt auditimi 2017-2021 është bërë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 36 të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, konkretisht:

-Për ndërtesat (Ilog. 212) është llogaritur amortizim në masën 1% të kostos historike ndërkohë, që duhet të llogaritej në masën 5% të vlerës së mbetur;

-Për inventarin ekonomik (Ilog. 218) është llogaritur në masën rreth 0.3% të kostos historike për pajisjet me afat të gjatë përdorimi ndërkohë që duhet të ishin llogaritur në masën 5% të vlerës së mbetur. Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni janë amortizuar me 25% të vlerës historike ndërkohë që duhet të ishin amortizuar mbi bazë grupimi me normën 25% të vlerës së mbetur;

-Për instalime pajisje (Ilog. 214) është llogaritur amortizimi në masën 6% të kostos historike ndërkohë që duhet të llogaritej në masën 5% të vlerës së mbetur.

Për vitin 2020, gjithashtu se për shkak të ristrukturimit, nga ana e AAPSK-së janë përgatitur 2 raportime financiare, konkretisht:

*-për periudhën 01.01.2020-31.11.2020, periudhë e cila ka qenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.*

*-për periudhën 01.12.2020-31.12.2020, periudhë në të cilën AAPSK ka kaluar në varësi të Ministrisë së Brendshme.*

Nga auditimi konstatohet se klasa e AAM (ndërtesa e konstruksione, instalime teknike, makineri e pajisje, mjete transporti, inventar ekonomik) paraqitet e njëjtë si në datën 30.11.2020 ashtu dhe në datën 31.12.2020, duke mos llogaritur saktë amortizimin me bazë mujore, si rrjedhojë as paraqitjen e fragmentizuar në veprimet rregulluese dhe të mbylljes së pasqyrave financiare.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.3 faqe 171-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për rishikimin e gjithë veprimeve korrigjuese me qëllim paraqitjen e saktë dhe të drejtë të vlerave të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit fizik të Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK-së u konstatua se:

-Për vitin 2018, 2019 dhe 2021 nuk ka dalë urdhër dhe si rrjedhojë nuk është kryer Inventarizimi fizik i Pronave dhe Llogarive në Administrim të AAPSK, duke sjellë risk të humbjes apo tjetërsimit të tyre, veprim ky në kundërshtim me pikën 26 dhe 28 të kreut III, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Për vitin 2020 nga ana e Kryeadministratorit është nxjerrë Urdhri nr. 2190 datë 21.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të pronave dhe Llogarive në administrim të AAPSK-së. Bashkëlidhur dosjes së inventarizimit nuk gjendet asnjë dokumentacion, procesverbal apo relacion në lidhje me rezultatet e kontrollit fizik dhe inventarizimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, veprim ky në kundërshtim me Urdhrin nr. 2190 datë 21.12.2020.

Për vitin 2022 konstatohet se nuk është kryer një inventarizim i detajuar dhe i plotë në lidhje me pasuritë dhe llogaritë në administrim nga AAPSK, ndërsa në lidhje me procesin e inventarizimit të aktiveve dhe materialeve nuk është përgatitur relacion në përfundim të procesit të inventarizimit në kundërshtim me shkronjën c të pikës 85 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4 faqe 183-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1Rekomandimi:** Nga ana e Kryeadministratorit të AAPSK-së të merren masa për kryerjen e inventarizimit vjetor fizik të pronave dhe llogarive në administrim të AAPSK-së me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre.

Nga ana e komisioneve të inventarizimit të merren masa që në përfundim të procedurave të inventarizimit të përgatisin relacionin përmbledhës drejtuar Kryeadministratorit, me qëllim përcjelljen e rezultateve dhe problematikave të konstatuara.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesverbaleve të mbajtura nga Specialisti i Kontrollit fizik mbi monitorimin shkeljet e konstatuara dhe raportimin janë konstatuar problematikat si në vijim:

-Administratorët e pasurive nuk kanë bërë shpallje për dhënien me qira dhe nuk kanë marrë masa për ndërprerjen e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm në kundërshtim me pikën 11, 17 të nenit 14 të Rregullores së Brendshme të AAPSK-së.

-Në 2 njësi shërbimi, është konstatuar ushtrimi i aktivitetit pa paguar qira dhe nga ana e administratorit të pasuritë nuk është ndjekur procedura e rinovimit të kontratës së qirasë, në kundërshtim pikën 18, b/d të nenit 14 të Rregullores së Brendshme të AAPSK-së.

-Nga ana e administratorit të pasurisë është lidhur kontratë qiraje për një sipërfaqe që nuk përputhje me gjendjen faktike, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 19 të ligjit nr. 34/2019.

-Për shoqërinë tregtare “M. V. 2.” SHPK me NIPT L.....S në administrim të drejtpërdrejtë nga administratori i pasurisë vazhdon të jetë në listën e të punësuarve subjekti të cilit i është sekuestruar pasuria në kundërshtim me pikën 26, neni 14 të Rregulloren së Brendshme të AAPSK-së.

-Nga ana e Administratorit të pasurive, rezulton se dy prej automjeteve të sekuestruara sipas vendimit gjyqësor nr. 26 datë 25.03.2020 i janë lënë në ruajtje dhe ngarkim ekonomistit të shoqërisë “R. B. D.” me NIPT K.....B, në kundërshtim me pikën f, të nenit 9, pikën 1, 2 të nenit 14 dhe pikën 1 të nenit 20 të ligjit nr. 34/2019.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5 faqe 67-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1Rekomandimi:** Administratorët e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara së bashku me specialistin për kontrollin fizik dhe provave materiale të kryejnë kontrole periodike në terren dhe të raportojnë tek Kryeadministratori mbi çdo problematikë të hasur.

Kryeadministratori i AAPSK-së në cilësinë e titullarit të institucionit, të marrë masa për administratorët e pasurive të cilët shmangin detyrat dhe përgjegjësitë nga detyrat e tyre funksionale.

**Në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit u konstatua se për vitet 2017-2022 raporti i monitorimit të buxhetit nuk është shoqëruar me relacionin e tij dhe mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit, duke mos mundur një paraqitje të mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës.

Raportet e monitorimit të buxhetit janë përgatitur jo në përputhje me formatet e përcaktuara në paragrafin 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Nga auditimi i planifikimit të buxhetit u konstatuan mangësi, për periudhën objekt auditimi viti 2022, të lidhura kryesisht me fazën e parë, gjatë së cilës planifikimi rezulton pothuajse sa

dyfishi i planifikimit të vitit paraardhës, duke akorduar fonde shtesë të paargumentuar. Ky konstatim mbështetet dhe nga ndryshimi përgjatë vitit dhe nga realizimi përfundimtar, konkretisht:

-Shpenzimet për paga e shtesa (artikulli 600) janë çelur në vlerën 13,146 mijë lekë, nga 7,381 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 78% më pak; Janë pakësuar gjatë vitit me 3,000 mijë lekë ose 22.8% krahasuar me planin;

Janë realizuar në vlerë 10,135 mijë lekë, pra 11 mijë lekë më pak se plani dhe 37,3% më pak se një vit më parë.

-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore (artikulli 601) janë çelur në vlerën 2,195 mijë lekë nga 1,236 mijë lekë realizuar një vit më parë apo 77,6% më shumë;

Janë realizuar në vlerën 1,690 mijë lekë, pra 23% më pak se plani fillestar dhe 36,7% më pak se realizimi i një viti më parë.

Për sa më sipër konstatohet se nga ana e AAPSK-së rishikimet janë bërë vetëm për llogarinë 600 “Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli”, pa i reflektuar këto rishikime dhe në llogarinë 601 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore”, si llogari që ecin në përpjesëtim të drejtë me njëra tjetrën.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.1 faqe 143-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1Rekomandimi:** Nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AAPSK, të merren masa:

-për hartimin e raporteve të monitorimit, shoqëruar me relacionet shpjeguese në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, me qëllim përmirësimin e evidentimit të përdorimit të fondeve buxhetore.

-për planifikimin dhe përgatitjen e kërkesave buxhetore në përputhje me nevojat e Institucionit.

**Në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përputhshmërinë e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit të AAPSK u konstatua se:

-në 5 procedura prokurimi evidentohet diferencë e konsiderueshme ndërmjet fondit limit të përlllogaritur dhe vlerës së kontratës fituese.

-Dosjet e procedurave të prokurimit të audituara për vitet 2019-2021 nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin nr. 03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe 158-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1Rekomandimi:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për:

-argumentimin e fondit limit duke reflektuar nevojat reale të institucionit si dhe bazuar në përcaktimet ligjore për prokurimet;

-sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike me qëllim saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit në përputhje me ligjin e arkivave.

**Në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i vlerësimit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se nga AAPSK nuk është ngritur një sistem funksional dhe efektiv për menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm duke qenë se u evidentuan problematika të ndryshme, konkretisht:

1. Nga ana e AAPSK-së nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, veprim ky jo në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar. Gjithashtu nuk ka

autorizuar punonjës në rolin e Koordinatorit të riskut, jo në përputhje me pikën 3.2 të udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016.

2. Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e agjencisë, veprim ky jo në përputhje me pikën 3, neni 16 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

3. Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korrespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave, veprim ky jo në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

4. Nëpunësit e AAPSK zotërojnë informacion, por jo të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar në të gjitha elementët e tij.

Për sa më sipër evidentohet se nga ana e AAPSK-së nuk janë marr masa për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv për kontrollin e brendshëm.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.5 faqe 188-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrin masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm me qëllim ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi shpërndarjen dhe përballimin e shpenzimeve të administrimit ka rezultuar se, në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”, administratorë të ndryshëm krijojnë shpërndarje të ndryshme me subjektivitet dhe në shkelle të parimit të proporcionalitetit. Konkretisht, disa administratorë e shpërndajnë këtë zë shpenzimi si në kartelat e pasurive të luajshme ashtu edhe në ato të paluajshme, disa të tjerë vetëm tek pasuritë e paluajshme. Gjithashtu, në rastet e shpërndarjes midis kartelave të pasurive të paluajshme, kjo shpërndarje është kryer në përpjesëtim me numrin e pasurive pa i'u referuar vlerës përkatëse të pasurisë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 201-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandimi:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të ngrejë një grup pune për analizimin e situatës dhe më pas të përcaktojë kritere të qarta lidhur me shpërndarjen e zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për periudhën objekt auditimi, rezulton se janë financuar 10 projekte, me vlerë prej 93,403,412 lekë, nga të cilat u audituan 4 projekte, në vlerën 12,960,000 lekë.

Nga auditimi mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar (KNMKKO) konstatohet se:

-KNMKKO, sipas Vendimit nr. 11, datë 27.01.2021, ka vendosur të financojë nga Fondi i Posaçëm subjektin Fondacioni A. C. I. “C.”, për projektin “Rehabilitimi dhe .....”, në shumën e 2,280,000 lekë. Midis AAPSK-së dhe Fondacionit “A. C. I.” (C.) është lidhur kontrata nr. 682, datë 26.02.2021 dhe me Urdhër Pagesën datë 22.04.2021, subjekti përfitues ka marrë pagesën paraprake prej 50% të fondit, në shumën 1,140,000 lekë. Rezulton se nga ana e fondacionit, në datë 25.06.2021, për realizimin e projektit është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën “P. I.”, në kundërshtim me nenin 9 të kontratës. Pavarësisht se ky fakt është evidentuar nga ana e komisionit të verifikimit me relacionin nr. 3091 prot., datë 10.11.2021, AAPSK nuk ka marrë

asnjë masë të mëtejshme për kthimin në buxhet të shumës së nënkontraktuar, veprim ky në kundërshtim me pikat 16 dhe 17 të kontratës.

-KNMKKO, sipas Vendimit nr. 06, datë 27.01.2021, ka vendosur të financojë nga Fondi i Posaçëm fondacionin “G.”, për projektin “Për rehabilitimin e ....”, në shumën 5,000,000 lekë. Midis AAPSK-së dhe subjektit “G.” është lidhur kontrata nr. 679, datë 26.02.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky fondacion në lidhje me këtë projekt rezulton se, nuk janë paraqitur kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore dhe dokumenti që vërteton se subjekti aplikues ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”, pika 9.

Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 679, datë 26.02.2021, rezulton se Fondacioni “G.” nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit financiar dhe përshkruar për shumën prej 2,500,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 374, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”, pika 18 dhe 19.

Nga auditimi i urdhër pagesave rezulton se, AAPSK ka derdhur në llogari të Fondacionit “G.” shumën prej 5,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 4 të kontratës që citon: “Pjesa prej 40% e fondit të posaçëm do të financohet pas miratimit të raportit afatmesëm (që përkon me gjysmën e periudhës së zbatimit të Projektit) dhe pjesa e mbetur prej 10% jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të raportit final”.

Për pjesën prej 50% të financimit, subjekti përfitues nuk ka përcjellë asnjë raportim financiar dhe përshkruar dhe nga AAPSK, në vijim nuk është marrë asnjë masë për kthimin në buxhet të vlerës prej 2,500,000 lekë, veprim ky në kundërshtim me nenet 16 dhe 17 të kontratës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.9 faqe 136-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,140,000 lekë, nga Fondacioni “A. C. I.” (C.)”, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 682, datë 26.02.2021 për projektin “Rehabilitimi dhe .....”;

-Të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,500,000 lekë, nga Fondacioni “G.” për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 679, datë 26.02.2021 për projektin “Për rehabilitimin e .....”.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura dhe dokumentacionit përbërës, pjesë e dosjeve si dhe praktikës së ndjekur për dorëzimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, për periudhën objekt auditimi, u konstatuan parregullsi, veprime dhe mosveprime, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht si vijon:

- Në lidhje me kthimin e pasurive të revokuara me vendim gjykate, nga ana e administratorëve të AAPSK-së janë dorëzuar pasuritë pa llogaritur dhe mbajtur paraprakisht shpenzimet e administrimit të bëra nga shteti, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me pikat 1, 2, 4 të nenit 20, pikat 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, dhe shkronjën “ë”, neni 26 kreu III, i Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar. Nga auditimi u përllogarit dëm shkaktuar buxhetit të shtetit në shumën 7,566,958 lekë, konkretisht:

1. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 3, datë 27.02.2018, nuk janë përllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 816,783 lekë.

2. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 1, datë 09.01.2019, nuk janë përllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 817,089 lekë.

3. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 7, datë 27.04.2018, nuk janë përllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 704,829 lekë.

4. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 8, datë 03.05.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 2,562,518 lekë.

5. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 5, datë 16.03.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 604,007 lekë.

6. Për kthimin e pasurive të revokuara sipas vendimit gjyqësor nr. 25, datë 19.11.2018, nuk janë përlllogaritur dhe mbajtur shpenzimet e administrimit në vlerën 2,061,732 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.7 faqe 117-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa që të kryhet verifikimi i të gjitha rasteve ku nuk janë mbajtur shpenzimet e administrimit dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, arkëtimi i vlerës prej 7,566,958 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

**I.** Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Ministrit të Brendshëm**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore si vijon:

#### **a) “Largim nga shërbimi civil”**

**1. Z. A.K.**, me detyrë Kryeadministrator për:

-Mospërmbushje të rëndë të detyrave, pasi në drejtimin dhe organizimin e veprimtarisë së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk ka arritur të zbatojë detyrimet dhe kompetencat ligjore, e rezultuar kjo në mangësitë e theksuara në mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

**II.** Mbështetur në nenin 15 shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; në nenin 11, kreu IV dhe nenit 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregulloren e Brendshme të AAPSK (Masat Disiplinore), si dhe në kontratën individuale të punës, **i rekomandojmë Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore si vijon:

#### **a) “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, për 5 (pesë) punonjës si më poshtë:**

**1. Z. A.B.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventualisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;

- Nuk ka marrë masa për krijimit e inventarit të brendshëm të dosjeve, çka mbart riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose te çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 15 si dhe ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Ka lejuar vendimmarrje nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros preventive, çka në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në menaxhimin apo administrimin e pasurive, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar...”, neni 16, pika 1, ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 19, pika 4;
- Nuk ka marrë masa për regjistrimin, sipas afateve ligjore, të bilancit vjetor kontabël, çka ndikon negativisht në transparencën e menaxhimit të subjektit dhe ekspozon këtë të fundit kundrejt sanksioneve administrative (gjoha) me efekt negativ financiar, në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 95, pika 3 (dh) si dhe ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 19, pika 4;
- Ka kryer shpenzime jo në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, çka ndikon negativisht në mirëpërdorim të fondeve, në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 2, pika b dhe neni 3, pika 2.
- Për problematikat e konstatuara në lidhje me revokimet e pasurive, veprime në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; pika e neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar;
- Ka lidhur kontratë qiraje të lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Kreu III, neni 21/a;
- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;
- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse;

(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## **2. Znj. B.I.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Ka kryer raportim të gabuar të gjendjes së ekzekutimit të vendimit, çka në ndikon negativisht në miradministrimin e pasurive sipas parimit të efektivitetit, efikasitetit, ekonomicitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 11, pika 2/(dh);
- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventualisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;
- Nuk ka marrë masa për krijimit e inventarit të brendshëm të dosjeve, çka mbart riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose te çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 15 si dhe ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Ka lejuar vendimmarrje nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros preventive, çka në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në menaxhimin apo administrimin e pasurive, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen

*e Krimin të Organizuar...”, neni 16, pika 1, ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 19, pika 4;*

- Nuk ka marrë masa për regjistrimin, sipas afateve ligjore, të bilancit vjetor kontabël, çka ndikon negativisht në transparencën e menaxhimit të subjektit dhe ekspozon këtë të fundit kundrejt sanksioneve administrative (gjyba) me efekt negativ financiar, në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 43, pika 3, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 95, pika 3 (dh) si dhe ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 19, pika 4;

- Për problematikat e konstatuara në lidhje me revokimet e pasurive, veprime në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; pika e neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar;

- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse;

*(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3. Z. E.B.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Nuk ka marrë në administrim të gjitha pasurive të specifikuara në vendimin e gjykatës duke u mbështetur në një vlerësim subjektiv të situatës, çka rrezikon, veç të tjera, humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestros preventive”, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 11, pika 2 (a, c) si dhe ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar...”, neni 16, pika 1;

- Ka vepruar jashtë afateve ligjorë (vonesë) në kryerjen e veprimeve të administrimit, çka përbëjnë një risk eventual (tjetërsim pasurie) për humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestros preventive”, duke ndikuar gjithashtu negativisht në administrimin e pasurisë, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 11, pika 2 (a, d) dhe neni 23, pika 2;

- Ka lejuar administrimin e pasurive të sekuestruara nga persona të cilët janë subjekt i vendimit të gjykatës, çka bën që pasuritë të administrohen formalisht "de jure" nga AAPSK por realisht ato administrohen "de facto" nga subjekti apo shtetasi të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 11, pika 2 (c);

- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventualisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;

- Nuk ka marrë masa për krijimit e inventarit të brendshëm të dosjeve, çka mbart riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 15 si dhe ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

- Ka lejuar vendimmarrje nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros preventive, çka në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në menaxhimin apo administrimin e pasurive, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar...”, neni 16, pika 1, ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 19, pika 4;



- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;
- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse;

(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4. Z. S.M.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Nuk ka marrë në administrim të gjitha pasurive të specifikuar në vendimin e gjykatës duke e justifikuar mosveprimin me një vlerësim subjektiv të situatës, çka rrezikon, veç të tjera, humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestrros preventive”, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 11, pika 2 (a, c) si dhe ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar...”, neni 16, pika 1;

- Ka vepruar jashtë afateve ligjorë (vonesë) në kryerjen e veprimeve të administrimit, çka përbëjnë një risk eventual (tjetërsim pasurie) për humbjen e qëllimit dhe efektit të instrumentit juridik “sekuestrros preventive”, duke ndikuar gjithashtu negativisht në administrimin e pasurisë, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 11, pika 2 (a, d) dhe neni 23, pika 2;

- Ka lejuar administrimin e pasurive të sekuestruara nga persona të cilët janë subjekt i vendimit të gjykatës, çka bën që pasuritë të administrohen formalisht "de jure" nga AAPSK por realisht ato administrohen "de facto" nga subjekti apo shtetasi të cilit i është bërë sekuestrimi sipas vendimit të gjykatës, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5, neni 11, pika 2 (c);

- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventualisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;

- Nuk ka marrë masa për krijimit e inventarit të brendshëm të dosjeve, çka mbart riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 15 si dhe ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

- Për problematikat e konstatuara në lidhje me revokimet e pasurive, veprime në kundërshtim me pikat: 1, 2, 4 të nenit 20, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; 1, 2, 3, 4, 5 të nenit 25, Kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar; pika e neni 26, kreu III, i Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar;

- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse;

(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5. Z. E.R.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Ka lidhur kontratë qiraje të lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Kreu III, neni 21/a;

- Ka lejuar vendimmarrje nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestrros preventive, çka në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në menaxhimin apo administrimin e

pasurive, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar...”, neni 16, pika 1, ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 5 dhe neni 19, pika 4;

- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventalisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;

- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse;

(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **b) “vërejtje me shkrim”, për 2 (dy) punonjës si më poshtë:**

**1. Znj. E.A.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventalisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;

- Nuk ka marrë masa për krijimit e inventarit të brendshëm të dosjeve, çka mbart riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 15 si dhe ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2. Znj. E.O.**, me detyrë administrator i pasurive pranë AAPSK, pasi:

- Nuk ka marrë masa për sigurimin e pasurisë, duke mos lidhur një kontratë sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, çka ekspozon eventalisht AAPSK-në dhe në të njëjtën kohë buxhetin e shtetit kundrejt një dëmi të konsiderueshëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, neni 18;

- Nuk ka marrë masa për krijimit e inventarit të brendshëm të dosjeve, çka mbart riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të administrimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 1371/1 prot., datë 07.06.2022 të AAPSK-së, neni 15 si dhe ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

- Administratori nuk aksesohet për të gjeneruar të dhënat e pasurive që ka në administrim, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 5, 6, 8 të VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;

- Ka administruar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave, të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AAPSK-së dhe kontratën përkatëse;

- Administratorja ka mbajtur procesverbalet me pronarët e pasurive, për kthimin e pasurive të revokuara, në tejkalim të afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10192, datë. 03.12.2009, i ndryshuar, neni 28/2.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 18-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## D.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi këta ish-punonjës aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion:

1. z. A.K., me detyrë Kryeadministrator pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për periudhën 01.10.2017 deri më 09.03.2021;
2. z. B.B., me detyrë Administrator pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për periudhën 01.10.2017 deri më 31.12.2022;
3. z. F.A., me detyrë ish Administrator pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara 01.10.2017 deri më 31.12.2022.

## E. TË TJERA

Për punonjësit e tjerë të cilësuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandojmë masa disiplinore pasi shkeljet e konstatuara pavarësisht se ekzistojnë, në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë dhënien e një mase disiplinore.

## V. ANEKSE

Aneksi nr.1

Automjete të Konfiskuara të dhëna Institucioneve Publike për vitin 2021			
Nr.	Emërtimi i Pasurisë	Vlera e përafërt e tregut	Institucioni Përfutues
1	AUDI A 6	700,000	AAPSK
2	BENZ	650,000	AAPSK
3	TOYOTA	1,500,000	Garda e Republikës
4	TOYOTA	650,000	Garda e Republikës
5	KAROTREC	Pa vlere (pa dokumente)	DPV Fier
6	MITSUBISHI	250,000	Bashkia Shkodër
7	BMV X5	550,000	Bashkia Peshkopi
8	VITO	350,000	DPV Tiranë
9	AUTOMJET BMË	950,000	Kontrolli i Lartë i Shtetit
10	RANGE ROVER	4,500,000	Dr.Shërbimeve Qeveritare
11	TOYOTA HILUX	1,350,000	Bashkia Elbasan
12	BENZ ML 350	1,300,000	Dr.Shërbimeve Qeveritare
13	VOLZVAGEN TUAREG	620,550	DVP Tiranë
14	VOLZVAGEN GOLF	900,000	A SH K
15	IVEÇO	3,100,000	Bashkia Berat
16	AUDI A8 BLIND	8,760,000	SPAK
17	BMV 730 D	1,250,000	KLGI
18	BMV 730D	1,500,000	Dr.Shërbimeve Qeveritare
19	LAND ROVER	4,453,200	Dr. Shërbimeve Mbeshtetëse DPPSH
20	AUDI A6	1,860,000	D PPPP
	VLERA TOTALE	<b>35,193,750</b>	<b>Lekë</b>

## Aneksi nr. 3

Automjete të konfiskuara në 31.12.2022							
Nr.	Emërtimi	Subjekti	Njësia	Sasia	Numri & data e vendimit	Data e marrjes në dorëzim	Vlera e përafërt e tregut
1	Autoveture Audi A 8 "Blind" A.....E	G.L	copë	1	142 / 30.12.2020	15.07.2020	1,815,000
2	Aut. Tip Ml targa A.....T	A.C	Cope	1	27 / 22.10.2020	27.06.2022	500,000
3	Aut. Tip Golf targa A.....U	N.B	Cope	1	27 / 22.10.2020	27.06.2022	150,000
4	Aut. Tip Audi targa A.....J	L.Q	Cope	1	27 / 22.10.2020	29.06.2022	450,000
5	Aut. Tip Audi me targa A.....D.	K.M	Cope	1	27 / 22.10.2020	25.07.2022	600,000
6	A.... 2011 SHPK Fier ASETË TE KONFISKUARA	A.APSK	Asete	1	24 / 29.01.2019	10.04.2019	2,100,000
7	Autoveture BMW A.....G	E.C	1	1	45 / 26.05.2020	07.07.2020	437,500
8	Autoveture Hyndai Tucson IBM7315	P.N	1	1	25 / 18.03.2020	14.04.2020	492,000
9	Autoveture Audi A.....B	E.A	1	1	24 / 18.03.2020	14.04.2020	738,000
10	Autoveture Volksëagen Pasat AA 066 DZ Viti 2001	G.P	1	1	200 / 26.11.2020	30.12.2020	309,400
11	Autoveture Humer Modeli H2 A.....Z ,viti 2005	A.P	1	1	232 / 30.12.2020	31.03.2021	15,000
12	Auto "Mercedes Benz" A.....E Viti1995	B.	Cope	1	10 / 15.02.2021	-	150,000
13	Benz-Mercedes A.....K	G.M	Cope	1	103 / 15.06.2022	02.09.2022	200,000
14	Aut" Phaeton" A.....R	A.K	Cope	1	102 / 09.07.2020	13.08.2020	700,000
15	Autovetur Toyota Rav 4 A.....Z	A.K	Cope	1	102 / 09.07.2020	28.01.2021	300,000
16	Auto. SIANGJONG A.....K	G.M	Cope	1	103 / 15.06.2022	25.11.2022	Proçes
17	Motocikletë AL 642	E.K	Cope	1	05 / 12.03.2021	10.01.2020	600,000
18	Audi A6 A.....G	M. S	Cope	1	148 / 09.07.2021	15.07.2022	skrap
19	Audi A3 A.....K	M. S	Cope	1	148 / 09.07.2021	15.07.2022	skrap
20	Rimorkio KOCH,ADR 424	A.M	Cope	1	17 / 25.06.2021	09.01.2020	100,000
21	Volksëagen A.....E	D.P	Cope	1	74 / 11.05.2022	22.12.2021	skrap
22	Automjet tip BMË 730D. Me targa A....C	B....	Cope	1	122 / 18.05.2021	22.12.2022	1,500,000
23	Autoveture Audi A6, me targë A....A,	K.D	Cope	1	224 / 30.12.2020	22.02.2022	1,100,000

Automjete të Konfiskuara të dhëna Institucioneve Publike për vitin 2022			
Nr.	Emërtimi i Pasurisë	Vlera e përafërt e tregut	Institucioni Perfitues
1	E TURAN	360,000	DPPSH
2	BMV	1,985,000	DPPSH
3	BMV	992,880	DPPSH
4	E CLAS	467,400	DPPSH
5	BENZ DAIMLER ML	500,000	DPPSH
6	MERCEDEZ E CLAS	620,555	DPPSH
7	NISAN	875,000	DPPSH
8	ML 320 CDI	750,000	DPPSH
9	E CLAS	868,000	DPPSH
10	X 5	800,000	SPAK
11	AUDI A 8	750,000	Ministria e Arsimit
12	PORCHE	2,500,000	DPPSH
13	AUDI	750,000	DPPSH
14	VOLVO	750,000	Mbështetja Vetqeverisja Vendore
15	BMV	2,214,000	Instituti i Ndërtimit
16	M BENZ	1,800,000	Mbikqyrja Policore
17	VOLZVAGEN	800,000	Mbikqyrja Policore
18	GOLF 5	370,000	Av.Shtetit
19	OPEL COMBO	309,250	Forcat Operacionale
20	M BENZ	430,500	Dibër
21	AUDI A 6	417,000	Q.Ekstremizmit
22	AUDI	1,230,000	AAPSK
23	E AMAROK	1,230,000	Bashkia Skrapar
24	M BENZ	800,000	Komisariati nr.1
25	MINI KUPER	492,000	Akademia e Sigurisë
26	AUDI A 5	650,000	Ministria e Financave
27	GOLFI 5	450,000	Spitali i Elbasanit
28	ML 320 CDI	700,000	Forcat Operacionale
29	AUTOBUS	3,000,000	DPPSH
30	AUDI	1,800,000	KLJG
31	MINIBUS	741,960	Drejtoria e Burgjeve
32	M BENZ	861,000	Prokuroria e Përgjithshme
33	M BENZ	300,000	Ministria e Financave
34	AUDI Q5	1,100,000	AAPSK
35	BENZ A CLAS	120,000	Drejtoria Vendore e Policisë
36	MERCEDEZ 203	650,000	DVP
37	MERCEDES 203	400,000	In.Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut
	VLERA TOTALE	<b>31,646,590</b>	Lekë

## Aneksi nr. 3

Automjete të sekuestruara në 31.12.2022							
Nr.	Emërtimi	Subjekti	Njësia	Sasia	Numri & data e vendimit	Data e marrjes në dorëzim	Vlera e përafërt e tregut
1	Automjet daimler Chrysler A....U FNSH	E.N	copë	1	33 / 30.03.2020	27.04.2020	372,330
2	Mjet lundrues Xhet sky	L.K	copë	1	177 / 27.10.2020	14.01.2021	5,000
3	Automjet, BMË, model 730 D, A...I, magazina e AAPSK	O.J	copë	1	147 / 29.09.2020	23.08.2021	
4	Automjeti me targë A....B Mercedes benc	A.C.	copë	1	19 / 31.07.2021	15.12.2021	840,000
5	Automjet "Ford Kuga" me targa A ....K, ngjyre e zezë,	A.C	copë	1	145 / 24.09.2020	10.09.2021	1,200,000
6	Autoveturë e markës "Toyota", Tipi "J12",	I.Z	copë	1	237 / 29.07.2021	3.12.2021	1,560,000
7	Automjet BMË, tipi 3D, vit 2012, me targë A....G	E.S	copë	1	9 / 27.06.2022	21.07.2022	1,200,000

8	"Mercedes-Benz", model G 63 AMG, targa A...Z	A.Gj	copë	1	22 / 27.07.2022	03.08.2022	15,210,000
9	"M-Benz", model GLE 400 d 4 MATIC Coupe, targa A...E	A.Gj	copë	1	22 / 27.07.2022	03.08.2022	5,850,000
10	"VOLKSEAGEN", model "GOLF", me targë A...S	A.Gj	copë	1	22 / 27.07.2022	03.08.2022	1,170,000
11	Auto "BM" ML CLASS A...K	C.	copë	1	62-2018-2885 / 31.05.2018	13.03.2019	4,500,000
12	Autoveture Benz Class C220 , Tr .....S. Viti I prodhimit 2000.	P. "B. P."	copë	1	V.nr.12 / 07.10.2010	01.01.2011	10,000
13	Autoveture Benz me targa. A...N	V. C	copë	1	V.nr 62-2018-2885	09.01.2020	800,000
14	1. Automjet tip BMË X5 30D me targa A...P	Z.T	copë	1	V.nr 117 / 23.07.2020	25.08.2020	1,625,000
15	1. Automjet Audi A4, me targe A...Y.	E.T	copë	1	V. nr 117 / 23.07.2020	25.08.2020	1,250,000
16	1. Automjet tip "Daimler Chrysler-B200 CDI , me targe AA	E.A	copë	1	23.07.2020	25.08.2020	500,000
17	Automjeti BMË -X5 targa A...X	E.B	copë	1	V.nr 208 / 12.09.2020	14.09.2021	1,800,000
18	Autoveture Toyota Targë A...D-me targa A...D, me Nr. Shasie SB.....",Dures	E.T	copë	1	V. nr 71 datë 29.01.2021	08.04.2021	350,000
19	Aut. Tip Ml targa A...T	A.C	copë	1	V.nr. 27 / 22.10.2020	27.06.2022	100,000
20	Aut. Tip Golf targa A...U	N.B	copë	1	V.nr. 27 / 22.10.2020	27.06.2022	150,000
21	Aut. Tip Audi targa A...J	L.Q	copë	1	V.nr. 27 / 22.10.2020	29.06.2022	550,000
22	Aut. Tip Audi me targa A...D.	K.M	copë	1	V.nr. 27 / 22.10.2020	25.07.2022	150,000
23	Makina benz me targa A...J	E.S	copë	1	03 / 07.02.2020	11.02.2020	2,500,000
24	Makina L. Rover me targa A...B	A.S	copë	1	03 / 07.02.2020	11.02.2020	4,500,000
25	Makina me targa A...B modeli 500 L,	E.S	copë	1	03 / 07.02.2020	05.06.2020	840,000
26	Automjet me targa A...J Mercedes benz	J.A	copë	1	151 / 01.10.2020	14.12.2020	600,000
27	Makine Audi me targa A...J	G.K	copë	1	112 / 20.07.2020	09.12.2020	600,000
28	Mercedes Benz S550V A...T	K.B	copë	1	26 / 25.03.2020	16.04.2020	1,200,000
29	Mjeti me targë A...B, Mercedes Benz,	M.F	copë	1	148 / 29.09.2021	22.07.2021	1,500,000
30	Mjeti me targë A...I, e markes BMW 730 D	A.Xh	copë	1	148 / 29.09.2021	16.09.2021	5,000,000
31	Autoveture Audi Q 7 A...G	O.J	1	1	21 / 12.03.2020	23.04.2020	2,460,000
32	Autoveture e markes Fiat ..... viti 2004	L.D	1	1	221 / 28.12.2020	27.03.2021	244,000
33	Autoveture transporti A...S viti 1994	L.H	1	1	72 / 29.01.2021	15.04.2021	3,000,000
34	Autoveture e markes Lancia A...I viti 2004	L.H	1	1	72 / 29.01.2021	15.04.2021	1,000,000
35	Autoveture Mercedes Benz Gle A...CG,Viti 2017	A.K	1	1	82 / 01.02.2021	26.08.2021	5,000
36	Autoveture Mercedes Benz CLK 200 A...0 PR Viti 2004	M.S	1	1	199 / 23.11.2020	17.09.2021	350,000
37	B41 Automjeti I llojit BMË, X6 me targa 0...E	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	3,375,000
38	Automjeti I llojit fuoristradë X3, me targa R...F	A.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	3,375,000
39	Automjeti I llojit DODGE, me targa A...I	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	3,375,000
40	Automjeti I llojit DODGE, me targa A...R	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	2,025,000
41	Automjeti I llojit Mitsubishi, ngjyrë gri, pa targa,	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	1,288,000
42	Automjeti I llojit ëolsvagen Tiguan me targa 0...H	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	1,996,064
43	Automjeti Land Rover model Defender me targa ...	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	5,175,750
44	Motocikletë tip BMË model R1200 me targa A...	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2019	4,118,000
45	Automjeti I llojit fuoristradë Mercedes Benz	C.M	copë	1	5 / 25.03.2019	10.09.2020	1,620,000
46	Automjet i markës Chrysler, me targa A...T	A.P	copë	1	63 / 25.01.2021	02.04.2021	1,000,000
47	Automjet tip Volkswagen Passat" targa A...E "	D.L	copë	1	Nr. 101 (64-2021-	07.12.2021.	600,000
48	Autoveture "TOYOTA RAV4" me targa A...M.	A.K	copë	1	182 / 26.10.2020	10.12.2020	400,000
49	Automjet i markës BMË G...D, me targë A...P	R.Z	copë	1	49/233 / 30.12.2020	12.03.2021	300,000
50	Volkswagen A...J	E.T	copë	1	178 / 28.10.20	11.05.21	225,820
51	Mercedes Benz, me targë A...R	M.T	copë	1	178 / 28.10.20	12.06.21	550,000
52	Linkoln A...B	G.T	copë	1	178 / 28.10.20	12.04.21	1,539,125
53	Auto "Volkswagen Tuareg" A...T	D.H	copë	1	53 / 10.06.2020	29.06.2020	500,000
54	Autovetur "Ford Fokus"	I.O	copë	1	119 / 03.08.2020	20.01.2021	25,000
55	Ssangyong, Rexton, A...I	I.O	copë	1	119 / 03.08.2020	20.01.2021	350,000
56	Auto. "Range Rover" A...R	E. X	copë	1	219 / 28.12.2020	16.02.2021	3,000,000
57	Auto. AA390 BK, Kia	G.M	copë	1	149 / 23.09.2020	16/04/2021	300,000
58	Motorri uji	F.S	copë	1	13 / 09.05.2021	14.07.2021	2,000,000
59	Auto. Mercedes Benz A...N	F.S	copë	1	13 / 09.05.2021	12.07.2021	1,107,000
60	Auto. GMC A...D	F.S	copë	1	13 / 09.05.2021	12.07.2021	24,000,000
61	Skaf I bardhë	K.B	copë	1	Procedim 69, viti 2022	13.04.2022	Proces
62	Land Rover	K.B	copë	2	Procedim 69, viti 2022	13.04.2022	Proces
63	Mjeti me targa A...B.tip Mercedes Benz	A. C	copë	1	48/231 / 20.01.2021	04.04.2021	315,000
64	Mjeti me targa A...O. tip, EOLSEAGEN PASSAT	A. C	copë	1	48/231 / 20.01.2021	04.04.2021	340,000
65	Autoveture Alfa Romeo A...L	R. X	copë	1	235 / 31.12.2020	19.05.2021	1,850,000
66	Autoveture Mercedes Bens me targa A...H	A.P	copë	1	84 / 08.02.2021	10.06.2021	2,300,000
67	Autoveture tipi Smart me targe A...B	R.Xh	copë	1	235 / 31.12.2020	19.05.2021	900,000
68	Autoveture tip Suzuki me targe A...	R.Xh	copë	1	235 / 31.12.2020	19.05.2021	600,000
69	Autoveture tip Smart me targe A...S	R.Xh	copë	1	235 / 31.12.2020	19.05.2021	900,000
70	Autoveture tip Porsche me targe A...Z	R.Xh	copë	1	235 / 31.12.2020	19.05.2021	3,100,000
71	Motorri uji marka Kahësaki I emertuar Almond	R.Xh	copë	1	235 / 31.12.2020	19.05.2021	900,000
72	Autoveture tip. Peugeot me targe A...O	R. Xh	copë	1	235 / 31.12.2020	27.08.2021	350,000
73	Autoveture Daimler Chrysler me targe A...B	A.P	copë	1	84 / 08.02.2021	19.07.2021	480,000
74	Autoveture BMË me targe A...S	A.P	copë	1	84 / 08.02.2021	19.07.2021	325,000
75	Autoveture Range Rover me targe A...P	A.P	copë	1	84 / 08.02.2021	19.07.2021	900,000
76	Autoveture BMË me targe A...J	A.P	copë	1	84 / 08.02.2021	19.07.2021	1,600,000
77	karoceri A...S ; AGR 471	Z.M	copë	1	184 / 28.10.2020	30.12.2020	309,400
78	Autobuz A...L, merced. Benc	Z.M	copë	1	184 / 28.10.2020	30.12.2020	618,800
79	Autobuz A...Z, merced. Benc	Z.M	copë	1	184 / 28.10.2020	30.12.2020	928,200
80	Benc me Targe A...M	XH.Sh	copë	1	29 / 07.11.2021	07.01.2022	850,000

## VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit është dhe dokumentacioni mbajtur si më poshtë:

### a. Akt konstatime:

-Akt konstatimi nr. 1 datë 09.06.2023, "Mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës me stafin e punësuar me kontratë "administratorët";

- Akt konstatimi nr. 2 datë 09.06.2023, “Mbi vendimmarrjen dhe procedurat e ndjekura nga administratorët në lidhje me dokumentacionin dhe të dhënat e regjistruara pranë QKB-së në funksion të administrimit të drejtpërdrejtë të shoqërive tregtare”;
- Akt konstatimi nr. 3 datë 09.06.2023, “Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për administrimin e aseteve të marra në dorëzim dhe mënyra e manaxhimit të tyre nga administratorët”;
- Akt konstatimi nr. 4 datë 09.06.2023, “Mbi shpërndarjen dhe përballimin e shpenzimeve të administrimit që lindin nga pagesa e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës”;
- Akt konstatimi nr. 5 datë 09.06.2023, “Mbi zbatimin e procedurave të dhënies me qira të objekteve, dhënies në përdorim dhe kalimi në pronësi institucioneve shtetërore”;
- Akt konstatimi nr. 6 datë 09.06.2023, “Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për dorëzimin e pasurive të revokuara”;
- Akt konstatimi nr. 7 datë 09.06.2023, “Mbi procedurat, afatet dhe raportimin për projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm me Vendim të KNMKKO”;
- Akt konstatimi nr. 8 datë 09.06.2023, “Mbi procedurat për tjetërsimin/shitjen e pasurive të konfiskuara me vendim gjykatë”;
- Akt konstatimi nr. 9 datë 09.06.2023, “Mbi kontrollin fizik të pasurive në terren”;
- Akt konstatimi nr. 10 datë 09.06.2023 “Mbi përdorimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”;
- Akt konstatimi nr. 11 datë 09.06.2023, “Mbi administrimin e pasurive të luajtshme dhe llogarive bankare”;
- Akt konstatimi nr. 12 datë 09.06.2023, “Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit”;
- Akt konstatimi nr. 13 datë 09.06.2023, “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për procedurat e prokurimit”;
- Akt konstatimi nr. 14 datë 09.06.2023, “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”;
- Akt konstatimi nr. 15 datë 09.06.2023, “Mbi auditimin e pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit”.

**b. Akt verifikime:**

- Akt verifikimi nr. 1 datë 09.06.2023, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm”.

**Shënim:** Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi, duhet t’u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**